

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI
PËR TREGTINË, TITUJT FINANCIARË
DHE SHËRBIMET FINANCIARE**

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2020

ISBN: 978-9928-01-112-1

Adresa:

Rruga “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 7926 datë 20.4.1995	Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare - <i>ndryshuar me ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996,</i> - <i>ndryshuar me dekretin 1631, datë 1.11.1996</i> - <i>ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997</i> - <i>ndryshuar me ligjin 8482, datë 10.5.1999</i> - <i>ndryshuar me ligjin 8885, datë 22.4.2002</i> - <i>ndryshuar me ligjin 9775, datë 12.7.2007</i> - <i>ndryshuar me ligjin 10 264, datë 8.4.2010</i> - <i>ndryshuar me ligjin 8/2016, datë 11.2.2016</i>	5
Udhëzim nr. 15 datë 2.5.2018	Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror	9
Ligj nr. 9572 datë 3.7.2006	Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare - <i>ndryshuar me ligjin 54/2014, datë 5.6.2014</i>	10
Ligj nr. 9879 datë 21.2.2008	Për titujt	28
Ligj nr.9901 datë 14.4.2008	Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare - <i>ndryshuar me ligjin nr. 10 475 datë 27.10.2011</i> - <i>ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 14.4.2008</i> - <i>ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, datë 2.10.2014</i>	72
VKM nr. 570 datë 3.10.2018	Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore	149
Udhëzim nr.69 datë 29.1.2009	Për procedurat e likuidimit të shoqërive shtetërore	150
Udhëzim nr.317/1 datë 4.9.2009	Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”	152
Udhëzim nr. 4557/1 datë 1.6.2017	Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., Tiranë	155
Ligj nr.10 198 datë 10.12.2009	Për sipërmarrjet e investimeve kolektive - <i>ndryshuar me ligjin nr. 36/2016, datë 31.3.2016</i>	156
Ligj nr.10 236 datë 18.2.2010	Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike	215
Ligj nr. 10 296 datë 8.7.2010	Për menaxhimin financiar dhe kontrollin - <i>ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015</i>	231

Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011	Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik - <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014</i> - <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 11, datë 6.5.2016</i> - <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 24, datë 7.12.2016</i>	246
Ligj nr. 48/2014 datë 24.4.2014	Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare - <i>ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.3.2015</i>	261
Ligj nr. 131/2015 datë 26.11.2015	Për Qendrën Kombëtare të Biznesit	267
Udhëzim nr. 883 datë 21.12.2018	Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre	274

LIGJ
Nr. 7926, datë 20.4.1995

PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE
NË SHOQËRI TREGTARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996; me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996; me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997; nr.8333, datë 23.4.1998; nr.8482, datë 10.5.1999; nr.8885, datë 22.4.2002; me ligjin nr.9775, datë 12.7.2007; me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010, me ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016)
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji, me termat vijuese:

a) “Ndërmarrje shtetërore”, që më poshtë do të quhen “ndërmarrje”, kuptohen gjithë personat juridikë publikë të themeluar sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1993 “Për ndërmarrjet shtetërore”.

b) “Shoqëri shtetërore”, që më poshtë do të quhen “shoqëri”, kuptohen gjithë personat juridikë publikë, të cilët do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe që do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 3

Të gjitha ndërmarrjet shtetërore do të transformohen në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Çdo ndërmarrje mund të transformohet në një ose disa shoqëri anonime ose me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar do të krijojnë këshill mbikëqyrës.

Neni 4

(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996; nr.8237, datë 1.9.1997; shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8482, datë 10.5.1999; shtuar pas fjalisë së parë me ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016)

Ministria e Ekonomisë është përfaqësuese e pronarit për pronën shtetërore. Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektro-energjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror.

Këshilli i Ministrave mund t'ia kalojë këtë të drejtë edhe organeve të qeverisjes vendore.

Ministria e Ekonomisë, përveç të drejtave që rrjedhin nga të qenët përfaqësues i pronarit shtetëror, kryen transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre, drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, nënshkruan kapitalin themeltar dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Ministritë, departamentet, drejtoritë a institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal, përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi.

Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët administrohet nga organi që ka bërë nënshkrimin e pjesës shtetërore të kapitalit, ose, kur kjo nuk është kryer, administrohet nga dikasteri a organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur varësinë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Transferimi i së drejtës së ortakut shtetëror në këto shoqëri (si kapitali i pjesës shtetërore etj.) bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave".

Neni 5

(Shfuqizuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996)

Neni 6

(Shtohet një paragraf me ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996; ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996)

Ministria e Privatizimeve drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Neni 7

(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9775, datë 12.7.2007)

Ministri i Privatizimeve ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar transformimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare.

Në rastet kur procedurat e privatizimit pengohen pa shkaqe të përligjura nga strukturat përgjegjëse të njësive të qeverisjes vendore apo të institucioneve qendrore, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i propozon organit ekzekutiv vendimmarrës të njësive të qeverisjes vendore apo titullarit të institucionit qendror marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës.

Neni 8

(Shtuar paragraf me ligjin nr.8099, datë 28.3.1996; ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996; ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997; ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.8333, datë 23.4.1998; ndryshuar me ligjin nr.8885, datë 22.4.2002; ndryshuar paragrafi i katërt me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010)

Organet drejtuese të shoqërive anonime janë:

- Këshilli mbikëqyrës,
- Drejtoria.

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3-9 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

Anëtarët e keshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore caktohen si më poshtë:

- a) 2/3 e numrit të anëtarëve caktohen nga përfaqësuesi i pronarit, për pronën shtetërore;

b) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministri i linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, për shoqërinë shtetërore përkatëse.

Drejtoria emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës kur për të bien dakord jo më pak se 2/3 e tij.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrje në këshillin mbikëqyrës dhe shpërblimet e jashtëzakonshme për shërbimet a detyrat që u besohen anëtarëve të këshillit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohet për atë kohë sa shteti do të jetë aksionar i vetëm".

Neni 9

Shoqëria që krijohet si pasojë e transformimit të ndërmarrjes, merr përsipër të gjitha detyrimet që ndërmarrja ka pasur përpara transformimit dhe përgjigjet ndaj të tretëve me pasurinë e saj.

Të gjitha kontratat e lidhura me të tretët nga ndërmarrja përpara transformimit mbeten në fuqi edhe për shoqërinë që krijohet.

Neni 10

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe për sa kohë që shteti do të jetë i vetmi aksionar ose ortak i shoqërive, organet drejtuese të ndërmarrjeve a shoqërive nuk kanë të drejtë të autorizojnë ose të kryejnë shitje të pasurive të paluajtshme dhe të makinerive e pajisjeve, të marrin hua dhe kredi, si dhe të krijojnë shoqëri të përbashkëta.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për ndërmarrjet që janë parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit".

Neni 11

Këshilli i Ministrave miraton statusin tip, aktet e tjera tip të themelimit si dhe kriteret e vlerësimit të kapitalit themeltar të shoqërive që do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve.

Neni 12

Shpenzimet për procesin e transformimit të ndërmarrjeve në shoqëri, si dhe regjistrimi i tyre sipas dispozitave në fuqi, përballohen nga vetë ndërmarrja.

Neni 13

Neni 191 dhe pika 4 e nenit 297 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregare", nuk zbatohen për shoqëritë shtetërore.

Neni 14

Nenet 94 dhe 95 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" shfuqizohen.

Neni 15

Ligji nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", do të ketë fuqi për sa kohë që ndërmarrjet nuk janë transformuar në shoqëri, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe.

Neni 16

Ky ligj nuk zbatohet për bankat shtetërore të nivelit të dytë dhe për institutet e sigurimeve shtetërore.

Neni 17

Të gjitha ndërmarrjet ekonomike me kapital tërësisht shtetëror që do të krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të themelohen e regjistrohen si shoqëri.

Neni 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Dispozitë e shtuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996 i miratuar me ligjin nr.8158, datë 7.11.1996.

Prona shtetërore që ka filluar procesin e privatizimit para hyrjes në fuqi të këtij dekreti vazhdon privatizimin pa ripërsëritur etapat e privatizimit që i ka kryer sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë kohë.

Për shoqëritë tregtare të regjistruara në gjykatë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, përfaqësues i pronarit për aksionet dhe pjesët e kapitalit shtetëror do të jetë Ministria e Ekonomisë, sipas përcaktimit të nenit 1.

Dispozitë e shtuar me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010 neni 2, e miratuar me dekretin nr.6522, datë 28.4.2010

Ngarkohen titullarët e ministrive që preken nga ky ligj që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të bëjnë ndryshimet në këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi më 15 maj 1995.

**Shpallur me dekretin nr.1090, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

UDHËZIM
Nr. 15, datë 2.5.2018

**MBI PROGRAMET E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHOQËRIVE TREGTARE
ME KAPITAL SHTETËROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me qëllim njësimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit të shoqërive ku ministria përgjegjëse për ekonominë, është përfaqësuese ligjore e pronarit shtetëror, miratohet udhëzimi që vijon:

I. Procesi i hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik

1. Programe të zhvillimit ekonomik hartojnë të gjitha shoqëritë publike me kapital shtetëror

2. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik të këtyre shoqërive bëhet për periodha 1-vjeçare, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre.

3. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, në strategjitë sektoriale përkatëse si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Hartimi i programeve vjetore të zhvillimit ekonomik, kryhet nga drejtoritë e shoqërive dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

5. Programet e zhvillimit ekonomik, së bashku me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive me kapital shtetëror përcillet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

6. Për shoqëritë strategjike, portet dhe shoqëritë që subvencionohen nga ministritë e linjës administrative, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës do të kërkohet mendimi i ministrive përkatëse. Projektprogrami i shoqëruar me vendimin e këshillit mbikëqyrës dhe prononcimin e ministrisë së linjës administrative do të përcillet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

7. Programi i zhvillimit në shoqëritë ku shteti zotëron mbi 50 për qind të paketës së aksioneve, shqyrtohen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve. Përfaqësuesi i autorizuar i aksionarit shtetëror në mbledhjen e Asamblesë, shpreh qëndrimin zyrtar përkatëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

8. Programet e zhvillimit ekonomik në shoqëritë ku shteti zotëron nën 50 për qind të paketës së aksioneve, shqyrtohen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve. Përfaqësuesi i autorizuar i aksionarit shtetëror në mbledhjen e asamblesë, shpreh qëndrimin zyrtar përkatës të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

II. Procedura e miratimit të programeve të zhvillimit

1. Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive me kapital shtetëror, miratohen përfundimisht nga ministria përgjegjëse për ekonominë, me cilësinë e pronarit të pronës shtetërore.

2. Praktika e projektprogramit që propozohet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë duhet të përmbajë:

- Tabelën me treguesit kryesorë të programit të zhvillimit, për vitin programues dhe parashikimin për dy vitet pasardhëse.

- Relacionin shpjegues të administratorit të shoqërisë, mbi projektprogramin ekonomik që propozojnë për miratim.

- Vendimin e Këshillit mbikëqyrës mbi projektprogramin ekonomik.

- Mendimi i ministrive të linjës administrative për shoqëritë e specifikuar në pikën 6 të këtij udhëzimi.

III. Afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda datës 30 tetor të çdo viti, u dërgon shoqërive udhëzimin metodik me treguesit kryesorë që duhet të përmbajë hartimi i programit të zhvillimit ekonomik për vitin pasardhës.

2. Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projektprogramet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrëse, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti.

3. Ministrinë që përfaqësojnë linjën adminis-trative të shoqërive strategjike, portretet dhe shoqëritë që subvencionohen nga këto ministri, pasi i shqyrtojnë programet e zhvillimit, formulojnë qëndrimet përkatëse për treguesit kryesorë të tyre, brenda datës 30 janar të çdo viti.

4. Drejtoria e administrimit të pronës shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, brenda muajit janar të çdo viti monitoron dhe shqyrton praktikën e projektprogrameve të zhvillimit ekonomik, të propozuara nga organet drejtuese të shoqërive.

5. Ministria përgjegjëse për ekonominë miraton projektprogramin e secilës shoqëri me pjesëmarrje mbi 50% kapital shtetëror, brenda muajit shkurt të çdo viti.

6. Për raste të veçanta, kur propozohen ndryshime në programin e miratuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë ndiqet e njëjta procedurë për miratimin e ndryshimit në programin e zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë. Nëse ndryshimet në programin ekonomik të zhvillimit, konsistojnë brenda zërave të miratuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë, miratimi i këtij ndryshimi bëhet vetëm me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Udhëzimi nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

LIGJ
Nr. 9572, datë 3.7.2006

PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që në vijim do të quhet “Autoriteti”.

Neni 2

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja:

- a) e tregut të titujve dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në tituj e që veprojnë në këtë treg;
- b) e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- c) e tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga institutet private të pensioneve vullnetare;
- ç) e veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare që mbikëqyren”.

KREU II

STATUSI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 3

Statusi i Autoritetit

(Ndryshuar paragrafi i parë, shtuar paragraf me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti është person juridik, publik, me qendër në Tiranë. Autoriteti është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet ndërhyrja në veprimtarinë e tij, e cila mund të cenojë pavarësinë e Autoritetit.

Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë akte, që janë rregulloret, rregullat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë e miratuara nga Bordi i Autoritetit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregulatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit.

Autoriteti, për veprimtarinë që ushtron, në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

Neni 4

Bordi i Autoritetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Organi vendimmarrës i Autoritetit është Bordi, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët, një kryetar, një drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, një nëndrejtor ekzekutiv dhe dy anëtarë të tjerë.

Neni 5

Kërkesat për t'u emëruar anëtar i Bordit

(Ndryshuar pika 2, fjalë në pikën 3, pika 7, shtuar paragraf pas pikës 7, ndryshuar paragrafi i parë pas pikës 7, ndryshuar fjalë në paragrafin e dytë pas pikës 7 me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit janë:

1. Shtetas shqiptarë.
2. Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.
3. Me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet në njërin nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:
 - a) financë-kontabilitet;
 - b) administrim i shoqërive tregtare;
 - c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;

- c) hartim legjislacioni;
- d) shkencë e aktuarëve;
- dh) sigurime shoqërore dhe pensione.
- 4. Me integritet moral dhe profesional.
- 5. Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.
- 6. Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.
- 7. Në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit persona, të cilët:

- a) në tre vitet e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;
- b) kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi;
- c) në tre vitet e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtori ekzekutiv i Autoritetit nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjetër me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore shkencore, apo pjesëmarrjes në organizata vendase apo ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit.

Kryetari dhe dy anëtarët e tjerë të Bordit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk lejohen të jenë anëtarë të më shumë se 1 bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Çdo anëtar i Bordit ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara në këtë nen.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi.

Kryetari emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pas një procedure për zgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, pas një procedure për zgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Ministrisë të Financave, pas një procedure për zgjedhëse.

Dy anëtarët e tjerë emërohen nga Kuvendi, me propozimin, përkatësisht, nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pas një procedure për zgjedhëse.

Kandidati i propozuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nuk mund të jetë anëtar i këtij Këshilli.

Neni 7

Mandati i anëtarëve të Bordit

(Ndryshuar paragrafi i parë dhe i katërt, shfuqizuar fjalia e dytë e paragrafit të dytë, ndryshuar fjalë në paragrafin e tretë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Mandati i çdo anëtari të Bordit është 5 vjet. Në rastet kur mandati i anëtarit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në çastin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, por jo më shumë se tre muaj. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit, Autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikën për zgjedhjen e anëtarit të ri.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mund të rizgjidhen për një mandat të dytë pas përfundimit të mandatit të tyre.

Në përfundim të mandatit, anëtari i Bordit nuk mund të punësohet për një periudhë trevjeçare apo të përfshihet në shërbime me pagesë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga ndonjëri prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.

Personi që ka qenë i emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv dhe i ka mbaruar mandati, pas largimit nga detyra, kur nuk është i punësuar, përfiton një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që ka pasur, kur ka qenë në detyrë. Në rast punësimi, kur paga që marrin është më e vogël se ajo e parashikuar në këtë paragraf, ata kompensohen deri në, por në asnjë rast mbi, nivelin e pagës së muajit të fundit të përfituar gjatë detyrës, brenda një viti nga dorëzimi i detyrës. Pagesat e kryera në favor të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, përballohen nga Autoriteti dhe parashikohen si pjesë e buxhetit të Autoritetit. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individi i riemëruar anëtar i Bordit, si dhe ai që është liruar nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 8.

Neni 8

Lirimi nga detyra i anëtarit të Bordit

Kuvendi vendos lirimin nga detyra të anëtarit të Bordit përpara afatit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 7 të këtij ligji, në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet fizikisht i paafte për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
- c) për shkak të rrethanave të reja nuk respektohen kërkesat e parashikuara në pikat 5 e 6 të paragrafit të parë të nenit 5, si dhe kushtet e parashikuara në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 5 të këtij ligji;
- ç) në rast të mungesës pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;
- d) gjatë ushtrimit të funksioneve vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;
- dh) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të tij si institucion i pavarur;
- e) humbet nënshtetësinë shqiptare.

Propozimi për lirimin nga detyrara të anëtarit të Bordit i paraqitet Kuvendit nga vetë Bordi ose nga secili prej institucioneve, që kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të Bordit, si dhe nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit. Në propozimin për largimin e anëtarit përcaktohen arsyet dhe provat në lidhje me rastin. Kuvendi mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit. Kuvendi, pas shqyrtimit, vendos lirimin ose jo nga detyra të anëtarit.

Në rast të lirimit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit përpara afatit, anëtari tjetër emërohet me të njëjtën procedurë, siç është emëruar anëtari që lirohet, për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet.

Neni 9

Struktura organizative, pagat dhe trajtimet e tjera të Autoritetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi përcakton strukturën organizative të Autoritetit, numrin e punonjësve, pagën, shpërblimet dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetës dhe të shëndetit dhe të tjera të ngjashme. Bordi, në përcaktimin e masës së pagës, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të administratës, bazohet në një metodologji të qartë, që merr

parasysh kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetin e rregullatorit financiar në Shqipëri dhe nevojat e vetë institucionit.

Autoriteti, mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punëmarrësit e tij.

Përcaktimet e bëra në dispozitat e ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, dhe çdo përcaktim tjetër ligjor, si edhe përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e këtyre dispozitave, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetin.

Neni 10

Mbledhjet e bordit

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe i gjashtë , ndryshuar fjalë në paragrafin e tretë dhe të katërt me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Mbledhjet e Bordit thirren me nismën e Kryetarit ose me kërkesën e secilit prej anëtarëve drejtuar Kryetarit të Bordit. Bordi mbledhet të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe vendosur për rendin e ditës.

Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari joekzekutiv më i vjetër në moshë.

Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë.

Vendimet e Bordit janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 3 anëtarë.

Në votim nuk lejohet abstenimi.

Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e marra në mbledhje nënshkruhen nga Kryetari dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Bordi miraton rregulloren për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Neni 11

Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

Bordi njofton publikisht politikat dhe praktikat që ndjek për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe arsyet e ndryshimit të tyre.

Politika që ndjek për zbatimin e dispozitave, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përfshijnë edhe mjetet e zgjedhura nga Autoriteti dhe të përdorura në mënyrë të pavarur prej tij, gjatë përmbushjes së objektivave të këtij ligji.

Autoriteti miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni.

Bordi miraton rregulloren për mënyrën dhe afatet e botimit të tyre, si dhe për hartimin dhe funksionimin e faqes së Autoritetit në internet.

KREU III

OBJEKTIVAT, KOMPETENCAT E AUTORITETIT DHE TË DREJTAT E BORDIT

Neni 12

Objektivat e Autoritetit

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, Autoriteti udhëhiqet nga këta objektiva:

1. Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar.

2. Nxjtja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyren.

3. Sigurimi i respektimit të ligjit.

Neni 13

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe në shkronjën "c" të pikës 2 me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti me strukturat e veta ka si objekt të veprimtarisë:

1. Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, nëpërmjet hartimit të akteve të Autoritetit, të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligjet e fushës, si dhe botimin e udhëzimeve e materialeve shpjeguese.

2. Sigurimin e mbikëqyrjes shtetërore mbi tregun e titujve, tregun e sigurimeve, skemat e pensioneve vullnetare dhe veprimtari të tjera financiare jobankare, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet në fuqi.

Në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, Autoriteti ka të drejta të plota për:

a) miratimin, lëshimin apo refuzimin e licencave për subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren;

b) vëzhgimin dhe organizimin e mbikëqyrjes së subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren. Subjektet, qofshin këta individë apo persona, fizikë ose juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e përmenduara në nenin 2 të këtij ligji, në vijim do të quhen "subjekte të mbikëqyrura".

c) ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve të Autoritetit, të dala në zbatim të tij e të ligjeve të fushës dhe të akteve të Autoritetit, të dala në zbatim të tyre dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Neni 14

Kompetencat e Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:

1. Miraton politikat e licencimit, të rregullimit dhe të mbikëqyrjes, për të nxitur zhvillimin e tregjeve financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

2. Miraton rregullat, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe udhëzues për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji e të legjislacionit në fuqi.

3. Miraton të gjitha raportet që dërgon Autoriteti në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

4. Miraton, refuzon, pezullon apo heq licencat ose autorizimet për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve në tregjet financiare që mbikëqyren, si dhe rregullat përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

5. Miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese për subjektet e mbikëqyrura.

6. Miraton standarde kontabël dhe format e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet e mbikëqyrura.

7. Miraton kodin e etikës, rregulloren e funksionimit të Bordit dhe rregulloret për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit, që nxirren në zbatim të këtij ligji.

8. Miraton strategjitë, politikat dhe rregulloret e administrimit të përgjithshëm të Autoritetit, politikën e investimit në depozitat bankare apo në titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë së Autoritetit.

9. Miraton rregulloren për krijimin, investimin dhe përdorimin e fondit të rezervës së Autoritetit.

10. Miraton strukturën organizative të Autoritetit dhe numrin e punonjësve si dhe përshkrimet e punës dhe ndarjet funksionale.

11. Miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve.

12. Miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit.

13. Miraton rregullat për përcaktimin e elementeve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

14. Miraton buxhetin e Autoritetit, llojet e shpenzimeve, si dhe alokimet e përdorimin e fondit të rezervës.

15. Miraton pasqyrat financiare të Autoritetit.

16. Emëron drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të Autoritetit.

17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.

18. Miraton nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit, të marrëveshjeve të shkëmbimit të informacionit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

19. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për vitin e mëparshëm, i cili paraqitet në Kuvend në muajin prill të çdo viti, së bashku me pasqyrat financiare të audituara.

20. Miraton raportin e mbikëqyrjes, ku paraqitet gjendja dhe perspektiva e tregjeve që mbikëqyren, i cili botohet në muajin korrik të çdo viti.

21. Vendos për masat e mbikëqyrjes dhe sanksionet ndaj subjekteve të mbikëqyrura.

22. Ushtron çdo kompetencë tjetër dhënë Autoritetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

Vendimet e marra janë objekt ankimi në gjykatë.

Vendimet e Bordit arsyetohen dhe publikohen në mënyrën e caktuar prej tij për publikimin e njoftimeve zyrtare.

Vendimet e Bordit me karakter individual i njoftohen menjëherë subjekteve të interesuara.

Neni 15

Kompetencat e Kryetarit të Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Kryetari i Bordit ka këto kompetenca:

1. Thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit.
2. Paraqet rendin e ditës.
3. Urdhëron ngritjen e komiteteve të kontrollit, objektin e punës, si dhe afatet për shqyrtimin e çështjes.
4. I propozon Bordit ngritjen e komiteteve këshillimore, me qëllim hartimin e politikave për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit.
5. Kompetenca të tjera, të akorduara me vendimmarrje të Bordit.

Neni 16

Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson Autoritetin.
2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.

3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.
 4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij.
 5. Nxjerr urdhra dhe udhëzime në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.
 6. Emëron dhe shkarkon punonjësit e Autoritetit.
 7. Shkëmben të dhëna me Bankën e Shqipërisë, me institucione e agjenci të tjera qeveritare, me autoritete dhe administrata vendore, me organizata jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari të lidhura me tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe me subjektet e mbikëqyrura.
 8. Bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë për inspektimin në bankat depozitare të veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.
 9. Kërkon nga Banka e Shqipërisë kryerjen e inspektimeve me objekt të caktuar në banka, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vënien në dispozicion të rezultateve të inspektimit.
 10. Përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me rregulloret e brendshme të Autoritetit.
- Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij.

Neni 17

Kompetencat e anëtarëve, që nuk kanë funksione ekzekutive

(Ndryshuar fjalë në fjalinë e parë të paragrafit të parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Tre anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione ekzekutive në Autoritet, kur kërkohet shqyrtimi i një çështjeje të veçantë, lidhur me mangësi apo shkelje të vërejtura gjatë veprimtarisë së Autoritetit dhe të strukturave të tij, funksionojnë si komitete kontrolli. Këta anëtarë shqyrtojnë dokumentacionin dhe përgatisin raporte të hollësishme, të cilat ia paaqesin Bordit. Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë.

Komiteti i kontrollit mund të emërojë njërin nga anëtarët e vet si raportues, i cili shqyrton apelimet dhe ankesat ndaj vendimeve të Bordit.

Raportuesi gëzon të gjitha të drejtat për të kryer inspektim të plotë rreth çështjes. Për vendimet e apeluara, raportuesi përgatit raporte të hollësishme dhe ia paraqet ato Bordit. Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë për rregullimin e gjendjes.

Bordi shqyrton raportin e paraqitur dhe vendos për masat e propozuara nëse ka të tilla.

Kuvendi vendos, nëse është e nevojshme, caktimin e auditit të jashtëm të Autoritetit.

Neni 18

Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit

(Ndryshuar fjalë në të gjithë nenin, ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Në ushtrimin e të drejtave të Bordit dhe të strukturave të tjera të Autoritetit, anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e ngarkuar për mbikëqyrjen gëzojnë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe me detyrën e ngarkuar, këto të drejta:

1. Kërkojnë nga subjektet e mbikëqyrura dhe subjektet e tjera, që kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve që rregullojnë tregjet e fushës, shpjegime me shkrim, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara dokumentesh, të dhëna, si dhe verifikojnë dokumentacionin dhe raportimet e bëra. Dokumentacioni dhe të dhënat e shkruara duhet të jenë në gjuhën shqipe.

2. Marrin të dhëna për fondet dhe asetet, përfshirë titujt, në pronësi të subjekteve të mbikëqyrura.

3. Inspektojnë llogaritë, dokumentet tregtare dhe çdo dokumentacion tjetër, që ka lidhje me transaksionet e kryera.

4. Kryejnë verifikime në palë të treta, të cilat përfshijnë vetëm shqyrtimin e asaj pjese të dokumentacionit apo të veprimtarisë së palës së tretë, që ka lidhje me çështjen për të cilën është inspektuar subjekti i mbikëqyrur.

5. U kërkojnë palëve të treta të dhëna, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara, të njësuara të dokumenteve, deklarata mbi llogaritë dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për realizimin e verifikimeve.

6. Marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga strukturat drejtuese dhe kontrolluese të subjekteve të mbikëqyrura.

Për zbatimin e procedurave të mbikëqyrjes, nënkryetari përgjegjës për subjektin e mbikëqyrur mund t'i kërkojë Bordit emërimin e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me kërkesat specifike të miratuara nga Bordi. Shpenzimet, në këtë rast, përballohen nga subjekti i mbikëqyrur.

Me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, bankat janë të detyruara që, për subjektet e mbikëqyrura, t'i japin Autoritetit të dhëna për numrat dhe kodet e llogarive ekzistuese apo të mbyllura, si dhe datën e transaksionit të fundit të kryer.

Të gjitha të dhënat dhe dokumentet, që përbëjnë shkelje të këtij ligji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre emrin e personit, që është marrë me hartimin e tyre, u dorëzohen palëve të treta nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vetëm me miratimin paraprak të personit në fjalë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Policia, prokuroria dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore detyrohen që, brenda kompetencave të tyre, të ndihmojnë Autoritetin dhe punonjësit e tij për përmbushjen e detyrave gjatë ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave të ngarkuara nga ky ligj, Autoriteti mund të ndërmarë inspektime të përgjithshme, në bashkëpunim me organet e tatim-taksave.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij nuk mund të jenë individualisht përgjegjës për dëmin që mund t'u shkaktohet personave të mbikëqyrur nga veprimet apo mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur veprimet apo mosveprimet janë kryer me faj dhe në mënyrë të qëllimshme. Autoriteti dëmshpërblen anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij për kostot ligjore të lindura gjatë procesit të mbrojtjes prej veprimeve ligjore të ndërmarra kundër tyre, për shkak të ushtrimit të funksioneve apo të detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi.

Neni 18/1

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

(Shtuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

1. Autoriteti lidh marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci apo institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucione të tjera të njohura me ligj, për të bashkëpunuar, shkëmbyer informacione, apo kryer inspektime të përbashkëta.

2. Autoriteti kryen hetime, në emër dhe për llogari të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse vendase apo të huaja, në sektorin financiar të agjencive apo institucioneve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucioneve të tjera të njohura me ligj, me kërkesë të tyre.

3. Autoriteti shkëmben me autoritetet dhe institucionet vendase apo të huaja, sipas fushave përkatëse të veprimtarisë:

- a) informacion për subjektet e mbikëqyrura;
- b) informacion për lëshimin e licencave;

c) informacion që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
ç) informacion që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushat e mbikëqyrura;

d) të dhëna të natyrës financiare;

dh) informacion për personat fizikë, të cilët mbajnë poste me përgjegjësi në këto subjekte.

4. Çdo informacion që merr Autoriteti dhe çdo informacion që i jepet një autoriteti tjetër mbikëqyrës trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të përcaktuara në ligj apo në akte nënligjore.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 19

Inspektimi

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Inspektimi ushtrohet nga nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, ose, në mungesë dhe me autorizimin e lëshuar prej tij, nga nëndrejtori ekzekutiv. Inspektimi bëhet me ose pa paralajmërim.

Nëpunësit e urdhëruar, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, inspektojnë për:

1. Respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve financiare që mbikëqyren.

2. Parandalimin dhe identifikimin e shkeljeve.

Për ushtrimin e inspektimit, subjekti i mbikëqyrtur është i detyruar t'u sigurojë nëpunësve të Autoritetit kushte normale pune, si dhe t'u ofrojë dokumentacion ose çdo të dhënë tjetër, të shkruar në gjuhën shqipe.

Nëpunësit e administratës së Autoritetit, para fillimit të procedurave të inspektimit, janë të detyruar të paraqesin urdhrin e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Subjekti i mbikëqyrtur është i detyruar t'u ofrojë Autoritetit dhe administratës së tij:

a) mjetet e nevojshme për inspektim, nëse i kërkohet kjo, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve në mjediset e Autoritetit;

b) personat e kontaktit, nga radhët e të punësuarve, për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;

c) hyrje pa limit në mjediset e zyrave;

ç) të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat, në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi;

d) pas një kërkesë paraprake, fotokopjet e llogarive dhe të dokumenteve të tjera, ku të shënohet me shkronja shtypi "E njëjtë me origjinalin", si dhe data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar nga personi i inspektuar.

Raporti për çdo inspektim përgatitet në dy kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit, që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundërfirmë personit që përfaqëson subjektin e mbikëqyrtur.

KREU IV

ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES

Neni 20

Organizimi dhe detyrimet

(Ndryshuar fjalë në fund të paragrafit të parë, ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Veprimtaria e Autoritetit mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme të përshkrimit të punës dhe me rregulloret e tjera për funksionimin e

administratës, të cilat miratohen nga Bordi, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji, si dhe të akteve të Autoritetit.

Nuk mund të punësohen në strukturat e Autoritetit persona:

- a) të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
- b) të cilët janë ortakë apo aksionerë të subjekteve të mbikëqyrura;
- c) që kanë qenë anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura në dy vitet e fundit;
- ç) që kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “c” të këtij neni, me anëtarët e Bordit apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje hierarkike;
- d) që janë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura;
- dh) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional dhe për të cilët janë marrë masa disiplinore për cenim të rregullave të etikës.

Neni 21

Shpërblimi i administrates

(Shfuqizuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

KREU V

DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 22

Konflikti i interesit

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurisë në çastin e marrjes së detyrës, si dhe më tej, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Anëtarët e Bordit nuk marrin pjesë në procedurat e diskutimit, votimit dhe vendimmarrjes, nëse kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare.

Nëpunësi i Autoritetit nuk merr pjesë në inspektime ndaj subjekteve të mbikëqyrura nëse ka interesa, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për çështjen për të cilën kryhet inspektimi, interes i cili cenon paanësinë e tyre.

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit, nëse vërejnë se ndodhen përpara rastit të parashikuar, përkatësisht, në paragrafin e dytë ose të tretë të këtij neni, bëjnë deklaratat me shkrim për këtë fakt dhe tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes.

Në rast se vërehet se megjithëse janë ndodhur përpara rastit të përmendur, përkatësisht, në paragrafin e dytë apo të tretë të këtij neni dhe nuk kanë bërë deklarin përkatës e për pasojë nuk janë tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, ndaj tyre merret masa e liritimit ose e largimit nga detyra. Masa e liritimit ose e largimit nga detyra nuk ndikon në vendimet e marra deri në atë çast.

KREU VI

KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 23

Kodi etik dhe profesionalizmi

(Ndryshuar fjalë në fund të paragrafit të parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale, të miratuara nga Bordi, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Kur vërehen shkelje të kodit të etikës, merren masa disiplinore deri në lirim të detyrës ose largimin nga detyra.

Neni 24 **Konfidencialiteti**

Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen “Informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit.

Nuk janë informacione konfidenciale të dhënat tregtare, të siguruar nga subjekti i mbikëqyrur, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuara nga Bordi.

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale.

Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirim nga detyra, për anëtarët e Bordit, ose largimin nga detyra, për nëpunësit e tjerë të Autoritetit.

Neni 25 **Përfundimi i trajtimit si informacion konfidencial**

Informacioni i klasifikuar konfidencial nuk trajtohet më si i tillë me kalimin e tre viteve nga çasti kur i është dorëzuar Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Bordit.

Bëjnë përjashtim nga respektimi i afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni rastet kur ky informacion kërkohet nga:

1. Autoritetet gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Autoritetet mbikëqyrëse bankare apo shërbimet inteligjente, sipas kritereve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje të përbashkëta.
3. Autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera, që ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme me atë të Autoritetit, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta për shkëmbim të dhënash, kur këto autoritete:

- a) sigurojnë të paktën të njëjtin nivel konfidencialiteti për të dhënat që dërgohen;
- b) bien dakord që, me kërkesë të Autoritetit, të vënë në dispozicion të njëjtën të dhënë;
- c) kanë arsye për kërkesën për informacion.

Në dhënien e këtij informacioni zbatohen dispozitat ligjore për të dhënat personale.

Të dhënat e marra nga subjekti i mbikëqyrur mund t’i rijepen atij në çdo kohë.

KREU VII **FINANCIMI DHE BUXHETI I AUTORITETIT**

Neni 26 **Financimi dhe buxheti**

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti është institucion financiarisht i pavarur dhe financohet me burime të veta.

Të ardhurat e Autoritetit krijohen nga:

- a) tarifat e mbledhura, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;
- b) gjokat e vendosura, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe penalitetet e vendosura për pagesat e vonuara të tarifave, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji;
- c) dhënia me qira e ambienteve në pronësi të Autoritetit;
- ç) investimi në depozita bankare apo titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

d) burime dhe veprimtari të tjera të lejuara nga ky ligj ose legjislacioni në fuqi.

Të ardhurat e Autoritetit përdoren:

a) për të mbuluar shpenzimet që kryen Autoriteti në përmbushje të përgjegjësisë së tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

b) për të kryer investime apo zbatuar projekte në përmbushje të përgjegjësisë së tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

c) për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës. Me “fond rezervë”, për qëllime të këtij ligji, kuptohet fondi, në të cilin alokohet diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor dhe që shërben për të mbuluar diferencën negative ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor. Alokimi i të ardhurave në fondin e rezervës kryhet derisa ky fond të arrijë nivelin mesatar gjashtëmujor të buxhetit të Autoritetit për tre vitet e fundit.

Neni 27

Përcaktimi i tarifave për subjektet e mbikëqyrura

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti mbledh nga subjektet e mbikëqyrura:

1. Tarifa për aplikim, dhënie e rinovime licencash, miratimesh dhe autorizimesh, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të legjislacionit në fuqi apo rregulloreve të Autoritetit.

2. Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura, të licencuara nga Autoriteti.

3. Tarifa për projekte të veçanta, prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura. Të ardhurat nga këto tarifa përdoren vetëm për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre projekteve.

Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura caktohet në nivelin deri në 1,5 për qind të:

a) volumit të primeve të shkruara bruto vjetore nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jojetës;

b) volumit të primeve të shkruara, pasi janë zbritur elementet e kursimit, vjetore, nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jetës;

c) vlerës së përgjithshme të aseteve të fondit të pensioneve vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

ç) volumit të përgjithshëm të transaksioneve vjetore të realizuara në bursë apo në një treg të rregulluar;

d) treguesit të përzgjedhur si bazë në këtë ligj, në legjislacionin në fuqi apo në rregulloret e Autoritetit për subjektet e tjera të mbikëqyrura, që nuk përcaktohen në shkronjat “a” deri në “ç” të këtij paragrafi.

Rakordimi përfundimtar i shumës së tarifës së mbikëqyrjes për t’u paguar kryhet brenda një muaji nga paraqitja në Autoritet e pasqyrave financiare të audituara të subjektit të mbikëqyrur ose nga paraqitja e pasqyrave financiare vjetore përfundimtare, për ato subjekte që nuk kanë detyrim auditimi ligjor.

Tarifat e paguara nga subjekti i mbikëqyrur llogariten si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Kur fondi i rezervës është në nivelin e përcaktuar në shkronjën “c”, të nenit 26, të këtij ligji, çdo tepriçë që mbetet nga të ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore me kontributin e tyre.

KREU VIII KONTABILIZIMI DHE KONTROLLI I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT

Neni 28

Raportimi dhe kontrolli

Brenda muajit prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet Kuvendit:

1. Raportin vjetor për veprimtarinë e tij.
2. Deklarimin për gjendjen financiare vjetore.
3. Raportin për realizimin e planit të buxhetit.

Raporti vjetor për veprimtarinë e Autoritetit, përveç të dhënave që mund të kërkohen nga Kuvendi, përmban të dhëna për:

1. Përshtatshmërinë e infrastrukturës ligjore të tregut financiar të mbikëqyrur.
2. Vendimet e marra për dhënien e licencave, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, refuzimin e lëshimit të licencave apo të kërkesave të tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, regjistrimet e bëra në regjistra, vendimet e ankimuarra të Bordit dhe, në mënyrë të hollësishme, ankimimet e vendimeve të Bordit, të cilat janë pranuar nga gjykata.
3. Rezultatit e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura.
4. Politikat e ndjekura për vënien në dijeni të publikut, si dhe ato të bashkëpunimit të brendshëm e ndërkombëtar.
5. Organizimin, financimin dhe politikat për përzgjedhjen e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë.
6. Të dhëna të tjera, sipas vendimit të Bordit.

KREU IX REGJISTRAT E AUTORITETIT

Neni 29

Regjistrat

(Ndryshuar fjalë në fund të paragrafit të fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti mban regjistra të hapura për publikun për:

1. Shoqëritë, që ushtrojnë veprimtaritë si tregje të titujve (bursa).
2. Shoqëritë publike dhe emetuesit e tjerë të titujve.
3. Shoqëritë e investimit.
4. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe institutet private të pensioneve.
5. Fondet e investimit.
6. Tregtarët e titujve dhe këshilltarët e investimeve.
7. Shoqëritë e sigurimeve.
8. Agjentët e sigurimeve.
9. Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si institute private të pensioneve.

Bordi, me propozimin e Drejtorit i Përgjithshëm Ekzekutiv, miraton regjistra të tjerë dhe procedura për regjistrimin fillestar, mbajtjen dhe ruajtjet e regjistrave, si dhe procedurat që sigurojnë mirëfunksionimin e regjistrit, si një sistem informativ i plotë.

KREU X
GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR (GKSF)

Neni 30
Funksionimi i GKSF-së

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, më poshtë GKSF, krijohet si një njësi këshillimore që:

1. Asiston në zhvillimin e politikave të përbashkëta, në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve të anëtarëve të këshillit sa herë që është e nevojshme të kryhen inspektime në subjektet e mbikëqyrura.

2. Siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të grupit.

3. Asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

4. Asiston në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesëmarrësit e tregjeve financiare.

Anëtarë të GKSF-së janë:

- Ministri i Financave;
- Kryetari i Bordit të Autoritetit;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Me ftesë të GKSF-së, në mbledhjet e tij mund të marrë pjesë edhe Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe persona të tjerë.

GKSF-ja i bën secilit prej përfaqësuesve rekomandime dhe propozime, që kanë si qëllim përmirësimin e praktikave të plotësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës ligjore për tregjet financiare.

Të drejtën për të thirrur mbledhjen e GKSF-së e ka çdo anëtar.

Mbledhjet e GKSF-së kryesohen nga Ministri i Financave. Mbledhja e parë e GKSF-së thirret nga Ministri i Financave brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU XI
SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 31
Gjobat

(Ndryshuar fjalia e parë e paragrafit të fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Cilido person, që pengon Autoritetin e Mbikëqyrjes, strukturat e tij ose nëpunësit e autorizuar të administratës së tij në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga ky ligj ose nga çdo akt tjetër, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Çdo shkelje, sipas paragrafit të parë të këtij neni, e kryer nga persona që janë ortakë ose aksionerë të personit juridik, që kanë funksione drejtuese të personit juridik apo nga ortakë të vetëm të një shoqërie tregtare, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë dhe në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Njoftimi për vendimin e marrë nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Bordit.

KREU XII
KOMPETENCA E AUTORITETIT PËR ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Neni 32

Përdorimi i masave administrative

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi, për parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve të Autoritetit në zbatim të tij, parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Autoritetit, mund të miratojë vendime për subjektet e mbikëqyrura, të cilat duhet të trajtojnë mënyrën që duhet të ndjekin subjektet e mbikëqyrura për të korrigjuar situatën apo për të parandaluar dëmin. Këto vendime përcaktojnë afate për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e veprimeve, si dhe mund të parashikojnë detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve, në rastet kur vërehen veprime në kundërshtim me ligjin.

Autoriteti mund ta vërë në dijeni publikun për masat e marra në zbatim të paragrafit të parë të këtij neni.

KREU XIII
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 33

Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë kompetencat vendimmarrëse:

1. Të Komisionit të Letrave me Vlerë, të krijuar me ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar.

2. Të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, të krijuar me ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, të ndryshuar.

3. Të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, të krijuar me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensione”, të ndryshuar.

Mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, i kalojnë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky proces përfundon në çastin e shkrirjes së administratës së tri institucioneve të para.

Tarifat e zbatuara deri tani nga Komisioni i Letrave me Vlerë, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve mbeten në fuqi dhe zbatohen nga Autoriteti deri në miratimin e pagesave, sipas nenit 27 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Kryetari i Bordit, nënkryetaret dhe anëtarët e tjerë, të zgjedhur në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e Bordit të ri.

Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi miraton anëtarët e rinj të Bordit.

Brenda një muaji nga konfigurimi i Bordit të ri, miratohet struktura e re organizative dhe rregulloret e përshkrimit të punës dhe ndarjes së funksioneve.

Anëtarët e rinj të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të emëruar në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kanë si rast përjashtimor, vetëm për mandatin e parë, këto afate emërimi:

a) Kryetari, 4 vjet;

- b) Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, 5 vjet;
- c) nëndrejtori ekzekutiv, 4 vjet;
- ç) anëtarët e tjerë, 3 vjet.

Neni 34

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë

Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet përgjegjëse paraqesin në Kuvend propozimet për anëtarët e Bordit.

Brenda 10 ditëve nga marrja e propozimeve, Kuvendi emëron anëtarët e Bordit.

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë bëhet sipas afateve të mëposhtme:

1. Kryetari 5 vjet.
 2. Njëri prej nënkryetarëve 5 vjet dhe tjetri 4 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin e emërimit.
 3. Anëtarët, përkatësisht njëri 5 vjet, njëri 4 vjet dhe dy të tjerët nga 3 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin për emërimin e tyre.
- Kryetari thërret mbledhjen e parë të Bordit brenda 7 ditëve nga emërimi. Mbledhja e parë e Bordit organizohet në mjediset e përcaktuara në lajmërimin e thirrjes së bërë nga Kryetari.

Neni 35

Mbarimi i funksioneve dhe shkrirja e administratave të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari organet vendimmarrëse të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, si dhe përfundon mandati i anëtarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet vendimmarrëse të këtyre institucioneve.

Licencat dhe vendimet e tjera individuale administrative, të lëshuara deri në datën e miratimit të këtij ligji nga organet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mbeten në fuqi.

Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shkrihen administratat e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari, sipas procedurave të miratuara nga Bordi, fillon punën për rekrutimin e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në këto institucione. Gjatë kësaj periudhe, personat që ushtrojnë funksione ekzekutive në këto administrata nuk kanë më asnjë kompetencë vendimmarrëse për lëshimin e licencave apo zgjerimin e tyre. Ata janë përgjegjës për dorëzimin të Kryetari i Autoritetit të mjeteve, burimeve të të ardhurave, arkivave dhe detyrimeve të tjera, të përmendura në paragrafin e fundit të nenit 33 të këtij ligji.

Nëpunësit e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, të cilët nuk do të rekrutohen nga Autoriteti, përfitojnë të drejtat e parashikuara nga ligji "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 36

Caktimi i pagave, shpërblimeve dhe strukturës për vitin e parë financiar

Struktura e Autoritetit, paga e Kryetarit, e nënkryetarit dhe shpërblimi i anëtarëve të tjerë të Bordit për vitin 2006 caktohen nga Këshilli i Ministrave brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 37

Buxheti i Autoritetit për vitin e parë financiar të veprimtarisë

Buxheti i Autoritetit për vitin 2006 hartohet mbështetur në buxhetin e Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve.

Ngarkohet Ministri i Financave të bëjë ndryshimet e nevojshme për përgatitjen e buxhetit të vitit 2006 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

KREU XIV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Terminologjia

Në këtë ligj, termat kanë të njëjtin kuptim si në ligjet që rregullojnë secilin prej tregjeve financiare që mbikëqyren, që janë objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti.

Në këtë ligj, termi “tituj” ka të njëjtin kuptim me termin “letra me vlerë”.

Neni 39

Hartimi i rregulloreve të Autoritetit

Bordi, brenda dy muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloren e parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 9 të këtij ligji.

Bordi, brenda 6 muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloret e tjera për drejtimin e përditshëm të institucionit.

Neni 40

Shfuqizime

Ligji nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, shfuqizohet.

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjeve nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar, nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar, dhe nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shfuqizohen.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rishqyrton dhe miraton të gjitha aktet nënligjore, të cilat miratoheshin nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni.

Neni 41

Ndryshimet në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar

Në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë” të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në ligj fjala “Komision” zëvendësohet me fjalën “Autoriteti”.
2. Kreu II dhe Kreu X shfuqizohen.
3. Pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 64 shfuqizohen.
4. Neni 67 shfuqizohet.

Neni 42

Ndryshimet në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 4 e 5 të nenit 1 shfuqizohen.
2. Në pikën 10 të nenit 1 dhe kudo në ligj, ku është përdorur, termi “depozitëmarrës” zëvendësohet me termin “depozitar”.
3. Në nenin 19 fjala “inspektorët” zëvendësohet me fjalët “nëpunësi i urdhëruar”.
4. Kudo në ligj fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.
5. Kudo në ligj emërtesa “Inspektorat ”zëvendësohet me emërtesën “Autoriteti”.
6. Kreu XI shfuqizohet.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4988, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9879, datë 21.2.2008

PËR TITUJT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

PJESA E PARË

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton llojet e titujve, rregullon mënyrën dhe kushtet për emetimin e titujve, tregtimin dhe regjistrimin, identifikimin dhe kryerjen e transaksioneve me to, përcakton personat dhe individët e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me titujt, kushtet për organizimin e tregtimit publik të titujve, mbrojtjen e investitorëve dhe të mbajtësve të të drejtave mbi titujt, kushtet për dematerializimin e titujve, organizimin e funksionimit të regjistrave të titujve, shkëmbimin dhe rregullimin e tregut të titujve.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet për rregullimin e shërbimeve në investime, hapjen dhe mbylljen e procesit të tregtimit të instrumenteve financiare, për realizimin e transaksioneve të ardhshme financiare, analizave financiare dhe ndryshimeve të përqindjeve të të drejtave të votës, të zotëruara nga aksionerët e shoqërive të listuara.

Dispozitat e këtij ligji për manipulimin e çmimeve dhe për analizat e instrumenteve financiare janë të zbatueshme edhe për veprimet dhe mosveprimet e subjekteve të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e të kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, në masën që ato ndikojnë në tregtimin e titujve në një treg titujsh brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Titujt sipas formës juridike

Titujt janë instrumente financiare, të cilat emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave, që rrjedhin nga zotërimi i tyre.

Në termin “tituj” përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emtuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që më poshtë do të quhet Autoriteti.

Neni 4

Titujt sipas marrëdhënies juridike

Titujt mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione ose kuota të fondit të investimeve apo fondit të pensioneve.

Tituj të pjesëmarrjes në kapital janë tituj, të cilët provojnë të drejtat dhe detyrimet për një pjesë të kapitalit minimal apo atij të regjistruar të shoqërisë aksionere.

Titujt e borxhit janë instrumente, të cilat provojnë të drejtat dhe detyrimet e lindura nga marrëdhënia debitor-kreditor, ndërmjet emetuesit dhe mbajtësit të titullit.

Aksionet ose kuotat e fondit të investimeve janë titujt, që krijojnë të drejta dhe detyrime, që lidhen me një pjesë të kapitalit të një fondi investimesh.

Aksionet e fondit të pensioneve janë tituj, që krijojnë të drejta dhe detyrime të lidhura me një pjesë të kapitalit të një fondi pensionesh.

Neni 5

E drejta për të emtuar tituj

Titujt, të quajtur ndryshe në ligje të tjera si “letra me vlerë”, emetohen nga Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë tregtare, si dhe nga persona të tjerë juridikë, të cilët në vijim do të quhen “emetues”.

Titujt emetohen në lek ose në monedhë të huaj.

Neni 6

Transferimi dhe regjistrimi i titujve

Titujt regjistrohen në qendrat e specializuara për mbajtjen e regjistrave të titujve, që organizohen në përputhje me këtë ligj dhe licencohen nga Autoriteti, për të ushtruar veprimtari si regjistrarë të titujve.

Titujt emetohen, transferohen dhe ruhen si të dhëna elektronike në regjistrarët e titujve, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti.

KREU II DERIVATIVËT

Neni 7

Instrumentet financiare derivative

Për qëllim të këtij ligji, instrumente financiare derivative janë të drejtat e zotëruara nga një person, çmimi i të cilave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, varet nga çmimi i titujve, kursi i këmbimit valutor, indeksat e bursës ose normat e interesit dhe të cilat nuk përbëjnë tituj, sipas nenit 3 të këtij ligji.

Instrumentet financiare derivative janë instrumente financiare të standardizuara dhe jo të standardizuara.

Instrumentet financiare të standardizuara janë:

1. Instrumente financiare derivative të tregtuara në një treg të rregulluar ose në treg mbi bankat të derivativeve.

2. Instrumente financiare derivative, të cilat u japin mbajtësve të tyre të drejta të barabarta.

Instrumentet financiare të standardizuara, për qëllim të këtij ligji, janë opsionet dhe futures.

Autoriteti miraton kontratën-tip të mundësisë (opsion), si dhe kontratën-tip të së ardhmes (futures).

Autoriteti miraton rregulla për organizimin dhe funksionimin e tregjeve mbi bankat.

Neni 8

Përkufizimi i kontratës së opsionit

Opsioni është kontratë për shitjen e ardhshme të titujve, sipas së cilës njëra prej palëve të kontratës përfiton të drejtën, por jo detyrimin, për të blerë ose për të shitur titullin e përcaktuar në kontratë me një çmim, për të cilin është rënë dakord më parë, përgjatë të gjithë periudhës, për të cilën është rënë dakord më parë në çdo ditë pune, deri në përfundimin e kësaj periudhe, ndërsa pala tjetër merr përsipër detyrimin për të dorëzuar ose paguar titullin, që është objekt i kontratës, sipas kërkesës së mbajtësit të opsionit.

Në varësi së të drejtës, që përfitohet nga kontrata e opsionit, e cila mund të jetë e drejtë për blerje ose për shitje, kontrata e opsionit mund të jetë përkatësisht opsion për blerje ose për shitje.

Neni 9

Përkufizimi i kontratave të futures

Futures është një kontratë për shitje në të ardhmen, në bazë të së cilës njëra prej palëve të kontratës merr përsipër detyrimin për të lëvruar titullin, objekt të kontratës, ndërsa pala tjetër merr përsipër të paguajë çmimin, për të cilin është rënë dakord në një datë të mëparshme, të vendosur nga palët.

Neni 10

Oferta publike dhe tregtimi i kontratave të opsioneve dhe i futures

Oferta publike dhe tregtimi i kontratave të opsioneve dhe futures bëhen sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti për tregtimin e instrumenteve financiare derivative.

Neni 11
Titujt e transferueshëm

Titujt e transferueshëm janë:

- a) aksionet, titujt e borxhit, si dhe titujt e ngjashëm me aksionet dhe titujt e borxhit;
- b) kontrata ose të drejtat për nënshkrimin e tyre, blerja ose futja në zotërim e titujve të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni;
- c) kontrata futures dhe e opsionit dhe kontrata financiare, që lidhen me titujt e përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, në rastet kur këto pranohen për t'u tregtuar në treg titujsh, që rregullohet dhe mbikëqyret nga Autoriteti.

KREU III
LLOJET E TITUJVE

Seksioni I
Aksionet

Neni 12
Aksioni

Përkufizimi, llojet e aksioneve, mënyra e marrjes në zotërim të tyre, si dhe përmbajtja e vendimit të emetimit të aksioneve rregullohen sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 13
Elementet e regjistrimit elektronik të aksioneve

Regjistrimet elektronike të aksioneve në regjistrarët e titujve përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- 1. Llojin e aksioneve.
- 2. Datën e emetimit.
- 3. Emërtimin, selinë dhe numrin e regjistrimit të emetuesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 4. Mbajtësin e aksioneve:
 - a) për individët shënohen identiteti, adresa e banimit, si dhe numri i dokumentit të identifikimit;
 - b) për personat juridikë shënohen emërtimi, selia, si dhe numri i regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 5. Numrin e aksioneve të emetuara.
- 6. Vlerën nominale të aksioneve të emetuara.
- 7. Datën e regjistrimit të aksioneve në qendrën e regjistrimit të aksioneve.

Neni 14
Detyrimet e emetuesit për regjistrimin e aksioneve

Emetuesi regjistron aksionet në regjistrar, sipas mënyrës dhe procedurës të miratuar nga Autoriteti.

Neni 15
Detyrimet për njoftimin e ndryshimit të pronësisë mbi aksionet

Emetuesi dhe regjistrari njoftojnë Autoritetin, për çdo rast, kur gjatë një periudhe, jo më të gjatë se dymbëdhjetë muaj, të drejtat mbi aksionet me të drejtë vote e që përbëjnë të paktën 5 për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare janë transferuar më shumë se një herë.

Përveç njoftimit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, emetuesi i aksioneve njofton Autoritetin edhe:

- a) për personat e lidhur me mbajtësin e ri të aksioneve;
 - b) për personat, që kanë lidhur një marrëveshje me zotëruesin e ri të aksioneve;
 - c) nëse mbajtësi i ri është shoqëri e kontrolluar e një shoqërie tjetër;
 - ç) për shoqëritë e kontrolluara nga mbajtësi i ri i aksioneve;
 - d) për persona të lidhur me kapitalin në lidhje trashëgimie deri në shkallën e dytë.
- Persona të lidhur janë personat e trajtuar si të tillë nga ligji për shoqëritë tregtare.

Seksioni II **Obligacionet**

Neni 16 **Përkufizimi i obligacionit**

Obligacioni është një titull afatgjatë borxhi, i cili e detyron emetuesin që, në një datë të caktuar, në një ose më shumë këste, t'i paguajë titullarit të obligacionit vlerën nominale të obligacionit, si dhe interesin.

Neni 17 **Vendimi i emetimit të obligacioneve**

Vendimi i emetimit të obligacioneve miratohet nga organi i autorizuar i emetuesit.

Vendimi i emetimit të obligacioneve përmban elementet e mëposhtme:

1. Emërtimin dhe selinë e emetuesit.
2. Vlerën totale të emetimit.
3. Vlerën nominale të obligacionit.
4. Të dhëna për garantuesin.
5. Mënyrën e emetimit dhe të nënshkrimit të obligacioneve.
6. Qëllimin e përdorimit të fondeve, të siguruara nga emetimi i obligacioneve.
7. Llojin e obligacioneve dhe të drejtat që u japin titullarëve.
8. Afatet e shlyerjes së vlerës nominale të obligacionit, si dhe të interesave.
9. Normën e interesit, si dhe mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së interesit.
10. Vlerën e kapitalit themeltar të emetuesit dhe përqindjen që zë emetimi i obligacioneve në kapitalin e vetë emetuesit.
11. Burimet e fondeve për shlyerjen e obligacioneve.
12. Strukturën e emërtimit dhe numrin e obligacioneve.
13. Mundësitë e konvertimit në lloje të tjera titujsh.
14. Prioritetin e pagesës në rast të falimentimit të emetuesit.

Vendimi i emetimit të obligacioneve mund të përcaktojë privilegje apo përfitime të veçanta për blerësin.

Neni 18 **Llojet e obligacioneve**

Obligacionet mund të klasifikohen:

1. Sipas mënyrës së garantimit të të drejtave:
 - a) me garanci;
 - b) pa garanci.
2. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës mbi interesin:
 - a) obligacione me kupon zero, të cilat janë obligacione me interes të pagueshëm menjëherë;

- b) obligacione me kupon, të cilat janë obligacione me interes të pagueshëm në këtë.
- 3. Sipas interesit:
 - a) obligacione të skontueshme;
 - b) obligacione me normë interesi fikse;
 - c) obligacione me normë interesi të ndryshueshme.
- 4. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës së marrjes së vlerës nominale:
 - a) obligacione, që shlyhen me një këtë;
 - b) obligacione, që shlyhen me disa këtë.
- 5. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës së shlyerjes së vlerës nominale nga emetuesi:
 - a) obligacione të shlyeshme para datës së maturimit;
 - b) obligacione të pashlyeshme para datës së maturimit.
- 6. Sipas të drejtave të veçanta:
 - a) obligacione me pjesëmarrje, të cilat janë obligacione që, krahas interesit, i japin titullarit të drejtën të përfitojë edhe dividend;
 - b) obligacione, të cilat janë të konvertueshme në aksione;
 - c) obligacione të konvertueshme, të cilat janë obligacione që i japin titullarit të drejtën e parablerjes së aksioneve.

Neni 19

Elementet e obligacionit

Obligacionet, kur regjistrohen si të dhëna elektronike, përmbajnë elementet e mëposhtme:

1. Llojin e obligacionit.
2. Serinë e obligacioneve, kur emetuesi emeton më shumë se një seri të të njëjtit lloj.
3. Datën e emetimit të obligacioneve.
4. Emërtimin, selinë, si dhe numrin e regjistrimit të emetuesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
5. Titullarin e obligacioneve:
 - a) për individët: emri, adresa e banimit, si dhe numri i certifikatës së lindjes ose i pasaportës;
 - b) për personat juridikë: emërtimi, selia, si dhe numri i regjistrimit të biznesit.
6. Vlerën nominale të obligacioneve.
7. Normën e interesit.
8. Afatin dhe mënyrën e pagesës së interesit.
9. Datën e regjistrimit të obligacioneve në regjistrar.

Seksioni III

Bonot e thesarit, dëftesat tregtare dhe obligacionet shtetërore

Neni 20

Përkufizimi i bonove të thesarit dhe dëftesave tregtare

Bonot e thesarit dhe dëftesat tregtare janë tituj, të cilat e detyrojnë emetuesin t'i paguajë zotëruesit interesin, brenda periudhës së maturimit, si dhe të paguajë vlerën nominale të tyre në datën e maturimit.

Neni 21

Emetuesit e bonove të thesarit dhe dëftesave tregtare

Bonot e thesarit emetohen nga Ministria e Financave në emër të shtetit shqiptar, ndërsa dëftesat tregtare emetohen nga personat juridikë.

Bonot e thesarit dhe dëftesat tregtare janë tituj afatshkurtër.

Neni 22

Përkufizimi i obligacioneve shtetërore

Obligacionet shtetërore janë tituj me afat maturimi më të gjatë se një vit nga data e emetimit, të cilat emetohen nga shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Neni 23

Vendimi i emetimit të bonove të thesarit, dëftesave tregtare dhe obligacioneve shtetërore

Vendimi i emetimit të bonove të thesarit, dëftesave tregtare dhe obligacioneve shtetërore miratohet nga organi i autorizuar i emetuesit.

Neni 24

Përmbajtja e vendimit të emetimit të bonove të thesarit, dëftesave tregtare dhe të obligacioneve shtetërore

Vendimi i emetimit të bonove të thesarit, dëftesave tregtare dhe obligacioneve shtetërore përmban elementet e mëposhtme:

1. Vlerën totale të emetimit dhe vlerën nominale të çdo titulli.
2. Qëllimin, për të cilin do të përdoren fondet e siguruara nga emetimi.
3. Mënyrën e emetimit të titujve.
4. Normën e interesit.
5. Datat e maturimit.

Neni 25

Elementet e regjistrimeve elektronike të bonove të thesarit, dëftesave tregtare dhe të obligacioneve shtetërore

Bonot e thesarit, dëftesat tregtare dhe obligacionet shtetërore, që mbahen si të dhëna elektronike në regjistrar titujsh, përmbajnë elementet e mëposhtme:

1. Llojin e titullit.
2. Serinë e titullit, nëse emetuesi emeton më shumë se një seri të të njëjtit lloj.
3. Datën e emetimit.
4. Emrin, selinë dhe numrin individual të identifikimit të emetuesit.
5. Pronarin e titullit.
6. Vlerën nominale të titullit.
7. Interesin.
8. Afatin dhe mënyrën e pagesës së interesit.
9. Datën e regjistrimit të titujve të emetuesi ose në regjistrar.

Neni 26

Blerësit e bonove të thesarit, të dëftesave tregtare dhe obligacioneve shtetërore

Bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore mund të blihen në tregun primar nga banka, institucione financiare, investitorë institucionalë, persona juridikë e individë, kurse në tregun sekondar mund të blihen dhe shiten nga persona juridikë të tjerë, si dhe individë.

Dëftesat tregtare mund të blihen në tregun primar nga persona juridikë dhe individë.

Bonot e thesarit, obligacionet shtetërore dhe dëftesat tregtare mund të blihen dhe shiten lirshëm në tregun sekondar nga persona juridikë dhe individë.

PJESA E DYTË

KREU I

EMETIMI I TITUJVE

Neni 27

Emetimi i titujve

Emetimi i titujve është emetimi përmes një oferte publike ose private i titujve në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj.

Ofertë publike e titujve është ftesa për të nënshkruar titujt, e cila, duke përdorur mjetet masive të komunikimit, i drejtohet një numri të papërcaktuar personash.

Ofertë private e titujve është emetimi, në të cilin oferta për të nënshkruar titujt u drejtohet vetëm investitorëve institucionalë, aksionerëve ose punonjësve, por jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm, të cilët janë adresuar drejtpërdrejt tek emetuesi.

Investitorë institucionalë janë fondet e investimeve, fondet e pensioneve, shoqëritë e sigurimeve, si dhe personat juridikë, të cilët investojnë në titujt vetëm për llogari të portofoleve të tyre të investimit. Statusi i investitorit institucional certifikohet me vendim të Autoritetit. Autoriteti miraton rregullore për procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për certifikimin e investitorëve institucionalë.

Investitor i jashtëm është çdo individ ose person juridik, vendas apo i huaj, që nuk është aksioner apo punonjës i emetuesit dhe investitor institucional.

Neni 28

Detyrimi për përgatitjen e prospektit

Kur emetuesi emeton tituj në Republikën e Shqipërisë, ai publikon një prospekt për ofertën publike për shitjen e titujve ose ua dorëzon atë investitorëve të mundshëm. Prospekti, së bashku me ftesën për të nënshkruar titujt, përmban edhe informacion të plotë, të saktë dhe objektiv për mjetet dhe detyrimet, fitimin dhe humbjen, gjendjen dhe perspektivat financiare të emetuesit, qëllimin e marrjes së fondeve, faktorët e riskut dhe të drejtat që mbartin titujt, për të cilat nxirret prospekti, në bazë të të cilave investuesi mund të bëjë një vlerësim objektiv të perspektivave dhe rreziqeve të investimeve dhe të marrë një vendim për investimin.

Neni 29

Përmbajtja e detyrueshme e prospektit

Prospekti përmban:

A. Të dhëna për titujt, për të cilët publikohet prospekti dhe për mënyrën e kushtet e emetimit të tyre, të cilat përfshijnë:

1. Llojin dhe karakteristikat e titujve, numrin e përgjithshëm të tyre, si dhe përshkrimin e të drejtave që mbartin.

2. Një përmbledhje, që përcakton shkurtimisht karakteristikat dhe risqet kryesore të mbajtësit të titullit, garantuesit dhe titujve të ofruar.

3. Datën e fillimit të nënshkrimit, periudhën e nënshkrimit dhe pagesës.

4. Përshkrimin e mënyrës së shpërndarjes së titujve, nëse nënshkruhen më shumë tituj nga sa emetohen.

5. Emërtimin, selinë dhe adresën e veprimtarisë së personit që garanton, nëse ka të tillë.

6. Emërtimin, selinë dhe adresat e veprimtarisë së personave, që garantojnë detyrimet e emetuesit për titullin.

7. Emrat dhe adresat e institucioneve, përmes të cilave emetuesit do t'i përmbushin detyrimet që kanë ndaj pronarëve të titujve.

8. Çmimin ose mënyrën e përcaktimit të çmimit të titujve.

9. Procedurën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, si dhe pagesën.

10. Qëllimin, për të cilin synon t'i përdorë fondet emetuesi.

B. Të dhëna për emetuesin e titujve, ku përfshihen:

1. Emri i shoqërisë, selia dhe adresa e veprimtarisë, data e themelimit të personit juridik, forma ligjore, numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Vlera e kapitalit të nënshkruar dhe e kapitalit të paguar dhe, në rastin e një shoqërie anonime, të dhëna të hollësishme për kapitalin themeltar.

3. Nëse është filial ose shoqëri e kontrolluar nga një shoqëri tjetër, të dhëna për këtë shoqëri.

4. Listën e aksionerëve, që zotërojnë mbi 5 për qind të numrit gjithsej të votave të asamblesë së përgjithshme, duke përcaktuar përqindjen e votave që zotëron secili.

C. Të dhëna për veprimtarinë e emetuesit, ku përfshihen:

1. Përshkrimi i objektit të veprimtarive të emetuesit dhe i rrethanave të mundshme, të jashtëzakonshme, të cilat kanë ndikuar apo ndikojmë në rezultatet e disa prej këtyre veprimtarive.

2. Varësinë të patentat apo licencat, që u përkasin të tjerëve, apo kontrata me palë të treta, të cilat janë kusht i domosdoshëm për zhvillimin e veprimtarive të emetuesit.

3. Të dhëna për investime të mëdha në realizim e sipër.

4. Të dhëna bazë për konflikte gjyqësore ose ekzekutime të vendimeve gjyqësore, që mund të kenë efekt të ndjeshëm në gjendjen financiare të emetuesit.

5. Faktorët e riskut, ndaj të cilëve është i zbuluar emetuesi, që mund të ndikojnë në ushtrimin e të drejtave mbi titujt, për të cilët është përgatitur prospekti, si dhe çmimin e tyre në treg.

Ç. Të dhënat e mëposhtme për mjetet e emetuesit dhe borxhin, gjendjen financiare dhe rezultatin financiar të emetuesit për tri vitet e fundit dhe për vitin në vazhdim, përfshirë, në mënyrë të veçantë, tremujorin e fundit, me përjashtim të rasteve kur emetuesi nuk ka ushtruar veprimtari për një kohë kaq të gjatë:

1. Pasqyrat individuale dhe pasqyrat e konsoliduara financiare, kur ekzistojnë dhe nëse emetuesi përgatit vetëm pasqyra të konsoliduara, ato përfshihen në prospekt, nëse emetuesi përgatit pasqyra individuale dhe pasqyra të konsoliduara, i përfshin ato në prospekt. Të dhënat e pasqyrave të ndryshme duhet të jepen në tabela, të cilat mundësojnë krahasimin e zërave të ndryshëm gjatë viteve financiare të njëpasnjëshme.

2. Emrin e ekspertit kontabël, që ka certifikuar bilancin dhe nëse ky nuk ka pranuar ta nënshkruajë atë, ose nëse ka dhënë, me shkrim, mendimin profesional, ky informacion përfshihet në prospekt, së bashku me arsyet përkatëse.

D. Të dhëna për anëtarët e organeve vendimmarrëse, mbikëqyrëse apo ekzekutive të emetuesit, ku përfshihen:

1. Emrat e plotë të anëtarëve të organeve vendimmarrëse, mbikëqyrëse apo ekzekutive të emetuesit ose të organeve të tjera të emetuesit, pavarësisht nga emërtimi që mbajnë në strukturën e tij, si dhe pozicionet që ata mbajnë në këto organe.

2. Nëse prospekti nxirret për aksione, ai përmban curriculum vitae të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe të anëtarëve të drejtorisë, si dhe të ardhurat nga puna që kryejnë tek emetuesi.

DH. Deklaratën e mëposhtme të personave, që nënshkruajnë prospektin:

1. “Me besimin tonë maksimal dhe në bazë të të gjitha informacioneve dhe të dhënave, për të cilat jemi në dijeni, deklarojmë se të gjitha të dhënat, që përmbahen në këtë prospekt, përbëjnë paraqitje të plotë dhe të vërtetë të mjeteve dhe detyrimeve, fitimeve dhe humbjeve, gjendjes financiare dhe operacioneve të emetuesit, të të drejtave të lidhura me titujt, për të cilët është përgatitur ky prospekt dhe se nga ai nuk janë hequr fakte dhe të dhëna, të cilat mund të ndikojnë në plotësinë dhe vërtetësinë e këtij prospekti”.

2. Prospekti nënshkruhet nga përfaqësuesi apo përfaqësuesit ligjorë të emetuesit ose nga të gjithë anëtarët e organit drejtues përkatës të emetuesit. Në prospekt deklarohen arsyet, për të cilat

anëtarë të caktuar nuk kanë nënshkruar. Prospekti mund të nënshkruhet edhe nga persona të tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në nxjerrjen apo përgatitjen e të dhënave për prospektin.

Neni 30

Miratimi i prospektit

Prospekti, përpara publikimit ose dorëzimit të tij tek investitorët e mundshëm, paraqitet për miratim pranë Autoritetit. Emetuesi, së bashku me kërkesën për miratimin e prospektit, paraqet prospektin, vendimin për emetimin e titujve, si dhe çdo dokumentacion tjetër, të parashikuar nga ky ligj apo që i kërkohet nga Autoriteti.

Prospekti publikohet dhe u jepet investitorëve të mundshëm, vetëm pasi ai të miratohet nga Autoriteti.

Autoriteti, pas marrjes së praktikës, verifikon nëse prospekti përmban të gjitha të dhënat e renditura në nenin 29 të këtij ligji, por nuk kontrollon nëse informacioni që jepet në prospekt është i plotë dhe i vërtetë, si dhe ligjshmërinë e vendimit të emetimit të titujve e përmbajtjen e dokumenteve të tjera bashkëlidhur. Pavarësisht nga sa është parashikuar në këtë paragraf, nëse në praktikën e depozituar, në bazë të ndonjë informacioni të bërë publik ose kur Autoriteti ka të dhëna se ekzistojnë fakte apo rrethana të rëndësishme, që vërtetojnë mungesën e dokumenteve, të cilat duhet të deklaroheshin në prospekt, Autoriteti i kërkon emetuesit plotësimin e prospektit.

Nëse praktika ka bashkëlidhur të gjitha dokumentacionin e parashikuar në këtë ligj dhe prospekti përmban të gjitha të dhënat, sipas dispozitave të nenit 29 të këtij ligji, Autoriteti, me vendim, miraton prospektin.

Nëse brenda 15 ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës dhe të dokumentacionit bashkëlidhur, Autoriteti nuk merr vendim për miratimin apo refuzimin e prospektit, konsiderohet se Autoriteti e ka miratuar prospektin.

Kur Autoriteti i kërkon emetuesit të plotësojë dokumentacionin, afati llogaritet 15 ditë pune nga data e depozitimit në Autoritet nga emetuesi të dokumentacionit shtesë.

Autoriteti miraton formularin e kërkesës, përmbajtjen e dokumentacionit që i bashkëlidhet kërkesës për miratim të prospektit, si dhe tarifat e shërbimit për përpunimin e këtij informacioni.

Neni 31

Përgjegjësia për përmbajtjen e prospektit

Emetuesi mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave që jepen në prospekt. Autoriteti, me vendim, konfirmon vetëm nëse prospekti është depozituar sipas kërkesave të ligjit, se përmban të gjithë informacionin e parashikuar në këtë ligj dhe se ai mund të publikohet.

Emetuesi dhe personat, që zbulohen se e kanë përdorur prospektin për të mbuluar apo për të shtrembëruar fakte të rëndësishme, mbajnë përgjegjësi të plotë për tërësinë dhe vërtetësinë e të dhënave që përmban prospekti për aq sa ata, për shkak të pozicionit të tyre në lidhje me emetuesin, kishin dijeni apo duhej të kishin dijeni për informacionin e padeklaruar.

Neni 32

Publikimi i prospektit

Brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e vendimit për miratimin e prospektit për emetimin dhe shitjen e titujve, përmes një oferte publike, emetuesi e publikon prospektin në buletin e publikimeve zyrtare ose në dy gazeta të përditshme me tirazh më të madh. Në rastin e një oferte private, emetuesi publikon prospektin, brenda afatit të sipërpërmendur, në formë shoqëruese të ftesës për të nënshkruar titujt, që u dërgohet investitorëve të mundshëm.

Në publikimin e prospektit për ofertën publike jepen edhe adresa apo adresat, në të cilat mund të merren apo të porositen pa pagesë kopje të prospektit.

Në rastin e një oferte private, ftesa për të nënshkruar titujt u drejtohet, brenda 15 ditëve, të gjithë investitorëve të mundshëm, të caktuar dhe emetuesi nuk është i detyruar ta publikojë prospektin.

Nëse titujt ofrohen të shiten përmes një oferte publike, prospekti u vihet në dispozicion investitorëve në selinë e emetuesit, si dhe në të gjitha vendet ku bëhet nënshkrimi i titujve të lidhur me prospektin.

Prospekti publikohet dhe u vihet në dispozicion investitorëve të mundshëm përpara një pranimi të mundshëm të detyrimit për të nënshkruar dhe përpara nënshkrimit të titujve. Investitori nuk mban përgjegjësi për një pranim të mundshëm për të nënshkruar apo për kryerjen e nënshkrimit të titujve, përpara publikimit ose dërgimit të prospektit.

Nëse emetuesi nuk e publikon prospektin brenda afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ose nëse ai nuk ua dërgon investitorëve të mundshëm brenda afatit të parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni, vendimi i Autoritetit për miratimin e prospektit konsiderohet i shfuqizuar.

Neni 33

Ndryshimi i prospektit

Emetuesi, deri në fund të periudhës së nënshkrimit të titujve, nëpërmjet dokumentit të ndryshimit të prospektit, korrigjon ose deklaron çdo fakt të ri, që lind ose për të cilin vihet në dijeni, pasi Autoriteti ka vendosur miratimin e prospektit. Emetuesi, brenda 24 orëve nga konstatimi, i kërkon Autoritetit miratimin e ndryshimit të prospektit, të cilin ia bashkëlidh prospektit të ndryshuar, pa vonesë, së paku brenda tri ditëve pune.

Autoriteti, brenda shtatë ditëve pune nga marrja e kërkesës, shqyrton kërkesën për ndryshimin e prospektit.

Nëse Autoriteti e miraton ndryshimin e prospektit ose nuk merr një vendim për aplikimin brenda afatit të përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni, emetuesi e publikon ndryshimin e prospektit ditën e parë të punës, pas këtij afati, në të njëjtën mënyrë që është publikuar prospekti i parë.

Neni 34

Oferta private e titujve

Nëse titujt ofrohen përmes një oferte private, emetuesi, në vendimin e emetimit të titujve, jep listën me emrat e investitorëve të mundshëm, të cilëve do t'ua dërgojë ftesën për nënshkrim titujsh, së bashku me formën dhe vlerën e investimeve të tyre.

Në rastin e një oferte private titujsh, prospekti përmban të dhënat e përmendura në nenin 29 të këtij ligji. Të dhënat për pronat dhe borxhin, gjendjen financiare dhe rezultatin financiar, të përcaktuara në nenin 29 shkronja “Ç”, jepen vetëm për vitin financiar të mëparshëm dhe vitin financiar në vazhdim, deri në tremujorin e fundit, përpara depozitimit të kërkesës për miratimin e prospektit.

Në rastin e një oferte private të titujve, emetuesi i tyre komunikon me investitorët e mundshëm nëpërmjet dorëzimit të ofertës në adresën e investitorit.

Neni 35

Nënshkrimi e shlyerja e titujve dhe raportimi tek Autoriteti

Nënshkrimi dhe shlyerja e titujve në një ofertë publike bëhen brenda tri muajve nga data kur emetuesi merr dijeni për vendimin e Autoritetit. Ky afat, në rastin e një oferte private, nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Gjatë periudhës së shlyerjes së titujve, emetuesi i depoziton shumat e paguara në një llogari të veçantë, të hapur në bankën ku investitori ka një llogari të hapur për këto lloj transaksionesh.

Nëse në fund të periudhave të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mbeten të panënshkruara dhe të pashlyera të paktën 75 për qind e titujve të ofruar publikisht ose 90 për qind e titujve të ofruar privatisht, emetuesit nuk i lejohet t'i emetojë titujt dhe, brenda shtatë ditëve pas përfundimit të periudhës së përcaktuar për shlyerjen e titujve, u kthen investitorëve shumat që kanë paguar.

Brenda shtatë ditëve nga përfundimi i periudhës së shlyerjes, emetuesi njofton Autoritetin për numrin dhe përqindjen e titujve të nënshkruar dhe paguar dhe për personat që i kanë nënshkruar dhe paguar ato. Autoriteti, për të njëjtin emetim, mund të kërkojë nga emetuesi të dhëna të tjera për nënshkrimin dhe pagesën e titujve.

Nënshkrimi dhe shlyerja e titujve, pas përfundimit të periudhave të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, janë të pavlefshme.

Neni 36

Emetimi i titujve afatshkurtër

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për emetimin e titujve afatshkurtër.

Titujt afatshkurtër nuk mund të emetohen me kushte të shtyrjes së datës së maturimit, përmes emetimit të një serie të re titujsh. Emetuesi, që është shoqëri anonime, mund të emetojë dëftesa tregtare deri në një vlerë totale jo më të madhe se 40 për qind e vlerës së kapitalit të shoqërisë.

Emetuesit e titujve afatshkurtër nuk janë të detyruar të nxjerrin prospekt, por ata, brenda shtatë ditëve pas emetimit, njoftojnë, me shkrim, Autoritetin për emetimin dhe karakteristikat kryesore të titujve afatshkurtër. Emetimi konsiderohet se është realizuar në fund të ditës së fundit të periudhës, brenda së cilës duhet të bëhet pagesa e titujve në fjalë.

Njoftimi i përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni përmban të dhëna për:

1. Titujt, nënshkrimin dhe pagesën.
2. Emetuesin.
3. Personat përgjegjës të emetuesit.

Neni 37

Emetimi dhe regjistrimi në bursë i titujve, të ofruar përmes një oferte publike

Emetuesi emeton titujt, të cilët janë ofruar për shitje përmes një oferte publike, për nënshkrim, në formën e titujve të dematerializuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj dhe i kuoton ato në bursë brenda 30 ditëve nga data e emetimit.

Neni 38

Emetuesi i huaj

Emetues i huaj është emetuesi, selia e të cilit është e regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Emetuesi i huaj mund të emetojë titujt me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë vetëm përmes një shoqërie të autorizuar, me të cilën është lidhur ky emetues për ta përdorur si agjent emetimi.

Shoqëri e autorizuar mund të jenë shoqëritë komisionere ose bankat, që kanë marrë nga Autoriteti licencën për të kryer transaksione me titujt.

Kërkesa për miratimin e prospektit të emetimit të titujve të një emetuesi të huaj bëhet në emër të këtij emetuesi nga shoqëria e autorizuar, e përmendur në paragrafin e tretë të këtij neni. Kërkesa shoqërohet me një kontratë agjencie ose nënshkrimin e përbashkët të emetuesit të huaj dhe të shoqërisë së autorizuar.

Autoriteti mund ta miratojë publikimin e prospektit të emetuesit të huaj, edhe pse kërkesa nuk shoqërohet nga i gjithë dokumentacioni i parashikuar në këtë ligj ose nëse praktika nuk i përmban të gjitha të dhënat e specifikuar në ligj, nëse:

a) shoqëria e autorizuar, e përmendur në paragrafin e tretë të këtij neni, vërteton se sipas legjislacionit të vendit të emetuesit, nuk mund të jepen këto dokumente apo të dhëna dhe nëse Autoriteti gjykon se kjo gjë nuk i ul mundësitë investitorëve për të bërë një vlerësim objektiv të perspektivave dhe rreziqeve të investimit, si dhe për marrjen e një vendimi për investimin;

b) shoqëria e autorizuar vërteton se, sipas legjislacionit të vendit anëtar të Bashkimit Europian, në të cilin ka selinë e regjistruar emetuesi, nuk kërkohen këto dokumente dhe të dhëna për miratimin e prospektit.

Autoriteti mund të miratojë publikimin e një prospekti për një emetues të huaj, i cili emeton tituj me ofertë publike, njëkohësisht, në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend anëtar të Bashkimit Europian apo SHBA-së, nëse publikimi në këto vende është miratuar nga organi përkatës i atij shteti, ose mund ta kushtëzojë miratimin me plotësimin e prospektit, me të dhënat e përmendura në këtë ligj.

Shoqëria e autorizuar garanton Autoritetin se të dhënat e përfshira në prospektin e emetuesit të huaj janë të sakta dhe të plota.

Neni 39

Emetimi i titujve jashtë Republikës së Shqipërisë

Emetuesi, që mendon të emetojë tituj në një treg të huaj, njofton, paraprakisht, Autoritetin për karakteristikat e emetimit të planifikuar.

Në këtë njoftim duhet të jepen të dhënat e përcaktuara në shkronjat “A” dhe “B” të nenit 29 të këtij ligji, si dhe të dhëna për mënyrën e kleringut dhe të rregullimit të titujve.

Brenda tetë ditëve pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit dhe të pagesës së titujve të emetuar jashtë Republikës së Shqipërisë, emetuesi informon Autoritetin për numrin e titujve që janë nënshkruar dhe paguar.

Neni 40

Përjashtime nga nxjerrja e detyrueshme e prospektit

Emetuesi nuk është i detyruar të publikojë një prospekt, kur emeton aksione për qëllimet e mëposhtme:

1. Rritje të kapitalit fillestar, duke përdorur për këtë qëllim fitimin, rezervat ose fitimin e pashpërndarë.

2. Rritje të kapitalit fillestar, si rezultat i një bashkimi shoqërisht.

3. Rritje të kapitalit fillestar, në të cilin nënshkrimi dhe pagesa e titujve kryhen nga aksioneri i emetuesit, i cili ka më shumë se 75 për qind të të drejtave të votimit në asamblenë e përgjithshme.

4. Rritje të kapitalit fillestar, në të cilin marrin pjesë vetëm investitorët institucionalë.

5. Konvertim të obligacioneve të konvertueshme në aksione, nëse në çastin e emetimit të obligacioneve të konvertueshme ka publikuar apo ua ka dorëzuar prospektin investitorëve.

6. Shndërrim në shoqëri anonime i shoqërisë së një forme tjetër.

Emetuesi që nuk ka nxjerrë prospekt, në mbështetje të paragrafit të parë të këtij neni, brenda shtatë ditëve pas përfundimit të ditës së fundit të periudhës së pagesës së titujve, i jep Autoritetit informacion për emetimin e kryer.

Informacioni i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni përmban të dhënat e përmendura në nenin 29 shkronjat “A” dhe “B”, si dhe të dhënat për investitorët institucionalë dhe numrin e aksioneve të nënshkruara dhe të paguara.

Ndryshe nga sa parashikohet në paragrafin e parë të këtij neni, emetuesi përgatit një prospekt për emetimin e titujve, përmes një oferte private, kur ftesa për të nënshkruar u drejtohet vetëm

investitorëve institucionale, me kusht që një ose më shumë investitorë institucionale të nënshkruajnë dhe të paguajnë të gjithë titujt e emetimit, me synimin që, brenda një periudhe më të shkurtër se një vit, t'ua ofrojnë për shitje personave që nuk janë investitorë institucionale.

Emetuesi i përmendur në paragrafin e katërt të këtij neni paraqet përpara Autoritetit kërkesën për miratimin e prospektit, përpara se investitori institucional të fillojë ofrimin e titujve për shitje. Investori institucional, përpara shitjes, ua vë në dispozicion këtë prospekt klientëve të mundshëm.

Neni 41

Përfshirjet nga zbatimi i dispozitave të këtij kreu

Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen për emetimin e aksioneve gjatë krijimit të një shoqërie anonime, si dhe për emetimin e titujve, kur ato emetohen nga shteti shqiptar apo nga Banka e Shqipërisë.

Autoriteti miraton rregullat që zbatohen për emetimin e aksioneve gjatë krijimit të një shoqërie anonime.

KREU II

TRANSAKSIONET E TITUJVE DHE PERSONAT E AUTORIZUAR PËR TË KRYER KËTO TRANSAKSIONE

Seksioni I

Neni 42

Veprimtaria e lidhur me transaksionet e titujve

Veprimtari të lidhura me transaksione të titujve janë:

1. Blerja dhe shitja e titujve me porosi të klientit.
2. Blerja dhe shitja e titujve në emër ose për llogari të vet.
3. Administrimi i portofolit të titujve në emër të një klienti që është pronar i portofolit.
4. Veprimtaria e zakonshme e agentit emetues, ku përfshihen organizimi, përgatitja dhe zbatimi i nënshkrimit dhe i pagesës së titujve dhe ushtrimi i veprimtarive të tjera për emetuesin për emetimin e titujve, përgatitja për regjistrimin e titujve në një bursë dhe treg publik të rregulluar, duke përfshirë edhe hartimin e kërkesës për regjistrim, në emër të emetuesit.
5. Financimi i një emetimi, ku përfshihen organizimi, përgatitja dhe zbatimi i emetimit të titujve për emetuesin dhe nënshkrimi e pagesa e lidhur me të e të gjithë titujve ose vetëm e atyre të panënshkruar, për shitje të mëtejshme investuesve të mundshëm.
6. Veprimtaria e këshillimit për investime në tituj.
7. Veprimtaritë e lidhura me kleriungun, shlyerjen, kujdestarinë dhe regjistrimin e titujve.
8. Dhurimi, shkëmbimi dhe dhënia hua e titujve.
9. Shitja me qëllim riblerje e titujve dhe/ose anasjelltas.
10. Në përgjithësi çdo lloj operacioni apo veprimi juridik me titujt, që konsiderohet si i tillë nga Autoriteti.

Neni 43

E drejta për të ushtruar veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve

Transaksionet me titujt, si veprimtari tregtare, me përjashtim të veprimtarive të lidhura me kujdestarinë e titujve, mund të kryhen vetëm nga shoqëritë komisionere ose bankat, të cilat janë licencuar nga Autoriteti për të kryer transaksione të tilla dhe kanë objekt të veprimtarisë së tyre kryerjen e këtyre transaksioneve.

Seksioni II

Neni 44

Shoqëritë komisionere

Shoqëri komisionere është shoqëria aksionere, me seli në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e së cilës është kryerja e transaksioneve me titujt, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj, si dhe me licencën e lëshuar nga Autoriteti.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj, për shoqëritë komisionere zbatohen dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare.

Aksionet e një shoqërie komisionere paguhet në të holla dhe shlyhen tërësisht përpara regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar ose përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të rritjes së kapitalit.

Neni 45

Bankat si shoqëri komisionere

Shoqëria aksionere, e cila është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtaritë financiare të parashikuara nga nënndarjet “iii”, “v” dhe “vii” të shkronjës “dh” dhe në shkronjën “e” të pikës 2 të nenit 54 të ligjit nr.9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, mund të kryejë veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga Autoriteti për të ushtruar edhe këtë veprimtari.

Bankat, që kryejnë veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve, zbatojnë dispozitat e këtij ligji për atë pjesë të veprimtarisë që rregullohet nga ky ligj.

Shërbimet për transaksionet me titujt, të ofruara nga bankat, organizohen të shkëputura nga veprimtaritë e tjera bankare, për sa i takon strukturës, organizimit dhe kontabilitetit.

Dispozitat e këtij ligji, që rregullojnë shoqëritë komisionere, zbatohen edhe për bankat që ushtrojnë veprimtari si shoqëri komisionere, për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin që rregullon veprimtarinë e tyre si bankë.

Neni 46

Kufizim për pjesëmarrjen në shoqëritë komisionere

Banka mund të zotërojë aksione vetëm në një shoqëri komisionere.

Shoqëria komisionere, aksioneri i shoqërisë komisionere, individ apo personi juridik, i lidhur me një shoqëri komisionere përmes pronësisë së aksioneve ose interesave të biznesit me një person tjetër juridik, i cili, nga ana tjetër, është aksioner i asaj shoqërie komisionere, nuk mund të ketë as aksione as interesa biznesi në një shoqëri tjetër komisionere.

Neni 47

Licenca për të kryer veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve

Licenca, që lëshohet nga Autoriteti, për të kryer transaksione me titujt, lëshohet me afat të pacaktuar.

Autoriteti e heq licencën për të kryer veprimtari të lidhur me titujt, sipas kushteve të parashikuara nga ky ligj.

Licenca e lëshuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve përfundon:

1. Në ditën e fillimit së procedurës së falimentimit ose të likuidimit të të licencuarit.
2. Kur Autoriteti vendos heqjen e licencës.

3. Kur shoqërisë komisionere, e cila është edhe bankë, me vendim të mbikëqyrësit të tregut bankar, i hiqet licenca si bankë.

4. Me kërkesën e vetë shoqërisë.

Neni 48

Kërkesa për pajisjen me licencë

Autoriteti miraton aktin e themelimit dhe statutin e një shoqërie, që nuk është bankë e që krijohet për të ushtruar veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve, si dhe ndryshimet në këto akte.

Kërkesa për t'u pajisur me licencë për të ushtruar veprimtari të lidhur me transaksione të titujve depozitohet në Autoritet.

Autoriteti miraton rregullore për dokumentacionin shoqërues të kërkesës për licencim.

Përveç dokumentacionit tjetër, që mund të kërkohej nga Autoriteti, kërkesës i bashkëlidhen kopje të noterizuara të dokumenteve të mëposhtme:

1. Akti i themelimit, statuti dhe numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Deklarata nga secili prej aksionerëve të shoqërisë se nuk kanë aksione ose interesa biznesi në një shoqëri tjetër komisionere.
3. Kontrata, që vërteton se shoqëria ka punësuar me kohë të plotë të paktën një komisioner burse dhe/ose një këshilltar investimesh.
4. Dokumentacioni, në bazë të të cilit mund të përcaktohet se ekzistojnë kushtet organike, teknike dhe organizative për ofrimin e shërbimeve, me të cilat lidhet kërkesa për marrjen e licencës.
5. Informacion i hollësishëm për identitetin dhe madhësinë e kapitalit të mbajtur nga aksionerët me pjesëmarrje ndikuese.
6. Mandatpagesa, me të cilën vërtetohet shlyerja e detyrimeve me Autoritetin.
7. Kur kërkuesi është bankë, licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 49

Dhënia e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së lidhur me transaksionet e titujve

Brenda 60 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, Autoriteti merr vendim për kërkesën, për të cilin njofton kërkuenin.

Autoriteti, me vendimin e vet, mund të vendosë miratimin apo refuzimin e kërkesës, ose mund të kërkojë plotësimin e disa kushteve të caktuara për lëshimin e licencës, duke përcaktuar edhe afate. Nëse kërkuesi, që ka paraqitur kërkesën, nuk arrin t'i eliminojë të metat e specifikuar në njoftimin e marrë nga Autoriteti, brenda afatit të përcaktuar prej këtij të fundit, atëherë konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa.

Në vendimin për dhënien e licencës për kryerjen e transaksioneve të titujve, Autoriteti specifikon se për cilat transaksione jepet licenca.

Autoriteti mban një regjistër të shoqërive komisionere dhe të bankave të licencuara për kryerjen e transaksioneve të titujve.

Neni 50

Refuzimi i kërkesës për licencim

Autoriteti refuzon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së lidhur me transaksionet e titujve, nëse:

1. Dispozitat e statutit të shoqërisë bien ndesh me dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Shoqëria komisionere apo aksioneri i shoqërisë anonime zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, aksione ose interesa biznesi në një shoqëri tjetër komisionere.

3. Shoqëria anonime nuk ka të punësuar, të paktën, një komisioner burse dhe/ose këshilltar investimesh.

4. Shoqëria anonime nuk ka në dispozicion kapitalin e nevojshëm.

5. Shoqëria anonime nuk i përmbush kushtet e tjera për kryerjen e transaksioneve, me të cilat lidhet kërkesa për marrjen e licencës.

Neni 51

Bashkimi i shoqërive komisionere

Në rastin e bashkimit të dy shoqërive komisionere, shoqëria e re komisionere, brenda 15 ditëve nga regjistrimi në regjistër, i paraqet Autoritetit kërkesën për t'u pajisur me licencë të re, së bashku me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, sipas këtij ligji. Licencat e marra më parë njësohen menjëherë me një licencë të përkohshme, e cila lëshohet me afat deri në miratimin nga Autoriteti të licencës së re.

Nëse dokumentacioni i paraqitur është i plotë, Autoriteti konfirmon licencën e re brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në rastin kur njëra prej shoqërive komisionere është bankë, afati i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni është 15 muaj.

Neni 52

Kapitali themeltar i shoqërive komisionere

Kapitali themeltar i shoqërive anonime, që kërkojnë të pajisen me licencë për të ushtruar veprimtari në tregun e titujve, për kryerjen e transaksioneve të përcaktuara në pikat 1 dhe 6 të nenit 42 të këtij ligji, nuk mund të jetë më i vogël se 6 000 000 lekë.

Kapitali themeltar i shoqërive anonime, që kërkojnë të pajisen me licencë për të ushtruar veprimtari në tregun e titujve për kryerjen e transaksioneve të përcaktuara në pikat 2, 3, 8 dhe 9 të nenit 42 të këtij ligji, nuk mund të jetë më i vogël se 15 000 000 lekë.

Kapitali themeltar i shoqërive anonime, që kërkojnë të pajisen me licencë për të ushtruar veprimtari në tregun e titujve, për kryerjen e transaksioneve të përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të nenit 42 të këtij ligji, nuk mund të jetë më i vogël se 75 000 000 lekë.

Neni 53

Kapitali likuid neto

Për të siguruar detyrimet e veta ndaj kreditorëve, shoqëria komisionere ekuilibron fondet e veta likuide me detyrimet.

Ekuilibri i përmendur në paragrafin e parë të këtij neni shprehet si tregues i fondeve neto likuide, i cili llogaritet nga pjesëtimi i fondeve likuide, gjithsej, me detyrimet afatshkurtra të shoqërisë komisionere.

Treguesi i fondeve likuide neto të një shoqërie komisionere nuk mund të jetë më pak se një.

Shoqëria komisionere informon një herë në muaj Autoritetin për llogaritjen e treguesit të fondeve likuide neto.

Autoriteti miraton mënyrën e ekuilibrit të likuiditetit të kapitalit dhe procedurat e raportimit përpara Autoritetit.

Neni 54

Konflikti i interesave për drejtuesin e shoqërisë komisionere

Një individ nuk mund të jetë, në të njëjtën kohë, punonjës dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës apo i drejtorisë në më shumë se një shoqëri komisionere.

Neni 55

Hapja e degëve jashtë shtetit të shoqërive komisionere

Shoqëria komisionere mund të krijojë një degë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të kryer transaksione me titujt, në përputhje me ligjet e vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë.

Shoqëria komisionere njofton Autoritetin brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të degës në regjistrin e huaj ose nga marrja e licencës për kryerjen e transaksioneve me titujt jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Njoftimi shoqërohet me kopjet e dokumenteve të mëposhtme:

1. Përktimin dhe kopjen e noterizuar të origjinalit të marrë nga regjistri i huaj, në të cilin është regjistruar dega.
2. Përktimin dhe licencën origjinale për të kryer transaksione me titujt, të lëshuar nga organi i huaj autorizues.
3. Listën e personave të autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë komisionere në veprimtaritë e degës dhe të individëve, të cilët kryejnë transaksione me titujt në atë degë.
4. Në rastin kur shoqëria komisionere është bankë, edhe miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë për hapjen e degës jashtë shtetit.

Neni 56

Dorëzimi i të dhënave

Shoqëritë komisionere, brenda muajit mars të çdo viti, i dërgojnë Autoritetit bilancin dhe raportin vjetor të veprimtarisë tregtare, si dhe i paraqesin Autoritetit raporte periodike 3-mujore të veprimtarisë tregtare dhe pasqyrat financiare.

Përmbajtja e pasqyrave financiare, të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, miratohet nga Autoriteti.

Shoqëria komisionere vë në dijeni Autoritetin brenda tetë ditëve për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në kërkesën për pajisje me licencë.

Neni 57

Heqja e licencës për të kryer transaksione me titujt

Autoriteti shqyrton dhe vendos heqjen e licencës së lëshuar për të kryer transaksione me titujt në rastet kur:

1. Brenda dymbëdhjetë muajve nga lëshimi i licencës, shoqëria nuk arrin të ushtrojë veprimtaritë, për të cilat është lëshuar licenca.
2. Ndërpret veprimtaritë, për të cilat është lëshuar licenca, për të paktën gjashtë muaj.
3. Kryen transaksione me tituj, për të cilat nuk është pajisur me licencë.
4. Kryen veprimtari tregtare, që nuk është e lidhur me transaksionet me titujt.
5. Vepron në kundërshtim me dispozitat e parashikuara në këtë ligj për marrjen në pronësi të aksioneve ose të të drejtave të shoqërive të tjera komisionere.
6. Nuk zbaton dispozitat e parashikuara në këtë ligj për mbajtjen dhe vënien në dispozicion të klientëve të regjistrave.
7. Nuk arrin të njoftojë në kohë klientin për realizimin e porosive.
8. Nuk i mban paratë e dhëna nga klientët, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga ky ligj.

9. Jep hua tituj pa lejen, me shkrim, të titullarit të titujve.
10. Nuk ka më të punësuar komisionerë burse ose këshilltarë investimesh në ato raste kur një gjë e tillë kërkohet ose kur transaksionet me titujt, për llogari të klientit, janë kryer nga persona, të cilët nuk janë as komisionerë burse as këshilltarë investimesh.
11. Nuk arrin t'i japë Autoritetit të dhënat brenda afateve dhe sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
12. Nuk i lejon personat e autorizuar nga Autoriteti për të kryer mbikëqyrjen, sipas dispozitave ligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
13. Nuk arrin të ekzekutojë vendimin e marrë nga Autoriteti, me anën e të cilit urdhërohet të kryejë një detyrim të caktuar brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj ose në vendimin e Autoritetit.
14. Vë në rrezik ose komprometon funksionimin e bursës së një tregu tjetër publik të rregulluar ose të regjistruar të titujve.
15. Nuk i kryen transaksionet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të Autoritetit, me porositë dhe udhëzimet e klientit, ose i kryen ato pa kujdesin e duhur profesional.
16. Gjatë kërkesës për licencë ka depozituar të dhëna të rreme.
17. Nuk i përmbush më kushtet, në bazë të të cilave ka marrë licencën për kryerjen e transaksioneve me titujt dhe nuk arrin të rregullojë gjendjen brenda kohës së vendosur nga Autoriteti.
18. Kur shoqëria komisionere është bankë, i hiqet licenca si bankë.
- Me vendimin për heqjen e licencës, Autoriteti mund të vendosë heqjen, deri në dy vjet, të së drejtës për të rikërkuar pajisjen me licencë.
- Në vendimin për heqjen e licencës, Autoriteti mund të urdhërojë që porositë e pakryera dhe dokumentet e tjera të klientëve të shoqërisë komisionere të transferohen në një shoqëri tjetër komisionere, me pëlqimin e kësaj të fundit.
- Kur Autoriteti e gjykon të arsyeshme, për shkaqet e përmendura në pikat 7, 8, 11, 12, 13 e 14 të paragrafit të parë të këtij neni, mund, në vend të heqjes së licencës, të vendosë një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj, brenda të cilit shoqëria ndërmjetëse duhet të eliminojë parregullsitë. Kur shoqëria komisionere, edhe pas kalimit të afatit të vendosur nga Autoriteti për korrigjimin e gjendjes, nuk ka eliminuar parregullsitë, Autoriteti vendos heqjen e licencës.
- Për çdo vendim të lidhur me heqjen e licencës ose me përcaktimin e afateve për korrigjimin e gjendjes, Autoriteti njofton bursën, tregun publik të rregulluar, si dhe regjistrarin e titujve.

Seksioni III

Komisionerët e bursës dhe këshilltarët e investimeve

Neni 58

Komisionerët e bursës

Komisioneri i bursës është punonjësi i shoqërisë komisionere, i cili licencohet nga Autoriteti dhe është i autorizuar për tregtimin e titujve.

Autoriteti mban një regjistër të komisionerëve të licencuar të bursës.

Autoriteti miraton kriteret, që duhet të plotësohen për t'u pajisur me licencë si komisioner burse.

Autoriteti organizon dhe zbaton programe trajnimi dhe testimi për komisionerët, duke lëshuar certifikatat përkatëse. Autoriteti mund të licencojë institucione të kualifikuara, që të organizojnë programe trajnimi dhe testimi për komisionerët e bursës.

Neni 59

Këshilltarët e investimeve

Këshilltarët e investimeve janë punonjës të shoqërive komisionere, të cilët licencohen nga Autoriteti dhe autorizohen të japin këshilla për investime në tituj.

Autoriteti mban një regjistër të këshilltarëve të licencuar të investimeve.

Autoriteti miraton kriteret, që duhet të plotësojnë individët, për t'u pajisur me licencë për të vepruar si këshilltarë investimesh.

Neni 60

Kërkesa për pajisjen me licencë si komisioner burse ose këshilltar investimesh

Me kërkesën për pajisjen me licencë për ushtrim veprimtarie si komisioner burse ose këshilltar investimesh, personi depoziton edhe kopjen e kontratës së lidhur me shoqërinë komisionere, si dhe një dokumentacion shtesë, sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti.

Neni 61

Dhënia e licencave të komisionerëve të bursës dhe këshilltarëve të investimeve

Autoriteti, pas shqyrtimit të dokumentacionit, lëshon licencën, me anë të së cilës autorizohet ushtrimi i veprimtarisë si komisioner burse ose këshilltar investimesh.

Dispozitat e nenit 57 të këtij ligji zbatohen edhe për heqjen e licencave të komisionerëve të bursës dhe të këshilltarëve të investimeve.

Licencat jepen me afat të pacaktuar.

Kërkesa e personit për marrje licence për ushtrimin e veprimtarisë si komisioner burse ose këshilltar investimesh duhet të shoqërohet me certifikatën e kualifikimit, siç përshkruhet nga Autoriteti.

Neni 62

Veprimtari të tjera të shoqërisë komisionere

Shoqëria komisionere mund të kryejë transaksione me titujt, vetëm nëse ka punësuar, të paktën, një komisioner burse me kohë të plotë.

Shoqëria komisionere mund të kryejë shërbime të këshillimit të investimeve, vetëm nëse ka punësuar, të paktën, një këshilltar investimesh me kohë të plotë.

Shoqëritë komisionere, në secilën prej degëve të tyre, ku kryejnë transaksione me tituj ose ku ofrojnë shërbime të këshillimit të investimeve, punësojnë, të paktën, një komisioner burse ose këshilltar investimesh.

Neni 63

Heqja e licencës së komisionerit të bursës ose të këshilltarit të investimeve

Autoriteti vendos të heqë licencën e lëshuar për të ushtruar veprimtari si komisioner burse apo këshilltar investimesh kur:

1. Konstaton se të dhënat e depozituara bashkë me kërkesën për licencë kanë qenë të rreme.
2. Komisioneri i bursës ose këshilltari i investimeve është dënuar penalisht me vendim të formës së prerë ose nëse me vendim gjykate i është ndaluar të ushtrojë një profesion, i cili përfshihet tërësisht ose pjesërisht në veprimtaritë e shoqërisë ndërmjetëse.
3. Vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
4. Shkel në mënyrë të përsëritur rregullat e bursës ose të tregut publik të rregulluar.
5. Kryen veprimtari, që nuk janë pjesë e përshkrimit të pozicionit të punës të një komisioneri burse apo këshilltari investimesh.

6. Nuk i plotëson më kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca dhe nuk arrin t'i plotësojë këto kushte brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Autoriteti, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se katër muaj.

7. Me kërkesën e tij.

Seksioni IV

Të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë transaksione me tituj

Neni 64

Veprimi në emër të klientëve dhe informacioni konfidencial

Gjatë kryerjes së transaksioneve me titujt, shoqëritë komisionere, anëtarët e këshillave mbikëqyrëse të tyre, komisionerët e bursës dhe këshilltarët e investimeve veprojnë në emër të interesave të klientëve.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere, anëtarët e drejtorisë së shoqërisë komisionere, komisionerët e bursës, këshilltarët e investimeve dhe punonjësit e tjerë të shoqërive komisionere ruajnë fshehtësinë për informacionin për klientët, gjendjen dhe transaksionet e llogarive të klientëve, operacionet e kryera për klientët, si dhe të dhëna e fakte të tjera për transaksionet me titujt për klientët, për të cilat vihen në dijeni. Këto të dhëna konsiderohen informacion konfidencial dhe personat e sipërpërmendur nuk mund t'i përdorin apo t'ua kalojnë të tretëve, me përjashtim të rastit kur kërkohen nga Autoriteti, bursa, tregu publik i rregulluar, organet e tatim-taksave, organet e prokurorisë dhe të gjykatës, ose nëse publikimi i tyre është miratuar nga klienti.

Neni 65

Njoftimet për publikun

Njoftimet publike janë njoftime apo reklama të publikuara në mjetet e komunikimit në masë dhe në mjetet e komunikimit elektronik, që janë në përdorim të publikut.

Vetëm shoqëritë komisionere dhe bankat, që veprojnë si shoqëri komisionere, mund të publikojnë njoftime apo reklama, që ofrojnë transaksione me titujt.

Përmbajtja e njoftimeve apo e reklamave nuk duhet të jetë e tillë që t'i çojë investuesit në konkluzione të gabuara për të drejtat dhe detyrimet e lidhura me titujt apo transaksionet e titujve.

Shoqëritë komisionere dhe bankat, që veprojnë si shoqëri komisionere, depozitojnë në Autoritetin tekstin e njoftimeve apo të reklamave, përpara se ato të publikohen.

Nëse Autoriteti, brenda tri ditëve pune nga paraqitja e tekstit të njoftimit apo reklamës, nuk e ndalon zyrtarisht publikimin e tij, atëherë shoqëritë komisionere apo bankat, që veprojnë si shoqëri komisionere, mund ta publikojnë njoftimin apo reklamën.

Autoriteti ndalon publikimin e reklamave, përmbajtja e të cilave është hartuar në kundërshtim me dispozitat e paragrafit të tretë të këtij neni dhe bie në kundërshtim me këtë ligj ose me rregullat profesionale, të cilat mbrojnë interesat e investitorëve.

Neni 66

Kushtet e përgjithshme të kontratave të porosive

Shoqëria komisionere depoziton në Autoritet kontratat-tip të porosive, që lidh me klientët. Kushtet e përgjithshme të kontratave dhe lista e komisioneve të aplikuara afishohen në të gjitha mjediset, ku ushtron veprimtarinë e saj me investitorët, në vend të dukshëm, i cili arrihet me lehtësi nga investitorët.

Kushtet e përgjithshme të kontratave të porosive përmbajnë dispozita për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të shoqërisë së autorizuar e të investitorit dhe përshkruajnë risqet e lidhura me kryerjen e transaksioneve konkrete.

Shoqëria komisionere informon investitorin për të gjitha rrethanat e nevojshme për marrjen e një vendimi për blerjen apo shitjen ose për transaksione të tjera me titujt dhe, në veçanti, i jep atij informacion të vërtetë për ofertën dhe kërkesën, tregtimin e titujve dhe tendencat e çmimeve të tyre.

Neni 67

Kryerja e transaksioneve me porosi

Porosia në lidhje me transaksionet e titujve është një shprehje e njëanshme e vullnetit të klientit, e dhënë me gojë, me shkrim ose si mesazh elektronik për të porositurin që, në këtë rast është shoqëria e autorizuar dhe që përmban një urdhër, për të kryer një transaksion të caktuar me titujt, në emër të shoqërisë komisionere dhe për llogari të klientit.

Shoqëria komisionere e pranon menjëherë porosinë dhe e regjistron atë në librin e porosive.

Porosia e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni nuk përjashton zbatimin e kushteve të përgjithshme të kontratës, të përmendura në nenin 66 të këtij ligji.

Në librin e porosive regjistrohet çdo ndryshim apo anulim i një porositë, si dhe informacioni për ekzekutimin e porosisë. Çdo ndryshim i sasisë apo çmimit përbën porosi të re dhe regjistrohet si e tillë.

Neni 68

Mbajtja e librit të porosive

Shoqëria komisionere mban në formë elektronike librin e porosive, në të cilin regjistron të gjitha transaksionet, sipas parashikimit të dispozitave të këtij ligji.

Libri i porosive është shuma e të gjitha porosive individuale, të përmendura në nenin 67 të këtij ligji.

Porositë për blerje dhe shitje regjistrohen në librin e porosive, sipas renditjes kohore të marrjes së porosive dhe secilës porosi i vihet një referencë në formën e një numri rendor. Autoriteti miraton rregulla për radhën e ekzekutimit të porosive.

Në librin e porosive regjistrohet çdo ndryshim apo anulim i një porositë, si dhe informacioni për ekzekutimin e porosisë. Porositë, në të cilat sasia e titujve është ulur, mbajnë të njëjtën referencë rendore dhe të njëjtën radhë ekzekutimi. Çdo ndryshim tjetër i sasisë ose i çmimit përbën një porosi të re dhe regjistrohet si e tillë.

Shoqëria ndërmjetëse, sipas kërkesës, i jep menjëherë klientit një listë të porosive, siç rezulton nga libri i porosive.

Të dhënat në librin e porosive dhe ato të regjistruara për porositë janë gjithmonë të njëjta.

Libri i porosive mbahet në mënyrë që të parandalojë ndryshimin e mëpasshëm të të dhënave.

Libri i porosive mbahet për të paktën pesë vjet nga fundi i veprimtarisë tregtare, të cilit i referohet.

Autoriteti miraton përmbajtjen e librit të porosive dhe mënyrën e ruajtjes së tij.

Neni 69

Paratë e klientëve

Shoqëria komisionere i mban paratë e dhëna nga klientët për të paguar titujt apo fondet e realizuara nga shitja e titujve, në një llogari të veçantë ose në llogari të veçanta, të organizuara si llogari e klientit. Paratë e klientit nuk janë pronë e shoqërisë komisionere.

Këto para nuk mund të përfshihen në aktivet e shoqërisë komisionere dhe nuk konfiskohen, si pasojë e pretendimeve të ngritura nga të tretët kundër kësaj shoqërie.

Paratë e vendosura në llogarinë e klientit për blerjen e titujve përdoren në përputhje me porositë e klientit.

Shoqëria komisionere kalon në llogarinë e klientit paratë e siguruar nga shitja e titujve.

Neni 70

Dhënia hua e titujve

Shoqëria komisionere mund të japë dhe të marrë hua titujt, vetëm me miratimin me shkrim të zotëruesve të titujve.

Autoriteti miraton rregullore për kushtet dhe mënyrën e huadhënies së titujve, si dhe kontratën-tip të dhënies hua të titujve.

Neni 71

Detyrimet e shoqërive komisionere për ekzekutimin e porosive

Shoqëria komisionere njofton pa vonesë klientin për çdo transaksion tregtar për porosinë e tij, edhe kur kjo nuk i kërkohet nga klienti.

Kur një shoqëri komisionere blen ose shet titujt, në llogari dhe në emër të vet dhe/ose në llogari të punonjësve të vet, deklaron shprehimisht që porosia është e vetja.

Porosia e shoqërisë komisionere është e barabartë me porositë e tjera dhe nuk ka përparësi në ekzekutim.

Me përjashtim të rasteve kur Autoriteti ka parashikuar ndryshe, shoqëria komisionere i paraqet menjëherë sistemit të tregtimit të bursës porositë për të blerë ose shitur tituj të kuotuar në bursë.

Shoqëria komisionere mund të paraqesë, njëkohësisht, disa porosi për blerjen ose shitjen e titujve të një emetuesi, me të njëjtat kushte për çmimin dhe llojin e porosisë në sistemin e tregtimit të bursës ose të tregut publik të rregulluar, me përjashtim të rastit kur mundësia e realizimit të porosisë ulet nga kjo paraqitje sasiore.

Tregtimi, sipas paragrafit të mësipërm, është tregtim në bllok dhe bëhet në seanca të veçanta tregtimi.

Seksioni V

Neni 72

Kujdestaria e titujve

Operacionet e lidhura me kujdestarinë e titujve janë:

1. Mbajtja dhe ruajtja e titujve.
2. Raportimi për pagesat e dividendëve, interesave dhe instrumenteve të tjera të arkëtueshme.
3. Informimi për takimet e emetuesve të titujve dhe të drejtat e lidhura me aksionet dhe titujt e tjerë, të vënë në kujdestari dhe ekzekutimi i porosive të klientëve për përmbushjen e këtyre të drejtave.
4. Informimi për ndryshimet ligjore, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, prekin raportimin të klientit për gjendjen e llogarisë në kujdestari.
5. Shërbimi i organizimit të asamblesë së përgjithshme.
6. Shërbime të tjera, të lidhura me titujt, si përmbushja e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga titujt, siç është rënë dakord ndërmjet klientit dhe kujdestarit dhe që nuk bien në kundërshtim me ligjin.

Shërbimi i kujdestarisë së titujve rregullohet me një kontratë, sipas së cilës kujdestari merr përsipër të kryejë një apo më shumë nga operacionet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, për llogari të klientit dhe mbi bazën e një komisioni.

Operacionet e lidhura me kujdestarinë e titujve kryhen nga banka të autorizuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, me vendim të Autoritetit.

Për kryerjen e veprimtarisë së lidhur me kujdestarinë e titujve, kujdestari organizon njësi të veçanta brenda strukturës së vet.

Autoriteti miraton kushtet e kryerjes së transaksioneve, që lidhen me kujdestarinë e titujve, si dhe kontratën-tip të vënies në kujdestari të titujve.

Neni 73

Llogaritë e titujve në kujdestari

Kujdestari bashkë me regjistrarin hapin një llogari kujdestarie të titujve të dematerializuar. Kujdestari dhe regjistrari mund të hapin një llogari kujdestarie, e cila mund të organizohet si llogari me emër të përbashkët, llogari me kod të përbashkët ose llogari e përbashkët.

Me porosi të klientit, kujdestari mund të administrojë tituj në llogari kujdestarie.

Titujt në llogari kujdestarie janë pronë e klientit dhe nuk mund të përfshihen në pronën e kujdestarit dhe aktivet e tij, në rastin e likuidimit ose të falimentimit dhe as nuk mund të konfiskohen për pretendime të ngritura nga të tretët kundër kujdestarit.

Kujdestari i administron këto llogari si para të klientit, në përputhje me nenin 76 të këtij ligji.

Kujdestari mban përgjegjësi për të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj klientit, për shkak të zbatimit jo të mirë të kontratës, përfshirë edhe humbjen e fitimit.

Neni 74

Raportimi tek Autoriteti

Autoriteti mund t'i kërkojë kujdestarit të japë raporte të rregullta, që përmbajnë të dhëna për të gjithë klientët dhe sasitë e titujve në kujdestari.

Neni 75

Libri i kujdestarisë

Kujdestari bën regjistrime të posaçme për çdo klient, për titujt të cilët ka në kujdestari.

Kujdestari mban një libër kujdestarie, me të dhëna për të gjitha porositë për blerjen dhe shitjen e titujve.

Libri i kujdestarisë mbahet në të njëjtën mënyrë si libri i porosive, i përmendur në këtë ligj.

Autoriteti mund të kontrollojë, në çdo kohë, librin e kujdestarisë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër.

Kujdestari informon, brenda 24 orëve, klientin për çdo marrëveshje të nënshkruar sipas porosisë së klientit, edhe atëherë kur kjo nuk kërkohet nga klienti.

Dispozitat e parashikuara në këtë ligj për mbajtjen në kujdestari të titujve të dematerializuar zbatohen edhe për titujt, që emetohen në formën e dokumenteve.

Neni 76

Administrimi i portofolëve të titujve në emër të klientëve

Operacionet, që lidhen me investimet e parave në tituj me administrimin e titujve të klientit, kryhen nga shoqëria komisionere, kundrejt një pagese, sipas kontratës së lidhur për administrimin e portofolëve të titujve, në emër të shoqërisë ose në emër të klientëve.

Shoqëria komisionere mund të investojë fondet e klientit vetëm në:

- a) titujt e tregtuar në një bursë në Republikën e Shqipërisë;
- b) bursat e rregulluara, të huaja;
- c) titujt e emetuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria komisionere, që administron një portofol titujsh, në emër të vet dhe/ose në emër të klientit, i mban titujt në llogari të klientit, të veçuara nga prona e vet.

Për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të portofolëve të titujve, shoqëria komisionere mund të angazhojë një ose më shumë individë, të cilët janë licencuar nga Autoriteti si

administratorë të portofolëve të titujve. Rregullat për licencimin e individëve, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari si administratorë të titujve, miratohen nga Autoriteti.

Neni 77

Fusha e zbatimit të ligjit në administrimin e portofolit të titujve

Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me tregtimin e titujve në emër të vet dhe për llogari të klientit, zbatohen siç duhet edhe për operacionet, që lidhen me menaxhimin e portofolit të titujve, për llogari të klientit.

KREU III TREGTIMI I TITUJVE

Seksioni I

Neni 78

Licenca e ushtrimit të veprimtarisë si bursë

Tregtimi i titujve bëhet në mënyrë të organizuar në bursa të ngritura për të krijuar kushtet për përputhjen e ofertës me kërkesën e titujve.

Bursat, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, licencohen nga Autoriteti.

Autoriteti miraton kushtet, që duhet të përmbushin bursa dhe tregjet e tjera të rregulluara, për realizimin e qëllimit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe kufizimet për pjesëmarrësit në kapitalin bazë.

Brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, shoqëruar me dokumentacionin e plotë të kërkuarit, Autoriteti merr vendim për miratimin apo refuzimin e dhënies së licencës, për të cilin njofton menjëherë kërkuarin.

Neni 79

Bursat e titujve

Bursa e titujve krijohet si shoqëri aksionere, në përputhje me dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare dhe të këtij ligji.

Bursa e titujve siguron personel, pajisje, kushte teknike dhe organizim të tillë që:

1. Të gjithë anëtarët e bursës të mund të bëjnë dhe të pranojnë oferta për blerjen dhe shitjen e titujve, në mënyrë të njëkohshme, të barabartë dhe me të njëjtat kushte.

2. Të gjithë anëtarët e bursës të mund të marrin informacion tregu për titujt, që po tregtohen në të njëjtin çast dhe të mund t'i shesin ose t'i blejnë ato me të njëjtat kushte.

Në tregtimin në bursë marrin pjesë shoqëritë komisionere, të cilat janë anëtare të bursës. Anëtarësimi në bursë bëhet në përputhje me kushtet e anëtarësisë, të përcaktuara në rregulloren e bursës. Bursa pranon si anëtare të vetën çdo shoqëri komisionere, të licencuar nga Autoriteti e që plotëson kushtet anëtarësisë.

Neni 80

Kapitali minimal i bursave dhe aksionet

Kapitali minimal i një burse është 20 000 000 lekë.

Aksionet e bursës janë aksione të zakonshme dhe të regjistruara.

Neni 81

Kompetenca e bursës për të miratuar rregullore

Bursa, sipas rregulloreve të miratuara nga Autoriteti, përcakton organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e regjistrimit, të listimit dhe të tregtimit.

Autoriteti shqyrton rregulloret e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni brenda 60 ditëve nga data e regjistrimit të rregullt të kërkesës për miratim.

Kërkesa e përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni shoqërohet me pagesën e kuotave dhe të tarifave të përcaktuara për Autoritetin.

Neni 82

Raportimi i detyrueshëm

Bursat publikojnë dhe i paraqesin Autoritetit raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore, në të cilat përfshihen të dhëna për tregtimin, së bashku me çmimet dhe sasitë:

- a) e transaksioneve të negociuara;
- b) e transaksioneve të kryera në bursë nga pjesëmarrësit në tregtim.

Transaksion i negociuar është transaksioni me tituj ndërmjet dy investitorëve institucionalë, në emër dhe për llogari të tyre, që kryhet jashtë orareve zyrtare të bursës.

Bursa i mundëson, pa pagesë, Autoritetit monitorimin me lidhje të drejtpërdrejtë kompjuterike me sistemin e tregtimit të bursës.

Neni 83

Paanshmëria

Bursa nuk kryen transaksione me titujt dhe as mund të japë këshilla për tregtimin dhe investimin në tituj apo të japë mendime për avantazhet ose disavantazhet e blerjes apo të shitjes së titujve.

Bursat i paraqesin publikut vetëm avantazhet e regjistrimit të titujve në listën e bursës dhe avantazhet e tregtimit publik të organizuar.

Neni 84

Kriteret për emërimin e drejtorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të bursës

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të bursës mund të jenë personat që:

- a) janë shtetas shqiptarë ose të huaj;
- b) kanë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Ekonomisë ose në Fakultetin e Drejtësisë;
- c) kanë përvojë të paktën dyvjeçare në administrimin e shoqërive tregtare, në bankë, financë ose kontabilitet;
- ç) nuk janë dënuar nga gjykata për vepra penale në fushën e shoqërive tregtare, tatim-taksave apo ekonomike-financiare.

Në raportin vjetor të bursës publikohen informacione për pjesëmarrjen e anëtarëve në takimet e këshillit mbikëqyrës, si dhe për shpërblimet e anëtarëve të këtij këshilli.

Drejtorë të bursës mund të jenë personat që:

- a) janë shtetas shqiptarë;
- b) kanë mbaruar studimet e larta në fushat e ekonomisë, financës, kontabilitetit, biznesit, drejtësisë ose informatikës;
- c) nuk janë dënuar nga gjykata për vepra penale në fushën e shoqërive tregtare, tatim-taksave apo ekonomike-financiare.

Anëtarët e drejtorisë dhe të këshillit mbikëqyrës të bursës, si dhe punonjësit e bursës nuk

mund të jenë anëtarë të drejtorive ose të këshillave mbikëqyrëse të shoqërive komisionere apo të emetuesve të titujve, të cilët janë regjistruar në bursë.

Autoriteti miraton emërimin e drejtorëve dhe të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të bursës.

Autoriteti mund të miratojë kritere të tjera shtesë për individët, që kërkojnë të ushtrojnë detyrën e drejtorit apo të anëtarit të këshillit mbikëqyrës të bursës.

Neni 85

Informacioni konfidencial

Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me konfidencialitetin profesional, zbatohen edhe për punonjësit dhe anëtarët e drejtorisë dhe të këshillave mbikëqyrëse të bursës.

Kryetari i këshillit drejtues, një herë në muaj, i paraqet raport Autoritetit për marrjen ose dhënien në pronësi të titujve të personave të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Autoriteti miraton rregullore për mënyrat e përdorimit të informacionit konfidencial.

Neni 86

Kuotimet dhe listimi

Bursa, me rregullore, miraton kushtet e regjistrimit të titujve në kuotime të bursës, si dhe kushtet e listimit. Këto rregullore miratohen nga Autoriteti.

Kërkesat për listim lidhen me të gjithë titujt e një klase të një emetuesi.

Kuotimi është tregtimi i titujve në sesionet e tregtimit në bursë.

Listimi është regjistrimi në listën zyrtare të bursës dhe nuk përfshin kuotimin e titujve.

Neni 87

Negociueshmëria e titujve

Titujt e listuar në një bursë janë tërësisht të negociueshëm dhe të paguar.

Negociueshmëri e plotë do të thotë negociueshmëri e pakushtëzuar dhe e pakufizuar, pavarësisht vendit dhe mënyrës, me të cilën janë marrë në pronësi titujt, si për tregtimin në bursë dhe për mënyrat e tjera të marrjes në pronësi të titujve, në mënyrë të ligjshme.

Nuk mund të listohen në bursë aksionet e shoqërive anonime, transferimi i të cilave kushtëzohet nga miratimi i organeve vendimmarrëse të shoqërisë.

Neni 88

Pezullimi, heqja e listimit në bursë dhe anulimi i transaksioneve

Bursa miraton rregulla për pezullimin ose heqjen e një listimi në bursë të titujve, të cilat miratohen nga Autoriteti. Bursa, pa vonesë, njofton Autoritetin për vendimin e marrë.

Autoriteti, nëse mendon se kjo është e domosdoshme, për të garantuar funksionimin e tregut ose mbrojtjen e investuesve, pa vonesë, vendos pezullimin e një listimi në bursë ose anulimin e një listimi të caktuar.

Neni 89

Kompetenca e Autoritetit dhe e bursës në tregtimin e titujve

Autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, përveç rregullores së bursës, mund të miratojë rregulla për kushte shtesë, për listimin e titujve në kuotime të bursës.

Neni 90
Raporti financiar

Emetuesit e titujve të listuar në bursë nxjerrin dhe publikojnë, rregullisht, raporte financiare vjetore, gjashtëmujore dhe tremujore për veprimtarinë e tyre.

Autoriteti miraton rregullore për kushtet për publikimin dhe përmbajtjen e raporteve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.

Emetuesit e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, aksionet e të cilëve janë regjistruar në kuotimet e bursave të vendeve anëtare të Bashkimit European, mund të nxjerrin raporte për veprimtarinë e tyre, sipas këtij ligji ose akteve normative të vendeve anëtare të Bashkimit European.

Neni 91
Heqja e licencës së bursës

Nëse gjatë mbikëqyrjes konstatohen parregullsi ose paligjshmëri në veprimtarinë e bursës, Autoriteti mund të vendosë heqjen e licencës së bursës.

Seksioni II

Neni 92
Tregtimi i titujve ndërmjet investitorëve institucionalë

Autoriteti, me vendim, i njeh personit juridik statusin e investitorit institucional, nëse konstaton se ky person juridik:

- a) investon fondet e veta në tituj, për llogari të vet ose për të mbrojtur veprimtarinë tregtare nga risqet e tregut;
- b) ka përvojë në investimin dhe tregtimin e titujve.

Përmes mbylljes së një transaksioni të negociuar, investitorët institucionalë pranojnë përgjegjësinë e tyre për të gjitha risqet, që mund të lindin nga një transaksion i tillë.

Bursat, shoqëritë komisionere, emetuesit e titujve dhe regjistrarët e titujve nuk mund të jenë investitorë institucionalë.

Investitori institucional, që bëhet blerës në një transaksion të negociuar, njofton, me shkrim, për shitjen bursën, në të cilën janë kuotuar titujt, përmes sistemit të tregimit.

Njoftimi përmban të dhëna për çmimin dhe sasinë e titujve, që kanë qenë objekt i transaksionit.

Autoriteti miraton rregullore për afatet e njoftimit, si dhe përmbajtje të tjera shtesë të njoftimit, të përmendura në paragrafin e pestë të këtij neni.

KREU IV
KUFIZIMET PËR VEPRIMTARITË E LIDHURA ME TITUJT

Neni 93
Informacioni i privilegjuar

Informacion i privilegjuar janë të gjitha faktet, të cilat nuk janë bërë të njohura publikisht dhe të cilat i përkasin një ose më shumë emetuesve të titujve ose janë të lidhura me vetë titujt dhe të cilat, nëse do të viheshin në dispozicion të publikut, mund të ndikonin në tregun e bursës ose në çmimin e titujve. Informacion i privilegjuar konsiderohet informacioni për rrethanat, të cilat nuk janë të njohura publikisht e që kanë të bëjnë me porosi të palëve të treta për blerjen ose shitjen e instrumenteve financiare ose derivative, të cilat pjesëmarrësit në treg presin t'i marrin në përputhje me praktikën e njohura të tregut.

Autoriteti miraton rregullore për mënyrat e parandalimit të keqpërdorimit të informacionit të privilegjuar.

Neni 94

Ndalimi i shpalljes dhe i përdorimit të informacionit të privilegjuar

Të gjithë personat e përmendur në këtë nen i japin Autoritetit të dhënat e kërkuara, për të vendosur nëse është keqpërdorur apo jo informacioni i privilegjuar.

Personat, që zotërojnë informacion të privilegjuar, janë ata persona, të cilët marrin informacione të privileguara gjatë kryerjes së punës, profesionit ose detyrës së tyre.

Anëtarët e drejtorisë, këshillave mbikëqyrëse ose organeve të tjera të emetuesit, të barazvlefshme me to, janë ata persona, të cilët zotërojnë informacion të privilegjuar, që lidhet me emetuesin apo shoqërinë që kontrollon emetuesi.

Për qëllim të këtij ligji, edhe personat e lidhur konsiderohen persona që zotërojnë informacion të privilegjuar.

Anëtarët e organeve drejtuese, këshillave mbikëqyrës dhe punonjësit e shoqërive komisionere nuk mund të shpërndajnë informacionin e privilegjuar për titujt apo për emetuesit e tyre, të cilin e marrin gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Ky detyrim vazhdon edhe pasi ata i kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare të punës me shoqërinë komisionere.

Shoqëritë komisionere, të cilat vihen në dijeni për informacionin e privilegjuar nuk mund të blejnë apo të shesin titujt për llogari të tyre dhe as të këshillojnë në lidhje me titujt, me të cilat lidhet informacioni i privilegjuar.

Personat që zotërojnë informacion të privilegjuar, si dhe personat që vihen në dijeni për informacionin e privilegjuar, në mënyrë të paautorizuar dhe që janë të ndërgjegjshëm për natyrën e këtij informacioni nuk mund:

1. Të përfitojnë nga informacioni i privilegjuar gjatë blerjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të titujve të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë ose titujve të emetuar nga emetues të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se në cilin treg tregtohen.

2. Të shpërndajnë në publik informacionin e privilegjuar ose t'u japin palëve të treta.

3. Të përfitojnë nga informacioni i privilegjuar për t'u dhënë këshilla palëve të treta për blerjen ose shitjen e titujve të përmendur në paragrafin e pestë të këtij neni.

Personat që zotërojnë informacion të privilegjuar mund ta shpallin informacionin, vetëm nëse janë të autorizuar për të vepruar me ligj ose me akte, të cilat rregullojnë veprimtarinë ose detyrat që kryejnë ata.

Personave të përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni u kërkohet që, brenda 15 ditëve, duke filluar nga data kur është kryer transaksioni, t'i raportojnë emetuesit, Autoritetit dhe bursës çdo transaksion, me anën e të cilit marrin ose japin në pronësi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, titujt të emetuesve të renditur në paragrafët e dytë dhe të tretë të këtij neni, sipas dispozitave të parashikuara në nenet 106 dhe 107 të këtij ligji.

Neni 95

Detyrimet e emetuesit për informim

Emetuesi i titujve, i regjistruar në bursë, informon menjëherë publikun për të gjitha informacionet, që lidhen me rrethanat apo vendimet, që përbëjnë fakte me rëndësi materiale. Faktet, që konsiderohen me rëndësi materiale, përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Autoriteti.

Fakte me rëndësi materiale, për qëllime të paragrafit të parë të këtij neni, janë të gjitha informacionet dhe faktet, që mund të ndikojnë në çmimin e titujve.

Autoriteti miraton rregullore për mënyrën e dhënies dhe të përmbajtjes së informacionit, të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 96

Përfshirje nga detyrimi për të informuar

Kur një emetues nuk është në gjendje të publikojë informacionin e përmendur në nenin 97 të këtij ligji, për arsye se kjo do të vinte në rrezik interesat e vet të ligjshëm, emetuesi informon Autoritetin.

Autoriteti mund të vendosë përfshirjen nga ky detyrim për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

Neni 97

Detyrimi për dëshmipërbli, për shkak të mosrespektimit të detyrimit për informim

Në qoftë se emetuesi nuk publikon menjëherë informacionin e detyrueshëm për publikim, sipas parashikimeve të këtij ligji, në rastin kur një palë e tretë ka blerë instrumente financiare, ai detyrohet t'i kompensojë palës dëmin e shkaktuar nëse:

I ka blerë ato pasi i është mohuar e drejta për informim dhe i ka ende në zotërim deri në çastin që informacioni bëhet publik.

I ka blerë ato para lindjes së informacionit, që duhej të bëhej publik dhe i shet ato pasi i është mohuar e drejta për informim.

Në rast se emetuesi provon se mungesa e publikimit nuk është bërë me dashje apo në kushtet e neglizhencës, ai nuk është përgjegjës për dëmet e shkaktuara, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Nuk konsiderohet si dëm, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, në qoftë se në rastin e pikës 1 të këtij neni pala e tretë, në çastin e blerjes, ka pasur dijeni për mospublikimin e informacionit dhe nëse në rastin e pikës 2 të këtij neni pala e tretë, në çastin e shitjes, ka pasur dijeni për mungesën e njoftimit të informacionit.

Neni 98

Manipulimi i çmimeve

Për të shmangur krijimin e një përshtypjeje të rreme për tregun ndalohet:

1. Kryerja e një transaksioni me titujt, në mënyrë të tillë që realizimi nuk çon në ndryshim të mbajtësit të titujve, ose në mënyra të tjera, të cilat synojnë të duken sikur po realizohet një transaksion tregtar.

2. Dhënia e një urdhri për blerjen ose shitjen e titujve, duke e ditur që është dhënë apo do të jepet një urdhër për shitjen ose blerjen e këtyre titujve, me një çmim përafërsisht të njëjtë, nga i njëjti person ose person tjetër, në mënyrë që të duket sikur ka tregtim të vërtetë apo me qëllim që të krijohet një çmim fiktiv.

Ndalohen transaksionet me titujt me qëllim:

1. Rritjen e çmimit të titujve përkatës dhe nxitjen e investitorëve të tjerë për t'i blerë këta tituj.
2. Uljen e çmimit të titujve përkatës dhe nxitjen e investitorëve për t'i shitur këta tituj.
3. Rritjen e volumit të tregtimit, duke lënë përshtypjen sikur ka tregtim aktiv të titujve përkatës dhe nxitjen e investitorëve të tjerë për t'i blerë dhe/ose për t'i shitur këta tituj.

Neni 99

Përfshirja e informacionit të rremë

Përfshirja e informacioneve të rreme, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në vëllimin e tregtimit apo në çmimin e titujve, është e ndaluar.

Neni 100

Përgjegjësia e dëmit të shkaktuar, për shkak të publikimit të informacionit të rremë

Në rast se emetuesi i lejuar për tregtim në bursë brenda vendit publikon një informacion të rremë, detyrohet të kompensojë palët e treta për dëmin e shkaktuar, që rrjedh nga besimi për vërtetësinë e informacionit, nëse pala e tretë:

1. Ka blerë tituj pas publikimit të informacionit të rremë dhe i zotëron ende ato në çastin kur bëhet e ditur publikisht se informacioni ishte i pasaktë.

2. Ka blerë tituj përpara publikimit të informacionit të rremë dhe i ka shitur ato përpara se të bëhej e qartë se informacioni ishte i pasaktë.

Në rast se emetuesi provon se publikimi i informacionit të rremë nuk është bërë me dashje apo në kushtet e neglizhencës, ai nuk është përgjegjës për dëmet e shkaktuara, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Nuk konsiderohet si dëm, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, nëse në rastin e pikës 1 të këtij neni pala e tretë, në çastin e blerjes, ka pasur dijeni se informacioni ishte i rremë dhe nëse në rastin e pikës 2 të këtij neni pala e tretë, në çastin e shitjes, ka pasur dijeni se informacioni i publikuar ishte i pasaktë.

Përveç parashikimeve të këtij neni, për përgjegjësinë për publikimet mashtruese ose të pasakta zbatohen dispozitat e nenit 617 të Kodit Civil.

Neni 101

Ndalimi i tregtimit të motivuar nga komisionet

Shoqërive komisionere, të cilat menaxhojnë portofolin e titujve të klientëve, u ndalohet të shesin tituj apo të japin porosi për shitjen e tyre, ose të blejnë apo të japin porosi për blerjen e tyre vetëm me synimin për të fituar komisione për këto shërbime.

KREU V

MBROJTJA E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË LIDHURA ME TITUJT

Seksioni I

Garancia për përmbushjen e detyrimeve të lidhura me titujt

Neni 102

Ndalimi i garantimit të pagesës së dividendëve

Detyrimi i emetuesit për të paguar dividendët nuk sigurohet me garanci bankare, dorëzani apo formë tjetër garancie.

Çdo dorëzani apo garanci e pagesës së dividendit të ardhshëm konsiderohet e pavlefshme.

Neni 103

Garancia për pagesën e interesit dhe të principalit

Detyrimi i emetuesit të titujve për të paguar principalin, interesin dhe titujt e borxhit mund të sigurohet përmes një garancie bankare, dorëzanie apo forme të ngjashme me to, e cila duhet të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të të gjithë titujve të së njëjtës klasë.

Neni 104

Hipoteka e pronave të paluajtshme, vënia garanci e titujve të borxhit

Detyrimi i emetuesit për të paguar principalin dhe interesin mund të sigurohet përmes një

barre hipotekore për prona të paluajtshme dhe vënieje si garanci për tituj, vlera e të cilave nuk duhet të jetë më e vogël se detyrimi total i emetuesit për të gjithë titujt e garantuar.

Gjatë periudhës së vendosjes si garanci për titujt e dematerializuar, barra mbi to regjistrohet në regjistrarin e titujve dhe titujt e emetuar në formën e dokumenteve depozitohen në bankë.

Vlera e pasurive të paluajtshme dhe e titujve të lëna peng përcaktohet nga një ekspert ligjor i autorizuar nga Autoriteti.

Neni 105 **Shoqëritë publike**

Brenda 30 ditëve nga data e emetimit të aksioneve në ofertë publike, shoqëritë aksionere regjistrojnë aksionet në kuotim burse. Nga ky çast shoqëria aksionere konsiderohet si shoqëri me ofertë publike apo shkurt shoqëri publike.

Gjatë regjistrimit të aksioneve në kuotim, shoqëria publike publikon prospekte të shkurtuara. Kushtet për regjistrim përcaktohen nga bursa.

Shoqëritë publike, brenda 20 ditëve nga dita e fundit e çdo tremujori, i paraqesin Autoritetit raporte tremujore financiare dhe të veprimtarisë dhe, brenda 30 ditëve nga dita e fundit e çdo tremujori, i paraqesin atij raportet e konsoliduara. Raportet financiare dhe ato të veprimtarisë për tremujorin e katërt i paraqiten Autoritetit brenda 90 ditëve nga përfundimi i vitit financiar.

Autoriteti miraton rregullore për formën dhe përmbajtjen e raporteve të përmendura në paragrafin e tretë të këtij neni.

Raportet e përmendura në paragrafin e tretë të këtij neni dhe të depozituara në Autoritet vihen në dispozicion të publikut.

Përpara regjistrimit të titujve në kuotim në bursë, shoqëritë publike dërgojnë të dhëna për titujt dhe titullarët e tyre, brenda periudhave dhe sipas mënyrës së dhënies së informacionit, të përcaktuar në rregulloren e brendshme të regjistrarit, të miratuar nga Autoriteti.

Dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni nuk zbatohen për shoqëritë publike, për të cilat kanë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit, deri në përfundim të këtyre procedurave.

Seksioni II **Mbrojtja e investitorëve**

Neni 106 **Detyrimi për t'i raportuar ndryshimet në pronësinë e aksioneve**

Kur një person merr ose jep në pronësi aksione të një shoqërie publike dhe, për pasojë të këtij fakti, përqindja e votave të asamblesë, që ka ky person, kalon ose bie poshtë kufijve 5 për qind, 10 për qind, 25 për qind, 30 për qind, 50 për qind dhe 75 për qind të numrit të përgjithshëm të aksioneve, personi, brenda 15 ditëve, njofton me shkrim Autoritetin dhe emetuesin për transferimin e bërë.

Periudha e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni fillon nga çasti i mbylljes së transaksionit në fjalë ose nga çasti i lindjes së faktit, në të cilin mbështetet kalimi i të drejtave mbi aksionet, pavarësisht regjistrimit në librin e aksioneve apo në regjistrimin e regjistrarit. Transaksioni i bërë në përputhje me ligjin quhet i mbyllur, pavarësisht nëse në marrëveshjen për transferimin e të drejtave është parashikuar një kusht për shtyrje në afat.

Njoftimi i përmendur në paragrafin e parë të këtij neni përmban:

1. Emrin, mbiemrin, numrin e regjistrimit në regjistrin e gjendjes civile, si dhe vendin e banimit të personit, që ka marrë ose ka dhënë në pronësi aksionet, emrin, selinë dhe numrin e regjistrimit të personit juridik, emrin, mbiemrin, numrin personal të regjistrimit në zyrën e gjendjes civile dhe vendin e banimit të përfaqësuesit ligjor të personit juridik, që ka marrë ose ka dhënë në pronësi aksionet.

2. Marrëveshjen për transferimin e të drejtave mbi aksionet.
3. Numrin e aksioneve, të marra ose të dhëna në pronësi, përqindjen në kapitalin themeltar të emetuesit, në bazë të aksioneve të marra ose të dhëna në pronësi, numrin e të drejtave të votimit gjithsej në asamblenë e përgjithshme, të aksioneve të marra ose të dhëna në pronësi.
4. Numrin gjithsej të aksioneve, që nënkupton përqindjen e kapitalit themeltar të emetuesit, pas marrjes ose dhënies në pronësi të aksioneve.

Neni 107

Detyrimi për të informuar publikun dhe përjashtimet

Shoqëria publike emetuese, menjëherë pas marrjes së njoftimit të përmendur në nenin 106 të këtij ligji, njofton zyrtarisht bursën, ku është kuotuar dhe brenda shtatë ditëve e publikon njoftimin në buletin e njoftimeve publike.

Nëse emetuesi mendon se publikimi i njoftimit të përmendur në nenin 106 të këtij ligji mund t'i shkaktojë dëme të rënda dhe nëse publiku, edhe pa publikimin e njoftimit, do të jetë në gjendje të vlerësojë aksionet, për të cilat bën fjalë njoftimi, brenda tri ditëve nga marrja e njoftimit i kërkon me shkrim Autoritetit përjashtimin, përkohësisht, nga ky detyrim, për një periudhë kohe, e cila vendoset nga Autoriteti dhe, në çdo rast, nuk mund të jetë me e gjatë se tre muaj.

Nëse brenda shtatë ditëve nga marrja e kërkesës së parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni, Autoriteti nuk merr një vendim, kërkesa konsiderohet e refuzuar dhe emetuesi e përmbush detyrimin e vet për publikimin e njoftimit brenda shtatë ditëve.

KREU VI

RREGULLAT PËR ADMINISTRIMIN E KËSHILLTARIT TË INVESTIMEVE E PËR ANALIZAT FINANCIARE DHE KUFIZIMIN PËR SHPËRBLIMIN, PËR SHKAK TË SHKAKTIMIT TË DËMIT

Neni 108

Dispozita të përgjithshme për administrimin

Këshilltarët e investimeve janë shoqëri, të cilat krijohen për t'u siguruar investimeve një shkallë ekspertize dhe kujdesi në interes të klientëve, si dhe për të evituar konfliktet e interesit dhe për të siguruar përmbushjen e detyrimeve në interes të klientit.

Për realizimin e sa më sipër, ato, për aq sa është i nevojshëm e në mbrojtje të interesave të tyre, mund t'u kërkojnë klientëve të dhëna, që provojnë aftësitë për transaksionet e titujve për realizimin e investimit, qëllimin e transaksioneve, gjendjen financiare, si dhe t'u ofrojnë klientëve informacionin.

Neni 109

Dispozita të veçanta për administrimin

Administratorët, aksionerët ose punëmarrësit e tjerë të këshilltarit të investimeve ndalohen:

- a) t'u ofrojnë konsulencë klientëve të shoqërisë për blerjen ose shitjen e titujve, në rast se ofrimi i kësaj konsulence nuk është në përputhje me interesat e klientit;
- b) të kryejnë transaksione për llogari të vet, bazuar në të dhënat e një klienti për blerjen dhe shitjen e titujve, që mund të shkaktojnë dëme në kapitalin themeltar.

Neni 110

Rregulla organizative për këshilltarin e investimeve

Këshilltari i investimeve:

1. Organizohet, në mënyrë që të evitohet shfaqjen e konfliktit të interesave ndërmjet tij dhe klientëve ose ndërmjet vetë klientëve.

2. Ushtron procedura të brendshme kontrolli, të përshtatshme për parandalimin e shkeljeve, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 111

Kërkesat për ruajtjen e regjistrimeve

Këshilltari i investimeve, për përmbushjen e shërbimeve në investime, ruan të dhëna për:

- a) emetimin dhe udhëzimet e nevojshme, që lidhen me klientin, si dhe ekzekutimin e tyre;
- b) emrin e punonjësit, që ka pranuar kërkesën e klientit, afatin e paraqitjes së kërkesës, si dhe ekzekutimin e saj;
- c) komisionet dhe tarifat, që i ngarkohen klientit për kërkesën;
- ç) udhëzimet e dhëna nga klienti, si dhe pozicionimin e kërkesës me palët e treta.

Neni 112

Ndarja e aseteve

Këshilltari i investimeve, që nuk është i ngarkuar me ruajtjen e depozitave, ndan paratë e klientit, të mbajtura në ruajtje e që janë pranuar për shërbime këshillimi të investimit, për t'u përdorur në emër të këshilltarit e për llogari të klientit, nga mjetet monetare të saj dhe llogaritë e klientëve të tjerë.

Përpara kalimit të parave në ruajtje, këshilltari i investimeve njofton bankën për depozitim të vlerave monetare, për llogari të një pale të tretë.

Neni 113

Afati i reklamimit të dëmit

Shqyrtimi i ankesave të klientëve për dëmet e shkaktuara nga këshilltari i investimeve, për mospërmbushje të detyrimit për dhënie informacioni, bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 114

Analiza e instrumenteve financiare

Personat, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre profesionale apo tregtare, përgatisin informacione, që lidhen me instrumente financiare ose emetuesit e tyre, të cilat përmbajnë rekomandime, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për vendimmarrje në fusha investimi dhe synojnë t'i shpërndajnë këto informacione në grupe të paspecifikuara apo për individë, duhet të veprojnë në shkallën e nevojshme të ekspertizës dhe kujdesit.

Analizat financiare komunikohen ose shpërndahen publikisht, vetëm nëse ato janë përgatitur dhe dërguar në mënyrën e duhur dhe vetëm nëse, së bashku me analizat, janë deklaruar edhe:

- a) identiteti i personit përgjegjës për komunikimin dhe shpërndarjen e analizave financiare;
- b) rrethanat dhe marrëdhëniet, që mund të krijojnë konflikt interesi ndërmjet autorëve, personave përgjegjës për përgatitjen e analizave financiare ose veprimeve që lidhen me to.

Shoqëritë, që përgatisin dhe publikojnë analiza financiare, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, organizohen në mënyrë të tillë që:

- a) të evitojnë konfliktin e interesave;
- b) të ruajnë mekanizmat e nevojshëm të kontrollit për përcaktimin e shkeljeve të detyrimeve, të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Subjektet e ndryshme nga këshilltarët e investimeve, shoqëritë e investimeve apo të ngjashme me këto, të cilët, në ushtrimin e profesionit të tyre ose si pjesë të veprimtarisë së tyre, japin këshilla për investimet, njoftojnë menjëherë Autoritetin. Njoftimi është i detyrueshëm edhe kur subjektet ndërpresin veprimtarinë e këshillimit.

Autoriteti miraton rregullore për përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare, si dhe për rrethanat dhe marrëdhëniet që krijojnë konflikte interesi.

PJESA E TRETË

KREU I TITUJT E DEMATERIALIZUAR

Neni 115

Titujt e dematerializuar

Tituj e dematerializuar janë regjistrimet elektronike të një llogarie titujsh në sistemin kompjuterik të regjistrarit, me anë të të cilit emetuesi merr përsipër të përmbushë, kundrejt mbajtësit të të drejtave, detyrimet që përmbahen në titujt.

Titujt e dematerializuar mund të emetohen vetëm përmes ofertave publike.

Titujt e dematerializuar, që japin të drejta të njëjta në operacionet ligjore, brenda të njëjtit emetim dhe së njëjtës klasë, janë të konvertueshëm pa kufizime. Detyrimet e çdo lloji mund të përmbushen përmes transferimit të titujve të të njëjtit emitim dhe të së njëjtës klasë dhe, për rrjedhojë, kreditori nuk mund të pretendojë, në mënyrë të veçantë, tituj të dematerializuar.

Neni 116

Llogaria e titujve të dematerializuar

Llogaria e titujve të dematerializuar përmban të dhëna për emetimet, klasat, sasitë, të drejtat pasurore dhe titullarët e këtyre të drejtave, kufizimet e të drejtave pasurore dhe të dhëna për historinë e regjistrimeve të tyre.

Llogaria e titujve të dematerializuar mbahet:

- a) në emër të një personi të vetëm;
- b) në llogari të përbashkët, kur ajo është në emër të disa personave, të cilët mund të jenë pronarë ose bashkëpronarë;
- c) në emër të një banke kujdestare.

Shoqërive komisionere nuk u lejohej të mbajnë tituj të klientëve të tyre në një llogari të përbashkët me to.

Neni 117

Karakteristikat e titujve të dematerializuar

Titujt e dematerializuar nuk përmbajnë numra serialë, numra kontrolli dhe nënshkrimin e personave të autorizuar.

Pretendimet e lindura nga titujt e dematerializuar i përkasin pronarit të tyre.

Pronari i titujve të dematerializuar është personi, në emër të të cilit është hapur llogaria në regjistrarin, ku regjistrohet llogaria e këtyre titujve.

Nëse një bankë kujdestare mban tituj të dematerializuar, për llogari të një pale të tretë, veçmas nga prona e vetë bankës, pronari i këtyre titujve është personi, për llogari të të cilit i mban kujdestari.

Neni 118

Pronësia e titujve të dematerializuar

Pronësia dhe të drejtat që rrjedhin nga titujt e dematerializuar fitohen përmes transferimit nga llogaria e titujve të dematerializuar të transferuesit në llogarinë e titujve të dematerializuar të marrësit, në bazë të një marrëveshjeje, që ka qëllim fitimin e pronësisë, në bazë të një vendimi gjyqësor, me trashëgimi ose me ligj.

Pronësia dhe të drejtat, që rrjedhin nga titujt e dematerializuar, merren në çastin e regjistrimit të tyre në llogarinë e titujve të dematerializuar të marrësit në pronësi ose të personit, i cili, duke vepruar në rolin e kujdestarit, mban tituj të dematerializuar për llogari të blerësit.

Parashikimet e këtij neni zbatohen edhe për lëshimin e pronësisë.

Neni 119

Barra mbi titujt e dematerializuar

Barra mbi titujt e dematerializuar vihet përmes regjistrimit të kësaj të drejte në llogarinë e titujve të dematerializuar, në bazë të një marrëveshjeje të rregullt, vendimi gjyqësor apo sipas ligjit.

Mbi titujt e dematerializuar mund të vihet vetëm një barrë.

Për titujt e dematerializuar lejohet shlyerja e një pretendimi të garantuar, përmes pengut, jashtë gjykatës.

Barra mbi titujt e dematerializuar hiqet në çastin e dhënies së tyre në pronësi.

Neni 120

Kleringu, shlyerja dhe rirezervimi i titujve të dematerializuar

Transferimi i pronësisë së titujve të dematerializuar, në bazë të një transaksioni të mbyllur në bursë ose në një treg të rregulluar, kryhet përmes kleringut dhe shlyerjes.

Kleringu është krahasimi i informacionit mbi një transaksion ligjor të përfunduar, mbi titujt e dematerializuar, përcaktimi i afatit të pagesës dhe llogaritja e detyrimit për t'u paguar.

Shlyerja është procesi i ndërmjetësimit dhe mbikëqyrjes së pagesave dhe të transferimit të titullit, që lidhet me transaksionin ligjor.

Dhënia dhe heqja e së drejtës së pronësisë dhe e të drejtave të tjera mbi titujt e dematerializuar, në bazë të transaksioneve të vlefshme të mbyllura jashtë bursës, në bazë të një vendimi gjyqësor, përmes trashëgimisë apo në bazë të ligjit, bëhen nëpërmjet regjistrimit në kartelat elektronike, me procedurë rirezervimi.

Neni 121

Mundësia e leximit të të dhënave të regjistrimit të titujve të dematerializuar

Pronari i titujve të dematerializuar dhe banka kujdestare kanë të drejtë të shohin të dhënat e përmendura në paragrafin e parë të nenit 116 të këtij ligji.

Emetuesi i titujve të dematerializuar ka të drejtën të shohë të dhënat e përmendura në paragrafin e parë të nenit 116 të këtij ligji, të dhënat për titujt, emetues i të cilave është ai dhe të dhënat e pronarëve të këtyre titujve.

Emetuesi ose regjistrari i mundëson çdo aksioneri leximin e të dhënave të përmendura në paragrafin e parë të nenit 116 të këtij ligji, të cilat lidhen me aksionerët dhe aksionet e emetuesit në fjalë. Regjistrari ka të drejtën për shpërblim për koston e shkrimit dhe dhënies së raporteve. Aksioneri nuk duhet t'ua komunikojë apo t'ua vërë në dispozicion personave të tjerë informacionin për aksionerët dhe aksionet e përmendura në këtë paragraf.

Autoriteti ka të drejtën e leximit të të dhënave të përmendura në paragrafin e parë të nenit 116 të këtij ligji dhe të të gjitha të dhënave të mbajtura në regjistrin e regjistrarit të titujve.

Çdo individ, që vërteton interesin e tij të ligjshëm, ka të drejtë që, kundrejt pagesës, të lexojë historinë e transaksioneve të titujve të veçantë.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ky nen, regjistrari i titujve i mban si informacion të rezervuar të dhënat për gjendjen e llogarive individuale të titujve të dematerializuar.

Neni 122

Detyrimi i regjistrarit për të informuar

Regjistrari, në përputhje me rregulloren e tij të brendshme, të miratuar nga Autoriteti, informon:

1. Emetuesin për titujt e dematerializuar, të emetuar nga ai dhe për pronarët e këtyre titujve.
2. Pronarin për gjendjen dhe veprimet e llogarisë së titujve të dematerializuar.
3. Anëtarët e bursës për të dhënat që janë thelbësore për transaksionet me titujt e dematerializuar, që kanë bërë për llogari të tyre ose për llogari të klientëve.

Regjistrari i paraqet Autoritetit raporte mujore për punën e tij, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ky Autoritet për këtë qëllim.

Emetuesit e titujve të dematerializuar njoftojnë regjistrarin për të gjitha lëvizjet e lidhura me titujt e dematerializuar dhe për përmbushjen e të drejtave, që rrjedhin nga këta tituj.

Të dhënat dhe emrat e 10 pronarëve më të mëdhenj të çdo titulli i vihen në dispozicion publikut.

KREU II

REGJISTRARI I TITUJVE

Neni 123

Përkufizimi

Regjistrari i titujve, ose shkurt regjistrari, është shoqëria aksionere e licencuar nga Autoriteti, që ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe administrimin e të dhënave për titujt. Regjistrari i titujve nuk mund të kryejë veprimtari të tjera, të ndryshme nga veprimtaritë për të cilat licencohet nga Autoriteti.

Regjistri i titujve është dokumenti zyrtar dhe ligjor, i mbajtur në një formë të caktuar, i cili përmban të dhëna për pronësinë mbi titujt, me transaksionet e kryera në lidhje me to apo të dhëna për vendosjen e titujve si garanci.

Regjistri i veçantë emërtohet në varësi të llojit të titujve, për regjistrimin e të cilit synon veprimtaria e regjistrarit.

Regjistrari mund të licencohet për të regjistruar një ose më shumë tituj të përcaktuar.

Në emërtimin e regjistrarit vendoset në kllapa emërtimi i titujve, për të cilët është licencuar për të operuar.

Neni 124

Transaksionet mbi titujt

Transaksion mbi titujt quhet transferimi me apo pa shpërblim i pronësisë mbi të drejtat e mbartura nga titujt.

Neni 125

Drejtuesit e regjistrarit

Drejtor apo drejtues nënkupton individin që, pavarësisht nga emërtimi që mban në shoqëri, ushtron funksione drejtuese me përgjegjësi për administrimin e veprimtarisë së regjistrarit, marrjen e vendimeve për këtë veprimtari, vendosjen e procedurave dhe të politikave të administrimit, si dhe vendosjen e nënshkrimit e marrëveshjeve me të tretë.

Neni 126

Funksionet e regjistrarit

Regjistrari, në varësi të titujve, për të cilët është licencuar, ka si funksion ofrimin e shërbimit të regjistrimit të titujve, nëpërmjet organizimit të mënyrës së mbajtjes së regjistrit, në mënyrë të tillë që të sigurohen, në çdo kohë, të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt, si dhe kufizime të të drejtave të pronësisë mbi to.

Për realizimin e funksioneve të veta, regjistrari ka për detyrë:

1. Të organizojë regjistrimin e transaksioneve dhe të ndryshimeve përkatëse, në mënyrë që të evidentojë, në çdo kohë, të dhëna mbi zotëruesin e fundit të titujve dhe kushteve, që çojnë në kufizim të të drejtave të pronësisë mbi titujt.
2. Të lidhë kontrata dhe të bashkëpunojë me emetuesit e titujve.
3. Të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave të regjistruara, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi.
4. Të realizojë funksione të tjera, të parashikuara në statutin dhe rregullat e regjistrarit dhe që kanë lidhje me funksionet kryesore të tij.

Neni 127

Kërkesa për miratimin e statudit

Projektstatuti i një shoqërie, që ka për objekt veprimtarinë si regjistrar i titujve, i paraqitet Autoritetit përpara depozitimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Projekti shoqërohet me një kërkesë zyrtare, me anën e së cilës kërkohet miratimi nga Autoriteti.

Neni 128

Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e statudit

Autoriteti shqyrton kërkesën dhe projektin e marrë, përputhjen e përmbajtjes së statudit me veprimtarinë, për të cilën kërkohet licencimi dhe merr vendim për miratimin apo udhëzon ndryshime në të dhënat e statudit. Regjistrari është i detyruar të zbatojë udhëzimet e Autoritetit.

Miratimi i statudit nuk e kushtëzon Autoritetin në marrjen e vendimeve të mëvonshme për licencimin e të njëjtit subjekt, si regjistrar i titujve.

Neni 129

Formë-kërkesa

Kërkuesi plotëson formë-kërkesën e miratuar nga Autoriteti.

Formë-kërkesa shoqërohet nga kërkesa me shkrim për marrjen e licencës për të vepruar si regjistrar, dokumentacioni i përshkruar, sipas nenit 130 të këtij ligji, si dhe pagesa e kuotës përkatëse.

Neni 130

Dokumentacioni që shoqëron formë-kërkesën

Dokumentacioni që shoqëron formë-kërkesën për licencim si regjistrar përmban:

1. Statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë.
2. Numrin e regjistrimit si person juridik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
3. Të dhëna për ortakët e shoqërisë dhe veprimtarinë e tyre për tri vitet e fundit.
4. Nëse një ose disa ortakë janë persona juridikë, dokumentet themeltare, numrin e regjistrimit, si dhe të dhëna për rezultatin financiar të tri viteve të fundit.

5. Të dhëna për personelin drejtues dhe përvojën e punës së tyre gjatë tri viteve të fundit.
 6. Të dhëna të hollësishme për pajisjet dhe hapësirat, që do të përdoren për organizimin dhe administrimin e regjistrit të letrave me vlerë, si kompjuter, telefona, fakse, për shkallën e automatizimit të veprimtarisë së regjistrit etj.
 7. Dokumentin, që vërteton pronësinë, marrjen me qira apo çdo formë tjetër të zotërimit të mjediseve, ku do të kryejë veprimtarinë regjistri.
 8. Kopjen e dokumentit, të lëshuar nga institucioni përkatës, për sigurimin e mjediseve nga zjarri.
 9. Të dhëna për masat e marra për sigurimin e objektit.
 10. Curriculum vitae të drejtuesit apo drejtuesve të shoqërisë.
 11. Deklaratën personale të drejtuesve se ata plotësojnë të gjitha kërkesat e nenit 133 të këtij ligji.
 12. Rregullat e brendshme të funksionimit, në të cilat bëjnë pjesë rregullat që lidhen me:
 - a) organizimin e regjistrit, në varësi të titujve, për të cilin kërkohet licenca si regjistrar;
 - b) procedurat e transferimit të pronësisë mbi titujt, për të cilin kërkohet licenca si regjistrar;
 - c) dhënien e informacionit dhe ruajtjen e konfidencialitetit;
 - ç) procedurat dhe masat, në rast të pezullimit ose mbylljes së veprimtarisë me vendimin e organeve drejtuese të regjistrarit;
 - d) procedurat dhe masat, në rast të pezullimit ose mbylljes së veprimtarisë, me vendim të Autoritetit.
 13. Dokumentet e tjera shtesë, që mund të kërkohen nga Autoriteti.
- Dokumentacioni paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar e tij.
- Përveç rregullave të parashikuara në pikën 12 të paragrafit të parë të këtij neni, regjistri mund të hartojë rregulla të tjera, që mund të gjykohen nga ai si të nevojshme apo të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Nëse këto rregulla nuk janë përgatitur në çastin e paraqitjes së praktikës për licencim, ato bëhen objekt i miratimit nga Autoriteti në çastin që janë gati.

Neni 131

Shqyrtimi i praktikës nga Autoriteti

Autoriteti gëzon të drejtën e verifikimit në vend të të dhënave të deklaruara nga kërkuesi.

Neni 132

Dhënia e përgjigjes për vendimin e marrë

Autoriteti merr vendim për miratimin ose refuzimin e dhënies së licencës brenda 30 ditëve dhe, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit, njofton me shkrim kërkuesin për këtë vendim.

Neni 133

Kërkesa dhe kufizime për drejtorët e regjistrarit

Drejtorët e regjistrarit duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) të kenë arsimin e lartë përkatës, në përputhje me vendimin e Autoritetit dhe sipas pozicionit të punës së parashikuar;
 - b) të kenë përvojë pune, të paktën trevjeçare, në përputhje me specialitetin, për të cilin janë diplomuar;
 - c) të kenë punuar më parë në poste drejtuese;
 - ç) të jenë të pajisur me të paktën 3 referenca pozitive nga punëdhënësit e kaluar.
- Përveç kushteve të përgjithshme, drejtorët e regjistrarit duhet të plotësojnë edhe kushte specifike, të përcaktuara në rregullat e Autoritetit.

Neni 134

Detyrimi për të informuar kur ka ndryshime në dokumentacion

Personi juridik i licencuar, për të vepruar si regjistrar, i paraqet Autoritetit informacion të plotë për ndryshimet në të dhënat e paraqitura në çastin e licencimit.

Ky informacion paraqitet brenda një muaji nga ndodhja e ndryshimit, së bashku me arsyet, të cilat çuan në këtë ndryshim.

Neni 135

E drejta e Autoritetit për informim dhe kërkim informacioni

Regjistrari i paraqet Autoritetit raporte mujore për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij, të miratuara nga drejtori ekzekutiv i shoqërisë. Këto raporte paraqiten brenda 1 jave nga mbarimi i muajit për të cilin raportohet.

Regjistrari i paraqet Autoritetit raporte gjashtëmujore dhe vjetore për mbarëvajtjen e veprimtarisë, të miratuara nga këshilli mbikëqyrës. Këto raporte paraqiten brenda 2 muajve nga mbarimi i periudhës për të cilën raportohet.

Autoriteti, në çdo rast, mund t'i kërkojë të licencuarit informacion të përgjithshëm ose të dhëna për çështje të veçanta, të lidhura me veprimtarinë e licencimit si regjistrar.

Neni 136

Pezullimi dhe heqja e licencës së regjistrarit

Autoriteti mund t'ia heqë licencën e dhënë një shoqërie, për të ushtruar veprimtari si regjistrar, kur:

1. Shoqëria nuk e fillon veprimtarinë, për të cilën është licencuar, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të licencës.
2. I licencuari ndërpret veprimtarinë, për të cilën ka marrë licencë.
3. I licencuari është bërë objekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit.
4. I licencuari vihet në kushte administrimi të kontrolluara.
5. Autoriteti ka arsye për të besuar se i licencuari apo ndonjë drejtues ose punonjës i saj nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre me efektivitet dhe ndershmëri, në dëm të investitorëve.
6. I licencuari shkel dispozitat e parashikuara në këtë ligj.
7. I licencuari shkel ndonjë kusht apo kufizim, të zbatueshëm në çastin e dhënies së licencës.
8. Me kërkesën e të licencuarit.

Autoriteti mundet që, në vend të heqjes së licencës, ta pezullojë atë për një periudhë të caktuar, brenda së cilës i licencuari duhet të bëjë korrigjimet e kërkuara nga Autoriteti.

Shoqëria, së cilës i është hequr apo pezulluar licenca, sipas këtij neni, konsiderohet si e palicencuar nga data heqjes së licencës nga Autoriteti, ose për të gjithë periudhën, në të cilën i është pezulluar licenca.

Neni 137

Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave

Regjistrari ka këto detyra:

a) të mbrojë sistemin kompjuterik dhe të dhënat e përcaktuara në këtë sistem nga përdorimi i paautorizuar dhe nga ndryshimi dhe humbja;

b) të ruajë në një vend të sigurt dhe në formën origjinale dokumentacionin origjinal të përdorur për regjistrim në mënyrën e mbajtjes të së dhënave, për të paktën pesë vjet. Të dhënat e regjistruara në mënyrë elektronike mbahen përgjithmonë.

Autoriteti mund të përcaktojë standarde dhe teknika më të hollësishme për mbrojtjen e sistemit kompjuterik dhe të të dhënave që mbahen në të, që u përkasin titujve të dematerializuar.

Neni 138
Fondi garanci

Regjistrari, nëse ofron shërbime të kleringut dhe shlyerjes, krijon një fond garancie. Mjetet e fondit të garancisë krijohen nga pagesat e bëra nga shoqëritë, të cilat përdorin shërbimet e tij, të kleringut dhe të shlyerjes. Rregullat e pagesës së kontributeve dhe të përdorimit të fondit të garancisë përcaktohen nga regjistrari dhe i nënshtrohen miratimit të Autoritetit. Regjistrari nuk merr dhe nuk jep tituj hua.

Neni 139
Pezullimi i tjetërsimit apo i barrës mbi titujt

Autoriteti, me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve, mund të urdhërojë ndalimin e tjetërsimit apo të vënies së barrës mbi titujt për një periudhë, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtëdhjetë ditë.

Neni 140
Konfidencialiteti për regjistrarin

Dispozitat e të këtij ligji, që i përkasin detyrimit për të ruajtur sekretet zyrtare, aplikohen siç duhet edhe për punonjësit, anëtarët e drejtorisë dhe të këshillit mbikëqyrës të regjistrarit. Një herë në muaj kryetari i këshillit mbikëqyrës të regjistrarit i paraqet Autoritetit raport për marrjen në pronësi dhe tjetërsimin e titujve të personave të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni. Punonjësit e regjistrarit nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërive komisionere.

PJESA E KATËRT

KREU I
DISPOZITA PENALE

Neni 141
Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar

Personi, i cili, në mënyrë të autorizuar ose të paautorizuar, vihet në dijeni të informacionit të privilegjuar, për të cilin publiku nuk ka dijeni e që mund ta përdorë me qëllim fitimi material për vete, për një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- a) për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë;
- b) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, ia komunikon, pa autorizim, një palë të tretë;
- c) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, këshillon një palë të tretë për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë apo të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë, kryen kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 142

Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë

Veprimi apo mosveprimi i personit që:

- a) nënshkruan një kontratë fiktive për shitjen apo zëvendësimin e titujve;
- b) kryen porosi për blerje ose shitje të titujve, për të cilët është kryer porosia me të njëjtin çmim, apo nëse ai i përdor këto tituj si kundërporosi;
- c) përhap informacion apo fakte të tjera të rreme për rritjen ose rënien e çmimit të titujve apo krijimin e një tregtimi fiktiv aktiv të tyre, me qëllim përfitimi personal për vete, një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 143

Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre

Personi që, si anëtar i drejtorisë apo i këshillit mbikëqyrës të një emetuesi, lejon ose mundëson shpërndarjen e një prospekti, përmbajtja e të cilit ndryshon nga përmbajtja e parashikuar në nenin 29 të këtij ligji, apo lejon ose mundëson paraqitjen e të dhënave të rreme ose paraqitjen e rremë të fakteve me vlerë materiale në një prospekt dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Neni 144

Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar

Personi që, si anëtar i drejtorisë bursës, lejon regjistrimin në kuotimin një, kuotimin e shoqërive anonime publike apo në kuotime të tjera të titujve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj, dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 145

Fshehja e pronësisë

Personi, i cili me dashje nuk jep të dhëna për pronësinë, sipas dispozitave të nenit 106 të këtij ligji, dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 146

Tregtimi i paligjshëm i titujve

Personi që merret me ndërmjetësim të paautorizuar për blerjen ose shitjen e titujve dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

KREU II KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 147

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe e kryer nga personat e individët e autorizuar për të kryer transaksione me tituj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

Neni 148

Masa të tjera administrative

Një komisioner burse ose një këshilltar investimesh, i cili ka kryer një veprim në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mund të dënohet me masë plotësuese administrative, me heqje të licencës për të kryer transaksione me tituj për një periudhë deri në një vit.

Shkelja e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, e përsëritur ose e kryer për përfitim material, apo nga kryerja e së cilës kanë ardhur pasoja materiale dhe jomateriale ndaj një shoqërie të autorizuar, apo ka pasur si pasojë shkaktimin e dëmit material ndaj klientëve ose një pale të tretë, dënohet me heqje të licencës për të kryer transaksione me tituj për një periudhë njëvjeçare.

Neni 149

Kompetenca në miratimin e masave administrative

Shkeljet administrative, shqyrtimi i tyre dhe vendosja e masave administrative janë kompetencë e Autoritetit.

Administrimi i të ardhurave nga gjobat bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU III DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Seksioni I

Titujt e emetuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji

Neni 150

Format e aksioneve

Shoqëritë anonime i emetojnë aksionet si tituj të materializuar, sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, ose si tituj të dematerializuar, sipas dispozitave të këtij ligji.

Shoqëritë anonime që, për qëllim të këtij ligji, vlerësohen si shoqëri publike, i japin regjistrarit për dematerializim të dhënat për titujt dhe pronarët e tyre nga regjistri i aksioneve ose regjistri i emetuesve, brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti.

Shoqëritë anonime që, për qëllim të këtij ligji, nuk vlerësohen shoqëri publike dhe që nuk nxjerrin dokumente për aksione, ose nuk kanë emetuar aksione si tituj të dematerializuar, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, i japin regjistrarit për dematerializim të dhënat për titujt dhe pronarët e tyre nga regjistri i aksioneve ose nga regjistri i emetuesve, brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti.

Detyrime për shoqëritë e licencuara më parë

Shoqëritë e licencuara më parë nga Autoriteti, për të ushtruar veprimtari në tituj apo licenca e të cilave është pranuar nga Autoriteti, riorganizojnë ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe i paraqesin Autoritetit për miratim aktet e përgjithshme të harmonizuara, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nëse personat juridikë, të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, nuk organizojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me dispozitat të këtij ligji dhe nuk paraqesin aktet e përgjithshme të harmonizuara për miratim, licenca e tyre për kryerjen e transaksioneve nuk quhet e vlefshme pas mbarimit të periudhës gjashtëmujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Licencat e lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij, i nënshtrohen riformatimit, në përputhje me termat e përdorur në ligj. Hyrja në fuqi e këtij ligji nuk ndryshon afatet dhe kushtet, për të cilat janë lëshuar licencat për subjektet e përfshira në tregun e titujve.

Detyrime të Autoritetit

Autoriteti, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton aktet nënligjore në zbatim të tij.

Informacioni konfidencial

Anëtarët e bordit të Autoritetit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë detyrohen të ruajnë fshehtësinë e informacionit, me të cilin njihen gjatë kryerjes së detyrave të tyre në Autoritet ose në mënyra të tjera, me përjashtim të rasteve të veçanta, të cilat autorizohen për të vepruar ndryshe nga ligji. Ky informacion vlerësohet konfidencial.

Personat e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni nuk mund të japin këshilla për tregtimin e titujve dhe investimin në to, apo nuk duhet të japin mendime nëse është e favorshme ose e pafavorshme marrja apo shitja e titujve.

Ndalimi i veprimeve të përmendura në paragrafin e parë dhe në paragrafin e dytë të këtij neni vazhdon edhe për një periudhë gjashtëmujore që prej datës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës.

Nëpunësit e Autoritetit, sa herë që marrin ose shesin tituj, raportojnë, brenda dy ditëve, për këtë tek eprori i tyre drejtpërdrejtë, ndërsa anëtarët e bordit, brenda dy ditëve pas datës së blerjes ose shitjes, e deklarojnë në faqen zyrtare të Autoritetit, si dhe ua dërgojnë mjeteve të komunikimit masiv njoftimin, ku shpjegojnë llojin e titujve, emetuesin, datën dhe bazat ligjore për marrjen ose shitjen e tyre.

Detyrimi, që rrjedh nga paragrafi i mësipërm, zbatohet edhe për blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë nga bashkëshorti, fëmija, fëmija i birësuar, prindi apo thjeshtri e persona të tjerë, të cilët jetojnë me anëtarin e bordit të Autoritetit ose punonjësin në një familje të përbashkët dhe për blerjen e shitjen nga persona juridikë, tek të cilët këta persona kanë një interes të shumicës. Periudha e raportimit fillon nga dita kur punonjësi, kryetari ose anëtari i bordit të Autoritetit ka dijeni për faktin se janë marrë ose janë shitur tituj.

Parashikimet e këtij neni nuk pengojnë bashkëpunimin me autoritete të huaja për shkëmbimin e informacionit për qëllime të rregullimit të tregut, të mbikëqyrjes, asistencës teknike apo zbatimit të ligjit.

Konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer dhe përshkrimi i qëllimeve të përdorimit të tij pasqyrohen në marrëveshje.

Seksioni II
Dispozita të fundit

Neni 154
Shfuqizime

Ligji nr.8080, datë 3.5.1996 “Për letrat me vlerë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 155
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5650, datë 6.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9901, datë 14.4.2008

PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE
(ndryshuar me ligjin nr. 10 475 datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014)
(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I

DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TREGTARIN
DHE SHOQËRITË TREGTARE

Neni 1
Objekti i ligjit, përkufizime, regjistrime të detyrueshme

1. Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.

2. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

3. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecures së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

4. Nëse nuk parashikohet ndryshe, gjykata e përmendur në këtë ligj është seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, sipas dispozitave të neneve 334 deri në 336 të Kodit të Procedurës Civile.

5. Dispozitat, që kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse.

6. Në kuptim të këtij ligji, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës e anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemri vetor “atë” i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

Neni 2 Tregtari

1. Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.

2. Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.

3. Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).

4. Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet këtij ligji. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë, me urdhër të përbashkët, miratojnë pragjet e vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar.

5. Tregtari regjistrohet sipas neneve 28 pika 1 dhe 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse tregtari ka krijuar një faqe në internet, të gjitha të dhënat e njoftuara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe.

6. Tregtari është i detyruar të ndjekë parimet e ndershmërisë profesionale, të zbatueshme në mjedisin tregtar, ku ai vepron. Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara, përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.

7. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai çregjistrohet nga regjistri, në përputhje me nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 3 Shoqëritë tregtare

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.

Neni 3/1

Shkaqet e pavlefshmërisë

(Shtuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shkaqe të pavlefshmërisë së themelimit të një shoqërie tregtare, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (në vazhdim QKR), janë:

a) dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, nuk është hartuar në formë shkresore;

b) mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë;

c) objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin;

ç) në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë;

d) vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të këtij ligji;

dh) kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ky ligj.

2. Shkaqet e pavlefshmërisë, të parashikuara në pikën 1, janë të vetmet shkaqe, të cilat sjellin pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë, pas regjistrimit të saj në QKR.

3. Pavlefshmëria absolute, parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikimeve të nenit 190, pika 1, ose të nenit 192, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

4. Pavlefshmëria relative, e parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, shpallet nga gjykata. Shpallja e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, rrethana që shkakton pavlefshmërinë është korrigjuar, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Gjukata që shqyrton padinë e ngritur në lidhje me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare, gjatë të njëjtit proces gjyqësor, vlerëson nëse rrethana, që shkakton pavlefshmërinë, është korrigjuar dhe publikuar sipas kërkesave të pikës 4 të këtij neni.

6. Pavlefshmëria e shoqërisë tregtare, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk mund t’u kundërshtohet palëve të treta që kanë fituar të drejta nga shoqëria pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe nuk çliron themeluesit e shoqërisë nga detyrimi për të paguar kontributet e nënshkruara prej tyre, të paktën deri në vlerën e nevojshme për të përballuar detyrimet e marra përsipër ndaj kreditorëve.

7. Padia për të kërkuar që shoqëria tregtare të shpallet e pavlefshme parashkruhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në çdo rast, padia e lidhur me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare nuk mund të ngrihet pas publikimit të korrigjimit të rrethanës që shkakton pavlefshmërinë, sipas këtij neni, nëse kjo rrethanë mund të korrigjohet.

Neni 4

Emrat e regjistruar dhe emërtimet tregtare

1. Tregtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Tregtari dhe shoqëritë tregtare mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Emri i tregtarit ndiqet nga shtojca “tregtar i regjistruar” ose shkurtimi përkatës “TR”. Emri i shoqërisë kolektive duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri kolektive” ose shkurtimin “SHK”. Emri i shoqërisë komandite duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri komandite” ose shkurtimin “SHKM”. Emrat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive aksionare përmbajnë shkurtimet, të cilat tregojnë se janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” ose shoqëri aksionare “SHA”.

Neni 5

Transferimi i emrave dhe i përgjegjësisë

1. Personi, të cilit i transferohet veprimtaria e një tregtari ose e një shoqërie tregtare, mund të vijojë të përdorë emrin e regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë, me ose pa një shtesë, që tregon ndërrimin e pronësisë, nëse titullari i mëparshëm i veprimtarisë apo trashëgimtarët e tij e miratojnë këtë përdorim.

2. Nëse emri i regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë vijojnë të përdoren, titullari i ri i veprimtarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm. Marrëveshjet, që përcaktojnë ndryshe nga sa më sipër, nuk mund t'i kundrejtohen palëve të treta, edhe nëse janë bërë publike, me përjashtim të rastit kur tregtari ose shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për marrëveshjen, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

TTULLI II

THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

Neni 6

Statuti

Statuti i shoqërisë tregtare përmban të dhënat e përcaktuara në nenet 32 deri në 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Paragrafi i katërt i nenit 28 të ligjit të sipërpërmendur mbetet i zbatueshëm.

Neni 7

Objekti i ligjshëm

Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj.

Neni 8

Zyra qendrore

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në statut, zyra qendrore e shoqërisë tregtare është vendi, ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare.

2. Nëse zyra qendrore ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëritë tregtare u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Neni 9

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.

2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të saj.

4. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.

5. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen sipas kërkesave të neneve 26 pika 4, 28 pika 5 dhe 37 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

6. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe nën emrin e saj.

Neni 10

Përgjegjësia e themeluesve

1. Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

2. Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

3. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrejë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni. Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e mospërbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. Ortakët, aksionarët ose kreditorët duhet të respektojnë procedurat e neneve 91, 92, 150 e 151 të këtij ligji. Paditë duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare.

Neni 11

Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimtarisë

(Shtuar shkronja “d” në pikën 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit;
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- ç) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
- d) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty. Edhe në këtë rast zbatohet pika 5 e nenit 1 të këtij ligji.

2. Shoqëria përgjigjet për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara sipas pikës 1 të këtij neni. Nxjerrja e shkresave, formularëve e urdhrave apo e çdo dokumenti tjetër korrespondence, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

TITULLI III PËRFAQËSIMI

Neni 12

Kompetencat e organeve të shoqërisë dhe përfaqësimi ligjor

(Ndryshuar titulli, pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Statuti apo vendimet e shoqërisë nuk mund të ndryshojnë apo të kufizojnë kompetencat që ky ligj përcakton për organet e ndryshme të shoqërisë tregtare. Çdo veprim, që ka për qëllim ndryshimin apo kufizimin e kompetencave të organeve të shoqërisë, të cilat nuk lejohen shprehimisht, sipas këtij ligji, nuk mund t'u kundërvihen palëve të treta edhe nëse janë bërë publike në statut apo sipas mënyrave të parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

2. Shoqëritë tregtare përfaqësohen në marrëdhëniet me të tretët nga përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët veprojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky ligj dhe nga dispozitat e statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon kufizime në tagrin e përfaqësuesit ligjor për të vepruar i vetëm për disa apo për të gjitha marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët. Përfaqësuesit ligjorë mbeten të detyruar ndaj shoqërisë për të zbatuar të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit në marrëdhëniet me të tretët, të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet e shoqërisë. Me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin e tagrit të përfaqësuesit ligjor për të vepruar i vetëm për disa apo për të gjitha marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët apo në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, ky kufizim i tagrave të përfaqësimit mund t'u kundërvihet palëve të treta vetëm nëse është bërë publik në mënyrat e parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

3. Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për parregullsinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor të një shoqërie tregtare, nuk mund të jenë anëtarë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës dhe as përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

2. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij e veprimi nuk autorizohet, paraprakisht, prej:

- a) të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie kolektive apo komandite;
- b) të gjithë ortakëve ose të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar;
- c) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e administratorëve të shoqërive aksionare;
- ç) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës në shoqëritë aksionare.

Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Miratimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:

- a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/ bashkëshortes;
- b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
- c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/ bashkëshortes;
- ç) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.

4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.

5. Këshilli i administrimit ose këshilli mbikëqyrës i shoqërisë aksionare, që ka dhënë miratimin e një veprimi, sipas pikave 2 e 3, të këtij neni, duhet që pa vonesa, por në çdo rast brenda 72 orëve, t'i njoftojë asamblesë së përgjithshme aktin e miratimit të këtij veprimi, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë. Në rastin e shoqërive aksionare me ofertë publike, ky njoftim duhet të publikohet brenda afatit të sipërpërmendur edhe në faqen e internetit të shoqërisë, pavarësisht nga detyrimet e tjera për publikimin e miratimit të dhënë, që këto shoqëri mund të kenë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt". Brenda 6 muajve nga data e kryerjes së njoftimit për dhënien e autorizimit, sipas pikave 2 e 3, të këtij neni, asamblja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës të shpallë veprimin juridik të miratuar si të pavlefshëm, nëse miratimi është dhënë në shkelje të rëndë të ligjit apo të statutit.

6. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecures së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.

7. Një person, i cili është, njëkohësisht, administrator dhe ortak apo aksionar i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë. Mospërmblidhja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

TITULLI IV PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Neni 14

Parimet

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj ose nga statuti, në rrethana të njëjta, ortakët dhe aksionarët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni 15

E drejta e informimit

1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët apo aksionarët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare.

2. Çdo dispozitë e statutit, që ndalon ose kufizon ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, është e pavlefshme.

3. Nëse personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk japin informacionin e kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, ortakët, anëtarët ose aksionarët e interesuar, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës kompetente të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e ortakut apo aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Mosdhënia e informacioneve të kërkuara, sipas këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni për kërkesën, vlerësohet refuzim.

Neni 16

Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Individit, i cili gëzon cilësinë e ortakut, aksionarit apo përfaqësuesit të ortakut ose aksionarit, të

administratorit apo të anëtarit të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare, i cili, me veprimet apo mos veprimet e tij, i siguron vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje, është përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike, me pasurinë e tij, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë kur:

- a) ka abuzuar me formën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare; ose
- b) ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose
- c) në çastin kur ka marrë dëjën apo duhet të kishte marrë dëjën që shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, nuk mori masat e nevojshme, të përfshira në kompetencat e tij/të saj, sipas këtij ligji, për të mos lejuar që, në varësi të rrethanave, shoqëria të vazhdonte ushtrimin e veprimtarisë tregtare, dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përgjegjësia personale për detyrimet e shoqërisë kufizohet deri në vlerat e përcaktuara në vijim:

- a) në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë; ose

- b) në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, për detyrimet e papaguara të shoqërisë, deri në vlerën e tregut të pasurisë apo pasurive të shoqërisë tregtare, të cilat i ka trajtuar si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose

- c) në rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dëjën për gjendjen e parashikuar sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Nëse një apo më shumë nga shkeljet e sipërpërmendura kryhen së bashku nga më shumë se një prej personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, atëherë këta persona përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike.

4. Personi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, përfshi autoritetet publike, vetëm nëse kryerja e shkeljeve të përcaktuara në këtë nen vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Personi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, të cilat, në momentin e marrjes përsipër të detyrimit nga shoqëria, kishin dëjën për shkeljet e përcaktuara në këtë nen apo, në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishin dëjën për to.

6. Padia ndaj personave të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 17

Ndalimi i konkurrencës

1. Ortakët e shoqërisë kolektive, ortakët e pakufizuar të shoqërisë komandite, ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të një shoqërie aksionare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

2. Statuti mund të parashikojë që ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët, sipas dispozitave të nenit 36 të këtij ligji, apo nga asambleja e përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të këtij ligji.

3. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, se ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:

- a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 18

Sekreti tregtar

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.

2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

3. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës, anëtarët e këshillit të punëmarrësve, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet të ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

TITULLI V

PJESËMARRJA E PUNËMARRËSVE

Neni 19

Këshilli i punëmarrësve

Punëmarrësit e një shoqërie tregtare, e cila ka më shumë se 50 punëmarrës, krijojnë këshillin e punëmarrësve, me mandat maksimal prej 5 viteve . Funksionet e një shoqërie tregtare, e cila ka mbi 20 punëmarrës, por më pak se 50, kryhen nga një përfaqësues, për çdo 10 punëmarrës, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga asambleja e punëmarrësve të shoqërisë. Asambleja e punëmarrësve zgjedh një përfaqësues të ri, për çdo 20 punëmarrës shtesë të shoqërisë. Në çdo rast, këshilli i punëmarrësve nuk mund të ketë më shumë se 30 anëtarë. Këshilli mund të nxjerrë rregullore të brendshme, për të organizuar procedurat e veta.

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e këshillit të punëmarrësve

1. Këshilli i punëmarrësve monitoron zbatimin e ligjeve, të kontratave kolektive dhe dispozitave të statutit dhe përfaqëson interesat e punëmarrësve të shoqërisë. Këshilli merr pjesë

në vendimmarrjen për shfrytëzimin e fondeve të posaçme dhe të aktiveve të tjera të shoqërisë, të parashikuara në kontratat kolektive dhe në statut, si dhe për shpërndarjen e pjesës së fitimeve, që asambleja e përgjithshme vendos t'ia shpërndajë punëmarrësve.

2. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë e mban këshillin e punëmarrësve të informuar për veprimtaritë dhe ecurinë e shoqërisë tregtare e në mënyrë të veçantë për efektet e politikave të shoqërisë për kushtet e punës, pagat, sigurinë në punë, ndarjen e mundshme të fitimeve, ndryshimin e statusit, sistemin e pensioneve të shoqërisë, ristrukturimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera. Përfaqësuesi ligjor, me kërkesën e këshillit të punëmarrësve, paraqet gjendjen e llogarive, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e këshillit mbikëqyrës apo të ekspertëve kontabël të autorizuar. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e shpallur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke e informuar për këtë këshillin e punëmarrësve. Në të kundërt, mund të kërket që përgjigjet të jenë me shkrim, duke përdorur edhe mjete të komunikimit elektronik.

3. Këshilli i punëmarrësve, gjithashtu, mund të informojë veten drejtpërdrejt për performancën e shoqërisë tregtare dhe të këqyrë librat e dokumentet e shoqërisë, duke u dhënë mendime dhe sugjerime organeve drejtuese për çështjet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Përfaqësuesi ligjor e informon këshillin e punëmarrësve për arsyet e mospranimit të mendimeve dhe të sugjerimeve të këtij këshilli.

4. Statuti nuk mund ta pengojë apo kufizojë ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe këshillit të punëmarrësve për një sistem ekuivalent informimi. Nëse përfaqësuesi ligjor nuk pranon të japë informacionet, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, këshilli i punëmarrësve, brenda 2 javëve pas refuzimit, mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të marrë një vendim detyrues për informimin.

5. Këshilli i punëmarrësve i raporton asamblesë së punëmarrësve të shoqërisë për veprimtaritë e veta të paktën dy herë në vit ose sa herë e kërkon shumica e punëmarrësve.

6. Kostot e zgjedhjes dhe të funksionimit të këshillit mbulohen nga shoqëria tregtare.

Neni 21

Pjesëmarrja e punëmarrësve në administrimin e shoqërive aksionare

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë tregtare dhe këshilli i punëmarrësve mund të bien dakord që ky të emërojë persona për të përfaqësuar punëmarrësit në nivelin e administrimit.

PJESA II

SHOQËRITË KOLEKTIVE

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Përkufizimi

Një shoqëri është shoqëri kolektive nëse regjistrohet si e tillë, e kryen veprimtarinë tregtare nën një emër të përbashkët dhe përgjegjësia e ortakëve përpara kreditorëve është e pakufizuar.

Neni 23

Regjistrimi

1. Shoqëria kolektive regjistrohet në përputhje me nenet 26, 28, 32 e 33 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Nëse shoqëria kolektive ka krijuar një faqe interneti, të dhënat, të cilat i raportohen Qendrës Tregtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

TITULLI II MARRËDHËNIET NDËRMJET ORTAKËVE

Neni 24

Liria kontraktore

(Zëvendësuar fjalë në fjalinë e dytë me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

Marrëdhëniet ndërmjet ortakëve rregullohen nga statuti. Nenet 25 deri në 37 të këtij ligji zbatohen vetëm në rastin kur në statut nuk parashikohet ndryshe.

Neni 25

Kontributet

1. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, të drejta, krah pune dhe shërbime). Kontributet e ortakëve janë të barabarta.

2. Ortakët e shoqërisë kolektive i vlerësojnë kontributet në natyrë, duke i shprehur vlerat e tyre në para, me anë të një marrëveshjeje të ndërsjellë me njëri-tjetrin. Nëse nuk arrihet marrëveshja, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të caktuar, me një vendim detyrues, një ekspert vlerësues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me të dhënat e tjera, të kërkuara për regjistrim.

Neni 26

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

Gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre, ortakët përgjigjen ndaj shoqërisë kolektive për të gjitha dëmet e shkaktuara me dashje ose me pakujdesi të rëndë.

Neni 27

Rimbursimi i shpenzimeve

Të gjithë ortakët kanë të drejtë t'i kërkojnë shoqërisë kolektive rimbursimin e shpenzimeve, që kanë bërë gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, të cilat janë të nevojshme, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë.

Neni 28

Vonesa në pagimin e kontributeve

Ortakët, të cilët:

a) nuk i paguajnë shoqërisë kontributin në para ose në natyrë brenda afatit të përcaktuar në statut;

b) nuk i kalojnë në kohën e duhur shoqërisë paratë e arkëtuara në emër të saj;

c) marrin para nga shoqëria pa qenë të autorizuar;

detyrohen të paguajnë interes mbi vlerat që detyrohen, duke nisur nga data kur duhet të kishin derdhur kontributin, të kishin bërë kalimin ose nga data, në të cilën kanë marrë paratë.

Neni 29

Rritja ose zvogëlimi i vlerës së kontributit

1. Ortaku nuk është i detyruar ta rrisë vlerën e kontributit të vet mbi shumën, për të cilën është rënë dakord, ose ta shtojë atë, nëse ky kontribut është zvogëluar nga humbjet.
2. Ortaku nuk mund ta zvogëlojë vlerën e kontributit të vet, pa miratimin e ortakëve të tjerë.

Neni 30

Disponimi i pjesëve

1. Ortaku nuk mund të heqë dorë, të transferojë apo të vendosë barrë mbi të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqëri, pa miratimin e ortakëve të tjerë.
2. Të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqërinë kolektive, mund t'u transferohen, pa asnjë kufizim, ortakëve të tjerë.

Neni 31

Administrimi

1. Të gjithë ortakët kanë të drejtë ta administrojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë kolektive, duke vepruar si administratorë.
2. Nëse, në mbështetje të statutit, i është ngarkuar administrimi një apo disa prej ortakëve, ortakët e tjerë përjashtohen nga administrimi.

Neni 32

Administrimi nga më shumë se një ortak

1. Nëse e drejta për administrimin u është dhënë të gjithë ortakëve ose vetëm disave prej tyre, secili prej administratorëve ka të drejtë të veprojë në mënyrë të pavarur, me përjashtim të rasteve kur veprimet e tyre kundërshtohen nga administratorët e tjerë.
2. Nëse statuti parashikon që administratorët mund të veprojnë vetëm në mënyrë të përbashkët, atëherë për çdo veprim kërkohet miratimi i të gjithë administratorëve, me përjashtim të rasteve kur vonesa në kryerjen e veprimit mund t'i shkaktojë dëm shoqërisë.
3. Nëse statuti parashikon që një administrator është i detyruar t'u bindet udhëzimeve të një administratori tjetër, kur këto udhëzime konsiderohen të papërshtatshme, ai njofton administratorët e tjerë për të marrë një vendim të përbashkët për kryerjen e veprimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa në kryerjen e veprimit mund t'i shkaktojë dëm shoqërisë.

Neni 33

Objekti i administrimit

1. E drejta për administrim përfshin kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.
2. Veprimet, të cilat tejkalojnë objektin e kompetencës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, kërkojnë miratimin e të gjithë ortakëve.

Neni 34

Kalimi i të drejtave të administrimit

Ortaku, me miratimin e gjithë ortakëve të tjerë, mund t'i kalojë një palë të tretë të drejtat e administrimit të shoqërisë.

Neni 35

Njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për administrim

1. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për shkaqe të arsyeshme, duke bërë njoftim paraprak, në një kohë të përshtatshme, për të mundësuar vazhdimin e veprimeve nga administratorët e tjerë, me përjashtim të rasteve kur dorëheqja e menjëhershme vlerësohet e justifikuar për një arsye të rëndësishme.

2. E drejta për administrim mund t'i hiqet ortakut me vendim të gjykatës përkatëse, me kërkesë të ortakëve të tjerë, nëse kjo justifikohet nga shkaqe të arsyeshme, përfshirë shkeljen e rëndë të detyrave të administratorit ose paaftësinë për t'i përmbushur ato në mënyrë të rregullt.

Neni 36

Marrja e vendimeve nga ortakët

1. Nëse vendimet duhet të merren nga ortakë nominalisht të përcaktuar, atëherë është i nevojshëm miratimi i të gjithëve, me përjashtim të rasteve kur ndonjëri prej tyre është në konflikt interesi me çështjen në shqyrtim.

2. Kur statuti lejon marrjen e vendimeve me shumicë votash, kjo shumicë duhet të jetë një shumicë e thjeshtë.

Neni 37

Humbja dhe fitimi

1. Në fund të çdo viti financiar, shoqëria përgatit pasqyrat vjetore financiare, ku përcaktohen fitimi dhe humbja, si dhe pjesa që i përket në to secilit ortak.

2. Secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë, në mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria.

TITULLI III

MARRËDHËNIET NDËRMJET ORTAKËVE DHE TË TRETËVE

Neni 38

Përfaqësimi i shoqërisë kolektive

1. Secili ortak ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut.

2. Nëse ortakët e përfaqësojnë shoqërinë bashkërisht, deklaratat, të cilat i drejtohen shoqërisë, mund t'i adresohen njërit prej ortakëve, me të drejtë përfaqësimi. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve apo kategorive të caktuara veprimesh.

3. Çdo përjashtim i ortakëve nga e drejta e përfaqësimit, çdo vendim për përfaqësim të përbashkët apo çdo ndryshim në të drejtat e një ortaku për përfaqësim njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 39

Njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për përfaqësim

1. Përfaqësuesi i shoqërisë mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, nëpërmjet një njoftimi paraprak, dhënë në një kohë të përshtatshme dhe duke pasur parasysh mundësitë e përfaqësuesve të tjerë, për të vijuar veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi i dorëhequr.

2. Ortakut mund t'i hiqet tagri i përfaqësimit me vendim të gjykatës përkatëse, me kërkesë të ortakëve të tjerë, veçanërisht në rastet e shkeljes së rëndë të detyrave të përfaqësimit apo të paaftësisë, për t'i përmbushur ato në mënyrë të rregullt.

Neni 40

Përgjegjësia personale e ortakëve

1. Ortakët përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë me të gjitha pasuritë e tyre. Çdo marrëveshje, në kundërshtim me këtë dispozitë, nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta.

2. Kreditori personal i ortakut mund të ekzekutojë kreditë, që ka ndaj këtij të fundit, duke ekzekutuar kreditë që ortaku ka ndaj shoqërisë, si dhe pjesën që ky ortak zotëron në shoqëri. Kreditori mund të kërkojë ekzekutimin e kredive, në përputhje me nenet 581 deri në 588 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 41

Prapësimet

Nëse një kreditor ngre padi ndaj një ortakut për detyrimet e shoqërisë, atëherë ortakut mund të mbrohet duke ngritur ndaj kreditorit prapësime, që i përkasin personalisht ortakut, si dhe ato që i përkasin shoqërisë.

Neni 42

Përgjegjësia e ortakut të ri

Personi, që fiton cilësinë e ortakut në një shoqëri kolektive ekzistuese, merr përsipër detyrimet e shoqërisë, përfshirë këtu edhe detyrimet që ekzistojnë përpara se ai ta fitonte këtë cilësi. Çdo marrëveshje në kundërshtim me këtë dispozitë nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta.

TITULLI IV

PRISHJA E SHOQËRISË KOLEKTIVE DHE LARGIMI I ORTAKËVE

Neni 43

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria kolektive priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;
- d) në rastet e parashikuara sipas nenit 47, të këtij ligji;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- ë) me vendim të ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga shumica e ortakëve, ndërsa në rastin e parashikuar sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të këtij neni, është i nevojshëm një vendim unanim i ortakëve.

3. Në rast mosveprimi të ortakëve për të vendosur prishjen e shoqërisë, për rastet e parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipër-përmendura, ekzistenca e një a më shumë prej shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe korrigjimi është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e rasteve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

Neni 44

Largimi i ortakut

Përveç rastit kur statuti parashikon ndryshe, ngjarjet e mëposhtme nuk kanë si pasojë prishjen e shoqërisë, por largimin e ortakut:

- a) vdekja e një ortaku;
- b) hapja e procedurave të falimentimit ndaj një ortaku;
- c) njoftimi i ortakut për largim nga shoqëria;
- ç) njoftimi i kreditorit personal të ortakut në rrethanat e përkrahura në nenin 46 të këtij ligji;
- d) vendim i ortakëve të tjerë;
- dh) raste të tjera të parashikuara në statut.

Neni 45

Njoftimi i ortakut për largim nga shoqëria

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, nëse shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të papërcaktuar, secili ortak mund të largohet nga shoqëria, duke njoftuar me shkrim ortakët e tjerë 6 muaj përpara. Në raste të justifikuara mund të zbatohet një njoftim me afat më të shkurtër.

Neni 46

Njoftimi nga kreditori personal i ortakut

Nëse kreditori personal i ortakut nuk ka arritur të ekzekutojë kreditë e tij ndaj këtij të fundit, në bazë të një vendimi gjyqësor, atëherë, brenda 6 muajve nga kërkesa, kreditori ka të drejtë t’i kërkojë shoqërisë likuidimin e pjesës që zotëron ortaku në shoqëri. Dispozitat e pikës 2 të nenit 40 të këtij ligji mbeten të zbatueshme edhe në këtë rast.

Neni 47

Prishja e shoqërisë me vendim gjyqësor

Shoqëria mund të priset me vendim gjyqësor për shkaqe të arsyeshme, në bazë të padisë së ngritur nga një ortak e, në mënyrë të veçantë, nëse njëri prej ortakëve, me dashje ose si pasojë e

pakujdesisë së rëndë, nuk ka kryer detyrat e caktuara në statut, apo nëse kryerja e këtyre detyrave është bërë e pamundur.

Neni 48

Përfshirja e ortakut

Në rrethanat e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji, gjykata, në bazë të padisë të ngritur nga një ortak, mund të vendosë të përfshijë ortakun përgjegjës dhe të mos vendosë prishjen e shoqërisë.

Neni 49

Ndarja e pjesës së ortakut që ikën

1. Pjesa e secilit ortak, që largohet nga shoqëria kolektive, ndahet në mënyrë proporcionale ndërmjet ortakëve të mbetur, me përfshirje të rasteve kur largimi është pasojë e falimentimit, njoftimit të kreditorit apo për raste të tjera të parashikuara në statut. Ortakët e mbetur janë të detyruar t'i paguajnë ortakut të larguar, kreditorëve apo trashëgimtarëve të tij, në përputhje me rregullat e trashëgimisë, vlerën që ai do të kishte përfituar nëse shoqëria do të ishte prishur në çastin e daljes së tij, duke pasur parasysh edhe veprimet ende të papërfunduara.

2. Nëse vlera e aktiveve të shoqërisë nuk është e mjaftueshme për të përballuar të gjitha detyrimet e saj, ortakut që largohet apo trashëgimtarët e tij, në përputhje me rregullat e trashëgimisë, përgjigjet për diferencën, në përpjesëtim me pjesën e humbjeve të shoqërisë, që i takojnë.

3. Në rast përfshirje, sipas nenit 48 të këtij ligji, ortakët mund të zbresin nga shuma e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vlerën e dëmit të mundshëm, që shoqëria ka pësuar nga mospërmblidhjet e ortakut.

Neni 50

Procedura për rastet kur mbetet vetëm një ortak

1. Kur, për çfarëdo arsye, shoqëria kolektive mbetet me një ortak të vetëm, atëherë ai është i detyruar që, brenda 6 muajve nga ngjarja e këtij fakti, të marrë masat e nevojshme për ta përshtatur shoqërinë me kërkesat e këtij ligji, apo në mënyrë alternative t'i kalojë veprimtarinë e saj një shoqërie të themeluar rishtazi, që pranon ekzistencën e një ortakut të vetëm ose të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë duke u regjistruar si tregtar.

2. Nëse brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ortakut i mbetur nuk regjistron një prej veprimeve si më sipër në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria kolektive vlerësohet e prishur dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji. Çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

Neni 51

Vazhdimi i shoqërisë nga trashëgimtarët

1. Shoqëria kolektive vazhdon ta ushtrojë veprimtarinë me trashëgimtarët e ortakut të vdekur, nëse lejohet në statut dhe pranohet nga trashëgimtarët.

2. Trashëgimtarët mund të ushtrojnë të drejtën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data, në të cilën gjykata përkatëse, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, lëshon dëshminë e trashëgimisë.

Neni 52

Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Të gjithë ortakët janë të detyruar të njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, për aktet, faktet e prishjes dhe largimit të ortakëve.

Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, sipas nenit 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

TITULLI V

LIKUIDIMI I SHOQËRISË KOLEKTIVE

Neni 53

Likuidimi i shoqërisë kolektive në gjendjen e aftësisë paguese

Prishja e shoqërisë kolektive në gjendjen e aftësisë paguese ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, sipas neneve 190 deri 205 të këtij ligji.

Neni 54

Parashkrimi i padive ndaj një ortaku

1. Me përjashtim të rasteve kur padia ndaj shoqërisë kolektive ka një afat parashkrimi më të shkurtër, paditë ndaj një ortaku për detyrimet e shoqërisë kolektive ngrihen brenda 3 vjetëve pas prishjes së saj.

2. Parashkrimi nis në datën kur është regjistruar prishja e shoqërisë.

3. Nëse detyrimi ndaj shoqërisë kolektive bëhet i kërkueshëm pas regjistrimit të prishjes, parashkrimi nis në datën kur detyrimi bëhet i kërkueshëm.

4. Ndërprerja e parashkrimit për detyrimet e shoqërisë kolektive zbatohet edhe ndaj personave, që kanë pasur cilësinë e ortakut në çastin e prishjes.

Neni 55

Parashkrimi në rastin e largimit të ortakut

Ortaku i larguar nga shoqëria përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që kanë lindur përpara largimit të tij, nëse këto detyrime kanë lindur përpara 3 viteve nga data e këtij largimi. Parashkrimi nis në datën e regjistrimit të largimit të ortakut.

PJESA III

SHOQËRIA KOMANDITE

Neni 56

Përkufizimi

1. Shoqëri komandite është shoqëria, në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit nuk është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i pakufizuar. Ortaku i pakufizuar ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, dispozitat që rregullojnë shoqërinë kolektive janë të zbatueshme edhe për shoqërinë komandite.

Neni 57
Regjistrimi

1. Shoqëria komandite regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 34 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Nëse shoqëria komandite ka krijuar faqe të saj në internet, të dhënat që i njoftohen për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 58
Marrëdhëniet ndërmjet ortakëve

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve rregullohen nga nenet 59 deri 61 të këtij ligji. Statuti mund të parashikojë ndalimin e konkurrencës, sipas nenit 17 të këtij ligji, edhe për ortakët e kufizuar.

Neni 59
Administrimi

1. Veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite administrohet nga një ose më shumë ortakë të pakufizuar. Ortakët e kufizuar nuk kryejnë veprime administrimi.

2. Një ortak i kufizuar nuk mund të kundërshtojë veprimet e administrimit të ortakut të pakufizuar, me përjashtim të rasteve kur ai kryen një veprim, që shkon përtej veprimtarisë të zakonshme të shoqërisë.

Neni 60
Përballimi i humbjeve

Ortaku i kufizuar përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera.

Neni 61
Ndalimi i përfaqësimit ligjor

Ortaku i kufizuar nuk mund të veprojë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite.

Neni 62
Përgjegjësia e ortakëve të kufizuar

1. Ortaku i kufizuar përgjigjet personalisht ndaj kreditorëve të shoqërisë kolektive deri në vlerën e kontributeve të pashlyera. Ortaku i kufizuar nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur ka shlyer të gjitha kontributet e tij.

2. Rritja e paregjistruar e një kontributi të regjistruar prodhon efekte ndaj kreditorëve, vetëm nëse shoqëria ka njoftuar kreditorin për këtë rritje, ose nëse rritja është publikuar në mënyrë të zakonshme.

3. Marrëveshjet ndërmjet ortakëve, që përjashtojnë ortakun e kufizuar nga detyrimi për të shlyer kontributet, apo që shtyjnë afatin e shlyerjes së këtyre kontributeve, nuk prodhojnë efekte ndaj kreditorëve.

4. Zvogëlimi i kontributeve nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, për sa kohë ky zvogëlim nuk është regjistruar, me përjashtim të rastit kur kreditori kishte dijeni për këtë zvogëlim. Zvogëlimi i kontributeve, edhe nëse është i regjistruar, nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, detyrimet e të cilëve kishin lindur përpara regjistrimit të këtij zvogëlimi.

5. Nëse shoqëria i kthen ortakut të kufizuar kontributet e dhëna, ortakut i kufizuar përgjigjet ndaj kreditorëve sikur kontributi të mos ishte paguar ndonjëherë. I njëjti parim zbatohet edhe në rastet kur ortakut i kufizuar tërheq një pjesë të fitimit dhe pjesa e tij në shoqëri bëhet më e vogël se kontributi i marrë përsipër.

6. Ortaku i kufizuar nuk është i detyruar t'i kthejë fitimet, të cilat i ka marrë në mirëbesim, në bazë të pasqyrave financiare, të përgatitura në mirëbesim.

Neni 63

Regjistrimi i ndryshimeve të kontributit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Ortakët duhet t'i njoftojnë për regjistrim Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të gjitha rritjet ose zvogëlimet e kontributit të një ortakut të kufizuar, sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 64

Përgjegjësia nga perceptimi i cilësive ligjore

1. Ortaku i kufizuar përgjigjet si ortak i pakufizuar, nëse emri i tij është përfshirë, me pëlqimin e tij, në emrin e regjistruar të shoqërisë.

2. Ortaku i kufizuar, që ka lidhur me një palë të tretë një marrëveshje në cilësinë e agentit të autorizuar të shoqërisë, por pa u cilësuar si i tillë, përgjigjet për këtë veprim si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rastit kur provon se i treti kishte dijeni për faktin se ortakut vepronte si agent i autorizuar apo në bazë të rrethanave të qarta nuk kishte si të mos ishte në dijeni.

3. Ortaku i kufizuar përgjigjet për detyrimet e shoqërisë si të ishte ortak i pakufizuar, nëse ai vepron në kundërshtim me parashikimin e fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 59 të këtij ligji.

Neni 65

Përgjegjësia përpara regjistrimit

Kur themeluesit e shoqërisë komandite marrin përsipër detyrime për veprimtarinë tregtare të shoqërisë, përpara se shoqëria të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ortakut i kufizuar, që pranon të marrë përsipër këto detyrime, përgjigjet si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rastit kur provon se pala e tretë kishte dijeni për kufizimet e përgjegjësisë së tij, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk kishte si të mos ishte në dijeni.

Neni 66

Përgjegjësia e një ortakut të ri të kufizuar

Ortakut i kufizuar, i cili fiton këtë cilësi në një shoqëri komandite ekzistuese, përgjigjet sipas dispozitave të nenit 62 të këtij ligji, për detyrimet e shoqërisë, që kanë lindur përpara fitimit të kësaj cilësie.

Neni 67

Largimi i ortakëve

1. Shoqëria komandite nuk prishet për shkak të vdekjes apo të prishjes së një ose më shumë prej ortakëve të kufizuar.

2. Nëse të gjithë ortakët e pakufizuar largohen nga shoqëria, atëherë shoqëria kolektive prishet dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Nëse largohen të gjithë ortakët e kufizuar, atëherë veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie kolektive apo, nëse mbetet vetëm një ortak i pakufizuar, veprimtaria mund të ushtrohet me statusin e tregtarit.

4. Ndryshimet e përmendura në pikat 1 e 3 të këtij neni duhet t'i njoftohen për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

5. Prishja e shoqërisë komandite në gjendjen e aftësisë paguese ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, sipas neneve 190 deri 205 të këtij ligji.

PJESA IV SHOQËRITË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 68

Përkufizimi

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

2. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenet 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.

3. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

4. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.

6. Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Neni 69

Regjistrimi

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Nëse shoqëria tregtare ka krijuar një faqe të saj në internet, të dhënat që i njoftohen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 70

Kapitali minimal

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë.

Neni 71

Shoqëria me ortak të vetëm

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

2. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria tregtare vijon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.

TTULLI II

KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 72

Zotërimi i kuotave

1. Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

2. Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

3. Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

4. Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

5. Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

6. Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

Neni 73

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të

rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 74

Pasojat e kalimit të kuotave

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 75

Pjesëtimi i kuotave dhe transferimi i tyre

1. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

2. Dispozitat e nenit 73 të këtij ligji për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

TITULLI III

MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

Neni 76

Shpërndarja e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 77

Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese

(Ndryshuar pika 3, shtuar pika 4 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria mund t’u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të këtij ligji, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut,

e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.

4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

Neni 78

Përgjegjësia personale për shpërndarjet e ndaluara

1. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 77 të këtij ligji, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

2. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e pa aftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 77 të këtij ligji, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

Neni 79

Rikthimi i shpërndarjeve të ndaluara

1. Paditë e shoqërisë, siç parashikohet në nenin 78 të këtij ligji, mund të ngrihen edhe sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

2. Parashkrimi i padive, sipas pikës 1 të këtij neni, nis në datën kur është kryer shpërndarja e ndaluar.

Neni 80

Anulimi i kuotave nga shoqëria

1. Statuti mund të parashikojë të drejtën e shoqërisë për të anuluar një kuotë. Në këto raste statuti duhet të parashikojë shkaqet e procedurat për anulimin e likuidimin e kuotës.

2. Kuota mund të anulohet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti.

3. Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e saj.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

KREU I

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 81

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 82

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenet 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 83
Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 84
Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 85
Përfaqësimi në asamble
(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 86
Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme

duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 87

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 88

E drejta e votës

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të këtij ligji.

2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 89

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 90

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 91

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 92

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 87, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt, përpara gjykatës kompetente, padi në emër të shoqërisë, për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.

3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të këtij ligji zbatohet edhe për këto padi.

Neni 93

Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 94

Ndalimi i kufizimeve

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.

2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji.

KREU II ADMINISTRATORËT

Neni 95

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

(Ndryshuar fjalia e tretë e pikes 1, shtuar pika 7, 8 dhe 9 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

7. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

8. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin

e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

9. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

Neni 96

Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 97

Shpërblimi

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshtëm të asamblesë së përgjithshme.

2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 98

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

TITULLI V PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

KREU I PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 99

Shkaqet e prishjes së shoqërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhe i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.
3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit

gyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

Neni 100

Regjistrimi i shpërbërjes

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

KREU II

LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Neni 101

Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 102

Përfundimi i ortakut

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përfundimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfundim.

2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Neni 103

Pasojat e largimit dhe përjashtimit

1. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

Neni 104

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

PJESA V

SHOQËRITË AKSIONARE

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE THEMELIMI

Neni 105

Përkufizimi dhe llojet

1. Shoqëria aksionare është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë e që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara.

2. Shoqëritë aksionare mund të jenë shoqëri me ofertë, private apo publike, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Neni 106
Regjistrimi

1. Shoqëritë aksionare regjistrohen sipas neneve 26, 28, 32 e 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Nëse shoqëria krijon një faqe të saj në internet, të dhënat, të cilat regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 107
Kapitali minimal
(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 475, datë 27.10.2011)

1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.

2. Shoqëria aksionare me oferte publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë.

Neni 108
Llojet e kontributeve

Kontributet e aksionarëve mund të jenë në para apo në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme ose në të drejta të vlerësueshme në para). Kontributet e aksionarëve nuk mund të jenë në punë apo në shërbime.

Neni 109
Vlera nominale dhe emetimi i aksioneve

1. Çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale.

2. Aksionet nuk mund të emetohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Aksionet e emetuara më parë janë të pavlefshme. Themeluesit përgjigjen në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara ndaj zotëruesve të aksioneve, me emetim të parakohshëm.

3. Të drejtat e lidhura me aksionet nuk mund të transferohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 110
Vlera e aksioneve të emetuara

1. Vlera e përgjithshme nominale e aksioneve të emetuara nuk mund të jetë më e vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë. Rrjedhimisht, shoqëria nuk mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim nën vlerën e tyre nominale.

2. Shoqëria mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim më të lartë se vlera e tyre nominale.

Neni 111
Kostot e themelimit

1. Themeluesit mund t'i kërkojnë shoqërisë rimbursimin e kostove të themelimit, deri në vlerën më të lartë, të parashikuar në statut.

2. Kostot e themelimit u paguhen themeluesve nga fitimet, që realizon shoqëria. Përveç se kur parashikohet ndryshe në statut, aksionarët mund të vendosin që rimbursimi i kostove të themelimit të këtë përparësi gjatë shpërndarjes së fitimeve.

Neni 112

Kontributet në natyrë

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Kur aksionarët japin kontribute në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen përpara regjistrimit të shoqërisë nga një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse. Këta ekspertë janë persona fizikë apo juridikë, të licencuar sipas dispozitave të posaçme, me kompetenca teknike të nevojshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

2. Raporti i vlerësimit të ekspertëve duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur, sipas kësaj metode, i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit.

3. Aktivet, kuotat apo aksionet e një shoqërie ekzistuese mund të jepen si kontribut në një shoqëri aksionare, vetëm nëse shoqëria, që jep kontributin, ka të paktën 2 vite që është e regjistruar. Në këtë rast, së bashku me raportin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, paraqiten edhe pasqyrat financiare të dy viteve të fundit të shoqërisë në fjalë, si edhe dokumentet për vlerësimin e saj.

4. Raporti i vlerësimit, i përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni e sipas rastit dhe dokumentet e tjera dorëzohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me aplikimin për regjistrim.

5. Dispozitat e mësipërme zbatohen, gjithashtu, edhe kur shoqëria, brenda 2 vjetëve pas themelimit blen pasuri ose të drejta nga një prej themeluesve.

6. Raporti i vlerësimit, i përmendur në paragrafët e mësipërm, nuk është i detyrueshëm në rastet vijuese:

a) shoqëria themelohet në vijim të një bashkimi apo ndarjeje dhe raporti i vlerësimit të ekspertëve, të përcaktuar sipas nenit 217, të këtij ligji, është hartuar;

b) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, dhe nëse raporti i vlerësimit të ekspertëve të përcaktuar sipas nenit 217, të këtij ligji, është hartuar;

c) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadrin e një oferte për marrje në kontroll, me objekt blerjen apo shkëmbimin e aksioneve, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërisë, e cila është objekt i ofertës publike për marrje në kontroll.

Neni 113

Shlyerja dhe kalimi i kontributeve përpara regjistrimit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen përpara regjistrimit të shoqërisë, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Shumat që mbeten shlyhen në një ose më shumë këste, sipas vendimit të organeve të administrimit të shoqërisë. Vlerat më të larta, sipas pikës 2 të nenit 110 të këtij ligji, duhet të shlyhen plotësisht.

2. Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të paguhen tërësisht përpara regjistrimit, nëpërmjet kalimit në favor të shoqërisë të titullit të pronësisë së kontributit në natyrë. Nëse, sipas ligjit, kërkohet kryerja e formaliteteve të posaçme për regjistrimin e kalimit të titullit të pronësisë së kontributit në natyrë, këto formalitete kryhen nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë. Kontributi në natyrë do të konsiderohet i paguar në çastin kur aksionari të ketë kryer të gjitha veprimet dhe të ketë nënshkruar të gjitha aktet e kërkuara nga ligji për kalimin e titullit të pronësisë së kontributit në emër të shoqërisë.

3. Themeluesit, të cilët nuk shlyejnë apo kalojnë kontributet e tyre brenda afateve të përcaktuara më sipër, përgjigjen ndaj shoqërisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 10 pikat 2 e 3 dhe 124 të këtij ligji.

Neni 114

Dispozitat e posaçme për shoqëritë me aksionar të vetëm

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Nëse përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit themeluesi i vetëm nuk ka shlyer apo kaluar tërësisht kontributet e tij në para ose natyrë, atëherë ai duhet garantojë shlyerjen e kontributit, nëpërmjet një garancie bankare, me vlerë të njëjtë me kontributin e nënshkruar me afat vlefshmërie jo më shumë se njëvjeçar e t'ia paraqesë këtë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me aplikimin për regjistrim. Nëse në përfundim të afatit njëvjeçar të garancisë bankare aksionari nuk i deklaron bankës shlyerjen tërësisht të kontributit të parashikuar në statut, shuma e garancisë bankare kalon automatikisht për llogari të shoqërisë për shlyerjen e kapitalit.

2. Nëse shoqëria mbetet me një aksionar, atëherë aksionari i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse aksionari i mbetur nuk e përmbush këtë detyrim, atëherë aksionari përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data, në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

Neni 115

Procedura e themelimit

1. Shoqëritë aksionare, pas miratimit të statutit nga themeluesit, themelohen në përputhje me dispozitat e nenit 106 të këtij ligji. Në statut përcaktohen administratorët e parë dhe anëtarët e parë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës. Detyra e këtyre personave përfundon në datën e mbledhjes së parë të asamblesë së përgjithshme.

2. Kontributet në para, sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, shlyhen në një llogari bankare, të përcaktuar sipas parashikimeve të statutit. Shoqëria, së bashku me aplikimin për regjistrim, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dokumentin bankar, që vërteton shlyerjen e kontributit në para.

3. Përfaqësuesi i shoqërisë mund të tërheqë fondet e mbledhura nga kontributet në para vetëm pas regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

TITULLI II AKSIONET

Neni 116

Llojet dhe kategoritë e aksioneve

1. Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.

2. Shënimi në statut i përparësive, që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve, prezumohet shterues.

3. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

Neni 117

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të këtij ligji.

3. Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionin, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshi momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e aksionit hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Transaksionet në formë elektronike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", konsiderohen të kryera në formë shkresore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Neni 118

Akti i emetimit të aksioneve

1. Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Në rastin e ofertës private apo publike të aksioneve, akti i emetimit të aksioneve duhet të ndjekë, gjithashtu, procedurat e përcaktuara në ligjin për titujt.

3. Shoqëria lëshon certifikatën e aksionit me shpenzimet e aksionarit që e kërkon atë. Vendimi për lëshimin e certifikatës merret nga themeluesit apo nga asambleja.

Neni 119

Regjistrimi i aksioneve

1. Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

2. Personat e regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni, prezumohen si aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve.

3. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër

që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Dispozitat e seksioneve IV, VII e VIII të kreut III të pjesës së posaçme të Kodit Penal zbatohen për parregullsitë e emetimit të aksioneve, si dhe për parregullsitë e kryerjes së regjistrimeve e të mbajtjes së regjistrit të aksioneve.

5. Përcaktimet e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni nuk cenojnë detyrimin e shoqërisë për njoftimin e listës së aksionarëve, në përputhje me pikën 4 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe detyrimin për të regjistruar aksionet, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Neni 120

Kushtet për kalimin e aksioneve

Statuti mund të parashikojë që kalimi i aksioneve të kushtëzohet nga pëlqimi i organeve drejtuesve të shoqërisë dhe/ose nga e drejta e parablerjes, në favor të aksionarëve të tjerë.

Neni 121

Zotërimi i përbashkët i aksioneve

1. Një aksion i shoqërisë mund të zotërohet nga një apo më shumë persona. Personat që zotërojnë në mënyrë të përbashkët një aksion, në marrëdhënie me shoqërinë, ushtrojnë të drejtat e aksionarit, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët.

2. Personat që zotërojnë një aksion në mënyrë të përbashkët, përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet, që rrjedhin nga zotërimi i aksionit.

3. Personat që zotërojnë një aksion, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga ky aksion. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

4. Veprimet e shoqërisë ndaj aksionit të zotëruar nga më shumë persona krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të tij, edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

5. Dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë janë të zbatueshme kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen e lidhur, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Neni 122

Të drejtat e votës

1. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

2. Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

TITULLI III

MARRËDHËNIET LIGJORE NDËRMJET SHOQËRISË DHE AKSIONARËVE

Neni 123

Detyrimi për të paguar kontributet

Aksionarët shlyejnë vlerën nominale të aksionit apo çmimin më të lartë të emetimit në llogarinë e shoqërisë dhe kalojnë kontributin në natyrë, në përputhje me specifikat e vetë kontributit apo me mënyrat e parashikuara në statut. Dispozitat e neneve 112 e 113 të këtij ligji zbatohen edhe për detyrimet e themeluesve.

Neni 124

Pasojat e vonesës së shlyerjes

1. Aksionari detyrohet t'i paguajë shoqërisë një kamatëvonesë prej 4 për qind në vit të shumës së pashlyer të kontributit në para, duke nisur nga data kur detyrimi bëhet i kërkueshëm, sipas këtij ligji apo sipas statutit. Shoqëria mund të kërkojë dëmshpërblim shtesë të shkaktuar nga vonesa në shlyerjen e kontributit në para. Statuti mund të parashikojë pagesa të mëtejshme, nëse ky detyrim nuk përmbushet në afat.

2. Shoqëria mund të caktojë një afat 30-ditor për shlyerjen e kontributit për aksionarët, që nuk e kanë kryer pagesën brenda afateve të parashikuara, sipas këtij ligji apo sipas statutit. Nëse këta aksionarë nuk përmbushin detyrimin e shlyerjes së kontributit brenda këtij afati, atëherë ata humbasin të drejtën e pjesëmarrjes në asamblenë e përgjithshme dhe aksionet e zotëruara prej tyre nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit. E drejta për të përfituar dividendë, si dhe çdo e drejtë tjetër e lidhur me aksionin pezullohet.

3. Nëse aksionari nuk shlyen kontributet në para, brenda 3 muajve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin për vlerën e kontributit të pashlyer e të anulojë aksionin, sipas nenit 186 të këtij ligji.

Neni 125

Ndalimi i faljes së detyrimit mbi kontributet

1. Shoqëria nuk mund t'i falë detyrimin për të shlyer kontributet në para apo kalimin e kontributeve në natyrë të nënshkruara nga aksionarët, si dhe detyrimet e tjera, që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimit për shlyerje apo kalim të kontributit.

2. Aksionarët nuk mund të kompensojnë të drejtat, që mund të kenë ndaj shoqërisë me detyrimin për shlyerjen apo kalimin e kontributit të nënshkruar, si dhe nuk mund t'i japin shoqërisë një kontribut të rënduar me barrë.

3. Shoqëria mund të çlirojë aksionarët nga detyrimi për të shlyer kontributet në para apo kalimi i kontributeve në natyrë vetëm nëpërmjet zvogëlimit të zakonshëm të kapitalit, në përputhje me nenet 181, 182, 183 e 184 të këtij ligji, në përpjesëtim me vlerën, me të cilën kapitali zvogëlohet. Çlirimi nga këto detyrime mund të kryhet edhe nëpërmjet anulimit të aksioneve, në përputhje me nenin 186 të këtij ligji.

Neni 126

Ndalimi i kthimit të kontributeve

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj, kontributet nuk mund t'u kthehen aksionarëve.

Neni 127

Rezerva ligjore dhe rezervat e tjera

1. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

2. Statuti mund të parashikojë krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.

3. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 128

Deklarimi i dividendit

1. Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

2. Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

3. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, dividendi shpërndahet mes aksionarëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë.

4. Në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të vendosë që shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të mos u paguhet aksionarëve, që zotërojnë aksione të kategorive të veçanta, por këto shuma të përdoren për qëllime të tjera. Të drejtat e aksionarëve, sipas parashikimeve të statutit, mund të ndryshohen vetëm nëpërmjet një vendimi të marrë me tre të katërtat e votave, sipas përcaktimit të nenit 145 të këtij ligji.

Neni 129

Rikthimi i pagesave të paligjshme

Aksionarët detyrohen t'i kthejnë shoqërisë të gjitha shumat e përfituara nga ajo në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Këtu përfshihet dividendi, nëse aksionari kishte dijeni apo nuk kishte si të mos ishte në dijeni që dividendi apo përparësitë e tjera ishin marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Padia për rikthimin e përfitimeve, sipas këtij neni, parashkruhet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së pagesës së parregullt.

Neni 130

Shpërblimi për transaksionet ndërmjet shoqërisë dhe aksionarëve

Me përjashtim të veprimeve, që lidhen me kontributin në kapital, shpërblimi i përfituar nga aksionari, në bazë të një veprimi ekonomik të kryer me shoqërinë, nuk mund të jetë më i lartë se vlera normale, që ka tregu në atë çast për veprime ekonomike të ngjashme.

Neni 131

Mosshlyerja e kredisë

1. Kur aksionari i jep hua shoqërisë, duke zbatuar kushte më pak të favorshme nga kushtet normale të tregut dhe nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, atëherë aksionari nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin e huasë, kur ky veprim do të kishte si pasojë reduktimin e kapitaleve të veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.

2. Nëse një i tretë i ka dhënë shoqërisë hua, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni dhe rikthimi i huasë është garantuar nga aksionari, atëherë i tretë, në rastet kur shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, mund t'i kërkojë shoqërisë vetëm rikthimin e shumës, që nuk ka mundur ta ekzekutojë nga garancia e aksionarit.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo palëve të treta, nëse, nga pikëpamja ekonomike, janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në këto pika.

Neni 132

Përgjegjësia për kreditë e shlyera

1. Kur në rastet e përmendura në nenin 131 të këtij ligji, shoqëria, gjatë një periudhe 1-vjeçare përpara datës së hapjes së procedurave të falimentimit, i ka kthyer aksionarit huanë, atëherë aksionari, të cilit i është rikthyer huaja, apo i cili ka dhënë garanci duhet t'i rikthejë shoqërisë shumat e huasë, që janë paguar prej saj. Aksionari përgjigjet deri në vlerën e garancisë, në çastin kur huaja është kthyer. Aksionari nuk përgjigjet për këto shuma, kur kolaterali i dhënë si garanci, i kalohet shoqërisë për pagesën e huasë.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo të palëve të treta, nëse nga pikëpamja ekonomike janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 133

Ndalimi i nënshkrimit e blerjes së aksioneve

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta. Blerja e aksioneve të veta nga shoqëria lejohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Një shoqëri e kontrolluar nuk mund të nënshkruajë ose të blejë aksionet e shoqërisë mëmë.

3. Nëse gjatë procedurës së themelimit apo të rritjes së kapitalit, një i tretë, në kundërshtim nga sa më sipër, ka nënshkruar ose ka blerë aksionet për llogari të një shoqërie, apo të një shoqërie të kontrolluar, sipas pikës 2 të këtij neni, atëherë ai vlerësohet se i ka nënshkruar apo blerë ato për llogari të tij.

4. Aksionet e fituara, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një viti nga data e fitimit, duhet të shiten nga shoqëria ose të anulohen, sipas nenit 186 të këtij ligji dhe çregjistrohen nga regjistri i aksioneve.

5. Shoqëria nuk mund të ushtrojë, për aksionet e veta, të drejtat që sipas ligjit rrjedhin nga zotërimi i tyre.

6. Aksionet e një shoqërie që zotërohen nga një shoqëri tjetër, e cila, në momentin e fitimit të tyre, nuk ishte, por bëhet në vijim shoqëri e kontrolluar, duhet që, në mënyrë alternative, të shiten nga shoqëria e kontrolluar apo të anulohen nga shoqëria mëmë, brenda një viti nga data në të cilën është krijuar mes tyre marrëdhënia shoqëri mëmë - shoqëri e kontrolluar sipas këtij ligji.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 134

Organet dhe publikimi

1. Organet e shoqërive aksionare janë:

a) asambleja e përgjithshme;

dhe, në varësi të dispozitave të statutit,

b) këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel);

c) këshilli mbikëqyrës dhe një apo më shumë administratorë, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre 2 organeve (sistemi me dy nivele).

Në këtë rast, sipas parashikimeve të statutit, administratorët mund të caktohen e shkarkohen nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës.

2. Shoqëritë aksionare, në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikën, që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e miradministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

KREU I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 135

Të drejtat dhe detyrimet

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të këtij ligji, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës e, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “ç” të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;

- c) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 136

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ky ligj, nga anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Pika 4 e nenit 13 të këtij ligji zbatohet në rastin kur veprimet sipas kësaj pike do të kryhen me personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të nenit 13 të këtij ligji.

5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

7. Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

Neni 137

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:

- i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të këtij ligji;
- ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;

- iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
- c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të këtij ligji;
- ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
3. 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:
- a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;
- b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;
- c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.
4. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Neni 138 **Rendi i ditës**

1. Rendi i ditës, që njoftohet sipas nenit 137 të këtij ligji, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.
2. Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
3. Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 137 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 139 **Mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës, i kërkuar nga aksionarët e pakicës**

1. Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
- a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të këtij ligji.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

Neni 140

Përfaqësimi në asamble

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

Neni 141

Pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme

1. Statuti apo asambleja e përgjithshme mund të përcaktojë rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Këto rregulla miratohen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e tre të katërtave të kapitalit, të përfaqësuar në mbledhje, sipas nenit 145 të këtij ligji.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut apo në rregullat e miratuara më sipër, asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

3. Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

4. Aksionarët, nëpërmjet një marrëveshjeje unanime me shkrim, mund të vendosin që çdo vendim, që ata kanë të drejtë të marrin sipas këtij ligji apo statutit të shoqërisë, të merret në mënyrë unanime.

Neni 142

Pjesëmarrja me mjete komunikimi elektronike

1. Statuti mund të parashikojë për aksionarët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

2. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson ortakëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

3. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar aksionarëve marrjen pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 143

Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

2. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.

3. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 144

Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkrësë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 145

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 144 të këtij ligji, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 135 të këtij ligji, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

Neni 146

Mënyra e votimit

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ky ligj ose nga statuti, asambleja e përgjithshme merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur.

2. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose, sipas rastit, të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Neni 147

E drejta e votës

Në përputhje me dispozitat e pikës 1 të nenit 122 të këtij ligji, çdo aksion mbart të drejtën e një vote.

Neni 148

Përjashtimi nga votimi

1. Aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Në rastet kur aksionari përfaqësohet me autorizim, ky ndalim zbatohet edhe për personin e autorizuar.

Neni 149

Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote

1. Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote, gëzojnë të gjitha të drejtat e tjera, që rrjedhin prej zotërimit të tyre, sipas këtij ligji.

2. Efektet e vendimit të asamblesë së përgjithshme për anulimin, kufizimin ose cenimin e të drejtave të përparësisë së këtyre aksioneve kushtëzohen nga pëlqimi i aksionarëve, që i zotërojnë ato.

3. Miratimi, sipas pikës 2 të këtij neni, merret gjatë një mbledhjeje të posaçme, vlefshmëria e së cilës kushtëzohet nga prania e aksionarëve, të cilët zotërojnë më shumë se 1/2 e pjesës së kapitalit të shoqërisë, që përfaqësohet nga aksione me përparësi. Vendimi i posaçëm për këto çështje merret me miratimin e 3/4 të aksionarëve, që zotërojnë aksionet me përparësi, të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje. Statuti nuk mund të ndryshojë këtë shumicë, apo të caktojë kushte ose procedura të tjera, të detyrueshme për t'u ndjekur për këtë çështje.

4. Nëse përparësia anulohet, atëherë këto aksione rifitojnë të drejtën e votës.

Neni 150

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të nisë një hetim të posaçëm për parregullsitë në veprimet e themelimit të shoqërisë dhe të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për

emërimit e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimit e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm, aksionarët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e ekspertit, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur.

4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimt, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditorët që, në keqbesim, paraqesin kërkesa, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjen në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 151

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 145, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe/ose për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo anëtarëve të këshillit të administrimit a këshillit mbikëqyrës.

2. Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve ose anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente padi në emër të shoqërisë për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.

3. Në varësi të organit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vendimi i të cilit paditet për shfuqizim, asambleja e përgjithshme merr pjesë në gjykim me anë të administratorëve, me anë të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës. Shoqëria mund të marrë pjesë në gjykim edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Aksionarët e pakicës ose kreditorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, që nuk bën pjesë në organet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të ankimuar, nëse organi, që ka nxjerrë aktin e paditur, nuk merret vesh me pajtim me personin, që përfaqëson shoqërinë, sipas pikave 3 ose 4 të këtij neni, për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Aksionarët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen e padisë ndaj administratorëve apo anëtarëve të këshillave, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si pasojë e vendimit të paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve ose anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës.

7. Dispozita e pikës 6 të nenit 150 të këtij ligji zbatohet edhe për paditë e parashikuara në këtë nen.

Neni 152

Të drejtat e lidhura me aksionin

Aksionari, që pengohet të ushtrojë të drejtat, të cilat rrjedhin nga zotërimi i aksionit të shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo të kërkojë dëmshpërblim. Padia duhet ngritur brenda 3 vjetëve pas pengimit të ushtrimit të së drejtës.

Neni 153

Ndalimi i kufizimeve

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e aksionarëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të përmendura në nenet 150, 151 e 152 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve, të përcaktuara në këto nene.

2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e aksionarëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 150, 151 e 152 të këtij ligji.

KREU II

KËSHILLI I ADMINISTRIMI. SISTEMI ME NJË NIVEL

Neni 154

Të drejtat dhe detyrimet

1. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i

këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën “e” të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;

g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli i administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 155

Numri, emërimi dhe përbërja e këshillit të administrimit

1. Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

2. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të këtij ligji, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të rizgjidhen.

3. Statuti mund të parashikojë që aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, të kenë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm. Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit mbi numrin maksimal prej 21 anëtarësh.

4. Anëtarë të pavarur të këshillit të administrimit vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 156

Zgjedhshmëria e kufizuar

1. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë.

2. Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i këshillit të administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është:

a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;

c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.

3. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e palëve të treta mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

4. Anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord.

5. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit të administrimit detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

Shkarkimi dhe dorëheqja

(Ndryshuar titulli, shtuar pika 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Anëtari i këshillit të administrimit, i cili është zgjedhur në përputhje me pikën 3 të nenit 155 të këtij ligji, mund të shkarkohet me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash.

3. Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrat e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të këtij ligji.

4. Anëtari i këshillit të administrimit mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Anëtari i këshillit të administrimit që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e anëtarit të ri të këtij këshilli, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.

5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e anëtarit të ri të këshillit të administrimit në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga anëtari i dorëhequr, atëherë administratori apo, në mungesë apo mosveprim të tij, anëtari i dorëhequr, i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, dhe Qendra Kombëtare të Regjistrimit regjistron largimin e anëtarit të këshillit të administrimit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

6. Dorëheqja e anëtarit të këshillit të administrimit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që anëtari ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

Administratorët

(Ndryshuar fjalia e katërt e pikës 1, shtuar pikat 8, 9, 10 dhe 11 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit. Emërimi mund t'u kundrejtohet palëve të treta, sipas parimeve të nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

3. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;

d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.

6. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe.

7. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8. Administratori, i cili nuk është anëtar i këshillit të administrimit, mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar këtij këshilli. Administratori, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, duhet të përcaktojë në njoftimin e shkruar datën në të cilën dorëheqja hyn në fuqi.

9. Nëse këshilli i administrimit nuk vendos emërimin e administratorit të ri përpara datës, në të cilën dorëheqja hyn në fuqi, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

10. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimeve të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

11. Në rastet kur administratori është njëkohësisht anëtar i këshillit të administrimit apo kur, sipas pikës 2, të nenit 167, administratori emërohet nga asambleja e përgjithshme, dispozitat e mësipërme të këtij neni, në lidhje me dorëheqjen e administratorit, nuk zbatohen dhe dorëheqja kryhet sipas pikave 4, 5 dhe 6, të neni 157, të këtij ligji.

Neni 159 Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve mund t'u kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 160
Shpërblimi

1. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga këshilli i administrimit dhe miratohet nga asambleja e përgjithshme.

2. Në përputhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, shpërblimet individuale përcaktohen nga këshilli i administrimit dhe duhet të pasqyrojnë, në mënyrë përshtatshme, ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, që mbajnë detyrën e administratorëve dhe anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Skema e shpërblimeve, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë, së bashku me një raport për efektin vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore, sipas shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji.

Neni 161
Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme

1. Statuti ose këshilli i administrimit mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit për këto rregullore merren në mënyrë unanime.

2. Këshilli i administrimit duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, në përputhje me dispozitat e statutit. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit.

3. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

4. Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

Neni 162
Marrja e vendimeve

1. Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

2. Vendimet e këshillit të administrimit mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

3. Përjashtimet nga e drejta e votës, sipas nenit 148 të këtij ligji, zbatohen edhe për anëtarët e këshillit të administrimit.

Neni 163

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të këtij ligji për detyrimin e besnikërisë, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator dhe/ose anëtar i këshillit të administrimit, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë aksionarëve kontributet;

b) u paguajnë aksionarëve interesa apo dividendë;

c) nënshkruajnë, blejnë, pranojnë si garanci apo anulojnë aksionet e shoqërisë;

ç) emetojnë aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;

d) shpërndajnë aktivet e shoqërisë;

dh) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse, për të shlyer detyrimet;

e) në rast të zmadhimit të kapitalit, emetojnë aksione përpara përmbushjes së kushteve apo kur kontributi nuk është kaluar sipas kërkesave të nenit 123 të këtij ligji;

ë) kryejnë pagesa në favor të anëtarëve të këshillit të administrimit apo administratorëve;

f) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 151 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga pikat 3 e 4 të këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo zbulimi i saj.

Përgjegjësia solidare e këshillit të administrimit dhe e administratorëve

Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve, burimet teknike, organizative dhe burimet, strukturat e praktikave të miradministrimit të shoqërisë. Pikat 3 e 5 të nenit 163 të këtij ligji zbatohen edhe për parashikimet e këtij neni.

Kërkesa për mbikëqyrje të veçantë

1. Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën sa 5 për qind e kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë këshillit të administrimit të kryejë mbikëqyrje të veçantë për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

2. Nëse këshilli i administrimit nuk e përmbush kërkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve, aksionarët dhe kreditorët në fjalë mund të nisin procedurën e parashikuar në nenin 150 të këtij ligji.

KREU III**ADMINISTRATORËT DHE KËSHILLI MBIKËQYRËS, SISTEMI ME DY NIVELE****Dispozita në zbatim**

1. Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

2. Në përputhje me rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, sipas pikës 1 të këtij neni, dispozitat e neneve 154 deri në 165 të këtij ligji gjejnë zbatim edhe për marrëdhëniet ndërmjet administratorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, ku funksionet e këtij këshilli, në përputhje me nenin 167 të këtij ligji, u korrespondojnë funksioneve mbikëqyrëse të këshillit të administrimit.

Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët

1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat “b” deri në “g” e “i” dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.

2. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të këtij ligji, nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës. Së bashku me funksionet e pikave 3, 4 e 5 të nenit 158 të këtij ligji, administratorët kanë të drejtë e duhet të kryejnë edhe funksionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “gj”, “h” e “i” të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji. Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 13 dhe nga shkronja “e” e pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji, veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga këshilli mbikëqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut.

3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të këshillit mbikëqyrës administratorët e shoqërisë administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Parashikimet e neneve 155 e 157 të këtij ligji zbatohen edhe për numrin e anëtarëve, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me përjashtimet vijuese:

a) anëtarët e këshillit nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur;

b) statuti mund të parashikojë që disa prej tyre mund të zgjidhen dhe/ose shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë.

5. Nenet 160, 161 dhe 162 të këtij ligji zbatohen edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij ligji. Për shkeljet e kryera nga administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të këtij ligji, anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk i kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

TITULLI V ZMADHIMI I KAPITALIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 168

Kushtet për të gjitha format e zmadhimit të kapitalit

1. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të këtij ligji, zmadhimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Kur zmadhimi i kapitalit ndryshon të drejtat, që rrjedhin nga zotërimi i një kategorie aksionesh, vlefshmëria e vendimit të asamblesë së përgjithshme i nënshtrohet pëlqimit të aksionarëve të prekur, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

3. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.

4. Dispozitat e këtij ligji për nënshkrimin, shlyerjen e kalimin e kontributeve për aksionet, e, në veçanti, nenet 107 deri në 114 dhe 123 deri në 133 zbatohen edhe për rastin e zmadhimit të kapitalit.

Neni 169

Regjistrimi dhe publikimi i rritjes së kapitalit *(Zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)*

1. Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.

2. Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë, sipas nenit 112 të këtij ligji.

3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqëruar duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.

4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 170

Ndalimi i emetimit të aksioneve

Përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen. Aksionet e emetuara në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshme. Personat, që kryejnë shkeljen, përgjigjen ndaj nënshkruesve në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga një emetim i pavlefshëm.

Neni 171

Fillimi i pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e emetimit, aksionet e reja marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit financiar, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.

2. Vendimi për zmadhimin e kapitalit mund të parashikojë, që aksionet e reja të marrin pjesë nga fitimet e vitit financiar, që i paraprin vitit, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.

Neni 172

Zmadhimi i kapitalit dhe shoqëria me aksionar të vetëm

Shoqëria me aksionar të vetëm mund t'ua ofrojë aksionet e reja personave të tretë e të kthehet në një shoqëri me shumë aksionarë. Ky ndryshim i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

ZMADHIMI I KAPITALIT ME EMETIM TË AKSIONEVE TË REJA

Neni 173

Kushtet

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Neni 174

E drejta e parablerjes

1. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, në përproportim me pjesën e kapitalit të regjistruar, që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet jo më vonë se 20 ditë pas publikimit të parashikuar në nenin 169 të këtij ligji.

2. Të drejtat e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohen ose të përjashtohen nga vendimi i asamblesë së përgjithshme për zmadhimin e kapitalit. Administratorët duhet t'i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport, ku të jepen arsyet për kufizimin ose përjashtimin

e këtyre të drejtave dhe ku të justifikohet çmimi i emetimit të propozuar. Ky vendim mund të merret vetëm nëse kufizimi ose përjashtimi i të drejtave është publikuar më parë në hapësirën në internet të shoqërisë dhe njoftuar për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU III ZMADHIMI I KUFIZUAR I KAPITALIT

Neni 175

Kushtet për zmadhimin e kufizuar të kapitalit (Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, të cilat mund t'u ofrohen për nënshkrim vetëm aksionarëve ekzistues, në përpjesëtim me aksionet e zotëruara prej tyre përpara rritjes së kapitalit apo duke rritur vlerën nominale të secilit aksion.

2. Me përjashtim të rastit kur rritja e vlerës nominale të secilit aksion vendoset të realizohet me përfshirjen e aktiveve të shoqërisë, sipas nenit 177, të këtij ligji, zmadhimi i kufizuar i kapitalit, në rastet e parashikuara sipas pikës 1, të këtij neni, mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

KREU IV ZMADHIMI I AUTORIZUAR

Neni 176

Kushtet për zmadhimin e autorizuar të kapitalit (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Statuti ose një vendim i asamblesë së përgjithshme për ndryshime në statut mund t'u japë administratorëve të drejtën për të kryer një apo disa herë, brenda një afati 5-vjeçar, përkatësisht, nga regjistrimi i shoqërisë apo nga vendimi i asamblesë, zmadhim të kapitalit me emetim të aksioneve të reja, për një vlerë maksimale të përcaktuar (kapital i autorizuar).

2. Në statut mund të parashikohen kushte të tjera e, në veçanti, kushti që nëse administratorët vënë në zbatim autorizimin e zmadhimit, të gjitha ose disa nga aksionet e emetuara mund ose duhet t'u jepen punëmarrësve të shoqërisë apo punëmarrësve të shoqërive të tjera, pjesë të një grupi.

KREU V ZMADHIMI I KAPITALIT ME AKTIVE TË SHOQËRISË

Neni 177

Kushtet

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlere më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.

3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 178

Regjistrimi dhe publikimi i zmadhimit të kapitalit me aktivet e shoqërisë

1. Regjistrimi i vendimit për zmadhimin e kapitalit, sipas nenit 177 të këtij ligji, duhet të shoqërohet nga bilanci, në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyra e fundit e të ardhurave dhe e shpenzimeve. Aplikimi duhet të përfshijë edhe një deklaratë të administratorëve, sipas së cilës vërtetohet se gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që, nëse vendimi për zmadhim do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zmadhimi do të ishte ende i mundur.

2. Njoftimi për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit duhet të përcaktojë se zmadhimi i kapitalit është kryer me kalimin e rezervave të shoqërisë ose me fitimin e pashpërndarë.

Neni 179

Shpërndarja proporcionale e aksioneve të emetuara rishtazi

Aksionarët kanë të drejtë të zotërojnë aksionet e emetuara rishtazi në përpjesëtim me aksionet e tyre, përpara rritjes së kapitalit. Çdo vendim i asamblesë së përgjithshme, që bie ndesh me këtë dispozitë, është i pavlefshëm.

KREU VI

OBLIGACIONET E KONVERTUESHME DHE ATO ME PJESËMARRJE NË FITIM

Neni 180

Obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim

1. Asambleja e përgjithshme mund të emetojë obligacione, që u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i konvertuar në aksione apo të drejtën e parablerjes së aksioneve, të cilat quhen obligacione të konvertueshme, si dhe obligacionet, që u japin zotëruesve të drejtën e marrjes pjesë në fitim, të cilat quhen obligacione me pjesëmarrje në fitim.

2. Asambleja e përgjithshme mund të autorizojë këshillin e administrimit (në sistemin me një nivel) apo administratorët (në sistemin me dy nivele), që brenda një periudhe prej 5 vitesh dhe sipas kushteve përkatëse, të emetojnë obligacionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni. Organi administrativ përkatës i njofton Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për regjistrim dhe publikim, vendimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Obligacionet me pjesëmarrje në fitim mund të ofrojnë përparësi në shpërndarjen e fitimeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 116 të këtij ligji, për aksionet me përparësi.

4. Aksionarët gëzojnë për obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim të njëjtat të drejta, që ky ligj u njeh atyre për parablerjen në rastin e emetimit të aksioneve të reja.

TITULLI VI

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

KREU I

ZVOGËLIMI I ZAKONSHËM I KAPITALIT

Neni 181

Kushtet

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.

4. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në nenin 107 të këtij ligji, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

Neni 182

Regjistrimi dhe publikimi i vendimit

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Ky vendim duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 183

Mbrojtja e të drejtave të kreditorëve

1. Kreditorët, pretendimet e të cilëve janë ngritur përpara datës së publikimit të vendimit për zvogëlimin e kapitalit, kanë të drejtë të marrin garanci të mjaftueshme nga shoqëria për kreditë, që nuk ishin bërë të kërkueshme përpara datës së publikimit të vendimit. Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm nëse kreditorët kërkojnë garancinë brenda 90 ditëve, pas datës së publikimit.

2. Përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe përpara se kreditorët përkatës të jenë shlyer apo të kenë marrë garanci të mjaftueshme, shoqëria nuk mund të kryejë pagesa në favor të aksionarëve ose falje të detyrimeve për të shlyer kontributet, si pasojë e zvogëlimit të kapitalit.

Neni 184

Regjistrimi dhe publikimi i zvogëlimit të kapitalit

1. Administratorët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për zvogëlimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Kapitali quhet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

KREU II

ZVOGËLIMI I THJESHTËZUAR I KAPITALIT

Neni 185

Kushtet

1. Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve, si dhe transferimi i fondeve të rezervat kryhen nëpërmjet një procedure të thjeshtuar.

2. Nenet 181, 182 e 184 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për rastin e zvogëlimit të thjeshtuar të kapitalit.

KREU III ZVOGËLIMI I KAPITALIT ME ANULIM AKSIONESH

Neni 186

Kushtet

1. Kapitali mund të zvogëlohet edhe nëpërmjet anulimit të aksioneve.
 2. Anulimi i aksioneve lejohet vetëm:
 - a) kur ky veprim është i pranuar nga statuti apo nga një vendim, që ndryshon statutin, i cili është marrë përpara nënshkrimit të aksioneve, që do t'i nënshtrohen anulimit;
 - b) në përputhje me nenin 133 të këtij ligji;
 - c) nëse aksionarët, që i zotërojnë këto aksione, pranojnë anulimin.Parashikimi i statudit nuk është i nevojshëm nëse aksionarët përkatës japin pëlqimin.
 3. Anulimi i aksioneve duhet të përmbushë kërkesat e zvogëlimit të zakonshëm të kapitalit. Në këtë rast, vendimi i asamblesë zëvendësohet me vendimin e administratorëve.
 4. Pagesa e vlerës së aksioneve të anuluar, në favor të aksionarëve, kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 183 të këtij ligji.
 5. Dispozitat për zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit nuk janë të zbatueshme, nëse aksionet, kontributet e të cilave janë shlyer tërësisht, i kalohen shoqërisë pa kundërshtim.
 6. Vendimi i zvogëlimit të kapitalit i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- Kapitali zvogëlohet, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

TITULLI VII PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 187

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

(Shtuar shkronja "e" në pikën 1 me ligjin nr. 10 475, datë 27.10.2011; ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Shoqëria aksionare prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i pareaalizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;
 - d) kur, si pasojë e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta të shoqërisë janë në vlerë më të ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar, të përcaktuar sipas nenit 107, të këtij ligji, apo kur vendoset zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nën këtë vlerë minimale dhe hyrja në fuqi e këtij zvogëlimi nuk kushtëzohet me realizimin e një zmadhimi vijues, nëpërmjet të cilit shoqëria të rikapitalizohet me kontribute të reja me vlerë, të paktën, sa vlera e nevojshme për të arritur kapitalin minimal të përcaktuar sipas atij neni;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - ë) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e aksionarëve.

2. Prishja e shoqërisë si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në përputhje me shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e aksionarëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 145, të këtij ligji.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së aksionarëve për të vendosur prishjen, sipas rasteve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpër-mendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

Neni 188

Regjistrimi i prishjes së shoqërisë

1. Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes ex officio.

Neni 189

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë aksionare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

PJESA VI

LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

TITULLI I

LIKUIDIMI I ZAKONSHËM NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

Neni 190

Dispozita të përgjithshme

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, ajo prishet në bazë të vendimeve të përcaktuara nga pika 5 e nenit 43, pika 5 e nenit 99, dhe pika 5 e nenit 187, të këtij ligji, dhe çregjistrohet nga regjistri tregtar,

sipas nenit 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, pa iu nënshtruar procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë titull, dispozitat e zbatueshme për shoqëritë, që nuk janë prishur, zbatohen edhe për shoqëritë në likuidim e sipër.

3. Nenet 191 deri në 203 të këtij ligji parashikojnë rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese për të gjitha llojet e shoqërive. Këto shoqëri likuidohen me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të këtij ligji.

Neni 191

Emërimi i likuiduesve

1. Në shoqëritë kolektive dhe komandite, likuidimi kryhet nga të gjithë ortakët apo nga një likuidues i emëruar në mënyrë unanime prej tyre. Në rastin kur një ortak ka më shumë se një trashëgimtar, trashëgimtarët emërojnë një përfaqësues të përbashkët. Nëse ortakët nuk i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit faktin se të gjithë ortakët do të jenë likuidues apo nuk emërojnë likuiduesin brenda 30 ditëve nga data e prishjes, atëherë çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

2. Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Dispozitat e pikës 6 të nenit 91 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për këtë rast.

3. Çdo person i interesuar, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, në përputhje me pikën 1 të këtij neni apo të asamblesë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Neni 192

Emërimi i likuiduesve nga gjykata

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykatë.

Neni 193

Shkarkimi i likuiduesve

1. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

2. Paditë, që lidhen me shpërblimin e likuiduesit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 194

Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

1. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi “në likuidim”.

Neni 195

Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 196

Administrimi nga likuiduesit

1. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

2. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

3. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.

4. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakëve të tjerë, asamblesë së përgjithshme, këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës.

5. Për likuiduesit nuk zbatohet neni 17 i këtij ligji.

Neni 197

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

(Ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 195 të këtij ligji, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

4. Në shoqërinë kolektive e komandite, ortakët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, në përputhje me përgjegjësitë, që ky ligj i cakton secilit, për mbulimin e humbjeve. Nëse një ortak nuk shlyen pjesën e humbjeve që i takon, atëherë ortakët e tjerë detyrohen të paguajnë pjesën e tij në raport me pjesët që secili zotëronte në shoqëri. Ortakët, që kanë shlyer pjesën e ortakut mospërmbushës, kanë ndaj tij të drejtën e regresit.

Neni 198

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat

më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 199

Mbrojtja e kreditorëve

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Likuiduesi nuk mund të shpërndajë aktivet e mbetura të shoqërisë përpara përfundimit të afatit të depozitimit të pretendimeve të kreditorëve, të përcaktuar sipas nenit 195 të këtij ligji.

2. Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi është në dijeni, nuk kërkon të drejtat e veta, shumat përkatëse depozitohen pranë gjykatës, ndërsa mallrat depozitohen në një magazinë me shpenzimet e kreditorit. Rregullat e përgjithshme për kontratën e depozitës janë të zbatueshme.

3. Nëse një detyrim nuk mund të shlyhet menjëherë ose nëse është i debatueshëm, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë garanci e përshtatshme.

Neni 200

Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi

1. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.

2. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit u paraqesin ortakëve të tjerë të shoqërisë kolektive e komandite apo asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij.

3. Nëse ortakët e tjerë në shoqërinë kolektive e komandite apo asambleja e përgjithshme miratojnë raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.

4. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave.

5. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.

Neni 201

Shpërndarja e aktiveve

1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Ortakët apo aksionarët nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit në rast shkatërrimi, dëmtimi apo uljeje të vlerës së pasurisë, nëse kjo nuk varet nga veprimi apo mosveprimi i shoqërisë ose i personave, që kanë vepruar në emër të saj.

Neni 202

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 203

Përgjegjësia e likuiduesit

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

2. Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Nëse ka disa likuidues, ata përgjigjen në mënyrë solidare. Krahas likuiduesve, ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët përgjigjen ndaj kreditorëve të shoqërisë në mënyrë solidare deri në vlerën që u është shpërndarë. Kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 195 të këtij ligji, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në dijeni, nuk kanë të drejtë të ngrenë padi, sipas fjalisë së parë dhe të dytë të kësaj pike.

3. Paditë e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

TITULLI II

LIKUIDIMI I THJESHTËZUAR

Neni 204

Kushtet dhe procedura

1. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

4. Paditë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 205

Çregjistrimi pas likuidimit të thjeshtëzuar

(Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura në vijim të procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar, administratori njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me nenin 49, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

PJESA VII GRUPIMI I SHOQËRIVE

Neni 206

Detyrimi për informim

Sa herë që një person fiton ose kalon aksione të një shoqërie aksionare e, si pasojë e këtij veprimi, numri përgjithshëm i votave të zotëruara në asamblenë e përgjithshme bëhet, përkatësisht, më i madh apo më i vogël se 3 për qind, 5 për qind, 10 për qind, 15 për qind, 20 për qind, 25 për qind, 30 për qind, 50 për qind ose 75 për qind, ky person, brenda 15 ditëve nga kryerja e veprimit, është i detyruar t'ia njoftojë këtë veprim me shkrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 207

Mëma dhe shoqëritë e kontrolluara

1. Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues.

2. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues.

3. Të drejtat e mëmës mbi shoqërinë e kontrolluar, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, vlerësohen të tilla edhe në rastin kur këto të drejta ushtrohen nëpërmjet një shoqërie tjetër, të kontrolluar nga mëma apo nga një person i tretë, që vepron për llogari të kësaj shoqërie tjetër apo për llogari të vetë shoqërisë mëmë.

4. I tretë prezumohet se vepron për llogari të shoqërisë mëmë, nëse ai përfshihet në përcaktimet e pikave 2 e 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 208

Pasojat e ekzistencës së grupit kontrollues

1. Nëse ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, sipas përkufizimit të pikës 1 të nenit 207 të këtij ligji, shoqëria mëmë detyrohet të mbulojë humbjet vjetore të shoqërisë së kontrolluar.

2. Ortakët apo aksionarët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'u blejë kuotat, aksionet apo obligacionet e zotëruara prej tyre në shoqëri.

3. Kreditorët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'i ofrojnë garancitë e mjaftueshme për kreditë e tyre shoqërisë së kontrolluar.

4. Kreditorë të shoqërisë së kontrolluar vlerësohen personat, që kanë pësuar dëme nga veprimet e shoqërisë së kontrolluar, pavarësisht vendit të regjistrimit të kësaj të fundit.

Neni 209

Detyrimi i besnikërisë në grupin influencues

1. Nëse ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 207 të këtij ligji, përfaqësuesit e mëmës duhet të veprojnë, duke marrë parasysh:

a) çdo detyrim të shoqërisë mëmë, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të këtij ligji, apo në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas nenit 98 të këtij ligji dhe në rastin e një shoqërie aksionare, sipas nenit 163 të këtij ligji;

b) pasojat dhe përfitimet që një vendimarrje ka për grupin në tërësi;

c) interesin e shoqërisë së kontrolluar.

2. Përfaqësuesit e shoqërisë mëmë vlerësohen se kanë shkelur detyrimin e besnikërisë, nëse administratorët e pavarur, duke pasur parasysh sa më sipër, nuk do të kishin marrë atë vendim.

3. Përfaqësuesit e shoqërisë mëmë detyrohen të veprojnë në përputhje me dispozitat, që rregullojnë detyrimin e besnikërisë ndaj shoqërisë së kontrolluar, përfshirë detyrimin për të vepruar në interesin më të mirë të kësaj të fundit.

Neni 210

Përgjegjësia për dëmin

1. Kur përfaqësuesi i shoqërisë mëmë ka shkelur detyrimin e besnikërisë, sipas nenit 209 të këtij ligji, kjo shoqëri, në emër të së cilës përfaqësuesi ka vepruar, detyrohet të shpërblejë dëmin që ka shkaktuar në këtë rast.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, anëtarët e organeve administrative të mëmës janë përgjegjës, në mënyrë solidare, për dëmin e shkaktuar.

3. Anëtarët e organeve administrative të shoqërisë së kontrolluar, që shkelin detyrimin e besnikërisë, përgjigjen në mënyrë solidare, së bashku me personat e përcaktuar më sipër.

Neni 211

Padia për shpërblimin e dëmit

1. Nëse shoqëria e kontrolluar nuk ka nisur procedurat e nevojshme për shpërblimin e dëmit brenda 90 ditëve, pasi dëmi i përmendur në pikën 1 të nenit 209 është bërë i dukshëm, padia e shoqërisë së kontrolluar mund të ngrihet kur:

a) shoqëria e kontrolluar është shoqëri, kolektive apo komandite, nga secili ortak;

b) shoqëria e kontrolluar është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nga ortakët, që zotërojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme apo një vlerë më të vogël, të përcaktuar në statut, si dhe çdo kreditor i shoqërisë. Në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 6 të nenit 91 të këtij ligji;

c) shoqëria e kontrolluar është shoqëri aksionare, nga aksionarët që zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e saj, të cilët pretendojnë ndaj shoqërisë detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar.

2. Paditë si më sipër duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data kur është vënë re dëmi.

3. Kreditorë të shoqërisë së kontrolluar vlerësohen edhe ata persona, që kanë pësuar dëme nga veprimet e shoqërisë së kontrolluar, pavarësisht vendit të regjistrimit të kësaj të fundit.

Neni 212

E drejta e shitjes

Nëse mëma zotëron 90 për qind ose më shumë të pjesëve, aksioneve apo kuotave të shoqërisë së kontrolluar, zotëruesit e pjesëve, aksioneve apo kuotave të mbetura kanë të drejtë t'i kërkojnë mëmës t'ua blejë këto me çmimin e tregut, brenda 6 muajve nga kërkesa.

PJESA VIII SHOQËRIA SHTETËRORE

Neni 213

Dispozitat e zbatueshme

1. Shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përkufizimit të nenit 207 të këtij ligji.

2. Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë shtetërore u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

PJESA IX RIORGANIZIMI I SHOQËRIVE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR DHE I SHOQËRIVE ANONIME

Neni 214

Dispozita të përgjithshme

1. Dispozitat e kësaj pjese janë të zbatueshme vetëm për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

2. Një shoqëri mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

3. Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qenë të regjistruara për të paktën një vit.

4. Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

TITULLI I BASHKIMI

Neni 215

Përkufizimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

KREU I BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Neni 216

Marrëveshja dhe raporti i bashkimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen të paktën:

a) forma, emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive që marrin pjesë në bashkim;

- b) raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;
- c) kushtet e ndarjes së kuotave apo aksioneve të shoqërisë përthithëse;
- ç) data, duke nisur nga e cila zotëruesit e këtyre kuotave apo aksioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit, si dhe çdo kusht i posaçëm që ndikon në ushtrimin e kësaj të drejte;
- d) data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse;
- dh) të drejtat që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave, aksioneve, të drejtat e veçanta apo titujt e ndryshëm nga aksionet e shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër e parashikuar në lidhje me ta;
- e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

2. Përfaqësuesit ligjorë të secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

3. Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecursisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit.

4. Shoqëritë, që përmbushin kërkesën e pikës 3, të nenit 214, të këtij ligji, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin sipas pikës 3, të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.

5. Nëse viti i fundit ushtrimor, të cilit i referohen pasqyrat financiare, të përmendura në pikat 3 ose 4, të këtij neni, është mbyllur në një datë e cila është më e hershme se gjashtë muaj përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit, atëherë, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion aksionarëve raporte financiare gjashtëmujore, shoqëria harton gjithashtu pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në një datë, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se dita e parë e muajit të tretë përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit dhe i publikon ato sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri pjesëmarrëse në bashkim duhet të njoftojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre, si dhe organet e administrimit të shoqërive të tjera që marrin pjesë në bashkim, më qëllim njoftimin e asambleve të përgjithshme të shoqërive përkatëse në lidhje me çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet e shoqërisë, nga data në të cilën është hartuar projekt-marrëveshja e bashkimit, deri në datat eaktuara për mbledhjet e asambleve të përgjithshme që do të vendosin mbi miratimin e projekt-marrëveshjes së bashkimit.

7. Detyrimi për hartimin e raportit të për-mendur në pikën 2, të pasqyrave kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, të këtij neni, mund të përjashtohet me miratimin e të gjithë ortakëve/aksionarëve me të drejtë vote të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.

Neni 217

Raporti i ekspertëve

(Shtuar shkronja “ç” në pikën 2 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, caktojnë ekspertë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt-marrëveshjes së bashkimit.

Ekspertët mund të caktohen për secilën shoqëri ose në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkim. Ata caktohen nga gjykata përkatëse, nëse kjo kërkohet nga përfaqësuesit ligjorë.

2. Ekspertët hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklarata ekspertët duhet të shprehen, në veçanti:

a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;

b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;

c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.

ç) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit.

3. Ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme.

4. Raporti i ekspertëve depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji.

5. Përfshirja e ekspertëve, sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

Neni 218

Miratimi i marrëveshjes së bashkimit

(Ndryshuar pika 3, shtuar pika 4 me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Projektmarrëveshja e bashkimit prodhon efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive, që marrin pjesë në bashkim. Projektmarrëveshja e bashkimit miratohet, përkatësisht, në përputhje me shumicën e parashikuar në pikën 1 të nenit 87 dhe pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Kur nga projektmarrëveshja e bashkimit preken të drejtat e aksionarëve/ortakëve të veçantë apo të drejtat, që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë projektmarrëveshja i nënshtrohet, sipas rastit, miratimit të ortakëve apo aksionarëve të prekur, ose një votimi të veçantë, i cili merret me shumicën e tre të katërtave të votave të secilës kategori aksionesh të prekura.

3. Secili aksionar apo ortak i shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga shoqëria, pa pagesë, kopje të plotë apo të pjesshme të dokumenteve, në bazë të të cilave kryhet bashkimi, sipas neneve 216 dhe 217. Nëse aksionari apo ortaku ka pranuar kryerjen e njoftimeve nga shoqëria në formë elektronike, këto dokumente mund t'i dërgohen me postë elektronike.

4. Shoqëria do të përjashtohet nga detyrimi për të mbajtur në dispozicion në selinë e saj dokumentacionin që duhet t'u jepet ortakëve apo aksionarëve, sipas pikës 3, nëse për një periudhë të pandërprerë, e cila nis një muaj përpara datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për miratimin e projektmarrëveshjes së bashkimit, ky dokumentacion u vihet në dispozicion ortakëve apo aksionarëve, pa pagesë, për t'u parë, shkarkuar apo për të marrë kopje në formë shkresore në faqen e internetit të shoqërisë. Për çdo ndërprerje të

përkohshme të mundësisë për të hyrë në faqen e internetit të shoqërisë, për arsye teknike apo arsye të tjera, afati njëmuajor i publikimit ndërpritet dhe rinis nga e para në momentin kur faqja e internetit të shoqërisë bëhet sërish e arritshme.

Neni 219

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë përrthithëse, që kryhet në kuadër të bashkimit, nuk u nënshtrohet parashikimeve që lidhen me:

- a) ndalimin e zmadhimit derisa të kryhen pagesat e pashlyera për kuotat/aksionet e nënshkruara më parë;
- b) kushtet për nënshkrimin e kuotave/aksioneve të reja;
- c) të drejtat e parablerjes nga aksionarët/ortakët të aksioneve/kuotave të reja.

Neni 220

Regjistrimi, publikimi dhe pasojat

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, njoftojnë bashkimin për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me marrëveshjen e bashkimit, procesverbalin e asamblesë për miratimin e bashkimit, si dhe procesverbalin për miratimin e ortakëve/aksionarëve të veçantë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërive, nëse ka.

2. Nëse kapitali i regjistruar i shoqërisë përrthithëse rritet, në kuadër të bashkimit, vlera e zmadhimit njoftohet së bashku me bashkimin.

3. Regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit:

a) ka pasojë kalimin të shoqëria përrthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përrthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe të palët e treta;

b) bën që aksionarët apo ortakët e shoqërisë së përrthithur të bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërisë përrthithëse;

c) bën që shoqëria që përrthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kaluar në procesin e likuidimit.

Neni 221

Mbrojtja e kreditorëve

1. Nëse kreditorët e një shoqërie, që merr pjesë në një bashkim, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt marrëveshjes së bashkimit, sipas nenit 220 të këtij ligji, paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre, shoqëria duhet t’u japë garanci të mjaftueshme për kreditë e tyre. Garanci e mjaftueshme për kreditorët vlerësohet deklarata me shkrim, e dhënë nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçuar deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t’i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit.

2. Kreditorët e siguruar të procedurës së falimentit nuk kanë të drejtë të kërkojnë garancinë e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara kreditorëve, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së përmendur në fjalinë e dytë të pikës 1 të këtij neni.

Neni 222

Mbrojtja e zotëruesve të të drejtave të veçanta

Shoqëria përthithëse detyrohet t'u garantojë zotëruesve të obligacioneve të konvertueshme e të aksioneve me përparësi të njëjtat të drejta, që këta gëzonin në shoqërinë e përthithur.

Neni 223

Mbrojtja e të drejtave të ortakëve dhe aksionarëve

1. Kur aksionarët apo ortakët e shoqërive që bashkohen nuk kanë dhënë pëlqimin për bashkim, atëherë këta kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksioneve apo kuotave të zotëruara të tyre nga shoqëria që rezulton nga bashkimi, apo në rast mosmarrëveshjes, me çmimin e përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pavarur, i emëruar nga gjykata me kërkesë të këtyre aksionarëve apo ortakëve. Në mënyrë alternative, aksionarët mund të kërkojnë që shoqëria përthithëse të këmbejë aksionet e tyre me përparësi pa të drejtë vote, me aksione me të drejtë vote. Janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për kundërshtimet e palëve gjatë procesit të ekspertimit.

2. Të drejtat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të ushtrohen brenda 60 ditëve nga data e publikimit të bashkimit për shoqërinë përthithëse, sipas nenit 220 të këtij ligji.

Neni 224

Përgjegjësia e organeve të administrimit, të organeve mbikëqyrëse dhe ekspertëve

1. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës të shoqërisë përthithëse përgjigjen solidarisht, bashkë me shoqërinë përthithëse, për dëmet që ortakët, aksionarët dhe kreditorët e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, kanë pësuar nga ky veprim, me përjashtim të rasteve kur ata provojnë se i kanë përmbushur rregullisht detyrimet ligjore, të lidhura me vlerësimin e pasurive të shoqërive dhe me procedurat e përsosjes së marrëveshjes së bashkimit.

2. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së përthithur, si dhe ekspertët e pavarur të licencuar, të angazhuar në vlerësimin e bashkimit, përgjigjen për të njëjtat shkaqe e me të njëjtat kushte, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në të dyja rastet, paditë si më sipër duhen ngritur brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të bashkimit të shoqërisë përkatëse.

Neni 225

Bashkimi me përthithje në raste të veçanta

(Ndryshuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Nëse shoqëria përthithëse zotëron mbi 90 për qind ose të gjithë kapitalin e shoqërisë aksionare që do të përthithet, atëherë bashkimi me përthithje ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse, nëse:

a) publikimet, sipas pikës 3, të nenit 216, janë kryer në lidhje me shoqërinë përthithëse, të pakën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të saj apo të shoqërive të tjera, objekt të përthithjes, që do të miratojnë projekt marrëveshjen e bashkimit; dhe

b) të pakën një muaj përpara datës së caktuar sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, të gjithë aksionarët apo ortakët e shoqërisë përthithëse kanë të drejtë të njihen me dokumentacionin, në përputhje me nenet 216 dhe 217, në selinë e regjistruar të shoqërisë përthithëse. Parashikimet e pikave 3 dhe 4, të nenit 218, janë të zbatueshme edhe në këtë rast; dhe

c) aksionarët ose ortakët e shoqërisë përthithëse, që zotërojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të saj apo të numrit të përgjithshëm të votave, nuk kërkojnë thirrjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse për miratimin e bashkimit.

2. Nëse të gjitha aksionet e shoqërisë, që do të përthithet, që japin të drejta vote në asamblenë e përgjithshme, zotërohen nga shoqëria përthithëse, atëherë kërkesat, sipas parashikimeve të neneve 216, pika 1, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, dhe 2, 217, 218, pikat 3 dhe 4, 220, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji, nuk zbatohen.

3. Nëse shoqëria përthithëse zotëron të paktën 90 për qind, por jo të gjithë kapitalin e shoqërisë aksionare që do të përthithet, atëherë bashkimi ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse dhe kërkesat, sipas parashikimeve të neneve 216, pika 2, 217 dhe 218, pikat 3 dhe 4, nuk zbatohen, nëse aksionarët e pakicës së shoqërisë që përthithet kanë të drejtën t’ia shesin aksionet e tyre me vlerë tregu shoqërisë përthithëse. Në rast mosmarrëveshjeje, në lidhje me përcaktimin e kësaj vlere, aksionarët e pakicës së shoqërisë që përthithet kanë të drejtë të kërkojnë që vlera e tregut për shitjen e aksioneve të tyre të përcaktohet nga gjykata.

KREU II BASHKIMI ME KRIJIMIN E NJË SHOQËRIE TË RE

Neni 226

Dispozitat e zbatueshme

1. Dispozitat e neneve 216 deri në 225 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e bashkimit me themelim të një shoqërie të re. Shoqëria e themeluar rishtazi vlerësohet si shoqëri përthithëse.

2. Shoqëria e krijuar rishtazi nga bashkimi u nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për themelimin e shoqërisë.

TITULLI II NDARJA

Neni 227

Përkufizimi, dispozitat e zbatueshme

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të këtij ligji.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

TITULLI III SHNDËRRIMI

Neni 228

Dispozita të përgjithshme

1. Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë:

a) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas;

b) një shoqëri aksionare e me ofertë private mund të shndërrohet në një shoqëri aksionare me ofertë publike dhe anasjelltas, nëse përmbushen kërkesat e këtij ligji të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe të ligjit për titujt.

2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 229

Procedura

1. Administratorët e shoqërisë, që shndërrohet, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe efektin, që do të ketë shndërrimi te punëmarrësit e shoqërisë.

2. Vendimi për shndërrimin e shoqërisë duhet të merret nga asambleja e përgjithshme, me një shumicë prej tre të katërtave. Nëse shndërrimi ka si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të veçanta të aksionarëve apo ortakëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim i nënshtrohet miratimit të aksionarëve apo ortakëve të prekur. Pika 2 e nenit 218 të këtij ligji është e zbatueshme.

3. Administratorët thërrasin të gjithë aksionarët apo ortakët, që nuk ishin të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhjen e asamblesë, që ka vendosur shndërrimin, duke u kërkuar të deklarojnë me shkrim nëse e pranojnë apo jo shndërrimin e shoqërisë, sipas vendimit përkatës. Thirrja e aksionarëve apo ortakëve bëhet me shpallje, e cila publikohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, dy herë, me interval të ndërmjetëm prej jo më pak se 15 ditëve dhe jo më shumë se 30 ditësh. Aksionarët/ortakët e thirrur duhet të depozitojnë në selinë e shoqërisë deklaratën me shkrim brenda 60 ditëve nga publikimi i fundit i thirrjes.

4. Publikimi i shpalljes së përmendur në pikën 3 të këtij neni nuk është i detyrueshëm, kur në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar të gjithë aksionarët/ortakët apo kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme u ishte njoftuar individualisht aksionarëve/ortakëve në mungesë. Në rastin e fundit, afati 60-ditor nis nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes. Miratimi i shndërrimit vlerësohet i dhënë nëse aksionarët/ortakët nuk e deklarojnë qëndrimin e tyre me shkrim brenda afatit të caktuar.

5. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223 të këtij ligji.

6. Për përgjegjësitë ligjore të përfaqësuesve ligjorë dhe të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë në shndërrim për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224 të këtij ligji.

7. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me vendimin e shndërrimit, procesverbalin e asamblesë së përgjithshme për vendimin e shndërrimit, dokumentet e vendimit të aksionarëve të veçantë dhe të aksionarëve, të cilët nuk kanë qenë të

pranishëm në mbledhjen e asamblesë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

8. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) shoqëria që shndërrohet, të vazhdojë të ekzistojë në formën ligjore, të përcaktuar në vendimin e shndërrimit;

b) aksionarët/ortakët e shoqërisë që shndërrohet, të marrin pjesë në shoqëri, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, për formën e re të shoqërisë;

c) të drejtat e personave të tretë për aksionet e shoqërisë që transformohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për aksionet e shoqërisë së shndërruar.

PJESA X DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 230

Vijimi i funksionimit dhe detyrimi për përshtatje

(Shfuqizuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

Neni 231

Zbatimi i këtij ligji dhe procedurat në vijim

(Shfuqizuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

Neni 232

Shfuqizime

Ligjet nr.7632, datë 4.11.1992 “Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar”, nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Dispozita të fundit dhe kalimtare

(Dispozitë kalimtare e parashikuar me ligjin nr. 129, datë 2.10.2014)

1. Pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, asnjë shoqëri tregtare nuk mund të priset për shkak të mospërbushjes përpara kësaj date të kërkesave të nenit 230, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

2. Shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar përpara datës 20.5.2008, të cilat në datën hyrjes në fuqi të këtij ligji ende nuk kanë adaptuar statutin e tyre me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë të detyruara që jo më vonë se 3 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji:

a) të miratojnë ndryshimet e nevojshme në statutin e tyre për ta përputhur atë me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;

b) t’i regjistrojnë këto ndryshime të statutit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

3. Mospërbushja e detyrimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 30 000 lekë. Gjoka aplikohet dhe vilet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ndërpret shërbimin për këto shoqëri deri në kryerjen e veprimeve, sipas përcaktimit të shkronjave “a” ose “b”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në pagesën e plotë të gjobës.

4. Afati 3-mujor, i përmendur në pikën 2, është afat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit sipas pikës 2, të këtij neni, dhe, në asnjë rast, nuk mund të përdoret si justifikim për moszbatimin e plotë të dispozitave në fuqi të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

5. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ngarkohet të nisë dhe të vazhdojë deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, fushata informuese për publikun në faqen e saj në internet, si dhe në ambientet e sporteleve të saj në qendër dhe në sportelet e tjera të saj të shërbimit për detyrimet, sipas këtij neni.

Neni 233
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5694, datë 5.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr. 570, datë 3.10.2018

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE AKSIONARE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të kreut III, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

- a) Tre, për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme;
- b) Gjashtë, për shoqëritë e sektorëve strategjikë me rëndësi të veçantë.

2. Anëtarët e këtyre këshillave propozohen si më poshtë vijon:

- a) 2/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga përfaqësuesi i pronarit, për pronën shtetërore;
- b) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga ministri i linjës administrative apo organi i vetëqeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, për shoqëritë shtetërore përkatëse.

3. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës emërohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë dhe i njëjti person nuk mund të marrë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës.

4. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore mund të përzgjidhen:

- a) Nëpunës të institucioneve shtetërore, kur legjislacioni në fuqi nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera;

- b) Specialistë të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet dhe personat që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara;

- c) Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës.

5. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a vendore që kryejnë funksione auditimi, punonjës të emëruar si administratorë të shoqërive tregtare, drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare dhe kushdo tjetër, që ka konflikt interesash, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, si më poshtë vijon:

a) Në shoqëritë aksionare shtetërore strategjike, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ndërsa, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page;

b) Në shoqëritë aksionare shtetërore jostrategjike kombëtare, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page;

c) Në shoqëritë aksionare shtetërore jostrategjike vendore, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të prefekturës dhe, për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page.

Për efekt të këtij vendimi, paga mujore përfshin pagën për funksion dhe pagën e grupit.

7. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime.

8. Në mbledhjen e tij të parë këshilli mbikëqyrës cakton sekretarin, i cili mund të jetë përfaqësues i pronarit ose i shoqërisë, si dhe masën e shpërblimit të tij. Masa e shpërblimit të sekretarit të këshillit mbikëqyrës në shoqëritë strategjike të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, në shoqëritë jostrategjike kombëtare të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj dhe në shoqëritë jostrategjike vendore 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

9. Këshilli mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe u raporton, për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit.

10. Këtij vendimi nuk u nënshtrohen shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të akteve të veçanta nënligjore.

11. Vendimi nr. 642, datë 11.10.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, si dhe udhëzimi nr. 318, datë 8.4.2009, i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, shfuqizohen.

12. Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë, ministritë e linjës, organet e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionare shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

UDHËZIM

Nr.69, datë 29.1.2009

PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË SHOQËRIVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me seksionin V, “Likuidimi” të kreut VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë, dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e aseteve, elemente të pasurisë, që do të likuidohet.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shiten nëpërmjet ankandit, pas publikimit në Buletinin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi për shitje bëhet dy herë radhazi, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe vendoset edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin, që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku do të bëhet edhe shpërndarja e dokumenteve personave të interesuar.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Komisioni i ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, të cilët përcaktohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

7. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH (20%), për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Gjithashtu, pagesa prej 20 për qindësh, e ngurtësuar për pjesëmarrje, nuk kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, të truallit dhe makinerive e pajisjeve është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues, të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë, në përputhje me çmimet e tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik, si dhe vlera e mjeteve të xhiros të objektit përkatës.

11. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros, si më poshtë vijon:

a) Artikujt e grupit “a”, që kanë vlerë tregtimi me qarkullim normal, vlerësohen me çmimin e shitjes me shumicë në treg.

b) Artikujt, që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Artikujt e grupit “c”, që nuk gjejnë treg shitjeje, vlerësohen me vlerën kontabël, që kanë pasur në kohën kur kanë hyrë në magazinë shumëzuar me koeficientin 0.1.

ç) Për metalet me ngjyrë, si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, llogaritet referuar çmimit të bursës së Londrës (LME). Në rast se nuk realizohet shitja me vlerën e llogaritur sipas LME-së, shoqëria cakton vlera të reja, deri në vlerën kontabël të mallit.

12. Raportet e vlerësimit të ekspertëve vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

13. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

14. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, objekti publikohet për herë të dytë, me 70 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim, duke i shtuar kësaj vlere edhe vlerën e truallit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues, si dhe 50 për qind të vlerës së inventarit ekonomik dhe të mjeteve të xhiros. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëherë publikohet me vlerë kontabiliteti. Nëse nuk shitet as me vlerën sipas kontabilitetit, atëherë vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Për makineritë dhe pajisjet, që nuk kanë mundur të shiten me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, zbatohen procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si shitja e aseteve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo edhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në mënyrë proporcionale, në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht. Për kërkesat debitorë, të paarkëtueshme, si në rastin, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet, duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

17. Likuidatori nuk mund të lidhë kontrata dhe as nuk mund të shesë asete me mirëkuptim, pa autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

19. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

20. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

21. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

22. Udhëzimi nr.548, datë 2.8.2007 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital tërësisht shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.317/1, datë 4.9.2009

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1719,
DATË 17.12.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr.7926, datë 20.45.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me seksionin V, “Likuidimi” të kreut VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e aseteve, elemente të pasurisë, që do të likuidohet.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shiten nëpërmjet ankandit publik, pas publikimit në Buletinin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi për shitje bëhet katër herë radhazi, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe afishohet edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga autoriteti shitës, i cili bën dhe dorëzimin e dokumenteve standarde të ankandit të shpallur kandidatëve blerës kundrejt një pagese të përcaktuar në njoftimin për ankand.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Njësia e ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, të cilët përcaktohen me urdhër të likuidatorit të shoqërisë. Dy të tretat e anëtarëve të njësisë së ankandit caktohen me autorizim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mbi bazën e kërkesës së likuidatorit të shoqërisë, 10 ditë përpara datës së shpalljes së ankandit.

7. Bazuar në kreun III, pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të njësisë së ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH-në (20%) për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, i konfiskohet sigurimi i ofertës, si dhe humbet të drejtën për të marrë pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, të truallit dhe makinerive e pajisjeve është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues, të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë, në përputhje me çmimet e tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik, si dhe vlera e mjeteve të xhiros të objektit përkatës.

11. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

12. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros si më poshtë vijon:

a) Artikujt e grupit “a”, që kanë vlerë tregtimi në qarkullim normal, vlerësohen me çmimin e shitjes me shumicë në treg.

b) Artikujt, që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Artikujt e grupit “c”, që nuk gjejnë treg shitjeje, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur, shumëzuar me koeficientin 0.1.

ç) Për metalet me ngjyrë, si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, llogaritet referuar çmimit përkatës sipas Bursës së Londrës (LME).

13. Raportet e vlerësimit të ekspertëve vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

14. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, mbas shpalljes dy herë për shitje, objekti publikohet për herë të tretë, me një ulje VAM-i me 30 për qind të vlerës fillestare, duke i shtuar kësaj vlere edhe vlerën e truallit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëherë për përcaktimin e destinacionit të mëtejshëm të objektit vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Bazuar në kreun III, pika 16 dhe 17 “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, makineritë dhe pajisjet që nuk kanë mundur të shiten me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, publikohen për herë të dytë me 50 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim. Në rast se shitja nuk realizohet, zbatohen procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si shitja e aseteve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo dhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në mënyrë proporcionale në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht, sipas detyrimeve të pasqyruara në bilancin kontabël të miratuar nga organet kompetente. Për kërkesat debitorë, të paarkëtueshme, si në rastin, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

17. Likuidatori nuk mund të lidhë kontratë dhe as nuk mund të shesë asete me mirëkuptim, pa autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

19. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

20. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

21. Udhëzimi nr.317, datë 8.4.2009 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr. 4557/1, datë 1.6.2017

**PËR REGJISTRIMIN E TITUJVE NË SHOQËRINË “QENDRA E REGJISTRIMIT
TË AKSIONEVE” SH.A., TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 119, pika 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të neneve 6 e 13 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”,

UDHËZOJ:

1. Shoqëritë aksionare, të cilat rezultojnë të regjistruara në regjistrin tregtar, në rastet e ndryshimeve në lidhje me transferimin e aksioneve, kapitalin e regjistruar, numrin e aksioneve dhe/ose vlerën nominale të secilit aksion, kanë detyrimin e pasqyrit të këtyre ndryshimeve në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë.

2. “Titull”, sipas formës juridike, janë ato të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”.

3. Detyrimi për regjistrimin e titujve (aksioneve) në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë, rrjedh nga pika 5 e nenit 119 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë dhe Shoqëritë aksionare të regjistruara në Regjistrin Tregtar.

5. Udhëzimi nr. 309, datë 3.6.2014, “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a.”, Tiranë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

LIGJ
Nr.10 198, datë 10.12.2009

PËR SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

(ndryshuar me ligjin nr. 36/2016, datë 31.3.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1
OBJEKTI DHE ZBATIMI

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë:

- a) kushtet dhe kriteret për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe të shoqërive administruese;
- b) emetimin dhe shitjen e kuotave dhe të aksioneve;
- c) shlyerjen e kuotave;
- ç) marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- d) veprimtaritë e kryera nga palët e treta, për llogari të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- dh) realizimin e mbikëqyrjes, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese, depozitarëve dhe të personave të përfshirë në shitjen e kuotave e të aksioneve, që duhet të mbikëqyren, sipas këtij ligji;
- e) veprimtarinë e sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive dhe të shoqërive administruese të huaja në Republikën e Shqipërisë;
- ë) funksionimin e drejtë të tregut të kapitaleve dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të tyre, nëpërmjet vendosjes së rregullave.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1."Sipërmarrje investimesh kolektive, SIK" është personi juridik ose bashkimi i posaçëm i aseteve të investitorëve, themelimi dhe organizimi i së cilës përcaktohet në këtë ligj. Kjo sipërmarrje funksionon në njërin nga format e mëposhtme:

a) si "Fond investimi", që është sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave, në përputhje me konceptin e përshtatur në nenin 54 dhe dispozitat e tjera të këtij ligji;

b) si "Shoqëri investimi", që është sipërmarrja me pjesëmarrje të mbyllur, e themeluar si shoqëri aksionare, në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, e cila mund të jetë me ofertë publike ose me ofertë private dhe veprimi i vetëm tregtar i së cilës është kryerja e

investimeve, në përputhje me konceptin e përshkruar në nenin 58 dhe në dispozitat e tjera të këtij ligji.

2. “Aksionar ndikues” është personi, që ushtron të drejta ose ka kontroll efektiv mbi aksionet, të cilat përfaqësojnë 5 për qind ose më shumë të kapitalit themeltar të shoqërisë ose që do t’i jepnin atij 5 për qind ose më shumë të numrit të përgjithshëm të aksioneve, me të drejtë vote në shoqëri.

3. “AMF” ose “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar në përputhje me ligjin nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

4. “Asete” janë titujt, instrumentet e tregut të parasë, instrumentet derivative, para dhe pasuri të tjera, në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive, të shoqërisë administruese apo depozitarit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

5. “Bursë titujsh” është një bursë titujsh e licencuar nga AMF-ja.

6. “Depozitar” është një bankë e licencuar, e nivelit të dytë, e caktuar nga shoqëria administruese, e cila, në bazë të një marrëveshjeje me shoqërinë administruese dhe me porosi të saj, kryen veprimtarinë si depozitar në mënyrën e parashikuar nga ky ligj. Për qëllime të këtij ligji, depozitari ka të njëjtin kuptim me kujdestarin e përcaktuar në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

7. “Fond furnizues” është fondi që investon vetëm nëpërmjet një fondi tjetër, që është fondi kryesor. Kuotat shiten tek investitorët, nëpërmjet një fondi furnizues, por investohen nëpërmjet fondit kryesor.

8. “Fond ombrellë” është fondi i investimeve kolektive, që ka në pronësi portofole të veçanta asetesh, përfshirë nënfonde ose seri të ndara.

9. “Institucione financiare” janë shoqëritë e administrimit të portofolit dhe shoqëritë e sigurimit të jetës.

10. “Investitor” është subjekti, që ka në pronësi kuota në një fond investimi ose aksione në një shoqëri investimesh.

11. “Këshilli i administrimit”, duke iu referuar themelimit dhe funksionimit të shoqërive administruese, është këshilli administrativ i shoqërisë, të organizuar si shoqëri tregtare me një nivel, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

12. “Këshilltar investimi” është subjekti i licencuar për të kryer veprimtarinë e këshilltarit të investimit, në përputhje me ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

13. “Kontrollues kryesor” është çdo person, që ushtron ndikim mbi të licencuarin, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet, pa kufizim, çdo person, që përcakton veprimet e drejtuesve të shoqërisë së rregulluar nga ky ligj, mendimet e të cilëve ndikojnë në procesin e vendimmarrjes së të licencuarit.

14. “Kuota” janë të drejtat ose interesat e investitorëve në një fond investimi.

15. “Kuota akumulimi” janë kuotat e një fondi, për të cilat të ardhurat nga investimi rriinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.

16. “Kuota të ardhurash” janë kuotat e një fondi, për të cilat të ardhurat nga investimi u shpërndahen periodikisht mbajtësve të kuotave.

17. “Ligji për shoqëritë tregtare” është ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

18. “Mbajtës kuotash” është çdo person fizik apo juridik, i cili ka marrë në zotërim kuota në një fond investimi, në bazë të dispozitave të këtij ligji.

19. “Ofertë private” është emetimi i aksioneve dhe ftesa për t’i nënshkruar ato, që u drejtohet vetëm investitorëve institucionalë, aksionarëve ose punonjësve të një shoqërie, por jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm, të cilët janë kontaktuar drejtpërdrejt nga emetuesi. Termat “Investitorë institucionalë” dhe “investitorë të jashtëm” kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

20. “Ofertë publike” është ftesa për të nënshkruar tituj, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv.

21. “Palë e lidhur” është personi fizik ose juridik që është i lidhur me shoqërinë administruese apo shoqërinë e investimit, në rrethanat kur personi fizik ose drejtuesi i personit juridik është:

- a) anëtar i këshillit të mbikëqyrjes, i këshillit të administrimit ose punonjës i shoqërisë;
- b) anëtar i komitetit të kontrollit të shoqërisë;
- c) aksionar ndikues i shoqërisë;

ç) bashkëshort ose i afërm deri në shkallën e tretë të lidhjes së gjakut i një anëtar i këshillit të mbikëqyrjes, të administrimit ose të komitetit të kontrollit, punonjës i shoqërisë, aksionar ndikues i shoqërisë, kontrollues kryesor i shoqërisë;

d) person, i cili ka të drejtë të marrë vendime ose të ndikojë në vendimet e shoqërisë, në bazë të një kontrate ndërmjet palëve ose për çfarëdolloj arsye tjetër.

22. “Marketim” është marketimi në publik, nëpërmjet dhënies së ofertave, shpërndarjes së formularëve të aplikimit apo fletushkave ose përdorimi i materialeve të tjera promociionale, në mënyrën e përshkruar në këtë ligj.

23. “Prospekt” është dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin për sipërmarrjen e investimeve kolektive, nëpërmjet të cilit ftohet publiku për të nënshkruar ose blerë kuotat apo aksionet në sipërmarrjen përkatëse të investimeve kolektive.

24. “Rregullat e fondit” janë dokumentet kryesore, që rregullojnë krijimin e fondit të investimeve, ku përfshihen marrëveshja e administrimit dhe marrëveshja me depozitarin, që, në rastin e shoqërisë së investimit, nënkuptojnë statutin e shoqërisë së investimit.

25. “Shoqëri administruese” është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria tregtare e vetme dhe e vazhdueshme e së cilës është themelimi dhe/ose administrimi i fondeve të investimit dhe të shoqërive të investimit, në përputhje me këtë ligj.

26. “SNRF” janë “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”.

27. “Shoqëria prind” është shoqëria tregtare, që ka në pronësi ose nën kontroll një apo disa shoqëri të tjera tregtare.

28. “Tituj” ose “Letra me vlerë” janë titujt sipas përcaktimeve të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

29. “Treg i rregulluar” është çdo bursë, treg mbi banak ose çdo treg tjetër i organizuar i titujve, që vepron rregullisht, është i hapur për publikun dhe është i njohur zyrtarisht nga AMF-ja.

30. “Shtet i Bashkimit Europian” është një shtet anëtar i Bashkimit Europian.

31. “Shtet i lejuar” është një shtet, përveç Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të Bashkimit Europian, që ofron kushte dhe regjim të ngjashëm për mbikëqyrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe që është i njohur si i tillë nga AMF-ja.

32. “Vlera neto e aseteve” është vlera neto e pasurive të sipërmarrjes së investimeve kolektive pas zbritjes së:

- a) çdo detyrimi të papaguar, qoftë ose jo menjëherë i ripagueshëm;
- b) çdo shume të papaguar të kredive të garantuara me hipotekë mbi pasuri të paluajtshme.

Neni 3

Sipërmarrjet e investimeve kolektive

1. Në kuptim të këtij ligji, çdo person juridik ose bashkim asetesh konsiderohet sipërmarrje investimesh kolektive, pavarësisht formës ligjore, kur pjesëmarrja nëpërmjet aksioneve, kuotave ose të drejtave të tjera ofrohet për qëllime të rritjes së pjesëmarrjes në para dhe, në mënyrë të shprehur, synon të investojë mbi 60 për qind të kësaj pjesëmarrjeje në portofol titujsh, depozita dhe në të gjitha llojet e tjera të aseteve, ku investitorët nuk mbikëqyrin përditë marrjen e vendimeve për investimet dhe ku objektivi parësor është nxjerrja e përfitimeve për investitorët nga investimet e tyre, si në formë fitimi ashtu edhe në ndonjë formë tjetër.

2. Nuk janë sipërmarrje investimesh kolektive, sipas këtij ligji:
- a) bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
 - b) fondet e pensionit, të licencuara nga AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
 - c) shoqëritë e sigurimit, të licencuara nga AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) personat juridikë, që investojnë fondet e veta;
 - d) pjesëtarët e familjes, që bëjnë investime të përbashkëta, jo të tilla që kanë lidhje me këtë ligj;
 - dh) personat e tjerë, të përjashtuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
 - e) sipërmarrjet e investimeve kolektive që e rrisin kapitalin pa promovim të shitjes së kuotave/aksioneve të tyre ndaj publikut.
3. Përcaktimet e dhëna në pikën 2 të këtij neni nuk prekin të drejtat e personave të përmendur në këtë pikë, që kanë fituar ose fitojnë sipas ligjeve, rregulloreve ose marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 4

Ndalimi i ofertimit, administrimit dhe tregtimit pa autorizimin e AMF-së

1. Asnjë subjekt, i themeluar për të kryer veprimtaritë, që parashikohen nga ky ligj, nuk mund t'i kryejë ato pa autorizimin përkatës të AMF-së.
2. Kryerja e veprimtarisë së themelimit dhe/ose administrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive, që parashikohet në nenin 3 të këtij ligji, pa miratimin e AMF-së, ose kryerja e shërbimeve të ndërmjetësimit në tregtimin e kuotave apo të aksioneve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë, përbën vepër penale dhe dënohet sipas dispozitave të neneve 131 e 132 të këtij ligji.

Neni 5

Regjimi fiskal për fondin e investimit

1. Administrata tatimore në Republikën e Shqipërisë, me kërkesë të shoqërisë administruese dhe për qëllime tatimi, lëshon certifikatë, që vërteton klasifikimin tatimor për sipërmarrjen e investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë.
2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni tatimor, sipërmarrja e investimeve kolektive, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve të fondit, si dhe personi i fundit, që përfiton prej saj.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

1. Funksionimi i shoqërive administruese dhe veprimtaria e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive u nënshtrohen dispozitave të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, dhe dispozitave të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj ose aktet nënligjore, të miratuara në përputhje me të.
2. Në rast konflikti të ligjeve për çështjet e mësipërme, dispozitat e këtij ligji kanë epërsi ndaj dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

SEKSIONI 2

REGJISTRI I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 7

Regjistri i fondeve

1. Sipërmarrjet e investimeve kolektive regjistrohen në Regjistrin e Fondeve të Republikës së Shqipërisë.
2. Regjistri i Fondeve mbahet nga AMF-ja dhe është i hapur për publikun.
3. Regjistri i Fondeve duhet të përmbajë informacion të përditësuar, sidomos për llojin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, objektin e saj, qëllimin e investimit, strukturën organizative dhe çdo ndryshim të strukturës së saj ligjore dhe/ose organizative. Kërkesat specifike për përmbajtjen përcaktohen me rregullore të AMF-së.
4. AMF-ja mban dhe përditëson Regjistrin e Fondeve në përputhje me rregulloret përkatëse të tij, duke siguruar uniformitetin e informacionit dhe duke pasqyruar faktet dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Regjistrimi në Regjistrin e Fondeve

1. Regjistrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Regjistrin e Fondeve bëhet vetëm pas dhënies së licencës nga AMF-ja për themelimin dhe funksionimin e sipërmarrjes.
2. Në çastin e dhënies së licencës nga AMF-ja dhe të regjistrimit në Regjistrin e Fondeve, i cili është uniform, i pandryshueshëm dhe unik, çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive i jepet një numër identifikimi.

Neni 9

Njoftimi i regjistrimit

Vendimi për regjistrimin në Regjistrin e Fondeve botohet në buletin zyrtar të AMF-së.

KREU II

SHOQËRITË ADMINISTRUESE, KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 10

Objekti i shoqërisë administruese

1. Shoqëria administruese është shoqëri aksionare, me afat të pacaktuar, në të cilën të paktën 51 për qind të aksioneve ose të së drejtës së votës janë në pronësi të bankave apo të institucioneve financiare. Shoqëria administruese regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me objekt kryesor veprimtarinë e themelimit dhe/ose administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe veprimtari të tjera, që parashikohen në këtë ligj.
2. Organizimi i shoqërisë administruese bëhet sipas modelit me një nivel drejtimi.

Neni 11

Emërtimi i shoqërisë administruese

1. Termat “shoqëri e administrimit të fondit”, “shoqëri investimi”, “këshilli i administrimit të fondit”, “investitor”, “investim” ose “për të investuar”, veçmas ose së bashku me termat e tjera, mund të përdoren në emërtimin e shoqërisë ose në shtojcën e emërimit të saj vetëm nga shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive për paraqitjen e objektit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe për qëllime marketimi.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për shoqëritë, që përdorin termat “administrim fondesh”, “investim”, “investitor” ose “për të investuar” në një kontekst që nuk nënkupton se objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë është themelimi dhe/ose administrimi i sipërmarrjeve kolektive të investimeve, që do të thotë investimi i aseteve në emër dhe për llogari të mbajtësve të kuotave në një fond investimi ose në emër dhe për llogari të aksionarëve të shoqërisë së investimit.

Neni 12

Kapitali i regjistruar i shoqërisë administruese dhe burimet e tij

1. Vlera minimale e kapitalit themeltar të regjistruar të shoqërisë administruese është 15 625 000 lekë. Në rast se vlera neto e aseteve të SIK-ve që administrojnë shoqëria administruese tejkalon shumë prej 31 250 000 000 lekësh, kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë administruese zmadhohet me të paktën 0,02 për qind, e llogaritur kjo mbi shumën e vlerës neto të aseteve të SIK-ve të administruara që tejkalon pragun prej 31 250 000 000 lekësh. Në këtë rast, shuma totale e kapitalit themeltar të regjistruar të shoqërisë administruese nuk duhet të tejkalojë shumën maksimale prej 1 250 000 000 lekësh.

2. Kapitali themeltar i pjesëmarrjes për themelimin e shoqërisë administruese nuk mund të jetë hua, kredi ose paradhënie nga persona të tretë.

3. Forma, llogaritja dhe shuma e kapitalit, që duhet të kenë detyrimisht shoqëritë administruese, përcaktohen me rregullore të AMF-së.

Neni 13

Objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese

1. Shoqëritë administruese kryejnë vetëm veprimtari për themelimin dhe/ose administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, përveç rasteve kur AMF-ja jep licencën ose autorizimin me shkrim për kryerjen edhe të ndonjë veprimtarie tjetër. Objekti i veprimtarisë së tyre përfshin:

- a) administrimin e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- b) marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shitjen e kuotave në fondet e investimit ose të aksioneve në shoqëritë e investimit;
- c) kryerjen e detyrave administrative, që përfshijnë, ndër të tjera:
 - i) mbajtjen e librave të llogarive kontabël dhe përgatitjen e raporteve financiare;
 - ii) përcaktimin e vlerës neto të aseteve dhe llogaritjen e çmimit të kuotave ose të aksioneve;
 - iii) përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë administruese me ligjet dhe rregulloret përkatëse;
 - iv) publikimet dhe raportimet tek aksionarët dhe mbajtësit e kuotave;
 - v) pagesat për aksionarët ose mbajtësit e kuotave nga asetet apo fitimi i fondit;
 - vi) emetimin dhe shlyerjen e kuotave në një fond investimi dhe emetimin dhe shlyerjen e aksioneve në shoqëritë e investimit me ofertë publike;
 - vii) mbajtjen e regjistrit të mbajtësve të kuotave ose të aksionarëve;
 - viii) mbajtjen e të dhënave në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
 - ix) detyra të tjera të natyrës administrative, të miratuara nga AMF-ja.

2. Shoqëritë administruese nuk mund të licencohen nga AMF-ja për të kryer vetëm shërbimet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, pa qenë të licencuara edhe për shërbimin e parashikuar në shkronjën “a” të po kësaj pike.

3. Shoqëritë administruese mund të licencohen nga AMF-ja për të kryer, përveç administrimit të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, edhe administrimin e fondeve të pensioneve apo të portofoleve individuale. Në këto raste, AMF-ja ka të drejtë të vendosë kushte shtesë për shoqëritë administruese, që duan të administrojnë këto veprimtari të tjera.

Zhvillimi i veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese

1. Shoqëria administruese, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj tregtare:
 - a) vepron me ndershmëri dhe paanësi, në interesin më të mirë të investitorëve dhe të integritetit të tregut;
 - b) vepron me aftësinë dhe kujdesin e duhur, duke zbatuar rregullat profesionale, praktikën e mirë tregtare dhe aktet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
 - c) duhet të jetë në gjendje të shlyejë në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme të gjitha detyrimet monetare, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për shoqëritë tregtare;
 - ç) duhet të jetë përgjegjëse për ushtrimin e duhur, në kohë dhe me efikasitet të të gjitha të drejtave dhe të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, në prospektin dhe/ose rregullat e fondit, pavarësisht nëse ndonjëra prej tyre u është deleguar palëve të treta;
 - d) garanton ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave të shoqërisë administruese për aksionarët, mbajtësit e kuotave, gjendjen e kuotave të fondit, shlyerjet dhe riblerjet, të dhëna, të cilat mund të jepen vetëm në bazë të një vendimi ose urdhri të gjykatës, të një marrëveshjeje mirëkuptimi për shkëmbim informacioni, që garanton ruajtjen e ndërsjellë të sekretit, të kërkesës individuale të një mbajtësi kuotash ose aksionari, si dhe të depozitarit;
 - dh) garanton se të gjitha dokumentet, komunikimet dhe njoftimet promovionale, që u bëhen aksionarëve ose mbajtësve të kuotave, qoftë të adresuara drejtpërdrejt ose të publikuara në shtyp apo nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit publik, janë të qarta, të sakta, jomashtruese dhe në përputhje me ligjin dhe kërkesat e AMF-së;
 - e) organizon shitjen e kuotave të fondeve të investimit ose të aksioneve të shoqërisë së investimit vetëm nëpërmjet personave të parashikuar në nenin 92 të këtij ligji;
 - ë) blen asetet, në emër dhe për llogari të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që ajo administron, duke i depozituar ato te një depozitar, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AMF-ja;
 - f) i dërgon depozitarit një kopje të të gjitha dokumenteve origjinale për transaksionet, që përfshijnë asetet e fondeve të investimit dhe/ose të shoqërisë së investimit, menjëherë pas përgatitjes së këtyre dokumenteve ose pas marrjes së tyre;
 - g) ruan të dhënat e transaksioneve, që lidhen me asetet e fondeve të investimit ose të shoqërive të investimit, veçmas nga llogaritë e veta dhe dokumentet e evidencave, që lidhen me fonde të tjera, dhe i pasqyron ato në periudha të rregullta kohore, në llogaritë e depozitarit;
 - gj) raporton për fondet dhe shoqëritë e investimit, që ajo administron, si dhe për vetë shoqërinë administruese, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e AMF-së;
 - h) depoziton në AMF raporte periodike, siç është parashikuar në këtë ligj dhe rregulloret e AMF-së;
 - i) mban marrëdhënie të ndershme dhe të drejta me AMF-në;
 - j) i raporton AMF-së çdo ndryshim për anëtarët e këshillit të administrimit, anëtarët e komitetit të kontrollit, strukturën e aksionarëve dhe kapitalin e regjistruar, si dhe çdo ndryshim tjetër për kushtet e miratuara më parë nga AMF-ja;
 - k) lejon AMF-në të inspektojë të dhënat e ruajtura nga shoqëria administruese dhe i bën ato të disponueshme në kohën e duhur, si dhe lejon takime dhe intervista me çdo person, që kryen një veprimtari të caktuar në shoqërinë administruese;
 - l) nuk lidh kontrata me qëllim kufizimin ose ndryshimin e përgjegjësisë dhe të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj. Çdo marrëveshje e tillë konsiderohet e pavlefshme;
 - ll) siguron që punonjësit e saj dhe çdo subjekt tjetër, me të cilin është lidhur një kontratë për shitjen e aksioneve të shoqërisë së investimit ose kuotat e fondit të investimit, veprojnë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret përkatëse në fuqi;
 - m) cakton të paktën dy anëtarë joekzekutivë të këshillit të administrimit në komitetin e kontrollit, për të garantuar përputhshmërinë e veprimeve të shoqërisë administruese me

dispozitat e këtij ligji dhe me çdo rregullore tjetër, si dhe për mbajtjen e kontakteve të rregullta me AMF-në;

n) administron SIK-të në përputhje me objektivat e investimit të çdo fondi apo shoqërie investimi, që ka në administrim;

nj) nxjerr urdhra të qartë dhe të kuptueshëm për depozitarin, në mënyrë që ai të ushtrojë të drejtat, që lidhen me asetet e SIK-së

o) garanton që llogaritja e vlerës së SIK-ve është e saktë dhe se çmimi i kuotës ose i aksionit është përcaktuar si duhet.

2. AMF-ja miraton rregullore të veçantë për kodin e sjelljes, e cila është e detyrueshme të zbatohet në çdo kohë nga shoqëria administruese.

Neni 15

Delegimi i funksioneve

1. Shoqëria administruese, në bazë të një marrëveshjeje me shkrim, mund t'ia delegojë administrimin e një pjese të portofolit të SIK-së, me qëllim kryerjen më efikase të veprimtarisë, një subjekti, që kryen veprimtari si shoqëri komisionere, por vetëm pas miratimit të shprehur me shkrim nga AMF-ja. AMF-ja miraton kushtet dhe kriteret e kësaj marrëveshjeje dhe monitoron efektivisht, në çdo kohë, veprimtarinë e shoqërisë administruese. Detyrimet e parashikuara në këtë pikë nuk pengojnë shoqërinë administruese për të vepruar ose sipërmarrjen e investimit kolektiv për t'u menaxhuar në interesin më të mirë të investitorëve të saj.

2. Shoqëria administruese nuk mund ta delegojë administrimin e shoqërisë.

3. Lidhja e marrëveshjeve të parashikuara në këtë nen nga shoqëria administruese nuk e çliron atë nga përgjegjësia e përcaktuar në nenin 34 të këtij ligji, kundrejt mbajtësve të kuotave ose të aksionarëve të shoqërisë investuese.

4. Shoqëria administruese është përgjegjëse kundrejt mbajtësve të kuotave ose aksionarëve të një shoqërie investimi për çdo mospërmbushje ose përmbushje të parregullt të marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bashkërisht ose veçmas me subjektin, me të cilin janë lidhur këto marrëveshje, përveçse kur dëmi vjen si pasojë e rrethanave, për të cilat ky subjekt nuk është përgjegjës. Në çdo rast, shoqëria administruese mbetet përgjegjëse kryesore ndaj mbajtësve të kuotave ose të aksionarëve të shoqërisë investuese.

5. Shoqëria administruese nuk duhet t'ia delegojë administrimin e një portofoli fondi investimesh ose të një shoqërie investimi ose të një pjese të tij një depozitari të fondeve dhe/ose shoqërisë së investimit apo ndonjë subjekti tjetër, interesat e të cilit mund të bien ndesh me ata të shoqërisë administruese, të mbajtësve të kuotave ose aksionarëve të shoqërisë investuese.

Neni 16

Licencimi i shoqërisë administruese

1. Shoqëria administruese nuk mund të kryejë marketimin, tregtimin, si dhe nuk mund të bëjë ofertë për shitjen e ndonjë kuote apo aksioni të një sipërmarrjeje investimi kolektiv pa qenë e licencuar nga AMF-ja.

2. Kërkesa për t'u pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive shoqërohet me:

a) dokumente, që vërtetojnë se subjekti është shoqëri aksionare, e themeluar dhe e regjistruar në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, përfshirë statutin, dokumente, që provojnë se kapitali minimal i kërkuar është shlyer plotësisht në para dhe dokumente, që vërtetojnë burimin e tij, dokumente, të cilat duhet të provojnë se themeluesi ose blerësi e ka paguar kapitalin themeltar apo atë për blerjen e aksioneve me të ardhura të ligjshme;

b) dokumente, që vërtetojnë se aksionarët ndikues të shoqërisë, anëtarët e këshillit të administrimit, drejtuesit ekzekutivë dhe kontrollori i brendshëm janë, si veçmas ashtu edhe

bashkërisht, subjekte të përshtatshme dhe të duhura për të drejtuar veprimtari tregtare. Dokumentet, që nevojiten për të përcaktuar nëse këta persona plotësojnë kërkesën për të qenë të përshtatshëm dhe të duhur, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji, përfshijnë diplomat, certifikatat dhe dokumentet e tjera përkatëse, që vërtetojnë formimin profesional, japin biografinë e plotë të personave, paraqesin përvojën e tyre profesionale dhe përmbajnë, gjithashtu, emrat dhe të dhënat e kontaktit të personave, që mund të vërtetojnë saktësinë e të dhënave biografike, një deklaratë, të nënshkruar dhe të noterizuar, nga secili person, nëse është në proces hetimi për kryerjen e veprave penale;

c) planin e biznesit për shoqërinë administruese, i planifikuar për një minimum prej tre vjetësh, ku jepen një përshkrim i veprimtarisë tregtare, që subjekti ka qëllim të kryejë, mënyra e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe perspektivat e zhvillimit të projektit. Plani i biznesit përmban përshkrime të hollësishme për:

i) mënyrën e organizimit të shoqërisë, përfshirë informacionin për madhësinë e parashikuar të fondeve, që kjo shoqëri synon të ofrojë;

ii) planin e marketingut të shoqërisë;

iii) planin operacional të shoqërisë, përfshirë dhe mënyrën e raportimit, si së brendshmi, tek administrimi i saj, ashtu dhe së jashtmi, tek AMF-ja;

iv) planin financiar, përfshirë dhe përshkrimin se si do të mbulohet kostoja e fillimit të veprimtarisë dhe si do të respektohet kërkesa për mjaftueshmërinë e kapitalit;

v) analizimin e risqeve, përfshirë dhe një përshkrim se si aplikanti do të adresojë riskun operacional, riskun e kreditit, riskun e përputhshmërisë me bazën ligjore dhe riskun e reputacionit;

ç) një përshkrim të strukturës organizative, ku jepen:

i) funksioni i kontrollit të brendshëm, përfshirë dhe emrat e personave përgjegjës për këtë funksion;

ii) funksioni i administrimit të riskut, përfshirë dhe emrat e personave përgjegjës për këtë funksion;

iii) informacion për sistemet teknologjike, që do të përdoren, përfshirë një deklaratë nga eksperti kontabël i jashtëm, që vërteton se sistemi i informimit të shoqërisë administruese është i përshtatshëm për të siguruar informacionin e kërkuar, sipas këtij ligji.

d) marrëveshjen paraprake ndërmjet shoqërisë administruese dhe një depozitari, që vërteton se depozitari do të ofrojë shërbime kujdestarie për këtë shoqëri;

dh) listën e aksionarëve të shoqërisë administruese, emrat dhe mbiemrat e tyre, adresën ose emrin e shoqërisë aksionare dhe selinë e regjistruar, vlerën nominale të aksioneve dhe përqindjen e aksioneve të mbajtura nga çdo aksionar;

e) listën e personave të lidhur me shoqërinë administruese, nëse ka;

ë) dokumentet, që vërtetojnë përmbushjen e kërkesës “i duhur dhe i përshtatshëm” ashtu siç është parashikuar në nenin 18 të këtij ligji;

f) kontratën e punës/shërbimit me këshilltar/ë investimi, nëse ka;

g) kontratat e delegimit, nëse ka;

gj) rregullat për parandalimin dhe menaxhimin e çdo konflikti interesash;

h) rregullat për ndarjen e administrimit të fondit të investimit nga të gjitha veprimtaritë e tjera, në të cilat është angazhuar shoqëria administruese e fondit të investimit;

i) rregullat për ndarjen e funksioneve të brendshme në veprimtarinë e shoqërisë, sipas strukturës së saj;

j) rregullat për përgjegjësitë e vendimmarjes;

k) rregullat për konfidencialitetin;

l) rregullat për mënyrat e komunikimit, në bazë të së cilave investitorët kontaktojnë shoqërinë administruese të SIK-së.

3. AMF-ja mund të miratojë rregullore me kërkesa shtesë në lidhje me përmbajtjen dhe formën që mund të ketë aplikimi për marrjen e autorizimit.

4. AMF-ja e shqyrton aplikimin brenda nëntëdhjetë ditëve kalendarike nga data, që konfirmon marrjen e aplikimit të plotë. Nëse AMF-ja nuk jep një përgjigje brenda kufirit kohor të caktuar, atëherë licenca konsiderohet se është dhënë. Në rast se aplikimi refuzohet, duhet të jepen shkaqet e këtij refuzimi, në përputhje me kërkesat procedurale administrative.

Neni 17

Kualifikimet

1. Të paktën dy anëtarë ekzekutivë të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese duhet të kenë njohurinë profesionale dhe përvojën e duhur për administrimin e veprimtarive të shoqërisë administruese. Këta anëtarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë zotësi të plotë juridike për të kryer transaksione me efekt ligjor;
b) të mos jenë shpallur fajtorë për kryerje veprash penale;
c) të jenë personat e duhur dhe të përshtatshëm për këtë pozicion, në bazë të nenit 18 të këtij ligji;

ç) të kenë të paktën tre vjet përvojë pune në një pozicion, profesional, drejtues ose të pavarur në një institucion financiar, si dhe të kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të këtyre institucioneve ose të jenë të licencuar apo të miratuar nga AMF-ja, për të ushtruar profesionin e këshilltarit të investimit në Republikën e Shqipërisë;

d) të kenë kualifikime dhe certifikata në programe profesionale të njohura nga AMF-ja ose institucione të tjera homologe, që të vërtetojnë aftësinë profesionale në fushën e administrimit të fondeve të investimeve dhe të portofoleve;

dh) t'i nënshtrohen testimit për njohuritë e fushës dhe legjislacionit, sipas rregullave të përcaktuara nga AMF-ja.

2. Çdo anëtar tjetër i këshillit të administrimit të një shoqërie administruese duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në shkronjat “a” deri “c” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 18

Kërkesa për të qenë i duhur dhe i përshtatshëm

1. Çdo person, i cili është ose do të bëhet aksionar ndikues, anëtar i këshillit të administrimit ose kontrollit në një shoqëri administruese, duhet të jetë i duhur dhe i përshtatshëm për të mbajtur këtë pozicion të caktuar.

2. Për të përcaktuar nëse një person është i duhur dhe i përshtatshëm për të mbajtur një pozicion të caktuar merren parasysh:

a) integriteti, ndershmëria, kujdesi dhe përkushtimi për të përmbushur përgjegjësitë, që lidhen me atë pozicion;

b) kompetenca, aftësitë profesionale dhe logjika e gjykimit, për përmbushjen e përgjegjësisë, që lidhen me atë pozicion;

c) fakti që interesat e klientëve të subjektit të licencuar ose të subjektit të propozuar për t'u licencuar, nuk duhet të cenohen nga një konflikt interesi, që buron nga personi, i cili mban atë pozicion.

3. Përveç dispozitave të sipërpërmendura, në përgjithësi, vlerësohen edhe sjelljet dhe veprimtaritë e mëparshme në biznes ose çështje financiare të personit në fjalë, dhe, në veçanti, duhet të kryhen hetime të posaçme, nëse ekziston ndonjë provë se personi ka qenë:

a) i dënuar për një vepër penale;

b) i përfshirë ose i lidhur me një humbje financiare, që ka ndodhur për shkak të pandershmërisë, paafësisë ose praktikës jo të mirë në sigurimin e shërbimeve financiare apo në administrimin e shoqërive të tjera;

c) i përfshirë në ndonjë praktikë biznesi, përfshirë dhe evazionin fiskal, që autoriteti e konsideron si vepër mashtruese apo të rëndë, ose, në përgjithësi, e vlerëson si një vepër të

parregullt, qoftë ose jo e ligjshme, apo si ndonjë vepër, e cila vë në dyshim përqasjen e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

4. Personat, që janë shpallur fajtorë për kryerjen e një vepre penale, nuk mund të mbajnë ose të jenë përfitues të një pakete kontrolluese, të jenë administratorë ose të mbajnë një pozicion drejtues në shoqërinë administruese. “Paketë kontrolluese”, për qëllime të kësaj pike, është:

- a) pronësia e mbi 30 për qind të një klase titujsh, me të drejtë vote;
- b) mundësia për të zgjedhur shumicën e administratorëve të këshillit ose administratorët e çdo organi politikëbërës;
- c) ushtrimi i një ndikimi kontrollues mbi administrimin ose politikat e një shoqërie administruese.

5. Një aksionar ndikues, drejtor, drejtues ekzekutiv ose administrator i një shoqërie administruese nuk mund të jetë aksionar ndikues, drejtor, drejtues ekzekutiv ose administrator i një depozitari, që ruan asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të shoqërisë administruese, ose të një personi të lidhur me depozitarin.

6. AMF-ja miraton një rregullore për të përshkruar me hollësi përkufizimin e kërkesës për të qenë i duhur dhe i përshtatshëm.

Neni 19

Funksioni i kontrollit të brendshëm dhe i administrimit të riskut

(shtuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr. 36/2016, datë 31.3.2016)

1. Shoqëria administruese ka një funksion të kontrollit të brendshëm financiar dhe një funksion të administrimit të riskut, me madhësi dhe kapacitet të përshtatshëm për veprimtarinë tregtare, të kryer nga kjo shoqëri administruese.

2. Personat, që kryejnë funksionin e kontrollit të brendshëm financiar dhe të administrimit të riskut, janë të pavarur dhe i raportojnë drejtpërdrejt këshillit të administrimit të shoqërisë administruese.

3. Kontrolli i brendshëm ka këto funksione:

a) kontrollon nëse shoqëria administruese është e organizuar në mënyrë të tillë që të nxisë administrimin efektiv dhe të kujdesshëm të biznesit, si dhe monitoron këshillin për përmbushjen e kësaj cilësie administrimi;

b) kontrollon zbatimin e parimeve e të qeverisjes së shoqërive, përcaktimin e politikave dhe të strategjive për respektimin e këtyre parimeve, si dhe konstaton çdo vit zbatimin e këtyre politikave e strategjive. Parimet e qeverisjes së shoqërive duhet të përfshijnë standarde të sjelljes gjatë kryerjes së veprimtarisë tregtare dhe të sjelljes etike të drejtorëve, administratorëve dhe të çdo punonjësi tjetër, politika për transaksionet personale dhe praktika të tjera transaksionesh me një natyrë, që i përmbahet parimit të trajtimit të njëjtë, pa kushte favorizuese;

c) mbikëqyr veprimtarinë e shoqërisë administruese dhe jep orientime të përditshme, për të garantuar se ai subjekt përputhet me objektivat dhe politikat e miratuara nga këshilli i administrimit, si dhe me legjislacionin përkatës;

ç) i bën rekomandime këshillit të administrimit për shqyrtim dhe miratim prej tij, për objektivat, strategjinë, planet e biznesit dhe politikat kryesore, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit;

d) i jep këshillit të administrimit informacionin e nevojshëm e të hollësishëm, për t'i mundësuar shqyrtimin e objektivave, të strategjisë dhe të politikave të biznesit, si dhe mbajtjen nga administratorët të përgjegjësisë për veprimtarinë e shoqërisë.

4. Funksioni i administrimit të riskut ka këto përgjegjësi:

a) krijimin dhe sugjerimin, të këshilli i administrimit, të miratimit të një sistemi për administrimin e riskut në sipërmarrjen e investimeve kolektive, që përfshin monitorimin e politikave të vendosura, në mënyrë që të identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen, në mënyrë të vazhdueshme, të gjitha rreziqet kryesore;

b) krijimin e sistemit të administrimit të riskut, që monitoron rreziqet, që i kanosen shoqërisë, përfshirë rrezikun e tregut, të kreditit, atë operacional, të emrit të mirë ligjor dhe atë që lidhet me veprimet e administratorëve në kundërshtim me interesat e mbajtësve të kuotave dhe të aksionarëve;

c) mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe të mënyrës së saj të administrimit e të sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe dhënien e orientimeve të përditshme për të garantuar se kjo shoqëri, individualisht dhe gjatë administrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive, vepron brenda kufijve të risqeve, të përcaktuara nga këshilli i administrimit, të parashikuara në prospektin dhe rregullat e fondit;

ç) përcaktimin e saktë dhe të pavarur të vlerës së derivativëve financiarë, të tregtuara në tregje të tjera të rregulluara. Shoqëria administruese, në përputhje me rregullat e përshkruara nga AMF-ja, i raporton kësaj të fundit, për çdo sipërmarrje individuale të investimeve kolektive, në lidhje me llojet e derivativëve financiarë në portofolin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, risqet që lidhen me to, kufijtë sasiorë dhe metodologjinë e zbatuar për matjen e risqeve, të rrjedhura nga pozicionet dhe transaksionet, që përfshijnë këta derivativë. Kur titujt ose instrumentet e tregut të parasë kanë derivativë të lidhura me ta, këta duhet të merren parasysh kur të llogaritet ekspozimi ndaj rrezikut të sipërmarrjes së investimeve kolektive, që parashikohet në këtë nen.

5. Shoqëria administruese krijon një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv të administrimit të riskut, në përputhje me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj të biznesit, i cili duhet të përmbajë, të paktën:

- a) strategjinë e administrimit të riskut, politikat, procedurat dhe masat;
- b) teknikat e matjes së riskut;
- c) ndarjen e përgjegjësisë që kanë të bëjnë me administrimin e riskut.

6. Autoriteti miraton rregulla për administrimin e riskut, në përputhje me pikën 5, të këtij neni, 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20

Kërkesat për kontabilitetin dhe kontrollin e jashtëm financiar

1. Shoqëria administruese duhet:

a) të mbajë vazhdimisht regjistra kontabël, të plotë dhe të rregullt, të përditësuar çdo muaj;

b) të përgatisë çdo vit pasqyrat financiare për vitin financiar të shoqërisë administruese, në përputhje me standardet e pranura të SNRF-së (Standardet Ndërkombëtare të Raportimeve Financiare), që pasqyrojnë, me hollësi, pozicionin financiar të biznesit në ditën e fundit të vitit financiar, rezultatin financiar të veprimtarisë dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për atë periudhë. Pasqyrat financiare duhet të paraqesin si duhet situatën e veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese e duhet të trajtojnë çdo çështje, e cila ka ndikuar ose ka mundësi të ndikojë në situatën financiare të shoqërisë;

c) të paraqesë, kur është shoqëri e kontrolluar, të dyja grupet e pasqyrave financiare vjetore, të kontrolluara, atë individuale dhe atë të konsoliduar.

2. Shoqëria administruese duhet të bëjë të mundur që pasqyrat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni të kontrollohen çdo vit nga një ekspert kontabël i regjistruar, i caktuar nga shoqëria administruese, në mënyrë që të përgatitet:

a) bilanci i audituar, përfshirë edhe shënimet, komentet, mendimet dhe dokumentet bashkëngjitur;

b) një pasqyrë e audituar të ardhurash dhe shpenzimesh, përfshirë edhe shënimet, komentet, opinionet dhe dokumentet bashkëngjitur;

c) një pasqyrë e audituar e rrjedhës së parave;

ç) eksperti kontabël i autorizuar duhet të kryejë kontrollin financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. AMF-ja ka të drejtë që, me shpenzimet e saj, të kryejë kontroll financiar në çdo periudhë të vitit që e gjykon të nevojshme.

Neni 21

Regjistrimet kontabël

1. Shoqëria administruese duhet të mbajë në çdo kohë regjistrimet kontabël, që nevojiten për të paraqitur qartë dhe saktë gjendjen e veprimtarisë tregtare, për të shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar dhe për të bërë të mundur që AMF-ja të përcaktojë, nëse ka vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit.

2. Regjistrimet kontabël të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të ruhen, për të paktën, pesë vjet.

3. Regjistrimet kontabël duhet të jenë të tilla, që të mund të riprodhohen në formë të lexueshme sa herë që kjo gjë kërkohet.

Neni 22

Ekspertët kontabël të regjistruar

1. Jo më vonë se dy muaj pas licencimit, sipas këtij ligji, shoqëria administruese duhet të caktojë një ekspert kontabël të regjistruar, për të audituar pasqyrat e saj financiare.

2. AMF-ja mund të miratojë kritere shtesë për ekspertët kontabël të autorizuar, që mund të certifikohen brenda fondeve të investimit.

3. Shoqëria administruese nuk mund të emërojë si ekspert të saj kontabël subjektin, ku njëri nga drejtorët, administratorët, ortakët ose zyrtarët e lartë të saj ka një interes financiar në shoqërinë administruese dhe në ndonjë nga veprimtaritë e veta tregtare. Për qëllime të këtij neni, mbajtësi i kuotave dhe/ose aksionari në një sipërmarrje të investimeve kolektive nuk konsiderohet se ka interes financiar në shoqërinë administruese.

4. Nëse emërimi i një eksperti kontabël të regjistruar përfundon për çfarëdo lloj arsyeje, ai i paraqet AMF-së një deklaratë, ku shpjegon shkaqet që ai mendon se kanë shkaktuar këtë përfundim dhe informon AMF-në me shkrim për çdo çështje lidhur me veprimtaritë e shoqërisë administruese, për të cilat eksperti kontabël i autorizuar është vënë në dijeni gjatë përmbushjes së funksionit të tij dhe që, sipas mendimit të këtij eksperti, mund të dëmtojnë aftësinë e shoqërisë administruese për të zbatuar kërkesat e këtij ligji.

Neni 23

Ndryshimi i kontrollit

1. Aksionar ndikues i shoqërisë administruese nuk bëhet asnjë person nëse:

a) nuk ka njoftuar më parë me shkrim autoritetin për qëllimin e tij;

b) autoriteti nuk e ka njoftuar me shkrim se nuk ka asnjë kundërshtim që ai të bëhet aksionar ndikues ose kontrollues kryesor.

2. Kur AMF-ja njofton subjektin, sipas pikës 1 të këtij neni, se nuk ka asnjë kundërshtim që ai të bëhet aksionar ndikues ose të zmadhojë pjesëmarrjen e tij financiare në shoqërinë administruese, në mënyrë që të bëhet aksionar ndikues, mund të specifikojë pjesëmarrjen maksimale financiare që subjekti lejohet të arrijë.

3. AMF-ja mund:

a) të nxjerrë rregulla për informacionin, që duhet të përmbajë njoftimi i përmendur në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni;

b) t'i kërkojë, kur e shih të nevojshme, informacion dhe dokumente të mëtejshme subjektit, që aplikon për aksionar ndikues.

4. Kur AMF-ja jep miratimin që një subjekt të bëhet aksionar ndikues, ajo duhet të vlerësojë nëse subjekti është i duhur dhe i përshtatshëm.

5. AMF-ja i kthen përgjigje subjektit, që aplikon për t'u bërë aksionar ndikues i një shoqërie administruese, jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së njoftimit nga kërkuksi.

6. Miratimi i dhënë nga AMF-ja për t'u bërë aksionar ndikues, sipas pikës 1 të këtij neni, humbet vlefshmërinë, nëse personi nuk është bërë aksionar ndikues, brenda një viti nga data e dhënies së miratimit.

Neni 24

Kundërshtimet për aksionarët ndikues ekzistues

1. Kur AMF-ja vlerëson se subjekti, që është aksionar ndikues i një shoqërie administruese, nuk përmbush kërkesat për të qenë i duhur dhe i përshtatshëm, ajo njofton, me shkrim, subjektin për mospërmbushjen, duke dhënë edhe arsyet përkatëse.

2. AMF-ja nuk i përfshin arsyet përkatëse në njoftimin, sipas pikës 1 të këtij neni, kur e gjykon se kjo sjell përhapjen e informacionit konfidencial, i cili është i dëmshëm për një palë të tretë.

3. Para paraqitjes së njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, AMF-ja i jep aksionarit ndikues njoftimin paraprak, me arsyet përse e vlerëson personin si jo të duhur dhe të përshtatshëm për të qenë aksionar ndikues i shoqërisë administruese.

4. Personi, i cili ka marrë njoftimin, sipas pikës 3 të këtij neni, ka në dispozicion një periudhë prej 20 ditësh pune për të kthyer përgjigje me shkrim dhe për të kundërshtuar vlerësimin e AMF-së, e cila duhet të marrë parasysh çdo dokument me shkrim, të paraqitur nga aksionari ndikues. AMF-ja duhet të përgjigjet brenda 25 ditësh pune nga data e marrjes së përgjigjes me shkrim nga aksionari ndikues, nëse ajo vlerëson se ky aksionar vazhdon të mos jetë apo nuk është më person i duhur dhe i përshtatshëm për të qenë aksionar ndikues.

Neni 25

Rastet kur aksionari ndikues nuk është i duhur dhe i përshtatshëm

1. Kur një person është bërë ose vazhdon të jetë aksionar ndikues, pa marrë miratimin e kërkuar nga AMF-ja dhe kur AMF-ja vlerëson se ky person nuk është më i duhur dhe i përshtatshëm për të qenë aksionar ndikues, ajo mund të urdhërojë që aksionet specifike, për të cilat zbatohet ky nen, deri në një njoftim të mëtejshëm, t'i nënshtrohen ndonjërit ose disa kufizimeve të mëposhtme:

a) pezullimit të çdo transferimi ose marrëveshjeje transferimi të aksioneve të aksionarit ndikues;

b) ndalimit të ushtrimit të së drejtës së votës së lidhur me aksionet;

c) ndalimit të kryerjes së pagesave në favor të aksionarit kryesor nga çfarëdo lloj shume, që rezulton nga pronësia mbi aksionet apo diçka tjetër e shoqërisë administruese.

2. AMF-ja mund të njoftojë shoqërinë administruese se nuk plotëson më kërkesat për licencën, për shkak se njëri nga aksionarët e saj ndikues nuk është më person i duhur dhe i përshtatshëm, dhe se licenca e saj mund të hiqet në përputhje me shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, përveç rastit kur aksionari ndikues e humbet këtë status nëpërmjet shitjes të së gjitha ose të një pjesë të aksioneve.

Neni 26

Përthithja dhe bashkimi

1. Një shoqëri administruese mund t'i blejë dhe t'i mbajë aksionet e një shoqërie tjetër administruese, me kusht që ajo t'i blejë dhe mbajë të gjitha aksionet e asaj shoqërie administruese të përthithur. Blerja nga shoqëria administruese e të gjitha aksioneve të një shoqërie tjetër administruese kërkon miratimin paraprak, me shkrim, të AMF-së.

2. Shoqëritë administruese mund të bashkohen vetëm pas miratimit me shkrim të AMF-së.
3. Nëse bashkimi i shoqërisë administruese sjell likuidimin e shoqërisë, para mbylljes së veprimtarisë tregtare ajo:
 - a) duhet të informojë të gjithë mbajtësit e kuotave dhe/ose aksionarët e shoqërisë investuese se do ta ndërpresë veprimtarinë e saj tregtare dhe do t'u lërë mbajtësve të kuotave dhe/ose aksionarëve tre muaj kohë për të ushtruar të drejtën për të transferuar investimet e tyre në një sipërmarrje tjetër të investimeve kolektive nën administrimin e shoqërisë administruese, të zgjedhur prej vetë atyre;
 - b) mund t'u ofrojë mbajtësve të kuotave dhe/ose aksionarëve të shoqërisë investuese lidhjen e një kontrate të re administrimi me shoqërinë administruese, që del nga bashkimi, por, në këtë rast, mbajtësit e kuotave dhe/ose aksionarët e shoqërisë investuese duhet të njoftohen, gjithashtu, në mënyrë korrekte, për të drejtën e tyre për të zgjedhur një shoqëri tjetër administruese apo për të kërkuar shlyerjen e kuotave dhe/ose të aksioneve të tyre.

Neni 27

Transferimi i veprimtarisë administruese në shoqërie tjetër administruese

1. Shoqëria administruese ka të drejtë t'ia transferojë veprimtaritë e fondit të investimit një shoqërie tjetër administruese, të licencuar nga AMF-ja, në përputhje me procedurën e përcaktuar prej saj dhe, në rastin e një shoqërie investimi me ofertë publike, pas miratimit të asamblesë së përgjithshme të saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 70 të këtij ligji.
2. Shoqëria administruese duhet të njoftojë, të paktën tre muaj para transferimit, të gjithë mbajtësit e kuotave në atë fond, për transferimin e administrimit. Shoqëria administruese nuk duhet të llogarisë dhe të ngarkojë tarifë largimi për mbajtësit e kuotave, të cilët gjatë kësaj periudhe dëshirojnë të largohen nga fondi.
3. Shoqëria administruese, që ia transferon administrimin një shoqërie tjetër të licencuar, duhet të lidhë një kontratë për transferimin e administrimit, e cila duhet të përmbajë:
 - a) përshkrimin specifik të të gjitha procedurave dhe të veprimeve, që do të ndërmerren nga të dyja shoqëritë për transferimin e administrimit;
 - b) kufirin kohor, që duhet të jetë jo më pak se tre muaj, i llogaritur nga data e publikimit të njoftimit për transferimin e administrimit, brenda të cilit shoqëritë do të kryejnë transferimin e administrimit.

Neni 28

Konflikti i interesit dhe ndalimet

1. Shoqëria administruese nuk duhet të ketë pjesëmarrje ndikuese ose kontrolluese në një shoqëri komisionere apo në një bankë të autorizuar për të kryer transaksione, që përfshijnë tregtimin e titujve.
2. Shoqëria administruese duhet të marrë miratimin e AMF-së, përpara se të krijojë një filial në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj.
3. Shoqëria administruese nuk merr pjesë në veprimtarinë tregtare të depozitarit. Veprimtaritë organizuese, drejtuese dhe administruese të depozitarit dhe të shoqërisë administruese nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Në këto detyra nuk ngarkohen të njëjtët persona.
4. Nuk mund të jenë aksionarë të shoqërisë administruese ose anëtarë të këshillit të administrimit personat:
 - a) të cilët, tre vjet para se të kenë marrë pjesë në shoqërinë administruese, kanë pasur të paktën 10 për qind pronësi në kapitalin e regjistruar të shoqërisë administruese, të bankës së licencuar për kryerjen e detyrave të depozitarit, të shoqërisë investuese, shoqërisë komisionere ose të një banke të licencuar për tregtimin e titujve, apo të një fondi pensioni, në çastin kur u është hequr licenca e veprimtarisë tregtare;

b) të cilët kanë humbur anëtarësinë në një shoqatë profesionale për shkak të shkeljes së rregullave të shoqatës ose kundër të cilëve AMF-ja apo një autoritet tjetër përgjegjës ka vendosur heqjen e licencës për kryerjen e veprimtarive, që lidhen me titujt;

c) e dënuar për një vepër penale, pesë vjet pas datës së marrjes së vendimit të formës së prerë, ku nuk përfshihet koha e vuajtjes së dënimit;

ç) e dënuar për vepra penale dhe/ose shkelje administrative, sipas ligjit “Për titujt”;

d) të cilët kanë një licencë të vlefshme nga AMF-ja, domethënë një komisioner ose këshilltar investimesh, që kryen efektivisht këto detyra si punonjës i një shoqërie komisionere ose i një banke të autorizuar për transaksionet me tituj;

dh) të cilët, aktualisht, mbajnë një post në shërbimin publik.

Neni 29

Dhënia e informacionit për konfliktin e interesit

1. Drejtori ose administratori i shoqërisë administruese, i cili:

a) është palë në një kontratë ose propozim-kontratë me shoqërinë administruese për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

b) është drejtor ose administrator i një subjekti, që është palë në një kontratë ose propozim-kontratë me shoqërinë administruese për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

c) ka pjesëmarrje pasurore në një subjekt, që është palë në një kontratë ose propozim-kontratë me shoqërinë administruese për sipërmarrjen e investimeve kolektive,

duhet të japë një përshtkrim të plotë, me shkrim, për marrëdhënien e tij me subjektin, me të cilin shoqëria administruese është duke vlerësuar mundësinë ose është duke lidhur një kontratë. Ai duhet, gjithashtu, të sigurohet se ky përshtkrim është pasqyruar në procesverbalet e takimeve të administratorëve dhe është përfshirë në raportet për mbajtësit e kuotave dhe/ose aksionarët, së bashku me raportimet e vlerës neto të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, në përputhje me nenin 128 të këtij ligji.

2. Informacioni i kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, jepet në rastin e një drejtori, në mbledhjen e administratorëve, gjatë së cilës vlerësohet për herë të parë kontrata e propozuar, nëse:

a) administratori nuk ka qenë në atë kohë i interesuar për kontratën, në mbledhjen e parë, pasi ai të ketë shfaqur interes;

b) administratori shfaq interes pas lidhjes së kontratës, në mbledhjen e parë, pasi ai të ketë shfaqur interes;

c) personi, i cili është i interesuar në një kontratë, më vonë bëhet administrator, në takimin e parë pasi personi të jetë bërë administrator.

3. Dhënia e informacionit të kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, në rastin e një administratori, që nuk ka funksionin e drejtorit, bëhet:

a) menjëherë, pasi ai të jetë vënë në dijeni se do të vlerësohet një kontratë e propozuar ose se është vlerësuar një kontratë në mbledhjen e administratorëve;

b) pasi të jetë lidhur kontrata, menjëherë pasi administratori të ketë shfaqur interes;

c) nëse personi, i cili ka interes në një kontratë, më vonë bëhet administrator, menjëherë pasi personi të jetë bërë administrator.

Neni 30

Kërkesat për mosmarrjen pjesë

1. Në rast se zbatohet pika 1 e nenit 29 të këtij ligji, për një administrator të lidhur me një kontratë, administratori nuk duhet të jetë i pranishëm në mbledhjen e administratorëve, gjatë së cilës është duke u vlerësuar ose votuar kontrata.

2. Çdo drejtor, i cili shkel përcaktimin e pikës 1 të këtij neni, humbet postin si administrator

dhe, për një periudhë prej 5 vjetësh, pas datës kur ka ndodhur shkelja, nuk do të ketë mundësi të zgjidhet ose emërohet si administratori i një institucioni të mbikëqyrur nga autoriteti.

Neni 31

Transaksionet e palëve të lidhura

1. Shoqëria administruese për sipërmarrjen e investimeve kolektive, që ajo administron, nuk duhet të japë kushte favorizuese për ndonjë palë të lidhur me të.

2. Për qëllime të këtij neni, “dhënie e kushteve favorizuese” nënkupton:

a) kryerjen e një veprimtarie tregtare, e cila për nga natyra, qëllimi, karakteristikat ose risku nuk do të kryhej nga kjo shoqëri me klientë të tjerë;

b) arkëtimin e interesave, të tarifave ose të detyrimeve të tjera apo pranimin e garancive, të cilat janë më të ulëta se ato që kërkohen për klientë të tjerë, pagimin e interesave a pagimin e interesave më të larta se ato që kërkohen për klientë të tjerë.

3. Asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive nuk duhet të shiten, huazohen ose përdoren për të garantuar një detyrim në dobi të:

a) shoqërisë administruese, që administron asetet e saj ose të depozitarit, që i ruan këto asetë;

b) çdo subjekti, i cili është palë e lidhur me secilin nga subjektet e përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike.

4. Shoqëria administruese nuk duhet të përdorë asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive, që ajo administron, për të blerë ndonjë aset të dhënë hua ose për të marrë përsipër ndonjë detyrim, në favor të subjekteve të renditura në pikën 3 të këtij neni.

Neni 32

Heqja e licencës

1. AMF-ja ka të drejtë t’ia heqë licencën shoqërisë administruese në rastet kur:

a) shoqëria administruese nuk ka arritur të fillojë veprimtari tregtare brenda një viti pas datës së dhënies së licencës;

b) shoqëria administruese ka hequr dorë vullnetarisht nga licenca;

c) shoqëria administruese pushon së kryeri veprimtarinë e themelimit dhe/ose të administrimit të fondit të investimit për gjashtë muaj radhazi, në përputhje me këtë ligj;

ç) licenca është dhënë në bazë të informacionit të pavërtetë, çorientues ose në çdo lloj mënyre të parregullt;

d) shoqëria nuk i përmbush më kushtet, në bazë të së cilave është dhënë licenca;

dh) shoqëria kryen shkelje të rënda ose sistematike të dispozitave të këtij ligji;

e) kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë administruese bie nën nivelin minimal të kërkuar.

2. Rregullat e hollësishme për kushtet kur mund të hiqet licenca përcaktohen në një rregullore të veçantë të AMF-së.

Neni 33

Mbyllja vullnetare e veprimtarisë së shoqërisë administruese

Shoqëria administruese mund ta mbyllë veprimtarinë e saj të regjistruar në rastet e mëposhtme:

1. Të paktën gjashtëdhjetë ditë para datës së përfundimit të veprimtarisë administruese, ajo i dërgon njoftim me shkrim depozitarit, kur ka përdorur shërbimet e depozitarit dhe AMF-së, nëse shoqëria administruese administron fond investimi, ose këshillit të administrimit të shoqërisë së investimit dhe AMF-së, nëse ajo administron një shoqëri investimi me ofertë publike.

2. Nëse krijohen rrethana të tilla, që tregojnë qartë se shoqëria administruese nuk është dhe as nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet, ajo njofton menjëherë AMF-në, nëse administron një fond investimi, ose këshillin e administrimit dhe AMF-në, nëse administron një shoqëri investimi me ofertë publike.

3. Nëse shoqëria administruese, që administron fondin e investimit, nuk ka arritur të zbatojë procedurën e transferimit të administrimit një shoqërie tjetër të licencuar administruese, në përputhje me këtë nen, jo më vonë se gjashtëdhjetë ditë pas datës së dërgimit të njoftimit, parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni dhe nëse po kjo nuk është zbatuar nga këshilli mbikëqyrës në rastin e një shoqërie investimi me ofertë publike, atëherë fillon procedura e likuidimit të fondit, në përputhje me dispozitat e kreut VIII të këtij ligji.

Neni 34

Përgjegjësia e shoqërisë administruese

1. Në rast se shoqëria administruese nuk ka kryer ose nuk ka arritur të kryejë, plotësisht ose pjesërisht, si dhe nëse ajo i ka kryer jo si duhet veprimtaritë dhe detyrat e parashikuara nga ky ligj, nga rregullat e fondit ose prospekti i fondit, atëherë kjo shoqëri administruese është përgjegjëse para mbajtësve të kuotave ose aksionarëve të shoqërisë së investimit për mungesën e kujdesit të duhur në zhvillimin e veprimtarisë tregtare, siç është parashikuar nga ky ligj, nga rregullorja e AMF-së, nga rregullat e prospekti i fondit, si dhe nga marrëveshja e administrimit. Kufizimi në çfarëdolloj mënyre i përgjegjësisë vlerësohet nul dhe i pavlefshëm.

2. Heqja dorë ose kufizimi i përgjegjësisë, si pasojë e delegimit të ndonjëres prej funksioneve të shoqërisë administruese te një palë e tretë, nuk ka efekte ligjore.

KREU III

VEPRIMTARITË JASHTË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE VEPRIMTARITË E SIPËRMARRJEVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SEKSIONI 1

VEPRIMTARITË E ADMINISTRIMIT TË SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 35

Mënyra e ushtrimit të veprimtarisë nga shoqëria administruese

Shoqëria administruese mund të kryejë veprimtari jashtë Republikës së Shqipërisë drejtpërdrejt ose nëpërmjet themelimit dhe funksionimit të një dege, në përputhje me aktet ligjore të vendit përkatës.

Neni 36

Themelimi i degëve në shtetet e Bashkimit European dhe në ato të lejuara nga AMF-ja

1. Shoqëria administruese, që kërkon të themelojë një degë në një shtet të Bashkimit European ose në një shtet tjetër jashtë Bashkimit European, nëse është lejuar nga AMF-ja, njofton për këtë AMF-në, duke treguar shtetin e Bashkimit European ose shtetin tjetër të lejuar, në të cilin ajo ka qëllim të themelojë një degë.

2. Njoftimi shoqërohet me të dhënat e mëposhtme:

a) informacionin e përgjithshëm për degën, që përmban:

i) objektin e veprimtarisë së degës;

ii) emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar degën;

iii) emërtimin dhe selinë e regjistruar të degës, ku mund të merret i gjithë informacioni për veprimtarinë e degës;

b) informacionin për sipërmarrjen e investimeve kolektive të administruar nga shoqëria, informacionin për kuotat ose aksionet, të cilat shoqëria administruese planifikon t'i ofrojë për nënshkrim publik, nëpërmjet degës në shtetin e Bashkimit European ose në shtetin tjetër të lejuar, që përmban:

i) përshkrimin e saktë të veprimtarive të planifikuara të biznesit, të cilat shoqëria administruese ka qëllim të kryejë, për shitjen e kuotave ose të aksioneve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

ii) për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive, prospektin e saj dhe/ose rregullat e fondit, si dhe raportin financiar për vitin paraardhës të biznesit.

3. Njoftimin e autoritetit përkatës për qëllimin e saj për themelimin e degës. AMF-ja, jo më vonë se tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe datës së marrjes së një kërkesë nga autoriteti përkatës i shtetit të Bashkimit European ose shtetit të lejuar, i dërgon autoritetit njoftimin, së bashku me dokumentet shitesë dhe njofton për këtë shoqërinë administruese.

4. Edhe këto të dhëna:

a) informacion për shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese;

b) deklaratë se çdo sipërmarrje e investimeve kolektive, me të cilën lidhet njoftimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përmbush kërkesat ligjore për fondet e investimit me ofertë publike dhe për shoqërinë e investimit me ofertë publike.

5. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 2 të këtij neni, AMF-ja nuk i dërgon autoritetit përkatës të një shteti të Bashkimit European ose të një shteti të lejuar, njoftimin për themelimin e degës, nëse, në bazë të informacionit të paraqitur, parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe në bazë të objektit të propozuar të veprimtarisë tregtare, ajo ka arritur në përfundimin se ekziston dyshimi i arsyeshëm për organizimin dhe administrimin e veprimtarive të degës, domethënë kapacitetin financiar të shoqërisë administruese për kryerjen e veprimtarisë tregtare në shtetin e Bashkimit European ose në shtetin e lejuar, për të cilin AMF-ja duhet të marrë një vendim. AMF-ja, gjithashtu, nuk e dërgon njoftimin ose nuk e miraton këtë veprimtari, nëse ajo konsideron se kjo ka një efekt të dëmshëm në veprimtarinë tregtare të shoqërisë administruese në Republikën e Shqipërisë.

6. Shoqëria administruese duhet të njoftojë me shkrim AMF-në për çdo ndryshim në të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të paktën një muaj para zbatimit të ndryshimeve të planifikuara.

SEKSIONI 2

VEPRIMTARITË E ADMINISTRIMIT TË SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE NGA SHOQËRI ADMINISTRUESE, ME SELI TË REGJISTRUARA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 37

Dhënia e licencës për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, të krijuara nga shoqëri të huaja administruese

1. Sipërmarrja e themeluar në bazë të licencës së lëshuar nga autoriteti përkatës në një shtet të Bashkimit European dhe/ose në një shtet, i cili është miratuar specifikisht nga AMF-ja, që përmbush kushtet e parashikuara në dispozitat e këtij ligji, që rregullon funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe që dëshiron të tregtojë kuotat dhe/ose aksionet e saj në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i paraqesë AMF-së dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin se sipërmarrja është e autorizuar nga autoriteti përkatës i shtetit të Bashkimit European dhe/ose i shtetit të lejuar dhe se plotëson kushtet e parashikuara për të kryer veprimtaritë përkatëse;

b) rregullat e fondit ose dokumente të tjera të përshtatshme të sipërmarrjes;
c) prospektin e plotë dhe prospektin e thjeshtëzuar;
ç) raportet financiare vjetore dhe atë të gjashtëmujorit të fundit;
d) të dhënat për metodën e tregtimit të kuotave në Republikën e Shqipërisë;
dh) të dhëna të hollësishme për shtetin, ku investitorët shqiptarë mund të marrin kopje të prospektit, të rregullave e fondit, raporteve dhe të të dhënave të tjera për sipërmarrjen, në gjuhën shqipe, si dhe të dhëna të hollësishme për shtetin, ku investitorët shqiptarë do të jenë në gjendje të blejnë dhe shesin kuotat apo aksionet.

Të gjitha njoftimet dhe raportimet e parashikuara në këtë pikë duhet të jenë edhe në gjuhën shqipe.

2. Nëse AMF-ja nuk e ka rrëzuar aplikimin brenda dy muajve, në bazë të mospërputhshmërisë së sipërmarrjes me kërkesat e parashikuara të shtetit të Bashkimit Europian dhe/ose të shtetit të lejuar apo me rregullore të tjera të Republikës së Shqipërisë, fondi mund të fillojë veprimtarinë, në përputhje me këtë ligj.

3. Ndalohet ofrimi i kuotave apo i aksioneve të një sipërmarrjeje të huaj në Shqipëri pa autorizimin e AMF-së.

Neni 38

Subjekte të këtij ligji

Sipërmarrja e parashikuar në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji u nënshtrohet dispozitave të këtij ligji në rastin e kryerjes së veprimtarive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 39

Akte nënligjore

AMF-ja miraton një rregullore për dhënien e licencave, veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sa u përket të dhënave për sipërmarrjen e investimit kolektiv, parashikuar në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 40

Dega e shoqërisë së huaj administruese

1. Shoqëria administruese, me seli të regjistruar në një shtet të Bashkimit Europian dhe/ose në një shtet të njohur, të lejuar dhe miratuar shprehimisht nga AMF-ja, që dëshiron të themelojë një degë në Republikën e Shqipërisë, duhet të njoftojë autoritetin përkatës në shtetin e Bashkimit Europian ose në shtetin e lejuar.

2. Shoqëria administruese duhet, gjithashtu, t'i paraqesë AMF-së të gjitha vërtetimet se është e autorizuar nga autoriteti përkatës i shtetit të Bashkimit Europian dhe/ose shtetit të lejuar, se plotëson kushtet e parashikuara dhe është e autorizuar të kryejë veprimtarinë përkatëse. Ajo i paraqet më tej AMF-së:

a) informacionin e përgjithshëm për degën, i cili përfshin:
i) objektin e veprimtarisë së degës;
ii) emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar degën;
iii) emërtimin dhe selinë e regjistruar të degës, ku merren të gjitha informacionet për veprimtarinë e saj;

b) informacionin për fondet e administruara nga shoqëria, për kuotat dhe aksionet, që shoqëria administruese planifikon të nxjerrë në ofertë publike, nëpërmjet degës në Republikën e Shqipërisë, si:

i) përshkrimin e saktë të veprimtarive të planifikuara të biznesit, të cilat shoqëria administruese ka qëllim t'i kryejë për shitjen e kuotave ose të aksioneve;

ii) për çdo fond, prospektin e tij dhe/ose rregullat e fondit, si dhe raportin më të fundit financiar.

3. Shoqëria administruese kërkon dhe bën të gjitha përpjekjet e mundshme që autoriteti përkatës në shtetin e Bashkimit European ose në shtetin e lejuar t'i dërgojë AMF-së njoftimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme bashkëngjitur.

4. Bashkë me njoftimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, shoqëria administruese bën të gjitha përpjekjet e mundshme që autoriteti përkatës në shtetin e Bashkimit European ose në shtetin e lejuar, t'i japë AMF-së të dhënat si më poshtë:

- a) informacion për shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese;
- b) deklaratë se çdo fond apo shoqëri investimi, me të cilin lidhet njoftimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, plotëson kërkesat e vendosura prej këtij autoriteti.

5. AMF-ja bën të gjitha kërkimet e nevojshme për të përcaktuar nëse shoqëria aplikante administruese, në këtë rast, është një biznes, që funksionon në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

6. Shoqëria administruese duhet të njoftojë autoritetin përkatës në shtetin e Bashkimit European ose në shtetin e lejuar për çdo ndryshim në rregullat e fondit, të paktën një muaj para zbatimit të këtyre ndryshimeve.

Neni 41

Miratimi për fillimin e veprimtarisë

1. Jo më vonë se dy muaj pas datës së marrjes së informacionit për propozimin për të hapur një degë të shoqërisë administruese të një shteti të Bashkimit European ose të një shteti të lejuar, AMF-ja duhet të njoftojë shoqërinë administruese për të gjitha përgjegjësitë ligjore, që lindin nga kryerja e veprimtarisë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

2. Vetëm pas marrjes së njoftimit, si dhe pas kalimit të kufirit kohor të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe në rast se njoftimi nuk merret brenda këtij kufiri kohor, shoqëria administruese mund ta fillojë dhe ta zhvillojë veprimtarinë tregtare në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloret e AMF-së.

KREU IV

ROLI DHE VEPRIMTARIA E DEPOZITARIT

Neni 42

Emërimi i depozitarit

1. Çdo sipërmarrje e investimeve kolektive, për të cilën kërkohet licencë, emëron një depozitar, i cili duhet të jetë i licencuar nga AMF-ja për të vepruar si depozitari i saj. AMF-ja miraton një rregullore, që përcakton procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit.

2. Emërimi i depozitarit dhe çdo ndryshim në emërimin e tij i nënshtrohen miratimit paraprak nga AMF-ja. Kontrata e lidhur ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese, si dhe ndryshimet e mëpasshme hyjnë në fuqi vetëm në datën e miratimit të tyre nga AMF-ja.

Neni 43

Depozitari

1. Depozitar është një bankë e nivelit të dytë, e cila kryen, për nevoja të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, veprimtarinë për ruajtjen e sigurt të grupimeve të aseteve, administrimin e llogarive të posaçme për asetet dhe veçimin e aseteve të çdo SIK-je individuale nga asetet e SIK-ve të tjera, si dhe kryen veprimtari të tjera, të parashikuara në këtë ligj për depozitarin.

2. Vetëm një bankë ose degë e një banke të huaj, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e miratuar nga Banka e Shqipërisë për të qenë edhe depozitar, mund të veprojë si depozitar i sipërmarrjes së investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë.

3. Veprimtaria e depozitarit, sipas këtij ligji, rregullohet nga ky ligj dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tij. AMF-ja ka përparesi në mbikëqyrjen e veprimtarisë së depozitarit.

Neni 44

Karakteristikat bazë të veprimtarisë së depozitarit

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive, e themeluar në përputhje me këtë ligj dhe që kryen veprimtari tregtare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë një depozitar për asetet e saj.

2. Dispozitat e detyrueshme të këtij ligji, të cilat rregullojnë detyrimet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të shoqërive administruese për përdorimin e shërbimeve të depozitarit, zbatohen për të gjitha sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe shoqëritë administruese, që i administrojnë ato.

3. Veprimtaria e mbajtjes së aseteve dhe veprimtari të tjera, të zhvilluara nga depozitari, për shoqërinë administruese, për sa i përket strukturës organizative, duhet të veçohen nga veprimtaria e shoqërisë administruese.

4. Asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përfshirë llogaritë bankare dhe asete të tjera, ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme për çdo SIK, për të cilën ajo kryen veprimtarinë e depozitarit.

5. Depozitari nuk mund t'i përdorë asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë për kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose për të marrë ndonjë përfitim për veten a punonjësit e tij, apo për qëllime të tjera, përveç përfitimit të aksionarëve a mbajtësve të kuotave.

6. Asetet e SIK-ve, që mbahen nga depozitari, kanë të drejtën e veçimit, si dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit.

Neni 45

Veprimi në interes të investitorëve

Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të fondeve dhe aksionarëve të shoqërive të investimit, për të cilët ai kryen veprimtarinë si depozitar.

Neni 46

Detyrat e depozitarit

1. Përveç ruajtjes së një grupimi të veçuar të aseteve të SIK-ve, mbajtjes së llogarive të veçanta për asetet e çdo SIK-je individuale dhe veçimit të aseteve të çdo sipërmarrjeje të tillë nga asetet e SIK-ve të tjera, depozitari kryen edhe veprimtaritë e mëposhtme:

a) në rastin e një fondi investimi, garanton, që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave të realizuara për llogari të fondit të investimit të shoqërisë administruese, janë kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat e fondit;

b) bë rastin e një fondi investimi, riblen, shlyen kuotat dhe bën pagesa në favor të mbajtësve të kuotave në fondin e investimit nga asetet e fondit;

c) garanton që llogaritja e vlerës neto të aseteve të aksioneve ose të kuotave në fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e fondit;

ç) zbaton urdhrat e shoqërisë administruese për transaksionet, që përfshijnë titujt dhe asetet e tjera që përbëjnë portofolin, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj, me

rregulloret e AMF-së, prospektin dhe/ose rregullat e fondit dhe bën të mundur realizimin dhe kryerjen e transaksioneve me titujt, që do të thotë se detyrimet monetare janë arkëtuar brenda kufijve kohorë, ligjorë ose kufijve kohorë të miratuar nga palët;

d) i raporton shoqërisë administruese për veprimet e shoqërisë për asetet e SIK-ve, të cilat i ruan në formë të shkruar ose elektronike dhe, në vijim, zbaton urdhrat e saj;

dh) arkëton të ardhurat dhe përfitimet e tjera përkatëse në dobi të SIK-së dhe që u bashkëngjiten aseteve të tij;

e) siguron se fitimi i SIK-së përdoret në përputhje me këtë ligj, me prospektin dhe/ose rregullat e fondit dhe se të gjitha kostot e paguara nga SIK-ja janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në prospekt dhe/ose rregullat e fondit;

ë) kryen veprimtari të tjera profesionale ose administrative, sipas parashikimeve në kontratën ndërmjet tij dhe shoqërisë administruese ose këshillit të administrimit;

f) mban, për çdo SIK të veçantë, evidenca dhe regjistrime për kryerjen e veprimtarisë si depozitar dhe i rakordon këto të dhëna me të dhënat e evidencave dhe të regjistrimeve të shoqërisë administruese;

g) i raporton AMF-së për çdo shkelje të këtij ligji dhe të kontratës nga shoqëria administruese, në rast se kjo shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje;

gj) u siguron akses në të dhënat dhe llogaritë kontabël, që lidhen me fondin dhe asetet e tij, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe personave të tjerë të autorizuar për kontroll, përfshirë dhe AMF-në;

h) me kërkesë të AMF-së, siguron çdo lloj informacioni për asetet, që mban për një sipërmarrje kolektive investimi, përfshirë, por pa u kufizuar, të dhëna, që provojnë ekzistencën e aseteve.

2. AMF-ja miraton një rregullore për të përshkruar metodën e zbatimit të dispozitave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 47

Përgjegjësia e depozitarit

Depozitari është përgjegjës para shoqërisë administruese, mbajtësve të kuotave në fondet e investimit dhe aksionarëve në shoqëritë e investimit për dëmet e shkaktuara, nëse ai nuk ka arritur të kryejë ose i ka kryer në mënyrë të parregullt veprimtaritë e parashikuara në marrëveshjen e nënshkruar nga shoqëria administruese dhe depozitari ose në këtë ligj, si dhe kur ai ua ka besuar veprimtaritë e tij, plotësisht ose pjesërisht, palëve të treta.

Neni 48

Marrëveshja ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese

1. Depozitari dhe shoqëria administruese lidhin një marrëveshje me shkrim, e cila nënshkruhet nga të dyja palët para noterit.

2. Marrëveshja hartohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe përmban të gjitha detyrimet thelbësore të secilës palë, në përputhje me këtë ligj, ose bën referenca të posaçme ndaj detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj, si dhe është në përputhje me të gjitha rregulloret përkatëse të AMF-së.

Neni 49

Konflikti i interesit për depozitarin dhe shoqërinë administruese

1. Depozitari duhet të veprojë vetëm në interes të mbajtësve të kuotave apo aksionarëve, për të cilët ai kryen veprimtari si depozitar.

2. Siç parashikohet edhe në pikën 3 të nenit 28 të këtij ligji, shoqëria administruese nuk merr pjesë në veprimtarinë tregtare të një depozitari. Veprimtaritë organizuese, drejtuese dhe administruese të depozitarit dhe të shoqërisë administruese nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Në këto detyra nuk përfshihen të njëjtët persona. Shoqëria administruese nuk duhet të jetë një shoqëri e kontrolluar nga depozitari.

Neni 50

Mbyllja e veprimtarisë së depozitarit

1. Shoqërisë administruese nuk i lejohet ta zëvendësojë depozitarin pa miratimin paraprak të AMF-së.

2. Depozitari, që ka për qëllim të mbyllë veprimtarinë si depozitar ose të zgjidhë marrëveshjen për shërbimet depozitare, të lidhura me një ose disa sipërmarrje të veçanta të investimeve kolektive, duhet t'u dërgojë, jo më pak se 60 ditë kalendarike përpara datës së dhënies së njoftimit të mbylljes së veprimtarisë ose njoftimit për zgjidhjen e kontratës, një njoftim, me shkrim, për qëllimin e tij, AMF-së, këshillit të administrimit të çdo shoqërie investimi dhe shoqërisë administruese të fondit të investimit, për të cilin ai kryen veprimtarinë e depozitarit.

3. Në rast se shoqëria administruese e fondit të investimit ose këshilli i administrimit i një shoqërie investimi nuk arrin të lidhë marrëveshje me një depozitar tjetër, brenda 60 ditëve kalendarike, pas marrjes së njoftimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, depozitari, nëse është në gjendje, vazhdon të sigurojë shërbime depozitare edhe për një periudhë tjetër prej 30 ditësh kalendarike.

4. Në përputhje me pikën 3 të këtij neni, nëse një depozitar ndërpret veprimtarinë e tij si depozitar dhe nuk është lidhur ende një marrëveshje me një depozitar tjetër, fondet e investimit dhe shoqëria e investimit, të cilave depozitari u ka siguruar shërbime depozitare, likuidohen, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

5. Shoqëria administruese e fondit të investimit ose këshilli i administrimit i një shoqërie investimi mund ta zëvendësojnë depozitarin me një depozitar tjetër. Depozitari i mëparshëm, jo më vonë se 3 ditë pune pas marrjes së njoftimit, njofton AMF-në, se nuk ka dijeni për shkelje në fuqi apo të pazgjidhura të ligjit ose rregulloreve.

6. Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes, depozitari ia transferon të gjitha asetet e fondeve të investimit dhe/ose të shoqërive të investimit, që ka në ruajtje, një depozitari tjetër, të caktuar për ruajtjen e aseteve, me të cilin shoqëria administruese ose këshilli i administrimit kanë lidhur marrëveshje depozitimi. Depozitari, gjithashtu, i dorëzon depozitarit tjetër librat e llogarive dhe të gjitha regjistrimet, dokumentet dhe materialet e tjera të rëndësishme për kryerjen e veprimtarisë së SIK-ve, për të cilat ai më parë siguronte shërbimet e depozitarit, në formë të shkruar ose elektronike, në varësi të metodës së ruajtjes së të dhënave të mësipërme.

Neni 51

Ndryshimi i adresës

Depozitari njofton AMF-në, me shkrim, të paktën një muaj para, për qëllimin e ndryshimit të adresës së selisë së regjistruar të tij ose të shtetit të përhershëm, ku ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 52

Regjistri i investitorëve

Depozitari krijon dhe mban një regjister të investitorëve të çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen nga AMF-ja. Depozitari, pas miratimit paraprak të AMF-së, mund të caktojë një person tjetër, për të krijuar dhe mbajtur regjistrin për

llogari të tij. Regjistri është dokumenti përmbledhës për personat, të cilëve u janë dhënë respektivisht të drejtat për kuotat apo aksionet, që janë në emër të tyre.

Neni 53

Njoftimi për shkeljet

1. Depozitari duhet të njoftojë AMF-në me shkrim, menjëherë pasi vihet në dijeni për faktin, mospërbushjen, veprimin ose mosveprimin e shoqërisë administruese a të shoqërisë së investimit, që përbën një shkelje ose cenim të ndonjërës prej dispozitave të këtij ligji apo të prospektit dhe/ose rregullave të fondit, dhe për hapat e ndërmarrë nga ai, për të mundësuar që shkelja ose cenimi të ndreqet sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Depozitari zbaton të gjitha udhëzimet e shoqërisë administruese ose të shoqërisë së investimit, përveçse kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se, nëse do të vepronte në këtë mënyrë, do të shkelte dispozitat e këtij ligji.

KREU V

SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

SEKSIONI 1

THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I FONDIT TË INVESTIMIT

Neni 54

Fondi i investimit

1. Fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, i krijuar në bazë të një kontrate, pas licencimit nga AMF-ja, dhe i administruar nga një shoqëri administruese, për grumbullimin e asetëve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave në fond, asetet e të cilit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me këtë ligj dhe mbajtësit e kuotave të të cilit kanë të drejtën, jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por, gjithashtu, të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre. Në këtë mënyrë, kuotat anulohen sipas ligjit.

2. Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së asetëve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie kontraktuale me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të asetëve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

3. Pavarësisht përcaktimit të pikës 2 të këtij neni, blerja e kuotave mund të kryhet edhe duke shpërndarë kuota të reja në bazë të shpërndarjes së pjesës në fitim, domethënë kur vlera e kuotave zvogëlohet në bazë të dhënies së kuotave të reja, ose në çdo rast tjetër, të parashikuar nga rregulloret që miraton AMF-ja.

4. Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Neni 55

Krijimi i fondit të investimit

1. Fondi i investimit mund të krijohet vetëm nga një shoqëri administruese e licencuar, pasi të jetë marrë licenca përkatëse nga AMF-ja.

2. Shoqëria administruese është organi drejtues i fondit të investimit, e cila e administron dhe e përfaqëson atë në lidhje me palët e treta.

3. Vetëm një fond investimi, i krijuar sipas këtij ligji, mund dhe duhet të përdorë shprehjen “Fond investimi” a ndonjë shkurtim të kësaj shprehjeje, në emërtimin e tij, reklamimet ose

materiale të tjera reklamuese a promocionale, apo për qëllime të përshkrimit të veprimtarisë së tij tregtare.

4. Aplikimi për licencë dhe aplikimi për regjistrimin e fondit të investimit në Regjistrin e Fondeve, i cili i paraqitet AMF-së nga shoqëria administruese, në emër të fondit, përmban këto të dhëna:

a) emrin e shoqërisë administruese, informacion për licencën, që i është dhënë shoqërisë administruese nga AMF-ja, si dhe emrin e mbiemrin e personit të autorizuar për të qenë përfaqësues, adresën, numrin telefonit e të faksit, si dhe adresën e e-mail-it të shoqërisë administruese;

b) dokumentet, që vërtetojnë licencën e dhënë nga AMF-ja shoqërisë, si shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

c) emërtimin e fondit dhe objektivat e investimit;

ç) prospektin e fondit;

d) rregullat e fondit;

dh) kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë administruese dhe depozitarit, së bashku me shtojcat, që përfshijnë licencën e Bankës së Shqipërisë, me anë të së cilës i jepet autorizimi depozitarit, për të vepruar si i tillë;

e) emrin e ekspertit kontabël të regjistruar, të emëruar pas miratimit nga AMF-ja, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në rregulloren e AMF-së.

5. AMF-ja shqyrton aplikimin e paraqitur dhe jep vendimin jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së aplikimit të plotë.

6. AMF-ja mund të miratojë rregullore, ku përcaktohen me hollësi kërkesat për lëshimin e licencës, përmbajtjen e detyrueshme të prospektit të fondit të investimit, si dhe të dhëna shtesë, nëse kjo është e nevojshme, për mbrojtjen e interesave të investitorëve.

Neni 56

Fondet ombrellë dhe fondet furnizuese

1. Një fond investimesh mund të funksionojë si fond ombrellë, kur ka një numër fondesh të ndërvarura, që, veçanërisht, mund të zbatojnë politika të ndryshme investimi. Fondet e ndërvarura kanë karakteristikat e mëposhtme:

a) nuk janë të regjistruara si person juridik;

b) kufijtë e investimit, rregullat për marrjen dhe dhënien hua të titujve të parashikuar në këtë ligj zbatohen për çdo fond të ndërvarur më vete;

c) portofoli i investimit të fondit të ndërvarur nuk përfshin kuotat e një fondi tjetër të ndërvarur të të njëjtit fond ombrellë;

ç) asetet e të gjitha fondeve të ndërvarura vlerësohen me të njëjtën shpeshtësi dhe të njëjtat mënyra vlerësimi;

d) fondi ombrellë është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara vjetore dhe gjashtëmujore, që mbulojnë të gjitha fondet e ndërvarura, si dhe pasqyra financiare vjetore dhe gjashtëmujore për secilin fond të ndërvarur.

2. Fondi i investimit mund t'i investojë të gjitha asetet në një fond të vetëm investimi dhe të licencohet si fond furnizues, me kusht që:

a) fondit kryesor të investimeve t'i jetë dhënë licenca nga AMF-ja;

b) rregullat e fondit të përcaktojnë se fondi i investimit është një fond furnizues i fondit kryesor;

c) borxhi i marrë nga fondi furnizues nuk mund të tejkalojë 10 për qind të vlerës neto të aseteve të veta dhe kufizohet vetëm për të lehtësuar shlyerjen e kuotave ose për të paguar shpenzimet operative.

Neni 57

Selia

Selia dhe adresa e fondit të investimeve është ajo e shoqërisë administruese.

SEKSIONI 2

THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË SË INVESTIMIT ME OFERTË PUBLIKE

Neni 58

Shoqëria e investimit

1. Shoqëria e investimit me ofertë publike është shoqëri aksionare, me seli në Republikën e Shqipërisë, e themeluar nga shoqëria e administrimit, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, vetëm pas miratimit paraprak nga AMF-ja. Objekti i veprimtarisë së saj tregtare është investimi i fondeve në tituj dhe asete të tjera, për shpërndarjen e rreziqeve të investimit dhe dhënien aksionarëve të saj të përfitimit të rezultateve të administrimit të këtyre fondeve, ku të drejtat e investorëve përfaqësohen nga aksionet e kësaj shoqërie.

2. Shoqëria e investimit mund të themelohet me afat ose pa afat.

3. Në rregullat e fondit të shoqërisë së investimit përcaktohen edhe objektivat e investimit.

4. Shoqëria e investimit nuk mund të angazhohet në veprimtari të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe as nuk mund të transformohet në një shoqëri holding ose në forma të tjera të ngjashme shoqërisht.

Neni 59

Themelimi i shoqërisë së investimit

1. Aplikimi për licencim dhe aplikimi për regjistrimin e shoqërisë së investimit në Regjistrin e Fondeve, i cili i paraqitet AMF-së nga shoqëria administruese, duhet të përmbajë:

a) emërtimin e shoqërisë administruese, informacionin për autorizimin, që i është dhënë shoqërisë administruese nga AMF-ja, si dhe emrin e mbiemrin e personit të autorizuar për të qenë përfaqësues, adresën, numrat e telefonit dhe të faksit, si dhe adresën e e-mail-it të shoqërisë administruese;

b) dokumentin, që vërteton se kjo shoqëri formohet në përputhje me sistemin e administrimit me dy nivele, sipas ligjit për shoqëritë tregtare;

c) emërtimin e shoqërisë së investimit;

ç) objektivat e investimit të shoqërisë së investimit;

d) emrin e mbiemrin, adresën, numrin e telefonit e të faksit, adresën e e-mail-it të anëtarëve, që marrin pjesë në mbledhjen e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit;

dh) rregullat e fondit që, në këtë rast, përbëjnë statutin e shoqërisë së investimit;

e) prospektin e shoqërisë së investimit;

ë) vendimin për emërimin e anëtarëve të këshillit të parë mbikëqyrës dhe deklaratimet e tyre, me shkrim, për pranimin e emërimit;

f) projektmarrëveshjen ndërmjet këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit dhe shoqërisë administruese;

g) kontratën e përfunduar ndërmjet shoqërisë administruese dhe depozitarit, së bashku me shtojcat, përfshirë edhe licencën e Bankës së Shqipërisë, me anë të së cilës i jepet autorizimi depozitarit për të vepruar si i tillë;

gj) emrin e ekspertit kontabël të regjistruar, kërkesat dhe kriteret e sakta për të cilin përcaktohen në rregulloren e AMF-së. Caktimi i ekspertit kontabël të regjistruar bëhet nga shoqëria administruese, emërimi i të cilit miratohet nga AMF-ja;

h) aplikimin për pranimin e aksioneve të shoqërisë së investimit në listimet zyrtare në bursë ose në një treg tjetër të rregulluar, të hapur për publikun, si dhe një konfirmim me shkrim për bursën përkatëse se aksionet e shoqërisë së investimit, duke u nisur nga aplikimi, i përmbushin kërkesat e listimit.

2. AMF-ja shqyrton aplikimin e paraqitur dhe jep vendim jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së aplikimit të plotë.

3. AMF-ja miraton një rregullore, ku përcaktohen me hollësi kërkesat për përmbajtjen e detyrueshme të aplikimit, rregullat e fondit, prospektet dhe kontratat e shoqërisë së investimit, si dhe të dhëna shtesë, nëse kjo është e nevojshme, për mbrojtjen e interesave të investitorëve.

Neni 60

Kapitali i regjistruar dhe aksionet e shoqërisë së investimit

1. Shuma minimale e kapitalit të regjistruar duhet të jetë të paktën 40 000 000 lekë.

2. Aksionet e shoqërisë së investimit paguhen plotësisht para regjistrimit të shoqërisë së investimit në Regjistrin e Fondeve dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose përpara regjistrimit të zmadhimit të kapitalit të regjistruar.

3. Aksionet e zakonshme të shoqërisë së investimit janë aksione të regjistruara, që u japin aksionarëve të drejta të barabarta, siç parashikohet nga ligji, prospekti dhe rregullat e fondit.

4. Shoqëria e investimit nuk duhet të emetojë lloje të tjera titujsh, përveç aksioneve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Aksionet e një shoqërie investimi pranohen në listimet zyrtare të bursës ose të tregut tjetër, të rregulluar e të hapur për publikun, të njohur e të miratuar nga AMF-ja.

Neni 61

Kostot e shoqërisë së investimit

1. Kostot dhe pagesat e lidhura me themelimin e shoqërisë së investimit mund të shlyhen duke debituar asetet e shoqërisë së investimit, vetëm nëse kjo është përcaktuar në prospekt dhe rregullat e fondit. Shuma maksimale e kostove dhe e pagesave të themelimit, që do të shlyhen nëpërmjet debitimit të aseteve të shoqërisë së investimit, shprehen në prospekt si përqindje e aseteve monetare të paguara në shoqërinë e investimit me themelimin e saj. Çdo kosto dhe pagesë tjetër e lidhur me themelimin, që tejkalon përqindjen e përcaktuar në këtë mënyrë, merret përsipër nga shoqëria administruese ose këshilli i mbikëqyrjes, që i ka kryer.

2. Nëse shoqëria e investimit nuk arrin vlerën minimale të kapitalit të regjistruar, kostot e pagesat për themelimin u ngarkohen themeluesve, që kanë miratuar rregullat e fondit dhe pjesëmarrjet, monetare ose të ngjashme, u kthehen të plota investitorëve.

3. Kostot dhe pagesat e lidhura me themelimin, të cilat shlyhen nga asetet e shoqërisë së investimit, nuk mund të tejkalojnë 3,5 për qind të totalit të aseteve të mbledhura, duke emetuar aksione.

4. Për sa u përket kostove të tjera, vetëm kostot e mëposhtme mund të paguhen nga asetet e shoqërisë së investimit:

a) tarifa e shoqërisë administruese, e cila do të jetë si përqindje e vlerës neto mesatare vjetore të aseteve të shoqërisë së investimit dhe do të pasqyrohet në kontratën ndërmjet shoqërisë së investimit e shoqërisë administruese e në prospektin e shoqërisë së investimit, e mund të zbritet si kosto vjetore nga asetet e shoqërisë së investimit, si dhe do të llogaritet në çdo llogaritje të vlerës neto të aseteve të shoqërisë së investimit;

b) tarifa për depozitarin;

c) tarifat dhe kostot e këshillit mbikëqyrës;

ç) kostot, komisionet ose pagesat, që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose shitjen e aseteve të shoqërisë së investimit;

- d) kostot e pranimi për listim në bursë ose në një treg tjetër të rregulluar;
- dh) kostot e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të avokatëve, të bëra gjatë kryerjes së veprimtarisë së shoqërisë së investimit;
- e) kostot e përgatitjes, shtypjes dhe tarifave postare për publikimin dhe dërgimin e raporteve që, në përputhje me këtë ligj, u dërgohen aksionarëve;
- ë) kostot e mbajtjes së asamblesë së përgjithshme, përveç rastit kur shoqëria administruese thërret asamblenë e përgjithshme të jashtëzakonshme dhe, në këtë rast, kostot përballohen nga kjo shoqëri;
- f) të gjitha tarifat dhe pagesat e parashikuara, që i janë paguar AMF-së, për dhënien e licencës shoqërisë së investimit;
- g) kostot e pranimi në listën zyrtare të bursës ose të një tregu të rregulluar publik;
- gj) tatimi mbi asetet dhe/ose fitimin e vendosur për shoqërinë e investimit;
- h) koston e reklamimit, por vetëm kur kjo është e detyrueshme për shoqërinë e investimit, në bazë të këtij ligji;
- i) kosto të tjera, siç janë parashikuar nga ligje të posaçme.
5. Tarifa e shoqërisë administruese, parashikuar në shkronjën “a” të pikës 4 të këtij neni, nuk duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që ajo të varet nga efektiviteti i veprimtarisë së shoqërisë së investimit.
6. Vetëm kostot e përcaktuara nga prospekti i shoqërisë së investimit mund të paguhen, duke debituar asetet e shoqërisë së investimit.
7. Shuma totale e të gjitha kostove të pasqyruara në libra, duke debituar shoqërinë e investimit, shprehet si një vlerë totale shpenzimi dhe llogaritet për çdo vit të mëparshëm në mënyrën e mëposhtme:

$$\frac{(\text{Tarifa totale e administrimit} + \text{shuma totale e të gjitha kostove të tjera, parashikuar në këtë nen, minus kostot e parashikuara në pikën 4 shkronjat “g” dhe “h” të këtij neni})}{\text{Vlera neto mesatare vjetore e aseteve}} \times 100$$

Kjo shumë publikohet në pasqyrat e audituara financiare të shoqërisë së investimit.

8. Vlera totale e kostove të shoqërisë së investimit nuk mund të tejkalojë 3,5 për qind të vlerës neto mesatare vjetore të shoqërisë së investimit. Pas kalimit të periudhës vjetore financiare, AMF-ja publikon, çdo vit, një përmbledhje krahasimore të vlerave totale të kostove për të gjitha shoqëritë e investimit.

9. Të gjitha kostot e ndeshura, të cilat në një vit të veçantë tejkalojnë vlerën totale të lejuar të shpenzimeve prej 3,5 për qind, merren përsipër nga shoqëria administruese.

Neni 62

Këshilli mbikëqyrës

- Këshilli mbikëqyrës i një shoqërie investimi duhet të ketë të paktën 5 anëtarë.
- Një maksimum prej 40 për qind të numrit të plotë të anëtarëve të keshillit mbikëqyrës të një shoqërie investimi mund të jenë punonjës ose persona të lidhur me shoqërinë administruese apo persona, të cilët, në dy vitet e fundit, kanë lidhur një kontratë për sigurimin e shërbimeve me shoqërinë e investimit, përfshirë dhe ekspertët kontabël të autorizuar, avokatët dhe noterët.
- Anëtarët e tjerë të keshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit me ofertë publike duhet jenë të pavarur, pra ata nuk mund të jenë:
 - të punësuar në shoqërinë administruese, depozitarë, ekspertë kontabël ose persona, të cilëve u është dhënë një licencë e vlefshme nga AMF-ja, për të qenë komisionerë ose këshilltarë investimi dhe që, efektisht, kryejnë këto veprimtari si punonjës të një shoqërie komisionere ose

të një banke të autorizuar për transaksionet me titujt, apo persona, të cilët, në dy vitet e fundit, kanë lidhur një kontratë për ofrimin e shërbimeve me çdonjërin prej tyre;

b) të punësuar te subjektet, që janë të lidhur me personat e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, ose me personat e afërt të tyre.

Neni 63

Personat që nuk mund të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës

Nuk mund të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit:

a) anëtarët e këshillit administrativ ose të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë administruese, të depozitarit, shoqërisë komisionere ose të një banke të autorizuar për transaksionet e kuotave, shoqërisë së sigurimit, fondit privat të pensioneve, të cilët e kanë mbajtur pozicionin në kohën kur këtyre shoqërive u është hequr licenca edhe deri në tre vjet pas heqjes së licencës;

b) personat, që kanë humbur statusin e anëtarit në një shoqatë profesionale, për shkak të shkeljes së rregullave të shoqatës, ose të cilëve AMF-ja u ka hequr licencën e transaksioneve me titujt;

c) personat e shpallur fajtorë me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundër pronës, sigurisë së veprimit të transaksioneve të pagesave ose falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, një vit pas marrjes formë të prerë të vendimit, ku nuk llogaritet koha e vuajtjes së dënimit;

ç) personat e shpallur fajtorë me vendim gjyqësor të formës së prerë, për përdorimin e paautorizuar dhe përhapjen e informacionit sekret, manipulimin e çmimeve dhe shpërndarjen e informacionit të rremë, pasqyrimin e të dhënave të rreme në prospekt dhe shpërndarjen e paautorizuar të tij, listimin e paautorizuar të titujve, fshehjen e informacionit për pronësinë dhe tregtimin e paautorizuar të titujve, siç është parashikuar në ligjin “Për titujt”, një vit pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë, ku nuk llogaritet koha e vuajtjes së dënimit;

d) personat e shpallur fajtorë me vendim gjyqësor të formës së prerë, për një vepër të parashikuar nga ligji “Për titujt”, për një vit pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë;

dh) personat nën masa sigurimi, të cilat i ndalojnë të kryejnë veprimtarinë tregtare, që është, tërësisht ose pjesërisht, pjesë e objektit të veprimtarisë së shoqërisë së investimit/shoqërisë administruese, për periudhën gjatë së cilës është në fuqi ndalimi;

e) çdo person që nuk ka zotësi juridike për të vepruar;

ë) personat, të cilët aktualisht mbajnë një post në shërbimin publik dhe janë nëpunës qeveritarë ose nëpunës të autoriteteve qeverisëse, vendore a rajonale, apo të autoriteteve përgjegjëse para Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose Kuvendit të Shqipërisë.

Neni 64

Afati i emërimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të një shoqërie investimi emërohen për një periudhë maksimale prej katër vjetësh, me të drejtë riemërimi.

Neni 65

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Shuma totale e shpërblimit dhe kostot e paguara për anëtarët e këshillit mbikëqyrës, si dhe numri dhe vlera e të gjitha aksioneve në shoqërinë e investimit, të mbajtura nga një anëtar i caktuar i këshillit mbikëqyrës, pasqyrohen në raportin vjetor financiar të shoqërisë së investimit. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk lejohen të marrin ndonjë shpërblim nga emetuesit e titujve, në të cilët shoqëria e investimit investon asetet e saj, përveç shpërblimit që u takon në bazë të kontratës së punës/marrëveshjes së shërbimit.

Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit me ofertë publike, përveç kompetencave të këshillit mbikëqyrës, dhënë në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare, përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë e investimit në lidhje me shoqërinë administruese. Përveç kësaj, këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për sa më poshtë:

- a) dhënien e miratimit për lidhjen e një kontrate me personat, që sigurojnë shërbime për shoqërinë e investimit. Këto kontrata nuk mund të lidhen për një periudhë më të gjatë se tre vjet;
- b) mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, ku këshilli mbikëqyrës ka të drejtë ta zgjidhë kontratën në rast të një mospërmbushjeje të saj, rast në të cilin asnjëra nga pagesat, të cilat duhet të shlyhen si rezultat i kësaj zgjidhjeje, nuk mund të tejkalojnë shumën e tre muajve shpërblim, të parashikuar nga kontrata e zgjidhur;
- c) mbikëqyrjen e përputhshmërisë së veprimtarisë tregtare me dispozitat e këtij ligji, prospektin e shoqërisë së investimit, si dhe me objektivat e kufizimet e investimit të shoqërisë së investimit;
- ç) dhënien e miratimit për vendimin, që do të propozohet për shlyerjen e aksioneve, emetimin e aksioneve dhe ristrukturimin e shoqërisë së investimit në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së investimit;
- d) njoftimin e AMF-së për çdo moszbatim të këtij ligji dhe të rregulloreve përkatëse nga shoqëria administruese dhe depozitari;
- dh) përcaktimin e raporteve financiare të shoqërisë së investimit, me propozimin e shoqërisë administruese.

Rasti i heqjes së licencës së shoqërisë administruese dhe depozitarit

1. Në rastin e heqjes së licencës së shoqërisë administruese ose në rast se ndodh ndonjë rrethanë tjetër, që ndalon kryerjen e vazhdueshme të veprimtarive të administrimit të një shoqërie investimi, këshilli mbikëqyrës, jo më vonë se 60 ditë kalendrike pas shfaqjes së këtyre rrethanave, duhet të nënshkruajë një marrëveshje me një shoqëri tjetër administrimi, në përputhje me parashikimin e nenit 68 të këtij ligji. Në të kundërt, këshilli mbikëqyrës thërret asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së investimit.

2. Në rast të heqjes së autorizimit të depozitarit të shoqërisë së investimit ose në rast se ndodh ndonjë rrethanë tjetër, që ndalon vazhdimësinë e veprimtarive kontraktuale, këshilli mbikëqyrës, jo më vonë se 60 ditë kalendrike pas shfaqjes së këtyre rrethanave, nënshkruan një marrëveshje me një depozitar tjetër. Në të kundërt, këshilli mbikëqyrës thërret asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Administrimi i shoqërisë së investimit me ofertë publike

1. Këshilli i administrimit i shoqërisë administruese ka autoritet, caktohet e vepron si këshill i administrimit të shoqërisë së investimit, si dhe e administron fondin në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë administruese dhe shoqërisë së investimit, që përfaqësohet nga këshilli i saj mbikëqyrës, mbështetur në dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret përkatëse.

2. AMF-ja miraton një rregullore, ku përcaktohet me hollësi përmbajtja e detyrueshme e marrëveshjes, që do të lidhet ndërmjet shoqërisë administruese dhe shoqërisë së investimit, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Shoqëria administruese është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër sipas marrëveshjes, parashikuar në pikat 1 e 2 të këtij neni, pavarësisht nëse ajo i përmbush këto

detyrime, drejtpërdrejt ose me anë të një pale të tretë, siç është e lejuar në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 69

Politika e investimit

Dispozitat e seksionit 6 të kreut V të këtij ligji për politikat e investimit janë të zbatueshme për të gjitha shoqëritë e investimit me ofertë publike, duke marrë parasysh ndryshimet e nevojshme të bëra.

Neni 70

Asambleja e përgjithshme

1. Për kompetencat, mbledhjen dhe mbajtjen e asamblesë së përgjithshme zbatohen dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare.

2. Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm aksionarët, që zotërojnë të paktën 3/10 e kapitalit të regjistruar të shoqërisë së investimit, me të drejtë vote.

3. Asambleja e përgjithshme, në bazë të votave, që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit të regjistruar, me të drejtë vote, të aksionarëve të pranishëm, miraton vendimet e mëposhtme:

a) zmadhimin e tarifës vjetore të shoqërisë administruese përtej shumës së përcaktuar në prospektin në fuqi;

b) ndryshimin në objektivat e investimit të shoqërisë së investimit, krahasuar me objektivat e pasqyruar në prospekt;

c) blerjen e aksioneve të shoqërisë së investimit, me qëllim shlyerjen e tyre;

ç) nëse shoqëria e investimit është themeluar për një periudhë të përcaktuar kohe, zgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së investimit përtej periudhës së pasqyruar në prospekt;

d) bashkimin dhe shkrirjen në një fond tjetër ose ndarjen e shoqërisë së investimit.

SEKSIONI 3

PROSPEKTI I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 71

Prospekti i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike

1. Ky seksion zbatohet njëloj për të gjitha sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike konsiderohet ftesë për blerjen e kuotave në një fond investimi ose të aksioneve në një shoqëri investimi.

Neni 72

Parimi i saktësisë

Informacioni i pasqyruar në prospekt duhet të jetë i saktë dhe i plotë.

Neni 73

Përmbajtja e prospektit

1. Prospekti duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët të jenë në gjendje të bëjnë vlerësimin e duhur të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe, në veçanti, të rreziqeve që lidhen me të.

2. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

A. Informacionin për sipërmarrjen si më poshtë:

a) emërtimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, duke treguar llojin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe emrat dhe një biografi të shkurtër të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, në rastin e një shoqërie investimi;

b) datën e themelimit të sipërmarrjes dhe kohëzgjatjen, nëse është me afat;

c) deklarin e vendit se ku mund të përftohen raportet gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe ku mund të merret një kopje e rregullave të fondit, prospekti i plotë ose informacione shtesë për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

ç) shumën minimale të aseteve, që pritet të grumbullohen dhe veprimtaritë që do të kryhen, nëse nuk është arritur shuma minimale e aseteve;

d) emrin e ekspertit kontabël të autorizuar të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

dh) të drejtat, që lidhen me kuotat ose aksionet e sipërmarrjes së investimeve kolektive, si:

i) e drejta e votës në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së investimit;

ii) e drejta e informacionit (raportet gjashtëmujore dhe vjetore);

iii) e drejta për dividendë ose pjesë të fitimit;

iv) e drejta për shlyerjen e kuotave në fondin e investimit;

v) e drejta për të përfituar pagesë nga pjesa e mbetur e pasurisë nga procesi i likuidimit ose falimentimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

e) rrethanat, në të cilat mund të vendoset mbyllja dhe procedura e mbylljes së sipërmarrjes së investimeve kolektive;

ë) në rastin e një shoqërie investimi, të dhëna për bursën ose bursat, ku do të listohen aksionet e shoqërisë së investimit;

f) llojet e aseteve, ku sipërmarrjes së investimeve kolektive i lejohet të bëjë investime;

g) përshkrimin e objektivave të investimit dhe strukturën e planifikuar të portofolit të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mënyrën e arritjes së objektivave të kësaj sipërmarrjeje të investimeve kolektive dhe rreziqet, që lidhen me investimet dhe strukturat e sipërmarrjes së investimeve kolektive, shpjegimi i të cilave (rreziqeve) është i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm;

gj) deklaratën, nëse i lejohet të investojë në kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata mundësie (opsione), si dhe instrumente të tjera financiare derivative dhe, në rast se ky lloj investimi është i lejuar, duhet të përmendet nëse këto transaksione do të kryhen për shmangien e rreziqeve apo për arritjen e objektivave të investimit, si dhe cili është efekti i këtyre transaksioneve në nivelin e rrezikut të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

h) listën e shteteve, të njësive të qeverisjes vendore ose të organizatave ndërkombëtare, në titujt dhe instrumentet e tregut të parasë të të cilave mund të investohen më shumë se 35 për qind të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

i) deklaratën se objektivi i investimit është replikimi i një indeksi, në rast se sipërmarrja e investimeve kolektive ka qëllim të replikojë një indeks aksionesh ose instrumentesh borxhi;

j) shumën minimale të investimeve të veçanta të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mënyrën e nënshkrimit të aksioneve ose kuotave dhe për fondin e investimit me ofertë publike, mënyrën dhe kushtet e shlyerjes së kuotave;

k) metodën dhe kohën e vlerësimit të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

l) nëse vlera neto e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive do të jetë shumë e paqëndrueshme dhe e luhatshme për sa i përket përbërjes së portofolit të sipërmarrjes së investimeve kolektive, për shkak të teknikave të administrimit të aseteve të kësaj sipërmarrjeje, deklaratën që tregon këto karakteristika të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

ll) në rastin e një fondi investimi, kohën, metodën dhe frekuencën e llogaritjes së çmimit për shitjen e kuotave të reja ose shlyerjen e atyre ekzistuese dhe mjetet e publikimit të këtyre çmimeve, rrethanat në të cilat emetimi ose shlyerja mund të pezullohen, përshkrimin e shumës

dhe frekuencën e pagesës së tarifave dhe të kostove të lejuara për emetimin dhe shlyerjen e kuotave;

m) në rastin e një shoqërie investimi, shumën, llojin dhe kufijtë e kostove të themelimit për t'u paguar nga shoqëria e investimit;

n) në rastin e çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive, tarifat vjetore dhe kostot e administrimit e kostot operative, që mund t'i ngarkohen sipërmarrjes dhe përshkrimin e efektit të tyre në të ardhurat e investitorëve në të ardhmen;

nj) të dhëna për mënyrën e përlogaritjes, mjetet dhe frekuencën e shpërndarjes së pjesës së fitimit ose të dividendëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive tek aksionarët ose mbajtësit e kuotave;

o) sqarim të shkurtër për taksat, që aplikohen për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

p) performancën në të kaluarën të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe profilin e investitorit tipik, të cilit i adresohet sipërmarrja e investimeve kolektive;

q) datën e përfundimit të vitit fiskal;

r) datën e publikimit të prospektit.

B. Informacionin për shoqërinë administruese si më poshtë:

a) emërtimin e shoqërisë dhe formën ligjore, selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore, nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numrin e licencës të dhënë nga AMF-ja, si dhe datën e themelimit e të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

b) nëse shoqëria administruese administron sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike, një listë të tyre;

c) emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit, biografite të tyre të shkurtra dhe të dhëna treguese, nëse kanë, në ndonjë mënyrë, lidhje me njëri-tjetrin;

ç) shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese dhe emrat e aksionarëve të shoqërisë administruese, formën ligjore dhe pjesëmarrjen e aksionarëve në kapitalin e regjistruar.

C. Emrat, format ligjore, datat e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe tek AMF-ja, si dhe rolin e shoqërive, që veprojnë si këshilltarë investimi të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe emrin e kryetarit të këshillit të administrimit ose të personave të tjerë përgjegjës në këto shoqëri.

Ç. Në rastin e një fondi investimi, parashikuar në nenin 37 të këtij ligji, në prospekt duhet të përmendet vendi në Republikën e Shqipërisë, ku investitorët vendas mund të pajisen me informacion dhe ku mund të blejnë apo të shesin kuotat ose aksionet e sipërmarrjes përkatëse të investimeve kolektive. Ky informacion duhet të publikohet në gjuhën shqipe.

D. Informacion për depozitarin, që përfshin emërtimin e shoqërisë, formën ligjore, selinë dhe adresën e këshillit të administrimit të depozitarit, si dhe numrat dhe të dhënat për licencat e lëshuara nga Banka e Shqipërisë dhe AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë si i tillë.

DH. Informacion lidhur me konfliktin e interesave, i cili i është dhënë AMF-së.

Neni 74

Miratimi dhe publikimi i prospektit

1. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikimit, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji, pas paraqitjes së aplikimit, AMF-ja duhet të miratojë çdo prospekt të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, para fillimit të ofertës publike për nënshkrimin e aksioneve ose të kuotave, si dhe duhet të miratojë, paraprakisht, ndryshimet në prospektet ekzistuese, të cilat janë bërë për shkak të ndryshimeve thelbësore. Nëse brenda periudhës së parashikuar, AMF-ja nuk arrin të marrë vendimin për miratimin e aplikimit të prospektit, ky i fundit ose ndryshimet e tij konsiderohen të miratuara.

2. Nuk lejohet tregtimi nëpërmjet një oferte publike i aksioneve ose i kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, para miratimit nga AMF-ja të prospektit të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

3. Shoqëria administruese, jo më vonë se 7 ditë kalendarike, nga data e miratimit nga AMF-ja, publikon prospektin në gazetën e përditshme, të shitura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. AMF-ja mund ta miratojë përgatitjen dhe shpërndarjen e prospektit në një formë të thjeshtuar (prospekt i thjeshtëzuar) vetëm për nevojën e një fondi investimi, me kusht që të bëhet një deklaratë e qartë dhe e hollësishme për ekzistencën e prospektit të plotë, i cili mund të sigurohet pas një kërkesë.

5. Kushtet dhe kriteret e përcaktuara në prospektin e thjeshtëzuar nuk duhet të ndryshojnë nga kushtet dhe kriteret e përmbajtura në prospektin e plotë. Prospekti i thjeshtëzuar duhet të shkruhet në një mënyrë që të kuptohet lehtë nga investitori i zakonshëm. Kërkesat e detyrueshme të prospektit të thjeshtëzuar mund të përcaktohen me një rregullore të AMF-së.

6. Elementet thelbësore të prospektit të plotë dhe atij të thjeshtëzuar përditësohen rregullisht.

7. Prospekti i plotë dhe ai i thjeshtëzuar publikohen, minimalisht, në gjuhën shqipe dhe i shpërndahen falas investorëve aktualë dhe/ose atyre potencialë.

Neni 75

Shpeshtësia e publikimit të prospektit

1. Në rastin e një shoqërie investimi, prospekti përgatitet dhe i paraqitet AMF-së për miratim në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe më tej për çdo emetim vijues.

2. Në rastin e një fondi investimi, çdo prospekt i ri përgatitet dhe i paraqitet për miratim AMF-së, si dhe sa herë që ka ndryshime thelbësore në prospekt, siç është parashikuar në pikat 1 e 2 të nenit 76 të këtij ligji dhe në raste të tjera, të parashikuara nga ky ligj.

3. AMF-ja mund të miratojë rregulla për përmbajtjen, publikimin dhe miratimin e prospekteve të plota dhe të thjeshtëzuara.

Neni 76

Ndryshimet në prospektin e një fondi investimi

1. Ndryshimet në prospektet e fondeve të investimit propozohen me qëllim:

a) zmadhimin e tarifave të hyrjes, të tarifave vjetore të administrimit ose tarifave të largimit;

b) ndryshimin e objektivave të investimit të fondit dhe për risqet e lidhura me investimet e parashikuara të fondit të investimit;

c) ndryshimin në politikën e shpërndarjes së fitimit;

ç) shkriren dhe bashkimin në një fond tjetër investimi ose ndarjen e fondit, të cilat u nënshtrohen miratimit paraprak nga AMF-ja dhe kërkesave të mëposhtme:

i) njoftimi për ndryshimet e propozuara duhet t'u dërgohet drejtpërdrejt, me postë, të gjithë mbajtësve të kuotave dhe publikohet në një gazetë të përditshme, që shitet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të paktën një herë në dy javë, gjatë një periudhe dymujore, para datës së zbatimit të ndryshimeve;

ii) të gjithë mbajtësit e kuotave duhet të njoftohen për faktin se ata kanë të drejtë të kërkojnë nga fondi një shlyerje të kuotave të tyre, pa zbritur ndonjë tarifë largimi, që zbatohet normalisht para zbatimit të ndryshimeve, së bashku me një njoftim për datën e shlyerjes;

iii) shlyerja e të gjitha kuotave, sipas kërkesës së marrë, kryhet para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në prospekt.

2. Përveç ndryshimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, edhe ndryshimet, që lidhen me anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë administruese, depozitarin ose ekspertët kontabël të autorizuar të fondit të investimit, i nënshtrohen miratimit paraprak nga AMF-ja.

SEKSIONI 4
RREGULLAT E FONDIT PËR SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE
ME OFERTË PUBLIKE

Neni 77

Përkufizimi i rregullave të fondit

1. Rregullat e fondit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike rregullojnë marrëdhëniet ligjore ndërmjet shoqërisë administruese dhe mbajtësve të kuotave/aksioneve.
2. Rregullat e fondit i bashkëngjiten prospektit të sipërmarrjes dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Nuk është e nevojshme që rregullat e fondit t'i bashkëngjiten prospektit, kur prospekti parashikon se mbajtësit e kuotave ose të aksioneve pajisen me rregullat e fondit, pas bërjes së një kërkesë, ose kur ai specifikon vendin se ku mund të sigurohen për shqyrtim rregullat e fondit.
4. Informacioni i dhënë në rregullat e fondit duhet të jetë i saktë dhe i plotë.

Neni 78

Përmbajtja e rregullave të fondit

Përveç rastit kur të dhënat e parashikuara në këtë nen janë pasqyruar tashmë në prospektin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, rregullat e fondit duhet të përmbajnë, minimalisht, edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe llojin e sipërmarrjes;
- b) datën e themelimit të sipërmarrjes dhe kohëzgjatjen, kur ajo është themeluar për një periudhë të caktuar kohore;
- c) vendin, ku mund të sigurohen raportet gjashtëmujore ose vjetore dhe ku mund të merret një kopje e prospektit ose çdo informacion tjetër shtesë për sipërmarrjen;
- ç) shumën minimale dhe maksimale të aseteve monetare, që synohet të grumbullohet dhe veprimet, që do të ndërmerren në rast se nuk arrihet shuma e caktuar minimale;
- d) deklaratën e kujdestarisë ku shprehet se:
 - i) pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive, përveç shumave që mbahen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë, ruhet nga depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e aksioneve ose të kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor;
 - ii) shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë, mbahen nga depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje;
 - iii) cila është monedha bazë e fondit;
 - iv) datat në vitin kalendarik, në të cilin fillon dhe mbaron viti financiar, i cili, në rastin e një fondi ombrellë, duhet të jetë i njëjtë për të gjitha fondet e ndërruarura përbërëse;
 - v) data në vitin kalendarik, që është jo më vonë se dy muaj pas datës, në të cilën mbaron periudha paraardhëse e kontabilitetit vjetor dhe që është data e deklarimit të shpërndarjes të së ardhurave vjetore që, në rastin e një fondi ombrellë, është e njëjtë për të gjitha nënfondet përbërëse;
- dh) të drejtat, që burojnë nga kuotat ose aksionet, si:
 - i) e drejta për të votuar në asamblenë e përgjithshme të një shoqërie investimi;
 - ii) e drejta për informacion (raportet gjashtëmujore dhe vjetore);
 - iii) e drejta për dividend ose pjesë në fitimin e shoqërisë;
 - iv) e drejta për të shitur aksionet ose kuotat të sipërmarrja dhe detyrimi i kësaj të fundit për të shlyer kuotën apo për të blerë aksionin;
 - v) e drejta për t'u paguar nga pjesa, që ka mbetur nga asetet pas likuidimit ose falimentimit;

e) në rastin e një shoqërie investimi, informacionin për bursën/bursat, në të cilat do të tregtohen aksionet;

ë) përshkrimin e objektivave të investimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe natyrën e portofoleve të sugjeruara ose ekzistuese, duke specifikuar sektorët e ekonomisë, mënyrën me të cilën mund të arrihen këta objektiva, dhe rreziqet, që lidhen me investimet dhe strukturat e sipërmarrjes së investimeve kolektive;

f) nëse ndonjëri nga objektivat e sipërmarrjes është një investim me natyrë specifike, deklarimin e këtij fakti dhe karakteristikat e kësaj natyre specifike;

g) shumën minimale, që mund të investohet nga çdo investitor, mënyrën e shlyerjes së kuotave dhe informacionin për mënyrën e llogaritjes dhe shpeshtësinë e shpërndarjes së fitimit të fondit të investimit të mbajtësit të kuotave;

gj) deklaratën se objektivi i investimit është replikimi i një indeksi, në rast se sipërmarrja e investimeve kolektive ka qëllim të replikojë një indeks aksionesh ose instrumentesh borxhi;

h) në rastin e një fondi investimesh: tarifat vjetore, kostot e administrimit dhe kostot operative, që mund t'i ngarkohen fondit, si dhe përshkrimin e efektit të tyre në të ardhurat e investitorëve në të ardhmen;

i) në rastin e fondeve ombrellë, në lidhje me vendosjen e tarifës për shkëmbimin e kuotave, një deklaratë, që autorizon shoqërinë administruese të një fondi ombrellë për të vendosur një tarifë fikse për shkëmbimin e kuotave ndërmjet fondeve të ndërruara (përveç këmbimit të parë, të bërë nga një investitor në secilin vit financiar) dhe specifikimin se cili është maksimumi i kësaj tarife;

j) informacionin për mënyrën e llogaritjes, si dhe mënyrën e frekuencën e shpërndarjes së dividendëve në një shoqëri investimi tek aksionarët e shoqërisë;

k) sqarim të shkurtër për tatimet dhe taksat, që vendosen për sipërmarrjen e investimeve kolektive;

l) kohëzgjatjen e vitit financiar;

ll) datën e publikimit të rregullave të fondit;

m) të dhënat për shoqërinë administruese si më poshtë:

i) emërtimin e shoqërisë, formën ligjore, selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore, nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numrin e licencës të dhënë nga AMF-ja, si dhe datën e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

ii) në rast se shoqëria administruese administron sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike, listën e këtyre sipërmarrjeve;

iii) emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit, biografite të tyre të shkurtra dhe të dhëna treguese, nëse ata kanë, në ndonjë mënyrë, lidhje me njëri-tjetrin;

iv) shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese dhe emrat e aksionarëve të shoqërisë administruese, formën ligjore dhe treguesin e pjesëmarrjes së aksionarëve në kapitalin e regjistruar;

v) emërtimet, format ligjore, datat e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe tek AMF-ja, si dhe rolin e shoqërive, që veprojnë si këshilltarë investimi të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe emrin e kryetarit të këshillit të administrimit ose të personave të tjerë përgjegjës në këto shoqëri.

n) në rastin e një fondi investimi, parashikuar në nenin 37 të këtij ligji, në prospekt duhet të përmendet vendi në Republikën e Shqipërisë, ku investitorët vendas mund të pajisen me informacion dhe ku mund të blejnë apo të shesin kuotat ose aksionet e sipërmarrjes përkatëse të investimeve kolektive. Ky informacion duhet të publikohet në gjuhën shqipe;

nj) informacionin për depozitarin, që përfshin emërtimin e shoqërisë, formën ligjore, selinë dhe adresën e këshillit të administrimit të depozitarit, si dhe numrat dhe informacionet për licencat e dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë si i tillë.

SEKSIONI 5
PROMOVIMI I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE
ME OFERTË PUBLIKE

Neni 79

E drejta për të promovuar sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike

Veprimtaritë promocionale të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të administruara nga shoqëritë administruuese, mund të ndërmerren dhe të kryhen vetëm nga:

- a) një shoqëri administruuese e licencuar, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
- b) një shoqëri administruuese e licencuar, me seli të regjistruar në një shtet të Bashkimit Europian ose në një shtet të lejuar nga AMF-ja.

Neni 80

Parimi i saktësisë

1. Para se të publikohet, i gjithë informacioni promocional për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike dhe shoqëritë, që i administrojnë ato, kryesisht, që lidhet me kuotat apo aksionet, operacionet financiare dhe të drejtat e mbajtësve të kuotave dhe/ose të aksionarëve të shoqërisë së investimit, i paraqitet për miratim AMF-së.

2. Shoqëria administruuese është përgjegjëse për integritetin dhe saktësinë e informacionit të publikuar për qëllime të promovimit të fondit të investimit.

3. Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë së investimit dhe këshilli i administrimit i shoqërisë administruuese janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për integritetin dhe saktësinë e informacionit të publikuar për qëllime promovimi të shoqërisë së investimit.

Neni 81

Kushtet e promovimit dhe publikimi i të dhënave

Informacioni promocional për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike mund t'u komunikohet personave të tretë nëpërmjet shtypit, reklamave në radio dhe televizion, me anë të takimit personalisht të personave, komunikimit telefonik, internetit dhe medias elektronike, si dhe nëpërmjet televizionit interaktiv, ku në mjetet e mundshme të komunikimit të medias përfshihen, gjithashtu:

- a) broshurat;
- b) reklamat në gazeta dhe revista, në radio, televizion dhe internet;
- c) posta e rregullt ose elektronike, mesazhet me faks ose forma të tjera të dërgimit të postës;
- ç) tregtimi përmes telefonit, përfshirë përdorimin e një ofruesi të specializuar të shërbimeve të tregtimit telefonik në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me shoqërinë administruuese;
- d) letrat, komunikimet telefonike ose kontaktet personale;
- dh) mjetet e promocionit të shitjeve me elemente të stimujve financiarë;
- e) publikime investimi ose publikime të tjera, që ofrojnë rekomandime të përgjithshme investimi, përfshirë dhe blerjet, pjesëmarrjen ose shitjet e investimeve;
- ë) paraqitja në një grup të madh njerëzish (20 ose më shumë);
- f) metodat ose mjetet e tjera të komunikimit, të cilat personat juridikë ose fizikë në Republikën e Shqipërisë mund t'i lexojnë, t'i shohin ose t'i marrin.

Neni 82

Ruajtja e kopjeve të materialeve promocionale

1. I gjithë informacioni promocional për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike miratohet nga personat e autorizuar, për të përfaqësuar shoqëritë administruuese.

2. Shoqëritë administruese mbajnë një kopje të çdo materiali promocional të publikuar, si dhe burimet e të dhënave, që mbështesin referencat e pasqyruara në këto publikime, të cilat duhet të jenë të disponueshme për inspektim nga AMF-ja.

Neni 83

Mënyra e promovimit

Në rastin kur shpërndahet informacion promocional për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike dhe shoqëritë e tyre administruese:

- a) nuk duhet të fshihet ose të paraqitet në mënyrë false qëllimi i tyre promocional;
- b) duhet të jepet një përshkrim i saktë dhe i vërtetë i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, që po promovohet, si dhe i detyrimeve të pritshme dhe i rreziqeve, që lidhen me to;
- c) duhet që faktet dhe citimet e dhëna të jenë të plota, të qarta, të vërteta dhe të kuptueshme, në datën në të cilën jepen, si dhe nuk duhet të jenë çorientuese dhe çdo fakt i dhënë të jetë i provueshëm;
- ç) duhet që çdo opinion i dhënë të jetë i plotë dhe i qartë dhe të përmendet se për përdorimin e mëtejshëm të tij është marrë miratimi nga shoqëria administruese;
- d) duhet që çdo krahasim i bërë të bazohet në fakte, të cilat janë të sakta dhe të përditësuara ose që përfundimet e tyre kryesore janë dhënë në mënyrë të qartë dhe se çdo krahasim i tillë është dhënë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, i cili, në asnjë mënyrë, nuk është çorientues dhe bazohet në të gjithë faktorët kyç për një krahasim të këtij lloji;
- dh) nuk duhet të jepet asnjë shtrembërim, në veçanti, për sa i përket ekspertizës profesionale të personave përgjegjës, aseteve, qëllimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese e numrit të aksioneve apo të kuotave, që ajo zotëron në sipërmarrjen e investimeve kolektive;
- e) duhet siguruar që paraqitja, përmbajtja ose forma e informacionit promocional nuk shtrembëron, fsheh ose pakëson rëndësinë e ndonjë deklarate, paralajmërimi ose reference, që duhet të jepet sipas këtij ligji apo akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- ë) duhet siguruar që nuk mund të citohet asnjë licencë e dhënë nga organi përgjegjës, pa lejen e AMF-së ose të organit tjetër përgjegjës dhe se asnjë personi të tretë nuk do t'i lihet të besojë se licenca e dhënë nga AMF-ja ka një kuptim të ndryshëm nga vërtetimi, që provon se firma e dhënë ka përmbushur të gjitha kushtet për përfitimin e statusit ligjor të treguar në licencë;
- f) nuk mund të hiqet asnjë e dhënë, nëse kjo heqje do ta bënte informacionin promocional të pasaktë, të pavërtetë, të paqartë ose çorientues (që çon në gjykime të gabuara);
- g) duhet të jepet një përshkrim i saktë dhe i vërtetë i sipërmarrjes së investimit kolektiv me ofertë publike, detyrimet e parashikuara dhe rreziqet që lidhen me to.

Neni 84

Paraqitja e rezultateve

Paraqitja e rezultateve të biznesit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike:

- a) nuk duhet të përbëjë garanci ose premtim;
- b) nuk duhet të bëhet në formën e vlerësimeve të përafërta;
- c) duhet të reflektojë performancën e veprimtarisë së investimit nga çasti i themelimit të tij deri në ditën e paraqitjes, ose performancën në pesë vitet e fundit, cilado nga të dy periodhat qoftë më e afërta;
- ç) duhet të bëhet në bazë të të dhënave më të fundit, të disponuara në çastin e paraqitjes së rezultateve;

d) duhet të hartohet në mënyrë të normalizuar për sa i përket periudhave të mbuluara, me përfshirjen ose përjashtimin e faktorëve të caktuar, që prekin këto rezultate (si për shembull bazën për çmimin, kostot, taksat, dividendët);

dh) nuk duhet të bëhet në një mënyrë që mund të interpretohet si parashikim për rezultatet e mundshme të veprimtarisë në të ardhmen.

Neni 85

Rregulloret e AMF-së

AMF-ja miraton një rregullore për përmbajtjen dhe mënyrat e paraqitjes së rezultateve të biznesit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

AMF-ja miraton një rregullore për përmbajtjen, kufijtë kohorë, dhënien dhe modifikimet e informacionit marketues për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

Neni 86

Përjashtime në zbatimin e kushteve të promovimit dhe publikimit të të dhënave

Komunikimet, që përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, për sa u përket kushteve të promovimit dhe të publikimit të informacionit promocional për fondet e investimit me ofertë publike, janë:

a) komunikimet ndërmjet shoqërisë administruese dhe çdo subjekti tjetër të licencuar, për të kryer një veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë;

b) njoftimet e shkurtra, ekskluzivisht faktike, në radio, televizion, shtyp ose media elektronike për sipërmarrjen dhe/ose shoqërinë administruese dhe të dhënat kryesore të kontaktit;

c) letrat dhe materialet e shkruara, që u adresohen individualisht personave të tretë për kërkesat e tyre specifike, të cilat nuk bien në kategorinë e reklamimit masiv postar;

ç) raportet vjetore të biznesit dhe raportet financiare të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose të shoqërisë së tij administruese.

SEKSIONI 6

POLITIKAT E INVESTIMIT PËR SIPËRMARRJEN E INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 87

Investimet e lejuara

1. Në një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, të paktën, 90 për qind e portofolit duhet të përbëhet nga:

a) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në një shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;

b) kuota e fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas këtij ligji, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;

c) depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në një shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;

ç) instrumente financiare derivativë;

d) instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të tregtuara në një treg të rregulluar.

2. Një sipërmarrje e investimeve kolektive mund të investojë jo më shumë se 10 për qind të aseteve të veta në tituj të transferueshëm dhe në instrumente të tregut të parasë, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër.

3. Një sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike nuk duhet të zotërojë metale të çmuara ose certifikata, që përfaqësojnë këto metale.

4. Një shoqëri investimi mund të zotërojë prona të luajtshme dhe të paluajtshme, që janë thelbësore për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprimtarisë tregtare.

5. Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike mund të mbajnë asete likuide për qëllime dytësore.

6. Një sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike, si pjesë të politikës së saj të investimit për administrim efektiv të portofolit, mund të përdorë instrumente financiare derivative. Megjithatë shoqëria administruese duhet të ketë një proces dhe teknika efektive të menaxhimit të riskut për administrimin eficient të portofolit apo për t'u ruajtur nga ndryshimi i kursit të monedhës, të cilat ia komunikojnë rregullisht AMF-së. AMF-ja mund të hartojë dhe të miratojë rregulla në lidhje me detyrimet e parashikuara në këtë pikë.

Neni 88

Kufizimet e investimit

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk mund të investojë më shumë se 5 për qind të aseteve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

2. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk mund të investojë më shumë se 20 për qind të aseteve të saj në depozita në të njëjtin institucion depozitues.

3. Kufiri 5 për qind, sipas pikës 1 të këtij neni:

a) mund të rritet deri në 10 për qind. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban një sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike të disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5 për qind të aseteve të fondit, nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës totale të aseteve të fondit;

b) mund të rritet deri në 35 për qind në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit Europian, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit Europian;

c) kufizimi i parashikuar në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij neni mund të rritet deri në 100 për qind me miratimin e AMF-së, në rast se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i) prospekti dhe rregullat e fondit përmendin shprehimisht shtetet, autoritetet qendrore a vendore ose organizmat publikë ndërkombëtarë, në të cilët sipërmarrja e investimeve kolektive ka qëllim të investojë më shumë se 35 për qind të aseteve të saj;

ii) asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive përbëhen nga të paktën 6 tituj ose instrumente të tregut të parasë, të llojeve të ndryshme;

iii) vlera e asnjë lloji titulli apo instrumenti të parasë, të përmendur në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk tejkalon 30 për qind të aseteve të SIK-së;

ç) mund të rritet deri në 25 për qind në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të licencuara, të cilat e kanë selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit Europian apo të lejuara nga AMF-ja. Kur SIK-ja investon më shumë se 5 për qind të aseteve të saj në këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80 për qind të vlerës totale të aseteve të sipërmarrjes kolektive me ofertë publike;

d) për titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të parashikuara në shkronjat “b” dhe “ç” të kësaj pike, nuk aplikohet limiti prej 40 për qind, referuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

4. Ekspozimi ndaj rreziqeve të palës tjetër i një sipërmarrjeje të investimeve kolektive në një transaksion me instrumente derivativ në një treg të rregulluar nuk tejkalon:

- a) 10 për qind të aseteve të tij, kur pala tjetër është një institucion i licencuar kreditimi;
- b) 5 për qind të aseteve të tij, në rastet e tjera.

5. Kufiri i kombinuar i investimeve, depozitimeve dhe ekspozimeve që lindin nga derivativët me një emetues të vetëm, së bashku, të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të tejkalojnë 20 për qind të aseteve.

Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të emetuara nga një emetues i vetëm, si dhe depozitat e bëra në të njëjtin institucion (emetuesi), të parashikuara në pikat 1 e 2 dhe në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 3 të këtij neni, nuk tejkalojnë 35 për qind të vlerës totale të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

6. Nëse sipërmarrja e investimeve kolektive përpiket që të replikojë një indeks aksionesh ose indeks instrumentesh borxhi, AMF-ja mund të lejojë që deri në 20 për qind të aseteve të fondit të investohet në aksione ose instrumente borxhi të një emetuesi të vetëm. Kufiri mund të lejohet nga AMF-ja deri në 35 për qind në një emetues të vetëm në kushte të jashtëzakonshme të tregut, veçanërisht kur tituj ose instrumente të caktuara të tregut të parasë janë me peshë të madhe në indeks.

7. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike mund të marrë në zotërim kuota ose aksione të një sipërmarrjeje tjetër të investimeve kolektive, me kusht që jo më shumë se 10 për qind e aseteve të saj janë investuar te një SIK tjetër e vetme.

a) Në total, një SIK mund të investojë deri në 30 për qind të aseteve të saj në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Kur SIK-ja merr në zotërim kuota ose aksione të një SIK-je tjetër, asetet e tyre nuk bashkohen, me qëllim llogaritjen e limiteve të përcaktuara në pikat 1 - 6 të këtij neni.

b) Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike duhet ta pasqyrojë në prospektin ose rregullat e fondit faktin, kur ajo ka synim të investojë një pjesë thelbësore të aseteve të saj në tituj/aksione në një formë tjetër sipërmarrjeje të investimit kolektiv me ofertë publike.

c) Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ka të përbashkët, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një shoqëri administruese me një sipërmarrje tjetër të investimeve kolektive me ofertë publike, në të cilën ajo investon, shoqëria administruese nuk vendos tarifa hyrjeje ose largimi për mbajtësit e kuotave ose aksionarët për investimet në kuotat apo aksionet e sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike.

8. Pikat 1 deri në 7 të këtij neni nuk zbatohen për fondin ombrellë, njësoj sikur ai të ishte fond i vetëm titujsh, por zbatohen për çdo fond të ndërruar të fondit ombrellë, njësoj sikur çdo fond i veçantë të ishte një fond i vetëm investimi.

9. Kufizimi i pikës 8 të këtij neni nuk përfshin investimin total të përbashkët nga fondet e ndërruara në çfarëdolloj klase të titujve të emetuar nga cilido emetues, nëse ai nuk tejkalon 10 për qind të vlerës së aseteve të të gjitha fondeve të ndërruara, të marra si një e tërë.

Neni 89

Huamarrja dhe huadhënia

1. AMF-ja, pas kërkesës së një sipërmarrjeje të investimeve kolektive, mund të japë miratimin për marrjen hua, përkohësisht:

- a) deri në 10 për qind të aseteve/kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- b) deri në 10 për qind të aseteve të shoqërisë së investimit, kur ajo merr hua për të bërë të mundur blerjen e pronës së paluajtshme për kryerjen e drejtpërdrejtë të biznesit.

2. Për shoqërinë e investimit, huamarrja, për arsyt e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës së mësipërme, nuk mund të kalojë në total 15 për qind të aseteve të saj.

3. Ndalohet huadhënia për llogari të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive, si dhe këto sipërmarrje nuk mund të përdoren për të siguruar apo garantuar ndonjë hua.

Neni 90

Kostot, që lidhen me fondin e investimit

1. Tarifat, që u ngarkohen mbajtësve të kuotave e fondit të investimit, kufizohen në:
- a) tarifën e hyrjes, e cila i shtohet shumës së pagesës në kohën e shitjes së kuotave;
 - b) tarifën e largimit, e cila zbritet nga vlera neto e aseteve të fondit, për çdo kuotë në kohën e shlyerjes;
 - c) tarifa e administrimit, e cila llogaritet ditë për ditë, në bazë të vlerës neto të aseteve të fondit, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Tarifa vjetore e raportuar e administrimit} \times \frac{1}{365} .$$

2. Kostot operative të shoqërisë administruese dhe të shërbimeve, të cilat ajo i siguron për fondet e investimit, përveç tarifave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk duhet t'i faturohen fondit, ku përjashtim i vetëm është nënshkrimi i kuotave nga mbajtësit e kuotave, në rastin kur ky shërbim sigurohet nga shoqëria administruese.

3. Nuk lejohet vendosja e tarifave për rezultatet e veprimtarisë së fondit.

4. Kostot e tjera, që mund të regjistrohen drejtpërdrejt, duke debituar mbajtësit e kuotave janë si më poshtë:

- a) tarifat dhe kostot, që i paguhen depozitarit;
- b) kostot, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e aseteve;
- c) kostot e mbajtjes së regjistrit të kuotave, përfshirë dhe kostot e lëshimit të vërtetimeve të transaksioneve ose vërtetimet e balancës së kuotave, nëse është e nevojshme, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- ç) kostot e auditimit vjetor;
- d) kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet gjashtëmujore dhe vjetore për mbajtësit e kuotave;
- dh) të gjitha tarifat dhe shpërblimet e parashikuara, që i paguhen AMF-së, për dhënien e licencës për fondin;
- e) taksat, që paguhen nga fondi për asetet ose fitimin e tij;
- ë) kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt dhe komunikimet e tjera të parashikuara;
- f) kostot e tjera, siç është parashikuar nga ligje të veçanta.

5. Asnjë kosto e vetme nuk paguhet nga asetet e fondit të investimit, përveç kur ajo është parashikuar si kosto në prospektin e fondit.

6. Asnjë tarifë ose shpërblim nuk i ngarkohet fondit të investimit, për reklamimin apo promocionin e kuotave të fondit dhe të shpërblimeve të përfaqësuesve të fondit për shitjet. Shoqëria administruese i paguan këto kosto nga të ardhurat e fituara, në bazë të tarifave të administrimit të hyrjes dhe largimit.

7. Shuma totale e të gjitha kostove të pasqyruara në librat kontabël, duke debituar fondet e investimit, shprehet si raport i shpenzimeve totale dhe mënyra e llogaritjes është e përcaktuar dhe e specifikuar në rregullat dhe prospektin e fondit, si dhe publikohet në raportin vjetor financiar, të audituar.

8. Raporti i shpenzimeve totale të fondit të investimit nuk duhet të tejkalojë 3,5 për qind të vlerës neto të aseteve të fondit. Me mbylljen e periudhës vjetore të kontabilitetit, AMF-ja publikon, çdo vit, një përmbledhje krahasimore të vlerave totale të shpenzimit, për të gjitha fondet e investimit.

9. Të gjitha kostot, të cilat në një vit të veçantë tejkalojnë maksimumin e lejuar të vlerës totale të shpenzimeve prej 3,5 për qind, merren përsipër nga shoqëria administruese.

Neni 91

Llogaritja e tarifave dhe kostove

Shuma totale e të gjitha kostove të pasqyruara në librat kontabël, duke debituar fondin e investimit, shprehet si raport i shpenzimeve totale dhe llogaritet për çdo vit paraardhës në mënyrën e mëposhtme:

$$\frac{\text{Tarifa totale e administrimit} + \text{shuma totale e të gjitha kostove të tjera,} \\ \text{parashikuar në nenin 90 të këtij ligji, minus kostot e parashikuara} \\ \text{në pikën 4, shkronjat "a", "b", "e" dhe "f" të nenit 90}}{\text{Vlera mesatare neto e aseteve}} \times 100$$

Kjo shumë publikohet në raportin financiar vjetor të audituar.

KREU VI

SHOQËRIA E INVESTIMIT ME OFERTË PRIVATE

Neni 92

Shoqëria e investimit me ofertë private

Shoqëria e investimit me ofertë private është një shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e cila themelohet në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare dhe vetëm pas miratimit të AMF-së. Objekti i veprimtarisë tregtare të kësaj shoqërie është investimi i fondeve, me qëllim shpërndarjen e riskut të investimit, duke u dhënë investitorëve të saj, të afruar përmes ofertës private, përfitimin e rezultateve të administrimit të atyre fondeve. Të drejtat e investitorëve përfaqësohen nga aksionet në atë shoqëri.

Neni 93

Themelimi i shoqërisë së investimit me ofertë private

1. Shoqëria e investimit me ofertë private mund të themelohet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe.
2. Aksionet e shoqërisë së investimit me ofertë private emetohen nëpërmjet një oferte private vetëm në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 "Për titujt" dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Në rregullat e fondit dhe prospektin e shoqërisë së investimit me ofertë private përcaktohen edhe objektivat e saj të investimit.
4. Shoqëria e investimit me ofertë private mund t'i ofrojë aksionet e veta vetëm pas regjistrimit në Regjistrin e Fondeve.
5. AMF-ja miraton një rregullore për të përcaktuar kërkesat e sakta të aplikimit për miratimin e shoqërisë së investimit me ofertë private.

Neni 94

Prospekti i shoqërisë së investimit me ofertë private

1. Prospekti i shoqërisë së investimit me ofertë private përbën një ftesë për blerje aksionesh, që i adresohet ekskluzivisht një personi të caktuar ose një grupi të kufizuar investitorësh, që

përbushin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Informacioni i dhënë në prospekt duhet të jetë i saktë dhe i plotë.

Neni 95

Ndalimet për promovimin e shoqërisë së investimit me ofertë private

1. Shoqëria e investimit me ofertë private nuk duhet të angazhohet në fushata publike për promovimin e investimit, që ajo administron. Shpërndarja publike e materialeve prezantuese, të cilat, përveç dhënies së informacionit për emërtimin dhe veprimtarinë e shoqërisë së investimit, orienton investitorët potencialë të përshtatshëm për këtë lloj shoqërie, në shoqërinë e investimit me ofertë private, nuk konsiderohet promovim publik.

2. Të gjitha të dhënat për paraqitjen e shoqërisë së investimit me ofertë private duhet të autorizohen nga anëtarët e këshillit të administrimit dhe duhet të jenë të plota, të qarta, të vërteta dhe të sakta dhe nuk duhet të jenë çorientuese, në veçanti, për sa i përket risqeve dhe tarifave.

Neni 96

Kushtet e paraqitjes së rezultateve dhe publikimi i të dhënave

Çdo paraqitje e rezultateve të biznesit të një shoqërie investimi me ofertë private:

a) përbëhet nga të dhënat më të fundit, të disponueshme në çastin e paraqitjes së rezultateve të biznesit;

b) hartohet në mënyrë të njëtrajtshme, për sa u përket periudhave të mbuluara, me përfshirjen ose përjashtimin e faktorëve të veçantë, të cilët ndikojnë në këto rezultate, p.sh. bazat për çmimin, kostot, taksat, dividendët etj.

Neni 97

Politika e investimit të një shoqërie investimi me ofertë private

Kërkesat, ndalimet dhe kufizimet e sakta për politikën e investimit të një shoqërie investimi me ofertë private përcaktohen me rregullore të veçantë të AMF-së.

KREU VII

SHITJA E AKSIONEVE OSE E KUOTAVE NË SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 98

Subjektet e lejuara

1. Shitja e aksioneve ose e kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike kryhet nga shoqëritë administruese.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, shitja e aksioneve ose e kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike mund të realizohet nga subjektet e mëposhtme ligjore, të cilat kanë lidhur një kontratë me shoqërinë administruese dhe që janë të autorizuar për të vepruar në Republikën e Shqipërisë:

a) bankat;

b) shoqëritë e sigurimit;

c) shoqëritë komisionere;

ç) persona të tjerë juridikë, që kryejnë transaksione shitjeje për shoqërinë administruese, në bazë të një kontrate bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Neni 99

Veprimtaria si agjent i shoqërisë administruese dhe investitorëve

1. Në shitjen e aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, bankat ose shoqëritë e sigurimit dhe personat e tjerë juridikë, të parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 98 të këtij ligji, veprojnë si agjentë të shoqërisë administruese, në bazë të një kontrate me shkrim, të përfunduar me këtë shoqëri.

2. Në shitjen e aksioneve ose kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, shoqëritë komisionere dhe bankat e licencuara, për të kryer veprime me titujt, veprojnë si agjentë të klientëve në blerjen e aksioneve ose të kuotave për llogari të tyre, bazuar në një kontratë të lidhur me ta.

Neni 100

Njoftimi i pezullimit të licencave

1. Subjektet e përmendura në nenin 99 të këtij ligji nuk do të përfshihen në transaksionet e shitjeve, që përfshijnë kuota ose aksione në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, gjatë periudhës në të cilën autoriteti përgjegjës ka pezulluar përkohësisht licencat e tyre.

2. Ata kanë detyrimin të njoftojnë menjëherë shoqëritë administruese, me të cilat kanë përfunduar një kontratë për kryerjen e transaksioneve të shitjeve, për çdo pezullim të licencës së tyre.

3. AMF-ja miraton një rregullore të veçantë, që rregullon kushtet, mënyrën e marrjes së autorizimit për shitjen e aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive për të gjithë individët e punësuar nga një person juridik dhe individët e tjerë, që kryejnë këto transaksione për shoqërinë administruese, sipas një kontrate të veçantë.

Neni 101

Mënyra dhe kushtet e shitjes

Subjektet e parashikuara në nenin 99 të këtij ligji, të autorizuar për shitjen e aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, kanë detyrimin:

a) t'u garantojnë investitorëve disponueshmërinë e të gjitha dokumenteve dhe të të dhënave përkatëse, kryesisht prospektin, raportet, çmimet etj.;

b) të kontrollojnë, nëse kërkesat për blerjen dhe shlyerjen janë përfunduar në mënyrë të rregullt;

c) t'i dërgojnë rregullisht shoqërisë administruese kërkesat për shitje dhe shlyerje;

ç) në promovimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike ose dhënien e të dhënave për shoqëritë e investimit me ofertë private, të përdorin vetëm prospektin, raportet dhe materialet promocionale ose prezantuese, të miratuara nga një shoqëri e licencuar administruese;

d) të mos japin ndonjë informacion të rremë ose informacion, që mund të jetë çorientues për investitorët për gjendjen e sipërmarrjes apo ndonjë deklaratë false rreth sipërmarrjes, objektivave të saj të investimit, risqet e lidhura me to, çmimet, rendimentin e investimit a ndonjë çështje ose informacion tjetër për sipërmarrjen apo shoqërinë administruese të licencuar, ose ndonjë deklaratë tjetër, e cila bie në kundërshtim me përmbajtjen e prospektit të fondit, rregullat e fondit ose raportet e tij;

dh) të mbajnë përgjegjësi para shoqërisë së administrimit për çdo gabim ose pakujdesi të punonjësve të tyre dhe për çdo mospërputhshmëri me këtë ligj dhe rregullore të tjera;

e) t'i bëjnë të ditur investitorit potencial shumën e komisionit të paguar për angazhimin e tyre në shitjen e aksioneve ose kuotave, të llogaritura si përqindje e tarifës së hyrjes, tarifës vjetore të administrimit ose tarifës së largimit;

ë) t'i bëjnë të ditur investitorit potencial faktin se cilën shoqëri administruese ai përfaqëson dhe nëse ai ofron për shitje vetëm produktet e asaj apo të më shumë shoqërive;

f) të sigurohen se sipërmarrja apo sipërmarrjet e investimeve kolektive të propozuara plotësojnë nevojat e palës së interesuar;

g) të veprojnë në çdo kohë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret përkatëse.

Neni 102

Dhënia e rekomandimeve

Në rastin kur shoqëritë komisionere japin rekomandime për blerje ose shitje të aksioneve ose të kuotave në një fond, ato janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e nenit 101 të këtij ligji, me përjashtim të shkronjave “dh” dhe “e” të pikës 1 të atij neni.

Neni 103

Shpërblimi për shitjet

Subjektet e parashikuara në nenin 99 të këtij ligji e marrin shpërblimin për punën e tyre vetëm nga shoqëria administruese, e cila e përballon nga tarifat hyrëse të administrimit ose të largimit, të arkëtuara nga investitorët.

Neni 104

Shitja e aksioneve në shoqëritë e investimit me ofertë private

1. Shitja e aksioneve në shoqëritë e investimit me ofertë private kryhet vetëm nga shoqëria administruese.

2. AMF-ja miraton rregullore, që përcakton personat e autorizuar për shitjen ose promovimin e shitjes së aksioneve, duke vendosur kushte për mënyrën e operimit të tyre, si dhe kërkesa për raportimin.

KREU VIII

BASHKIMI DHE MBYLLJA E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 105

Bashkimi dhe mbyllja e shoqërive të investimit me ofertë publike dhe private

Bashkimi dhe mbyllja e shoqërisë së investimit me ofertë publike dhe private realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 106

Bashkimi dhe mbyllja e fondeve të investimit

1. Dy fonde investimi mund të bashkohen vetëm në rast të miratimit paraprak nga AMF-ja. Procedura, kushtet dhe mënyra e bashkimit përshkruhen në një rregullore të nxjerrë nga AMF-ja për këtë qëllim.

2. Mbyllja e një fondi investimi realizohet nga shoqëria administruese, që administron fondin, përveç rasteve kur kjo shoqëri i është nënshtruar procedurave të falimentimit ose kur AMF-ja ka pezulluar përkohësisht ose ka hequr në mënyrë të përhershme licencën e shoqërisë administruese.

3. Në rastin kur nuk është e mundur mbyllja e fondit të investimit nga shoqëria administruese, për shkak të arsyeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, mbyllja realizohet nga depozitari i fondit. Nëse depozitari është duke iu nënshtruar procedurave të falimentimit ose kur licenca e tij si depozitar apo si bankë është pezulluar përkohësisht apo është hequr në mënyrë të përhershme, mbyllja e fondit realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF-ja.

4. AMF-ja është e detyruar të caktojë pa vonesë likuiduesin e fondit të investimit, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni dhe në caktimin e tij duhet të veprojë me kujdesin maksimal, duke u siguruar se ai do të marrë parasysh të drejtat dhe interesat e mbajtësve të kuotave në fondin e investimit. AMF-ja është përgjegjëse para mbajtësve të kuotave për çdo vonesë të pajustificuar ose hezitim në caktimin e likuiduesit të fondit të investimit ose për çdo sjellje, e cila është në kundërshtim me parimin e kujdesit maksimal dhe që i ka shkaktuar ndonjë dëm mbajtësit të kuotave.

Neni 107

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesit

1. Likuiduesi është i detyruar të informojë AMF-në dhe të gjithë investitorët e fondit për mbylljen e fondit, jo më vonë se 7 ditë nga data e marrjes së vendimit për mbylljen, ose nga data e emërimit të tij si likuidues.

2. Pas marrjes së vendimit për mbyllje, çdo shitje e mëtejshme ose shlyerje e kuotave në fondin e investimit është e ndaluar, përveçse në rastet e kërkesave të marra pas përcaktimit më të fundit të çmimit dhe para marrjes së vendimit për mbyllje.

3. Nga data e marrjes së vendimit për mbyllje, nuk ngarkohet asnjë tarifë mbi fondin e investimit përveç tarifave për depozitarin, kostot e lidhura me procedurën e mbylljes dhe shqyrtimin e saj, si dhe kostot për përgatitjen dhe paraqitjen tek investitorët e fondit të raporteve të audituara gjashtëmujore ose vjetore, gjatë procedurës së mbylljes së fondit të investimit.

4. Likuiduesi është i detyruar t'i paraqesë AMF-së raportet për ecurinë dhe raporte përfundimtare të mbylljes, si dhe është përgjegjës për përgatitjen e raporteve të kërkuara.

Neni 108

Përfundimi i procedurës së mbylljes së fondit të investimit

1. Gjatë procedurës së mbylljes shiten të gjitha asetet e fondit, si dhe paguhen detyrimet e fondit, të kërkueshme deri në datën e marrjes së vendimit për mbyllje.

2. Pjesa e mbetur e vlerës neto të aseteve të fondit u shpërndahet mbajtësve të kuotave në përpjesëtim me pjesën e tyre në fond.

3. AMF-ja miraton një rregullore për procedurën, kostot dhe kufijtë kohorë për prishjen e fondeve të investimit.

KREU IX

PËRCAKTIMI I VLERËS SË ASETEVE DHE I ÇMIMIT TË AKSIONEVE E TË KUOTAVE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 109

Frekuenca e llogaritjes së vlerës

Shoqëria administruese duhet të përcaktojë vlerën e aseteve të fondit të investimeve dhe të të gjitha detyrimeve e tarifave të saj, para se të llogarisë vlerën neto të aseteve për çdo kuotë apo çmimin për çdo kuotë.

a) Vlera neto e aseteve të një fondi investimi llogaritet ditë për ditë, në kohën e treguar në prospekt. Shoqëria administruese njofton AMF-në ditën tjetër të punës për vlerën e aseteve të fondit të investimit, detyrimet dhe tarifën e tij, si dhe për çmimin e kuotave të fondit të investimit, siç janë në datën e llogaritjes.

b) Vlera neto e aseteve të një shoqërie investimi llogaritet të paktën një herë në muaj, në kohën e treguar në prospekt.

c) AMF-ja miraton një rregullore të posaçme, duke specifikuar frekuenca të ndryshme, për përcaktimin e vlerës neto të aseteve.

Përgjegjësia për llogaritjen e vlerës së sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe të çmimit të kuotave dhe aksioneve

1. Vlera e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe çmimi i kuotave në një fond investimi llogariten nga shoqëria administruese.

2. Llogaritja e vlerave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga depozitari, i cili, në këtë rast, është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes. Depozitari nënshkruan dokumentin, që përmban përcaktimin e vlerës së aseteve dhe mban një kopje në dosjen e vet, e cila i vihet në dispozicion AMF-së për inspektim, sipas kërkesës.

3. Eksperti kontabël i jashtëm i sipërmarrjes së investimeve kolektive është i detyruar të bëjë kontrolle të rastësishme gjatë auditimit vjetor, për t'u siguruar se janë respektuar parimet e specifikuar në aktet nënligjore, për përcaktimin e vlerës, që çmimet e aksioneve ose të kuotave, të llogaritura në bazë të parimeve, janë të sakta dhe se tarifa e administrimit dhe tarifat apo kostot e tjera, të parashikuara në akte nënligjore, prospekt ose rregullat e fondit nuk tejkalojnë shumat e lejuara.

Parimet dhe mënyra e përcaktimit të vlerës së portofolit të sipërmarrjes së investimeve kolektive

1. Llogaritja e vlerës së portofolit duhet të sigurojë trajtim të njëjtë për të gjithë investitorët në sipërmarrjen e investimeve kolektive, pavarësisht llojit të sipërmarrjes ose faktit nëse kjo është një sipërmarrje me ofertë publike apo private.

2. Në rastin e titujve, përfshirë aksionet e shoqërive të investimit, përcaktimi i vlerës së aseteve bazohet në çmimin e tregut, që zbatohet në tregjet e organizuara dhe të rregulluara.

3. Në rastin kur nuk kemi çmim tregu, sipas pikës 2 të këtij neni, çmimi i transaksionit të fundit, të përfunduar për atë titull, ose rendimenti nga transaksioni i fundit, në rastin e titujve të borxhit, përdoret si bazë për llogaritjen e vlerës së aseteve, përveç se kur AMF-ja miraton një rregullat.

4. Në rastin e depozitave dhe llogarive rrjedhëse ose ekuivalentëve të tyre monetarë, pretendimeve dhe detyrimeve afatshkurtra dhe të të ardhurave e shpenzimeve të ardhshme, vlera nominale e përdorur zmadhohet me interesin e akumuluar, nëse nuk është parashikuar ndryshe nga AMF-ja.

5. Për të përcaktuar vlerën e transaksioneve të kontratave të së ardhmes dhe të mundësisë e të derivativëve, për të cilat nuk është e mundur të përcaktohet çmimi i tregut, AMF-ja miraton një rregullore specifike, duke përcaktuar mënyrat e përlogaritjes së vlerës së këtyre aseteve.

6. Në rastin e një fondi investimi përdoret çmimi i kuotës, nëse nuk është parashikuar ndryshe nga AMF-ja.

7. Vlera e aseteve në monedhë të huaj llogaritet në monedhën e Republikës së Shqipërisë, duke përdorur kursin e fundit të disponueshëm të këmbimit përpara përcaktimit të vlerës së aseteve, në përputhje me rregulloret e nxjerra nga AMF-ja.

8. Në rastin e formave të tjera të aseteve, të cilat nuk kanë çmim tregu, vlerësohet vlera e drejtë dhe e arsyeshme e këtyre aseteve. Procedurat për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të arsyeshme të aseteve përfshijnë vlerën kohore, duke skontuar rrjedhën e parave, krahasimet me asetet e ngjashme me çmim të njohur në treg, metodat e vlerësimit me opsione dhe mënyrat e tjera, të parashikuara nga AMF-ja.

9. Baza për përcaktimin e vlerës së aseteve specifikohet në prospektin dhe rregullat e fondit dhe zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme për çdo llogaritje të vlerës së aseteve të fondit.

10. AMF-ja miraton një rregullore për bazën e detyrueshme të llogaritjes për sipërmarrjet e investimeve kolektive, në lidhje me përcaktimin e vlerës së aseteve, përfshirë si titujt, edhe asetet

likuide apo gatilikuide, monedhën vendase dhe atë të huaj, kontratat e së ardhmes (futures) dhe mundësive (opsionit), derivativët, pronën e paluajtshme, si dhe kriteret për tregjet e rregulluara e të organizuara sipas kushteve, të përcaktuara nga ky ligj, si dhe kërkesat e likuiditetit për përcaktimin e duhur të çmimeve të tregut dhe kërkesat për vendosjen në kohë të këtyre çmimeve, ndërsa mbahen parasysh mënyrat e ndryshme të vlerësimit, në varësi të specifikave të fondeve.

Neni 112

Vlera neto e aseteve dhe vlera për çdo aksion ose kuotë

1. Në rastin e një fondi investimi, vlera neto e aseteve është vlera e aseteve të fondit, pra investimet afatgjata, të shtuara me asetet afatshkurtra, minus të gjitha detyrimet e tij. Vlera neto për kuotë është vlera neto e aseteve të fondit, e pjesëtuar me numrin e kuotave të fondit në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit.

2. Vlera neto e aseteve të një shoqërie investimi është vlera e aseteve të shoqërisë së investimit, pra investimet afatgjata, të shtuara me asetet afatshkurtra, minus të gjitha detyrimet e saj. Vlera neto e aseteve për çdo aksion është vlera neto e aseteve të fondit, e shpërndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet aksioneve të emetuara të fondit në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit.

3. AMF-ja miraton një rregullore, që përcakton asetet dhe detyrimet e sipërmarrjeve kolektive të investimit, si dhe bazën, mënyrën dhe kufijtë kohorë për llogaritjen e vlerës neto të aseteve dhe të vlerës neto të aseteve për kuotë apo aksion.

Neni 113

Oferta fillestare dhe përcaktimi i çmimit të kuotave ose aksioneve të fondit

1. Periudha për ofertën fillestare të kuotave në një fond investimi ose aksionet në një shoqëri investimi duhet të jetë jo më shumë se 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe kohore, shuma totale e aseteve monetare të mbledhura mbahet si depozitë dhe nuk investohet derisa fondi të ketë tejkaluar pragun ligjor më të ulët të vlerës së aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

2. Asetet monetare të mbledhura nuk mund të investohen, përveç në formën e depozitës, para kalimit të periudhës së ofertës.

3. Çmimi i emimit fillestar ose të parë të shoqërisë së investimit është çmimi nominal i çdo aksioni. Çmimi i emimeve të mëpasshme është çmimi i tregut i çdo aksioni dhe kjo nuk duhet të bjerë ndesh me të drejtën e aksionarëve ekzistues për të marrë oferta për aksione shtesë, në përpjesëtim me aksionet e tyre aktuale në shoqëri.

4. Në ofertën fillestare ose ofertën e parë të fondit të investimit, çmimi i emimit përcaktohet nga shoqëria administruese dhe pasqyrohet në prospektin e fondit. Pas ofertës fillestare, çmimi i kuotës së fondit të investimit është një çmim uniform, i barabartë me vlerën neto të aseteve për kuotë, i llogaritur në bazë të çmimit të tregut për të gjitha asetet e portofolit të fondit.

Neni 114

Çmimi i kuotave në fondin e investimit

1. Shitja dhe shlyerja e kuotave në një fond investimi realizohet në një ditë të caktuar, me një çmim të llogaritur në përputhje me ligjin, rregulloret dhe prospektin e fondit, si dhe publikohet, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Vetëm pas caktimit në këtë mënyrë të çmimit është e mundur llogaritja dhe vendosja e tarifave të hyrjes dhe largimit.

2. Nuk lejohet shitja ose shlyerja e kuotave në një fond investimi me një çmim poshtë ose sipër çmimit uniform të zbatuar aktualisht (vlera neto e aseteve) për një kuotë. Çmimi i kuotës mund të luhetet në varësi të ndryshimeve në vlerën neto të aseteve, të llogaritur në përputhje me një formulë, që mund të ndryshohet nga AMF-ja.

3. Çmimi i kuotës në një fond investimi llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:
Vlera neto e aseteve të fondit e pjesëtuar me numrin e kuotave të emetuara, duke pasur parasysh që:

- a) vlera neto e aseteve llogaritet në përputhje me dispozitat e nenit 112 të këtij ligji;
- b) numri i kuotave të emetuara, i barabartë me numrin e kuotave në çastin e llogaritjes së çmimit, duke pasur parasysh çdo shitje ose shlyerje të bërë nga çasti i llogaritjes së fundit të çmimit deri në çastin e llogaritjes së re të çmimit.

Neni 115

Këmbimi dhe shitja e kuotave në fondet e investimit

1. Mbajtësi i kuotave në një fond investimi mund të këmbejë kuotat e veta me kuota në një fond tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administrimi.

2. Shitja e kuotave në një fond investimi bëhet me çmimin e zbatueshëm, në përputhje me prospektin dhe rregulloret e fondit, në çastin e bërjes së pagesës për llogari të fondit, duke shtuar edhe shumën e tarifës së hyrjes, në rastin kur vendoset një tarifë e tillë.

3. Çdo pagesë për fondin e investimit bëhet në asete monetare dhe, vetëm në rrethana të veçanta, të parashikuara nga një rregullore e AMF-së, në tituj apo asete të tjera, me një kusht që titujt apo asetet e tjera të jenë të tregtuara në tregje të organizuara ose të rregulluara, kur është i mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë.

Neni 116

Shlyerja e kuotave në fondet e investimit

1. Shlyerja e kuotave në një fond investimi bëhet me një çmim të zbatueshëm, në bazë të prospektit të fondit dhe rregulloreve të AMF-së, në kohën e marrjes së kërkesës së vlefshme për shitje, duke zbritur shumën e tarifës së largimit, në rast se është vendosur një tarifë e tillë.

2. Shlyerja e kuotave, duke përdorur asete të fondit, ose shlyerja me anë të transferimit të një përqindjeje përkatëse të çdo lloji asetesh të fondit me një vlerë, e cila barazon vlerën e kuotave për t'u shlyer në këtë mënyrë, lejohet në rastet kur shitja e aseteve të fondit, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të komprometojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në fond, me kusht që rregullat e fondit dhe prospekti i tij të përshkruajnë mënyrën e shlyerjes së kuotave në këtë formë. Shlyerja me asete mund të bëhet vetëm duke transferuar atë pjesë të çdo lloji asetesh të fondit, e cila është në përpjesëtim me numrin e kuotave të investitorëve, që kërkojnë shlyerjen dhe vlerën totale të aseteve të fondit.

Neni 117

Certifikata e blerjes së kuotave dhe kushtet e pagesës në rastin e shlyerjes

1. Certifikata e blerjes së kuotave lëshohet pas kërkesës së bërë nga investitorët jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e marrjes së pagesës së bërë në fond.

2. Certifikata e blerjes së kuotave përmban:

- a) datën e blerjes së kuotave;
- b) emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese;
- c) numrin e kuotave të fondit, të cilat përfaqëson;
- ç) emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave;
- d) vendin dhe datën e lëshimit të certifikatës;
- dh) nënshkrimin e personit të autorizuar të shoqërisë administruese. Nënshkrimet mund të fiksohen me mënyra mekanike shumëfishimi.

3. Paratë e kuotave të shlyera të një fondi investimi i transferohen mbajtësit të kuotave të shlyera jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e marrjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Neni 118

Llogaritja e pasaktë e çmimit të kuotave në fondin e investimit

Në rastin e llogaritjes së pasaktë të çmimit të një kuote në një fond investimi me mbi 1 për qind, krahasuar me vlerën e llogaritur nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së përcaktuar në nenin 111 të këtij ligji, AMF-ja është e autorizuar të instruktojë shoqërinë administruese dhe depozitarin përgjegjës për këtë llogaritje të pasaktë që:

a) në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i ulët se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie:

i) të kompensojë çdo mbajtës të kuotave për çdo diferencë në shumën e marrë nga kuotat e shlyera;

ii) të kompensojë dëmet, duke paguar diferencën e duhur në fond;

b) në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i lartë se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie:

i) të kompensojë, duke vlerësuar dhe caktuar një numër proporcional të kuotave shtesë, çdo dëm të shkaktuar secilit investitor, të cilit i është ngarkuar çmimi më i lartë në blerjen e kuotave;

ii) të kompensojë dëmet, duke paguar diferencën në fond.

Neni 119

Tarifa e hyrjes dhe largimit të fondeve të investimit

1. Përveç çmimit të kuotave dhe tarifave të hyrjes dhe largimit, nuk ngarkohet asnjë tarifë tjetër për blerjen ose shlyerjen e kuotave në një fond investimi.

2. Tarifat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni janë të ndara nga çmimi i kuotave dhe mbahen nga shoqëria administruese, por ato mund të përfshihen edhe në të ardhurat e fondit.

3. Nuk ngarkohet asnjë tarifë hyrjeje ose largimi, në rast të mbylljes së një fondi investimi, për mosarritje të shumës minimale të fondit gjatë periudhës së ofrimit fillestar ose të parë, në përputhje me rregulloret e zbatueshme të AMF-së ose prospektin e rregullat e fondit.

4. Nuk ngarkohet asnjë tarifë largimi në rast të mbylljes së fondit, cilido qoftë shkaku i mbylljes.

5. Çdo rritje në tarifën e largimit hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga AMF-ja të ndryshimeve përkatëse në prospekt.

6. Nuk ngarkohet asnjë tarifë hyrjeje ose largimi gjatë transformimit të një fondi investimi.

7. Nuk vendoset asnjë tarifë largimi gjatë shkrirjes ose bashkimit të fondit të investimit me një fond tjetër ose gjatë ndarjes së fondit.

8. Vendimi i shoqërisë administruese për mospagesën e tarifave të hyrjes dhe/ose largimit pasqyrohet, në mënyrë të qartë, në prospektin e fondit, ku përshkruhen edhe rrethanat, në të cilat mund të bëhet kjo gjë.

9. Tarifat e hyrjes ose të largimit në një fond investimi mund të zvogëlohen, krahasuar me tarifat e treguara në prospektin e fondit, vetëm në rastet e transaksioneve të mëdha dhe në përputhje me klasifikimin e përcaktuar në mënyrë të detyrueshme në prospektin e fondit, publikuar e shpërndarë agentëve të shitjes së shoqërisë administruese, me një shënim për parashikimin, kur ndalohet zvogëlimi i tyre.

Neni 120

Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave në një fond investimi

(ndryshuar titulli, ndryshuar në pikën 1, shtuar pika 1/1, ndryshuar pika 2, 3 dhe 4, zëvendësuar fjalë në pikën 6 me ligjin nr. 36/2016, datë 31.3.2016)

1. Shlyerja e kuotave në një fond investimi mund të pezullohet vetëm kur shoqëria administruese dhe depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme ka arsye të

forta e të justifikuara, për pezullimin e shlyerjes, në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë. Për të njëjtat shkaqe, të parashikuara në këtë pikë, njëkohësisht me pezullimin e shlyerjes pezullohet, gjithashtu, edhe shitja e kuotave.

1/1. Nëse shoqëria administruese merr vendim për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave dhe, nëse depozitari nuk është dakord me një vendim të tillë, ky i fundit njofton menjëherë Autoritetin.

2. Shoqëria administruese, në çdo rast, i njofton menjëherë AMF-së vendimin për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave. AMF-ja, pas marrjes së njoftimit, mund të urdhërojë anulimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në fond. Shoqëria administruese publikon, menjëherë, në faqen e saj zyrtare të internetit, të dhënat për çdo pezullim të shitjes e të shlyerjes së kuotave, dhe përgjatë gjithë kohëzgjatjes së pezullimit, si edhe në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Shlyerja dhe shitja e kuotave në një fond investimi mund të pezullohet edhe nga AMF-ja, e cila mund të urdhërojë shoqërinë administruese dhe depozitarin të pezullojë përkohësisht shlyerjen dhe shitjen e tyre, nëse ekzistojnë shkaqe të forta dhe të justifikuara për këtë pezullim, si dhe nëse kjo është në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë.

4. Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave të parashikuar në këtë nen duhet të mbarojë sa më shpejt që të jetë e mundur, ose menjëherë sapo arsyet për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes nuk ekzistojnë më dhe jo më vonë se 28 ditë nga fillimi i pezullimit, përveçse nëse AMF-ja jep miratimin me shkrim për zgjatjen e kufirit të dhënë kohor. Rifillimi i veprimtarisë tregtare në një fond investimi i njoftohet pa vonesë AMF-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese, si dhe publikohet në një gazetë të përditshme, në qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Gjatë pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave, shoqëria administruese dhe agjentët e saj të shitjes mund të vazhdojnë të marrin kërkesa për shitjen ose shlyerjen e kuotave, që do të ekzekutohen menjëherë pasi të jenë llogaritur çmimet e tjera të shlyerjes dhe shitjes, por palëve porositëse u bëhet e qartë se porositë e tyre nuk do të përmbushen brenda kufijve kohorë, të përshkruar në prospektin dhe rregullat e fondit.

6. AMF-ja miraton rregulla më të hollësishme për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve, si dhe rregulla për bazën, përbërësit, mënyrën dhe kufijtë kohorë të llogaritjes, për përcaktimin e vlerës dhe të çmimit të fondeve të investimit, përbërësit, kufizimet, mënyrën e llogaritjes, mbledhjen dhe publikimin e tarifave për kuotat në fondin e investimeve, kohëzgjatjen dhe kushtet e periudhës së parashikuar të ofertës, procedurën, kufijtë kohorë dhe ekzekutimin e shitjes e të shlyerjes së kuotave, si dhe pezullimin e rifillimit të shitjes dhe të shlyerjes, shlyerjen në formën aktuale, si dhe zëvendësimin e kuotave në një fond me kuota në fonde të tjera, të administruara nga e njëjta shoqëri administrimi.

KREU X MBIKËQYRJA NGA AMF-JA

SEKSIONI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 121 **Roli i AMF-së**

1. AMF-ja merr masa për të garantuar një mbikëqyrje efektive, në përputhje me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

2. AMF-ja mund të lidhë marrëveshje me mbikëqyrës të tjerë vendas, të huaj (përfshirë ata ndërkombëtarë), të sektorit financiar, agjenci të zbatimit të ligjit ose të luftës kundër pastrimit të

parave, për të ndarë dhe shkëmbyer informacionin e nevojshëm të mbikëqyrjes apo për të bashkëpunuar për kryerjen e veprimtarisë së mbikëqyrjes, ashtu siç është përcaktuar në këtë ligj.

3. AMF-ja mund të shkëmbejë me një mbikëqyrës tjetër, vendas ose të huaj:

a) informacionin e nevojshëm të mbikëqyrjes, përfshirë dhe informacionin specifik, të kërkuar dhe të mbledhur nga një entitet i mbikëqyrur;

b) të dhënat përkatëse financiare;

c) informacionin për individët, që mbajnë pozicione me përgjegjësi në këto entitete.

4. AMF-ja duhet të ndërmarrë masa të arsyeshme, për të garantuar se çdo informacion i dhënë te një mbikëqyrës tjetër do të trajtohet si konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime mbikëqyrjeje.

5. AMF-ja duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të garantuar se mbikëqyrësi, që merr informacionin, do të këshillohet me të para ndërmarrjes së veprimit, në bazë të evidencave e të informacionit të marrë nga AMF-ja.

Neni 122

Imuniteti dhe dëmshpërblimi i personelit të AMF-së

1. Bordi i AMF-së dhe punonjësit e saj nuk mund të paditen në gjykatë për asnjë veprim a mosveprim të kryer në ushtrimin apo realizimin e ndonjë kompetence ose detyre të dhënë a të vendosur nga ky ligj, përveç nëse ky veprim ose mosveprim provohet se është bërë në keqbesim.

2. AMF-ja zhdëmton bordin dhe punonjësit e vet për çdo kosto ligjore, të ndeshur për mbrojtjen ndaj ndonjë procesi ligjor, të ndërmarrë kundër këtyre personave, në lidhje me kryerjen ose kryerjen e planifikuar të funksioneve zyrtare, brenda qëllimit të punësimit ose angazhimit të tyre, sipas këtij ligji, me kusht që ky person të ketë vepruar në mirëbesim.

Neni 123

Konfidencialiteti

1. AMF-ja mund të shpjegojë publikisht objektivat e politikave që ndjek, të raportojë për veprimtaritë dhe efektivitetin në ndjekjen e objektivave, duke përfshirë edhe informacionin e siguruar publikisht, për problemet institucionale dhe veprimet e ndërmarra.

2. Çdo informacion tjetër, i siguruar nga AMF-ja gjatë kryerjes së funksioneve të saj, nga i cili mund të identifikohet një person ose subjekt, nuk duhet të ekspozohet publikisht nga AMF-ja, nga anëtarët e këshillit ose punonjësit e saj.

3. Informacioni i parashikuar në pikat e mësipërme mund të jepet publikisht, me miratimin e çdo personi dhe të çdo subjekti, që mund të identifikohet nga ai informacion.

4. AMF-ja, kur e shikon të nevojshme, mund të japë informacion pa lejen e personit ose të subjektit, që preket nga informacioni në fjalë, në rastet e mëposhtme:

a) kur i mundëson AMF-së realizimin e ndonjë prej funksioneve të saj;

b) për qëllime të parandalimit ose zbulimit të një krimi;

c) për plotësimin e ndonjë detyrimi ndërkombëtar;

ç) për të asistuar ndonjë autoritet mbikëqyrës, vendas ose të huaj, që ushtron funksione, që korrespondojnë me ndonjë nga funksionet e AMF-së.

5. AMF-ja nuk duhet ta japë informacionin e marrë nga autoritetet mbikëqyrëse të huaja dhe kujdeset që informacioni konfidencial të ruhet gjatë të gjithë kohës, që konsiderohet i tillë.

SEKSIONI 2 MBIKËQYRJA

Neni 124

Qëllimi i mbikëqyrjes

1. AMF-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese, depozitarëve, si dhe çdo subjekti tjetër, që vepron si i tillë pa miratimin e shprehur të AMF-së dhe të dhënë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Veprimtaria mbikëqyrëse e ndërmarrë nga AMF-ja realizohet me anë të:

- a) inspektimeve në vend të çdo dokumenti, që lidhet me objektin e veprimtarisë të subjektit. Ky inspektim realizohet me ose pa njoftimin paraprak të subjektit të mbikëqyrur;
- b) marrjes dhe analizimit të raportimeve, siç është parashikuar në këtë ligj;
- c) zbatimit të masave të ndërmarra, siç është parashikuar në këtë ligj.

Neni 125

Inspektimi në vend

1. AMF-ja mund të kryejë inspektime në vend për çdo shoqëri administruese ose depozitar, për përcaktimin nëse i licencuari ka respektuar dispozitat e këtij ligji, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe rregullat e fondit apo kërkesat, sipas licencës së dhënë.

2. Për qëllime inspektimi, përveç dispozitës përkatëse të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, AMF-ja mund t’i kërkojë shoqërisë administruese ose depozitarit:

a) të sigurojë informacione të tilla, përgjigje ndaj pyetjeve dhe akses në dokumente, libra, regjistra, dëftesa, arkë, tituj dhe çdo informacion tjetër të një subjekti të licencuar, ashtu siç e vlerëson të nevojshme AMF-ja, për të përcaktuar nëse ky subjekt e ka respektuar këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) të paraqitet para autoritetit në vendin dhe orën e caktuar dhe t’u përgjigjet pyetjeve ose të japë informacionin, që AMF-së i duket me rëndësi për hetimin.

3. Inspektimi në vend realizohet vetëm gjatë orëve të punës dhe në ndonjërin nga mjediset e shoqërisë, që i nënshtrohet inspektimit.

4. Shoqëria administruese dhe/ose depozitari garantojnë se punonjësit dhe përfaqësuesit e caktuar prej tyre i lejojnë autoritetit akses në mjediset e biznesit.

5. Inspektimet në vend mund të realizohen në ndonjë ose në të gjitha mjediset, ku kryhet veprimtaria ose ku mbahen regjistrat nga shoqëria administruese dhe depozitari.

Neni 126

Autoriteti për të emëruar ekspertë

Për qëllime të inspektimit në vend, AMF-ja mund të emërojë një ose disa specialistë apo një a disa ekspertë të jashtëm, të cilët veprojnë në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktin e emërimit. Këta persona duhet të jenë të kualifikuar profesionalisht për të ekzaminuar, shqyrtuar dhe raportuar, në përgjithësi ose në lidhje me një çështje specifike, asetet dhe detyrimet e shoqërisë administruese dhe/ose depozitarit, librat e tyre kontabël, llogaritë dhe dokumentet e tjera të evidencave për paratë, titujt ose llojet e tjera të pasurive, të mbajtura për llogari të një personi tjetër, ose çdo çështje tjetër, që AMF-së i duket e rëndësishme për funksionet e subjektit të licencuar.

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Shoqëria administruese dhe depozitari janë të detyruar t'i japin menjëherë autoritetit çdo informacion që kanë në posedim, në rastin kur shoqëria administruese ose depozitari janë në dijeni apo kanë arsye të besojnë se:

a) informacioni është i rëndësishëm për ushtrimin, sipas këtij ligji, të funksioneve të AMF-së për shoqërinë administruese ose depozitarin;

b) mosdhënia e informacionit ka të ngjarë të sjellë si pasojë mashtrimin e AMF-së për ndonjë çështje, e cila është me rëndësi thelbësore për ushtrimin e atyre funksioneve, që lidhen me shoqërinë administruese ose depozitarin.

2. Shoqëria e administrimit dhe eksperti kontabël i jashtëm i shoqërisë administruese kanë detyrimin të informojnë menjëherë AMF-në për çdo çështje, kur ata kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se:

a) shoqëria administruese nuk është në gjendje ose ekziston rreziku që ajo të mos përmbushë detyrimet financiare në kohën e duhur ose që detyrimet e saj kapërcejnë asetet;

b) shoqëria administruese nuk është në gjendje të përmbushë kërkesën për mjaftueshmërinë e kapitalit, të përcaktuara në këtë ligj ose në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

c) gjendja ekzistuese e punëve ose ajo e propozuar mund të rrezikojë thelbësisht të drejtat e mbajtësve të kuotave/aksionarëve të sipërmarrjeve të administruara nga shoqëria administruese.

ç) eksperti kontabël i jashtëm, në lidhje me auditimin, ka për qëllim të bëjë një kualifikim thelbësor në raportin e tij, drejtuar mbajtësve të kuotave/aksionarëve për sipërmarrjen e investimeve kolektive ose shoqërinë administruese.

Raportimet

1. Shoqëria administruese dhe depozitari janë të detyruar t'i paraqesin rregullisht AMF-së raportime për veprimtarinë e tyre. Shoqëritë administruese paraqesin raporte për veprimtarinë e tyre të brendshme, si dhe për administrimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive.

2. AMF-ja miraton një rregullore, ku përcaktohen përmbajtja e raportimeve dhe kufiri kohor, brenda të cilit duhet t'u paraqiten raportimet për sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve.

3. Raportimet e veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe depozitarit, referuar në pikën 1 të këtij neni, janë tremujore, gjashtëmujore, vjetore dhe më të shpeshta, nëse konsiderohen të nevojshme nga AMF-ja.

Likuidimi dhe falimentimi i shoqërisë administruese

1. Likuidimi i shoqërisë administruese rregullohet nga dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Falimentimi i shoqërive administruese rregullohet nga ligji nr.8901, datë 23.5.2002 “Për procedurat e falimentimit”.

3. Në rastin e falimentimit, asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive, të cilat zotërohen nga mbajtësit e kuotave/aksionarët, trajtohen si çdo pasuri tjetër, që është objekt i së drejtës së ndarjes, siç parashikohet në ligjin nr.8901, datë 23.5.2002 “Për procedurat e falimentimit”.

KREU XI
KUNDËRVAJTJET PENALE DHE MASAT NDËSHKIMORE

SEKSIONI 1
SHKELJET DHE MASAT NDËSHKIMORE

Neni 130

Shkeljet dhe masat ndëshkimore

(shtuar shkronja “ë” në pikën 1 me ligjin nr. 36/2016, datë 31.3.2016)

1. Nëse ndodh ndonjë nga rastet e mëposhtme:
 - a) shkelje e rëndë dhe/ose sistematike e dispozitave të këtij ligji nga shoqëria administruese ose depozitari;
 - b) shoqëria e administron sipërmarrjen e investimeve kolektive në kundërshtim me rregullat e fondit, prospektin e tij ose kontratën për administrimin, të lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive;
 - c) banka, që shërben si depozitar për sipërmarrjen e investimeve kolektive, vepron në kundërshtim me kontratën e lidhur me shoqërinë administruese;
 - ç) shoqëria e administrimit ka paraqitur të dhëna false për themelimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive;
 - d) shoqëria ka paraqitur të dhëna false për themelimin e saj si shoqëri administruese;
 - dh) banka ka paraqitur të dhëna false për licencimin si depozitar;
 - e) shoqëria nuk arrin t’i paraqesë AMF-së raportimet, brenda kufirit kohor të parashikuar nga ligji, aktet nënligjore dhe me përmbajtjen e kërkuar;
 - ë) shoqëria administruese shkel rregullat për administrimin e riskut.
AMF-ja merr, të paktën, njërën nga masat e mëposhtme:
 - i) udhëzon shoqërinë administruese dhe/ose depozitarin të marrin masa të veçanta për të ndrequr shkeljen, në mënyrë që administrimi i sipërmarrjeve të investimit kolektiv/shërbimi si depozitar të përputhet me kërkesat ligjore dhe/ose rregullat e fondit;
 - ii) vendos gjoba, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - iii) pezullon ose heq licencën e sipërmarrjes së investimeve kolektive, të shoqërisë administruese dhe/ose depozitarit;
 - iv) urdhëron pagimin e shpenzimeve të arsyeshme, që kryhen nga ekspertë të caktuar nga AMF-ja, për hetimin e shkeljeve, prej subjekteve që hetohen, kur hetimi provon këto shkelje;
 - v) urdhëron subjektet e licencuara për të shkarkuar punonjësit me funksione ekzekutive, përfshirë kontrollorin e brendshëm, ose urdhëron marrjen e masave disiplinore për punonjësit e tjerë;
 - vi) urdhëron organet përkatëse të subjekteve të licencuara të thërrasin mbledhjen e organeve më të larta vendimore, për të diskutuar çështje të rendit të ditës, të përcaktuara nga AMF-ja;
 - vii) urdhëron një emetues, ofertues ose aksionar, me pjesëmarrje të paktën 5 për qind, të japë informacion specifik;
 - viii) urdhëron shoqërinë administruese t’ia kalojë detyrimet kontraktore të papërmblushura një subjekti tjetër, të përcaktuar nga AMF-ja;
 - ix) cakton një përfaqësues të AMF-së të ndjekë nga afër veprimtarinë e përditshme të shoqërisë administruese;
 - x) ndalon, kufizon, cakton kushte për shoqëritë administruese për:
 - çdo pagesë dividendi të bërë;
 - çdo pagesë të bërë për një punonjës me detyrë ekzekutive;
 - dhënien e çdo kredie ose transaksioni të ngjashëm për shoqëri, në të cilat secili nga aksionarët ose punonjësit në detyra ekzekutive ka një interes;
 - zgjatjen e afatit të marrëveshjeve të huave ose kredive të nënshkruara;

- hapjen e degëve të reja, të cilat ushtrojnë shërbime dhe veprimtari të reja;
- xi) urdhëron shoqëritë administruese që:
 - të hartojnë rregullore të reja të brendshme ose të rishikojnë apo të aplikojnë rregulloret ekzistuese, sipas udhëzimeve specifike;
 - të sigurojnë trajnime për punonjësit në detyra ekzekutive ose të punësojnë punonjës në detyra ekzekutive me përvojë dhe njohuritë e duhura;
 - të pakësojnë shpenzimet operationale;
 - të mbajnë mënjatë rezervat e duhura.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, AMF-ja shpall ftesën për paraqitjen e ofertave dhe të aplikimeve për administrimin/shërbimin si depozitar të një sipërmarrjeje të caktuar të investimeve kolektive të shoqëri të tjera administrimi të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe/ose depozitarë të tjerë.

Neni 131

Themelimi i paaautorizuar dhe/ose administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive

1. Çdo person, i cili me dashje angazhohet në një themelim dhe/ose administrim të sipërmarrjes së investimeve kolektive, pa u licencuar nga AMF-ja, ndëshkohet me gjobë nga 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) deri në 800 000 (tetëqind mijë) në lekë. Personi përgjegjës për këtë vepër dënohet me burgim deri në një vit.

2. Nëse, si rezultat i veprës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, subjekti i veprës ka përvetësuar fitime të konsiderueshme ekonomike, ai ndëshkohet me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë. Personi përgjegjës për këtë vepër dënohet me burgim deri në dy vjet.

Neni 132

Veprimtaria e palicencuar si depozitar i një sipërmarrjeje të investimeve kolektive

1. Çdo person, që kryen veprimtarinë e një depozitari të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive, i palicencuar nga autoriteti, ndëshkohet me gjobë nga 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë. Personi përgjegjës për këtë vepër dënohet me burgim deri në një vit.

2. Nëse, si rezultat i veprës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, subjekti i veprës ka përfituar vlera të konsiderueshme ekonomike, ai ndëshkohet me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë. Personi përgjegjës për këtë vepër dënohet me burgim deri në dy vjet.

SEKSIONI 2

MASAT PARANDALUESE

Neni 133

Ndalimi i kryerjes së veprimtarisë tregtare ose transaksioneve për shoqërinë administruese

1. Ndaj shoqërisë administruese ose depozitarit, që kryen një shkelje sipas këtij ligji, përveç sanksioneve të tjera, të vendosura për të, mund të merret dhe një masë parandaluese, për ta ndaluar atë të përfshihet në veprimtaritë e themelimit dhe të administrimit/depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive për një periudhë deri në 2 vjet.

2. Për çdo përsëritje të së njëjtës shkelje, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, autoriteti vendos një masë parandaluese në ngarkim të shoqërisë, për t'i ndaluar asaj kryerjen e veprimtarive

të themelimit dhe administrimit ose të depozitarit të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive, për një periudhë deri në 5 vjet.

Neni 134

Ndalimi për të kryer veprimtarinë tregtare ose transaksionet për personin përgjegjës në shoqërinë administruese

1. Kundër personit përgjegjës të shoqërisë administruese, i cili ka kryer njërën nga veprat e parashikuara në nenet 131 e 132 të këtij ligji, mund të merret një masë parandaluese, për ta ndaluar të veprojë si person përgjegjës në një shoqëri administrimi të sipërmarrjes së investimeve kolektive, për një periudhë deri në 1 vit.

2. Për çdo përsëritje të shkeljes së përmendur në pikën 1 të këtij neni, AMF-ja vendos një masë parandaluese në ngarkim të personit përgjegjës të shoqërive të administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që e ndalon atë të ushtrojë detyrën si person përgjegjës, për një periudhë prej 5 vjetësh.

KREU XII

ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR

Neni 135

Parashkrimi

Afati i parashkrimit për shkeljet e përcaktuara në këtë ligj është 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 136

Ankimi

Vendimet e autoritetit janë objekt ankimimi në gjykatë. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimeve të marra nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 137

Dispozita kalimtare

1. Personat juridikë, të krijuar sipas ligjit nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimit”, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t’i paraqesin AMF-së një aplikim për rilicencim, një deklaratë të hollësishme për numrin e investitorëve të përfshirë, një deklaratë për administrimin, marrëveshjet më të rëndësishme, një deklaratë për investimet e kryera, vlerat e tyre përkatëse, objektivat e investimit dhe informacione të tjera, që mund të kërkojë AMF-ja.

2. Ligji nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimit”, shfuqizohet.

3. AMF-ja nxjerr aktet nënligjore për fondet e investimeve, të krijuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimeve”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha bonot e privatizimit të investuara në fondet e investimit, të krijuara me ligjin nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimeve”, u rishpërndahen individëve. Ministri i Financave me udhëzim rregullon procedurat dhe afatet e rishpërndarjes.

Neni 138
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6368, datë 29.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 236, datë 18.2.2010

PËR MARRJEN NË KONTROLL TË SHOQËRIVE ME OFERTË PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike.

2. Ky ligj zbatohet për ofertat e shpallura publikisht për marrjen në zotërim të titujve, të emetuar nga një shoqëri publike, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në tregun e organizuar të titujve të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, si dhe nga shoqëritë publike të huaja, me seli brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të listuara në bursë në Shqipëri.

3. Ky ligj nuk zbatohet për ofertat për marrjen në zotërim të titujve të emetuar nga shoqëritë, objekti i të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të siguruar nga publiku, që ushtrojnë veprimtari në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe kuotat e të cilave riblihen ose shlyhen, me kërkesë të mbajtësve të tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga pasuritë e këtyre shoqërive. Masat e marra nga shoqëri të tilla, për t'u kujdesur që vlera në bursë e njësive të tyre të mos ndryshojë ndjeshëm nga vlera e aseteve neto të tyre, vlerësohen si ekuivalente të riblerjes ose të shlyerjes.

4. Ky ligj nuk zbatohet për titujt e emetuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administratë e shoqërisë tregtare” janë organet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, në përputhje me parashikimet e shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të nenit 134 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

b) “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

c) “Bashkëpunimi” është veçanërisht, por jo vetëm, veprimi i grupit të shoqërive, i cili përbëhet nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara dhe entitete të tjera, mbi të cilat shoqëria mëmë ose shoqëria e kontrolluar ushtron një influencë dominuese ose një interes pjesëmarrjeje.

ç) “Influencë dominuese” është ndikimi kontrollues i një shoqërie mëmë ose një marrëdhënie ndërmjet një personi dhe shoqërisë:

i) me anë të së cilës personi me influencë ka mundësi për të vendosur për shpërndarjen e të ardhurave të shoqërisë, diversifikimin e fitimit apo të humbjes së një shoqërie tjetër, ose ka ndikim mbi strategjinë e shoqërisë a politikat e saj të biznesit apo të shitjes;

ii) e cila lejon bashkërendimin e menaxhimit të shoqërisë me një shoqëri tjetër për një objektiv të përbashkët, pavarësisht nëse marrëveshja është e fiksuar në dokumentet e themelimit të shoqërisë apo në ndonjë kontratë tjetër;

iii) me anë të së cilës ka ndikim në menaxhimin e përbashkët, nëpërmjet bordit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës apo këshillit të administrimit, i cili përbëhet nga të gjithë ose disa nga personat e njëjtë (të cilët përbëjnë shumicën e nevojshme të vendimmarrjes);

iv) me anë të së cilës personi me influencë është në gjendje të ushtrojë një ndikim të konsiderueshëm në funksionimin e një shoqërie tjetër, pa qenë i përfshirë në kapitalin e saj;

d) “Interes pjesëmarrjeje” është marrëdhënia ndërmjet një personi fizik dhe juridik, përjashtuar influencën dominuese, e cila përbën zotërimin e drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të 20 për qind ose më shumë të të drejtave të votës apo të kapitalit në një shoqëri.

dh) “Kontroll” është marrja në zotërim e të paktën 30 për qind të të drejtave të votës së shoqërisë, objekt i ofertës. Për të vendosur përqindjen e zotërimit, llogariten, në total, kontrolli i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, zotërimi i personave, që veprojnë në bashkëpunim dhe zotërimi i personave të afërm.

e) “Marrja në zotërim” është zotërimi me anë të blerjes apo me ndonjë mënyrë tjetër e aksioneve apo e të drejtave të votës në shoqërinë, objekt i ofertës, përfshirë edhe opsione blerjeje dhe riblerjeje për aksione, të cilat kanë të drejtë vote, opsione blerjeje për kontratat futures ose ushtrimi i së drejtës së votës nëpërmjet pronësisë si përfitues. Zotërimi, përveçse nëpërmjet ofertës së drejtpërdrejtë, të dhënë nga blerësi, merret nga çdo lloj veprimi tjetër, si nëpërmjet trashëgimit apo prishjes së një shoqërie, e cila ndikon në të drejtat e votave të aksioneve apo ndryshon përqindjen e votimit, ose nëpërmjet bashkëpunimit të personave, që veprojnë në bashkëpunim, të cilët kanë si qëllim marrjen në zotërim.

ë) “Ofertë” është oferta e shpallur publikisht, që ka për qëllim zotërimin e titujve të një shoqërie publike kundrejt mjeteve monetare apo në këmbim të titujve të tjerë.

f) “Ofertë e detyrueshme” është oferta që duhet të bëhet detyrimisht, nëse arrihet marrja e kontrollit të një shoqërie publike, sipas nenit 28 të këtij ligji.

g) “Ofertë e shpallur publikisht” është oferta, që bëhet publike me anë të mjeteve masive të komunikimit.

gj) “Ofertë për marrje në kontroll” është oferta e shpallur publikisht për të marrë në zotërim titujt e një shoqërie, objekt i ofertës, nga një ofrues, i cili, së bashku me personat që veprojnë në bashkëpunim, synon të kalojë kufirin e kontrollit për shoqërinë, objekt i ofertës.

h) “Ofertë vullnetare e pjesshme” është oferta, që ka për qëllim marrjen në zotërim të titujve, të cilët nuk i japin ofruesit dhe personave që veprojnë në bashkëpunim me të kontrollin mbi shoqërinë, objekt i ofertës.

i) “Ofruesi” është personi fizik apo juridik, i cili bën një ofertë për të marrë në zotërim titujt e shoqërisë, objekt i ofertës.

j) “Palët e ofertës” janë ofruesi, anëtarët e administratës së ofruesit, kur ky është shoqëri tregtare, shoqëria objekt i ofertës, zotëruesit e titujve të shoqërisë, objekt i ofertës, anëtarët e administratës së shoqërisë, objekt i ofertës, si dhe personat, që veprojnë në bashkëpunim me këto palë.

k) “Person me influencë” është çdo person, që ushtron ndikim mbi të licencuarin, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet, pa kufizim, çdo person që përcakton veprimet e drejtuesve të shoqërisë së rregulluar nga ky ligj, mendimet e të cilëve ndikojnë në procesin e vendimarrjes së të licencuarit.

l) “Persona që veprojnë në bashkëpunim” janë persona fizikë ose juridikë, të cilët bashkëpunojnë me ofruesin apo shoqërinë, objekt i ofertës, në bazë të një marrëveshjeje të heshtur ose të shprehur në mënyrë verbale apo të shkruar, për marrjen e kontrollit të shoqërisë, objekt i ofertës, ose prishjen e rezultatit të suksesshëm të një oferte. Shoqëritë e kontrolluara të ofruesit ose të shoqërisë, objekt i ofertës, sipas kuptimit të nenit 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vlerësohen si persona, që veprojnë në bashkëpunim.

ll) “Shoqëri publike” është shoqëria aksionare me ofertë publike, e cila regjistron aksionet e saj në kuotim burse, në përputhje me nenin 105 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

m) “Shoqëria objekt i ofertës” është shoqëria publike, titujt e së cilës janë objekt i një oferte për marrje në zotërim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

n) “Titujt” janë titujt e transferueshëm me të drejtë vote në shoqëri, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

nj) “Treg i organizuar” është bursa apo një treg tjetër i rregulluar titujsh, i autorizuar, rregulluar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.8.2008 “Për titujt”.

o) “Zotërimi dhe kontrolli jo i drejtpërdrejtë”, është kur aksionet apo të drejtat e votës të një shoqërie janë të kontrolluara nëpërmjet aksioneve apo të drejtat e votës janë të zotëruara nga një shoqëri tjetër në këtë shoqëri (shoqëri e varur). Përmasat e zotërimit dhe kontrollit jo të drejtpërdrejtë përcaktohen duke shumëfishuar aksionet apo të drejtat e votës, të zotëruara nga shoqëria e varur me aksionet e të drejtat e votës, kush është më e madhja, të mbajtura nga shoqëria e varur e shoqërisë, objekt i ofertës. Nëse aksioni apo e drejta e votës është më e lartë se 50 për qind, do të trajtohet si një e plotë.

Neni 3

Parime të përgjithshme

Dispozitat e këtij ligji mbështeten në parimet e mëposhtme:

a) zotëruesit e titujve të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, të cilët i përkasin së njëjtës kategori, trajtohen në mënyrë të njëjtë;

b) nëse personi fizik apo juridik merr kontrollin e shoqërisë, objekt i ofertës mbrojtja e zotëruesve të tjerë të titujve është e garantuar;

c) zotëruesve të titujve të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, u sigurohet koha dhe informacioni i nevojshëm për marrjen e vendimit për ofertën në rastet kur këshillon zotëruesit e titujve, bordi i shoqërisë, objekt i ofertës, jep pikëpamjet e tij në lidhje me efektet e zbatimit të ofertës mbi punësimin, kushtet e punësimit dhe vendndodhjes së zyrave ku kompania ushtron biznesin;

ç) zotëruesi nuk duhet të ftojë aksionarët e shoqërisë, objekt i ofertës, që t'i bëjnë një ofertë për të shitur aksionet e veta;

d) administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, duhet të veprojë në interesin më të mirë të shoqërisë, si një e tërë, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 163 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

dh) krijimi i tregjeve të rreme për titujt e shoqërisë, objekt i ofertës, të shoqërisë që bën ofertën ose të një shoqërie tjetër, të prekur nga oferta, të cilat synojnë rritje apo rënie artificiale të çmimeve të titujve dhe që dëmtojnë funksionimin normal të tregjeve, është i ndaluar;

e) ofruesi bën njoftimin për ofertën vetëm kur garanton se mund të paguajë tërësisht mjetet monetare, nëse ofron të tilla, si dhe vetëm kur ka marrë të gjitha masat e arsyeshme, që garantojnë zbatimin e çdo lloji tjetër pagese;

ë) shoqëria tregtare, objekt i ofertës, nuk duhet të pengohet në ushtrimin e veprimtarisë së vet nga një ofertë për të blerë titujt e saj për një periudhë më të gjatë nga sa është e nevojshme.

Neni 4

Të dhëna për shoqëritë aksionare, subjekte të këtij ligji

1. Shoqëritë aksionare, subjekte të këtij ligji, publikojnë në raport dhe pasqyrat financiare vjetore të dhëna të hollësishme për:

a) strukturën e kapitalit, përfshirë edhe titujt, të cilët nuk pranohen për tregtim në tregun e rregulluar, duke përcaktuar kategoritë e ndryshme të aksioneve dhe për secilën kategori, të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin prej tyre dhe përqindjen e kapitalit aksionar, gjithsej, që përfaqësojnë;

b) kufizimet, nëse ka, për kalimin e titujve, siç janë kufizimet për zotërimin e titujve apo detyrimi për të marrë miratimin e shoqërisë a të zotëruesve të tjerë të titujve;

c) zotërimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta, sipas nenit 206 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

ç) zotëruesit e titujve me të drejta të posaçme kontrolli dhe një përshkrim të këtyre të drejtave;

d) sistemin e kontrollit të skemës së aksioneve të punëmarrësve, nëse ka, kur të drejtat e kontrollit nuk ushtrohen drejtpërdrejt nga punëmarrësit;

dh) normat, që rregullojnë emërimin dhe largimin e administratës së shoqërisë dhe ndryshimin e statutit;

e) kompetencat e anëtarëve të bordit të shoqërisë, në veçanti kompetencat për të emetuar dhe riblerë aksione;

ë) aktmarrëveshjet, ku shoqëria është palë, të cilat hyjnë në fuqi, ndryshojnë ose zgjidhen me ndryshimin e kontrollit të shoqërisë pas një oferte për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve, kur, për shkak të natyrës së tyre, të dhënat për to do të cenojnë rëndë shoqërinë tregtare. Ky përjashtim nuk zbatohet kur shoqëria tregtare ka detyrimin specifik për t'i bërë të ditura të dhëna të tilla në bazë të kërkesave të tjera ligjore, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

f) aktmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë tregtare dhe anëtarëve të këshillit apo punëmarrësve të saj, ku parashikohet kompensim, nëse ata, përkatësisht, japin dorëheqjen ose kur shkurtohet vendi i tyre i punës pa shkak të arsyeshëm, apo kur zgjidhen marrëdhëniet e punës me ta, për shkak të një oferte për marrje në kontroll.

g) çdo kufizim në të drejtat e votimit, si kufizimet e të drejtave të votimit të zotëruesve të një përqindjeje ose numri të caktuar të votave, afatet për ushtrimin e të drejtave të votimit ose sistemet, përmes të cilave, në bashkëpunim me kompaninë, të drejtat financiare që lidhen me titujt janë të ndara nga zotëruesit e titujve;

gj) çdo marrëveshje ndërmjet zotëruesve të aksioneve, të njohura nga kompania dhe që mund të rezultojnë në kufizime të transferimit të aksioneve dhe/ose të drejtave të votimit.

2. Administrata e shoqërisë, në mbledhjen vjetore të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, paraqet një relacion shpjegues për çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti miraton rregullore për të përcaktuar të dhënat shtesë, që mund të përfshihen në raportin dhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërive aksionare.

KREU II OFERTAT PËR MARRJE NË KONTROLL

Neni 5 **Pjesëmarrësit e ofertës**

1. Oferta për marrje në kontroll i drejtohet të gjithë aksionarëve të shoqërisë, objekt i ofertës, për të gjitha aksionet e shoqërisë.
2. Për të krijuar një përqindje kontrolluese, të drejtat e votës të personave, që veprojnë në bashkëpunim me ofruesin, vlerësohen si të drejta vote të vetë ofruesit.

Neni 6 **Njoftimi i vendimit për të bërë ofertën**

1. Përpara se të bëjë ofertën e marrjes në kontroll, ofruesi njofton me shkrim Autoritetin dhe administratorët e shoqërisë, objekt i ofertës.
2. Vendimi për bërjen e ofertës shpallet në faqen e internetit të ofruesit, në rastin kur lidhet me një person juridik, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në rastin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në regjistrin përkatës të titujve dhe në mjetet zyrtare të informimit të tregut të organizuar të titujve, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.
3. Ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, njoftojnë për vendimin për bërjen e ofertës punëmarrësit dhe, në rastin e shoqërive, këshillat e punëmarrësve të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 7 **Përgatitja dhe publikimi i dokumentit të ofertës**

1. Ofruesi, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit për bërjen e ofertës, i paraqet Autoritetit për miratim dokumentin e ofertës.
2. Dokumenti i ofertës përmban, të paktën, të dhënat:
 - a) e identifikimit të ofruesit dhe, kur ofruesi është shoqëri tregtare, formën, emrin dhe selinë e regjistruar të kësaj shoqërie;
 - b) për emrin, selinë e regjistruar dhe formën e shoqërisë, objekt i ofertës;
 - c) e identifikimit të personave, që veprojnë në bashkëpunim me ofruesin ose me shoqërinë tregtare, objekt i ofertës dhe, në rastin e shoqërive tregtare, formën e tyre, emrin, selinë e regjistruar dhe marrëdhënien me ofruesin apo shoqërinë tregtare objekt i ofertës;
 - ç) për zotërimi ekzistuese të titujve nga ofruesi apo për persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, në shoqërinë tregtare, objekt i ofertës, nëse ka;
 - d) për titujt dhe, nëse ka, kategoritë e titujve, për të cilat bëhet oferta;
 - dh) për përqindjet apo sasi të maksimale dhe minimale të titujve, që ofruesi propozon të blejë;
 - e) për llojin dhe masën e pagesës së ofruar për çdo titull dhe, kur pagesa e ofruar përfshin aksione, të dhëna për vlerën mesatare të ponderuar të tregut të këtyre aksioneve gjatë 12 muajve të fundit, si dhe për të drejtat e votës që mbartin;
 - ë) për vlerën e huasë së kërkuar nga ofruesi për të financuar ofertën për marrjen në kontroll, masat e marra nga ai për të garantuar financimin e ofertës, si dhe pasojat që pritet të ketë pranimi i ofertës në gjendjen financiare të ofruesit;
 - f) për kushtet dhe afatet, të cilave u nënshtrohet oferta për marrje në kontroll;
 - g) për synimet e ofruesit për veprimtarinë tregtare të ardhshme të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës dhe, për aq sa preket nga oferta, të shoqërisë ofruese, masat mbrojtëse që synohen të merren për ruajtjen e vendeve të punës të punonjësve dhe të administratorëve, si dhe

ndryshimet materiale në kushtet e marrëdhënieve të punës. Këtu përfshihen, në veçanti, planet strategjike të ofruesit për të dy shoqëritë tregtare, si edhe pasojat e mundshme për marrëdhëniet e punës dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërive;

gj) për kohën e lejuar për pranimin e ofertës për marrje në kontroll;

h) për masat, që duhet të merren nga zotëruesit e titujve, për të pranuar ofertën dhe për të marrë pagesën përkatëse për to;

i) për qëllimin e ofruesit lidhur me të drejtën për të larguar aksionarët e vegjël, të parashikuar në nenin 25 të këtij ligji, nëse arrihet pragu i përcaktuar;

j) për ligjin, që do të zbatohet për kontratat, që do të lidhen si rezultat i ofertës ndërmjet ofruesit dhe zotëruesve të titujve të shoqërisë tregtare objekt i ofertës, si dhe gjykatën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3. Dokumenti i ofertës publikohet menjëherë pas miratimit nga Autoriteti. Nëse Autoriteti, brenda 10 ditëve pune pas marrjes së dokumentit të ofertës, nuk shprehet për dokumentin e ofertës, atëherë miratimi i këtij dokumenti do të merret si i mirëqenë dhe ofruesi ka të drejtë ta publikojë atë menjëherë pas përfundimit të afatit 10-ditor. Për publikimin e dokumentit të ofertës zbatohen parashikimet e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji.

4. Ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, njoftojnë për dokumentin e ofertës punëmarrësit apo, në rastin e shoqërive tregtare, këshillat e punëmarrësve të tyre.

5. Kur nga përfitimi i kontrollit, që parashikohet të ndodhë, si rezultat i publikimit të dokumentit të ofertës, mund të krijohet një përqendrim, në kuptim të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për këtë përqendrim për të marrë autorizimin, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji.

Neni 8

Këshillimi i paanshëm, komitetet e pavarura dhe miratimi nga aksionarët

1. Bordi drejtues i një shoqërie, objekt i ofertës, kur ekziston mundësia e marrjes së një oferte, angazhon një këshilltar financiar të paanshëm për t'u këshilluar, nëse oferta është e pandershme dhe e paarsyeshme. Kjo këshillë, përfshirë edhe arsyetimet, duhet marrë me shkrim dhe, së bashku me rekomandimin e bordit drejtues të shoqërisë, objekt i ofertës, për pranimin e ofertës, u bëhet e njohur aksionarëve, nëpërmjet përfshirjes së saj në dokumentin e përgjigjes së ofertës. Nëse ndonjëri nga drejtuesit e shoqërisë, objekt i ofertës, është në konflikt interesash, bordi i kësaj shoqërie krijon një komitet të pavarur, për të shmangur përgjegjësinë e vet për ofertën.

2. Nëse ndonjëri nga drejtuesit e bordit të shoqërisë ofruese është në konflikt interesash, si rezultat i ofertës së bërë, bordi i kësaj shoqërie krijon një komitet të pavarur, për të bërë vlerësimin e ofertës së propozuar. Nëse konflikti është i natyrës materiale, Autoriteti vendos, ndër të tjera, nëse do të jetë i nevojshëm angazhimi i një këshilltari të paanshëm financiar nga bordi i shoqërisë ofruese për të këshilluar, sipas rastit, aksionarët e vet, si edhe nëse oferta duhet të jetë e kushtëzuar nga miratimi i shumicës së votave të dhëna nga këta aksionarë, qoftë duke qenë vetë të pranishëm ose të përfaqësuar nga persona të tjerë, në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve të kësaj shoqërie.

3. Një person, i cili ka ose ka pasur një lidhje financiare apo të një lloji tjetër me shoqërinë ofruese a shoqërinë, objekt i ofertës, e cila është e një natyre, që shkakton konflikt interesash, vlerësohet person i papërshtatshëm për dhënien e këshillës së paanshme.

4. Një këshilltar financiar nuk mund të vlerësohet i pavarur, nëse ka marrëdhënie me shoqërinë ofruese apo atë, objekt i ofertës, ose me aksionarët kryesorë të secilës prej tyre, të cilët cenojnë objektivitetin e këshillës që jep. Në qoftë se ka aksionarë në secilën shoqëri që nuk janë të paanshëm, sepse kanë interesa të tjerë në transaksionin e propozuar, të ndryshëm nga interesi i të qenit aksionar, këshilltari i paanshëm duhet të përpiqet për të mbrojtur interesat e shoqërisë ofruese dhe të shoqërisë, objekt i ofertës, duke u kujdesur vetëm për interesat e aksionarëve të

paanshëm, të cilët nuk kanë asnjë interes tjetër në transaksionin e propozuar, përveç interesit si aksionar.

5. Komiteti i pavarur i bordit të një shoqërie përbëhet nga drejtues, të cilët nuk kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ofertën që shqyrtojnë, përveç interesit si aksionar i shoqërisë, objekt i ofertës. Për këtë arsye, punonjësit e një shoqërie, objekt i ofertës, që janë të lidhur me shoqërinë ofruese, vlerësohen se kanë interes të tërthortë e për këtë arsye nuk janë të pavarur. I njëjti përcaktim vlen për punonjësit, drejtuesit, agjentët, partnerët, të afërmit dhe të lidhurit me ndonjë person, që ushtron kontroll apo drejtim për veprimtarinë e shoqërisë, objekt i ofertës, nëse një person i tillë ka interes të drejtpërdrejtë në ofertë. Për këtë qëllim, quhet “person i lidhur”, personi që kontrollon, kontrollohet ose është në të njëjtin kontroll, së bashku me personin në fjalë. Në raste paqartësie bëhet këshillimi i nevojshëm me Autoritetin. Nëse komiteti i bordit të drejtuesve në fakt nuk është i pavarur, ai nuk karakterizohet si i tillë. Në qoftë se është i pamundur krijimi i një komiteti të pavarur, përgjegjësia për ruajtjen e interesave të aksionarëve të pavarur i takon kryesisht këshilltarit të pavarur.

Neni 9

Ofertat e ndaluara

Autoriteti ndalon ofertën për marrjen në kontroll nëse:

a) ofruesi nuk ka paraqitur dokumentin e ofertës brenda 10 ditëve nga data e publikimit të vendimit për bërjen e një oferte;

b) dokumenti i ofertës nuk përmban elementet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji;

c) informacioni, që përmban dokumenti i ofertës, bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

ç) ofruesi nuk e ka publikuar dokumentin e ofertës, në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji.

2. Autoriteti këshillon dhe diskuton me ofruesin çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, për të korrigjuar veprimet apo mosveprimet e tij, që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Në rast se oferta për marrjen në kontroll nuk lejohet në bazë të pikës 1 të këtij neni dhe kur oferta ndalohet nga Autoriteti i Konkurrencës, dokumenti i ofertës nuk publikohet.

4. Kontrata për blerjen e titujve të shoqërisë, objekt i ofertës, që mbështetet në një ofertë të ndaluar, është e pavlefshme. Nëse kontrolli apo zotërimi merret në mënyrë të paligjshme, atëherë marrësi nuk mund të ushtrojë të drejtat, që rrjedhin nga aksionet (përfshirë të drejtat e votës edhe të drejtën për të marrë dividend), derisa ai të përfundojë kontrollin apo zotërimin e tij, të cilin e ka marrë duke shkelur dispozitat e këtij ligji, duke shitur sasinë e duhur të aksioneve.

Neni 10

Përgjegjësia për vërtetësinë e dokumentit të ofertës

Ofruesi mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara aksionarëve, të cilët e kanë pranuar ofertën, nëse, brenda 2 vjetëve pas përfundimit të ofertës për marrjen në kontroll, këta aksionarë paraqesin prova se dokumenti i ofertës ishte i pasaktë dhe i paplotë, me përjashtim të rasteve kur ofruesi provon se:

a) nuk ka qenë në dijeni të këtyre mangësive, pavarësisht përpjekjeve kërkimore të arsyeshme;

b) aksionarët, të cilët kanë pranuar ofertën, kanë qenë në dijeni ose rrethanat kanë qenë aq të dukshme sa ato duhet të ishin në dijeni të këtyre mangësive.

Neni 11

Kushtet dhe revokimi

1. Oferta për marrjen në kontroll përmban kushte, në rastet kur realizimi i tyre nuk varet vetëm nga ofruesi ose personat që veprojnë në bashkëpunim me të.

2. Ofruesi revokon ofertën për marrje në kontroll, përveçse kur ka përfunduar periudha kohore e lejuar për të pranuar ofertën, por edhe atëherë vetëm nëse njëra nga kushtet e lejuara të ofertës për marrjen në kontroll nuk është përmbushur apo nuk është hequr dorë.

Neni 12

Koha e lejuar për pranimin e ofertës

1. Koha e lejuar për pranimin e ofertës për marrje në kontroll nuk duhet të jetë më pak se 3 javë dhe më shumë se 10 javë nga data e publikimit të dokumentit të ofertës.

2. Nëse shoqëria, objekt i ofertës, thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për të vendosur për ofertën për marrjen në kontroll, koha e lejuar për pranimin është 10 javë nga data e publikimit të dokumentit të ofertës. Administratori i shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë ofruesin dhe Autoritetin për thirrjen e asamblesë së përgjithshme. Ofruesi publikon menjëherë këtë informacion, në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme, sipas pikës 2 të këtij neni, thirret jo më vonë se 21 ditë kalendarike para datës së parashikuar për mbajtjen e mbledhjes së kësaj asambleje, por me kusht që mbledhja të mos zhvillohet 21 ditë para datës së publikimit të dokumentit të ofertës. Ky afat është i vlefshëm edhe për informacionin që vihet në dispozicion të aksionarëve, në bazë të pikës 3 të nenit 137 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 13

Çmimi i drejtë

1. Ofruesi duhet të ofrojë një çmim të drejtë për aksionet e të njëjtit lloj apo kategori të shoqërisë, objekt i ofertës. Çmimi, përkatësisht, vlera shkëmbyese e ofertës për të marrë në kontroll nuk duhet të jetë më e ulët se vlera më e lartë e:

a) çmimit të drejtë të aksioneve të llogaritura në bazë të mënyrave të vlerësimit, të pranuar dhe të njohura nga të gjithë;

b) çmimit mesatar të ponderuar të tregut të aksioneve për 3 muajt e fundit;

c) çmimit më të lartë për çdo aksion, i paguar nga ofruesi ose nga persona, që veprojnë në bashkëpunim me të gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, përpara datës së bërjes së ofertës për marrje në kontroll. Në rast se çmimi i aksionit nuk mund të përcaktohet sipas kësaj mënyre, ai përcaktohet si çmimi më i lartë ndërmjet vlerës së fundit të emetimit dhe vlerës së fundit të paguar nga ofruesi.

2. Autoriteti nxjerr rregulla të detajuara për mënyrën e përcaktimit të çmimit të drejtë.

3. Pagesa e ofruar nga ofruesi është në mjete monetare ose në aksione të tregtueshme në tregun e organizuar, nëse aksionet janë mjaftueshmërisht likuide dhe aktive. Zotëruesve të aksioneve me të drejtë vote u ofrohen si kundërvlerë aksione me të drejtë vote.

4. Ofruesi ofron mjete monetare, kur ai ose personat që veprojnë në bashkëpunim me të, kanë blerë me mjete monetare të paktën 5 për qind të aksioneve ose të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, gjatë gjashtë muajve të fundit përpara datës së publikimit të vendimit për të bërë ofertën.

5. Nëse ofruesi apo personat që veprojnë në bashkëpunim me të, brenda 1 viti nga data e publikimit të dokumentit të ofertës, kanë marrë aksione të shoqërisë, objekt i ofertës, me një çmim më të lartë se ai i parashikuar në ofertë, ofruesi u paguan aksionarëve, të cilët kanë pranuar ofertën, diferencën e çmimit. Ky rregull nuk zbatohet:

a) nëse aksionet janë marrë në përmbushje të një detyrimi ligjor për të dëmshpërblyer aksionarët e shoqërisë, objekt i ofertës;

b) në rastin e blerjes së aktiveve të shoqërisë, objekt i ofertës, gjatë një bashkimi ose ndarje shoqërishe, sipas parashikimeve të nenit 214 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

c) në rastin e ushtrimit të një të drejte parablerjeje gjatë zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, objekt i ofertës, në përputhje me nenin 174 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 14

Vlerësimi nga administrata dhe këshilli i punëmarrësve të shoqërisë, objekt i ofertës

1. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, brenda 10 ditëve nga data e publikimit të dokumentit të ofertës apo të ndryshimeve të bëra në të, harton dhe publikon një dokument, ku paraqet opinionin e vet për ofertën për marrje në kontroll, duke analizuar pasojat që mund të ketë zbatimi i ofertës mbi interesat e shoqërisë, përfshirë dhe pasojat në marrëdhëniet e punës. Ky dokument përmban edhe pasojat që mund të kenë për shoqërinë tregtare, objekt i ofertës, planet strategjike të parashikuara nga ofruesi në dokumentin e ofertës, duke përfshirë këtu edhe pasojat e mundshme të këtyre planeve për marrëdhëniet e punës dhe vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në këtë dokument jepen edhe arsyet, për të cilat administrata e shoqërisë tregtare mbështet opinionin e mësipërm.

2. Administrata ia komunikon, në të njëjtën kohë, këtë opinion edhe këshillit të punëmarrësve, i cili harton një opinion të veçantë për pasojat e ofertës për marrjen në kontroll në marrëdhëniet e punës, që i bashkëlidhet opinionit të hartuar nga administrata.

3. Dokumenti publikohet në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 15

Veprimet që kryen administrata e shoqërisë, objekt i ofertës

Nga çasti i publikimit të vendimit për të bërë ofertën, deri në çastin e publikimit të rezultateve, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, nuk duhet të kryejë veprime, të cilat mund të pengojnë realizimin e ofertës për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve kur:

a) këto veprime, sipas neneve 163 e 167 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, do të kryheshin nga administrata e një shoqërie në përmbushje të detyrave të veta, edhe nëse shoqëria nuk do të kishte marrë një ofertë për marrje në kontroll;

b) administrata kërkon një ofertë alternative.

Neni 16

Kufizim me zgjedhje i masave mbrojtëse

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar votash, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendos moszbatimin e nenit 15 të këtij ligji.

2. Në këtë rast, pas publikimit të vendimit për të bërë ofertën, deri në çastin e publikimit të rezultateve, administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, nuk mund të kryejë veprime, të cilat çojnë në pengim të ofertës për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve kur:

a) veprimet janë autorizuar nga asambleja e përgjithshme, pas publikimit të vendimit për të bërë ofertën;

b) veprimet janë pjesë e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë;

c) veprimet nuk bëjnë pjesë në ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, por kryhen në zbatim të

vendimeve të marra përpara datës së publikimit të vendimit, për të bërë ofertën dhe kanë filluar të zbatohen para kësaj date;

c) administrata kërkon një ofertë alternative.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi i asamblesë publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

Neni 17

Moszbatimi i kufizimeve në lidhje me kalimin e aksioneve

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar votash, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendos zbatimin e normave të mëposhtme:

a) gjatë kohës së lejuar për pranimin e ofertës për marrjen në kontroll, të mos zbatohen ndaj ofruesit kufizimet e vendosura për kalimin e aksioneve, të parashikuara në statutin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në aktmarrëveshjet e bëra ndërmjet shoqërisë, objekt i ofertës dhe zotëruesve të aksioneve të saj ose në kontratat ndërmjet zotëruesve të aksioneve të një shoqërie, objekt i ofertës.

b) kur, pas një oferte për marrjen në kontroll, ofruesi ka 75 për qind ose më shumë të kapitalit me të drejtë vote, kufizimet për kalimin e aksioneve, të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike dhe të drejtat e jashtëzakonshme të aksionarëve për emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të këshillit, të parashikuara në statutin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, nuk zbatohen në mbledhjen e parë të asamblesë së përgjithshme të thirrur nga ofruesi, me qëllim për të bërë shtesa dhe ndryshime në statut apo për të shkarkuar ose emëruar anëtarë të administratës. Për këtë qëllim, ofruesi ka të drejtën ta thërrasë, brenda një periudhe shumë të shkurtër, asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

2. Parashikimet e shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për aksionet me përparësi pa të drejtë vote.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni. Vendimi publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

4. Kur në bazë të pikës 1 të këtij neni u janë shkelur të drejtat, zotëruesit e këtyre të drejtave mund t’i kërkojnë ofruesit dëmshpërblim për çdo humbje të shkaktuar. Shuma minimale e dëmshpërblimit duhet të përcaktohet në dokumentet e themelimit të shoqërisë, objekt i ofertës, dhe nuk duhet të tejkalojë vlerën e kapitalit të kësaj shoqërie shumëzuar me numrin e të drejtave të votës, që kanë aksionet me përparësi. Dëmshpërblimi duhet të paguhet nga ofruesi në mjete monetare jo më vonë se 8 ditë pune pas datës së përfundimit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

5. E drejta për të kërkuar këtë dëmshpërblim mund të zbatohet me vendim gjykate deri në përfundimin e një periudhe 2-mujore pas shkeljes së të drejtave.

6. Pikat nga 1 deri në 4 të këtij neni nuk zbatohen në rastin kur një autoritet i pushtetit qendror ose vendor zotëron tituj të shoqërisë, objekt i ofertës, të cilët u japin të drejta të veçanta, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Neni 18

Zbatimi i reciprocitetit

1. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë, objekt i ofertës, e cila ka vendosur moszbatimin e nenit 15 të këtij ligji, mund të vendosë që ky nen të zbatohet, nëse ofruesi ose shoqëria mëmë e

ofruesit, në përputhje me nenin 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk i nënshtrohet dispozitave të barazvlefshme me nenin 16 të këtij ligji.

2. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë, objekt i ofertës, e cila ka vendosur për zbatimin e normës së kapërcimit të kufirit, të parashikuar në nenin 17 të këtij ligji, mund të vendosë për moszbatimin e kësaj norme, nëse ofruesi ose shoqëria mëmë e ofruesit, në përputhje me nenin 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk i nënshtrohet një norme të tillë.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e asamblesë së përgjithshme, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni. Vendimi publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

Neni 19

Ndryshimi i ofertës

1. Ofruesi, deri në një ditë pune përpara përfundimit të afatit të lejuar për pranimin e ofertës, mundet:

- a) të rrisë çmimin;
- b) të ofrojë një çmim alternativ, me vlerë të barabartë;
- c) të zvogëlojë sasinë minimale të aksioneve ose të të drejtave të votës, të cilat duhen marrë për ta quajtur të suksesshme ofertën për marrje në kontroll;
- ç) të revokojë ndonjë kusht, nëse ka.

2. Ndryshimet e ofertës për marrje në kontroll njoftohen menjëherë, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji e nëse ky publikim bëhet brenda 8 ditëve pune përpara përfundimit të afatit të lejuar për pranimin e ofertës, afati i pranimit të ofertës së ndryshuar shtohet me, të paktën, 8 ditë pune pas datës së këtij publikimi.

3. Aksionarët, që e kanë pranuar ofertën përpara çastit të ndryshimit të saj, mund të tërhiqen nga kontrata deri në mbarimin e afatit të lejuar për pranimin.

Neni 20

Ofertat konkurruese

1. Oferta konkurruese për marrje në kontroll janë ofertat e bëra nga të tretët gjatë kohës së lejuar për pranimin e ofertës për marrjen në kontroll. Çdo person ka të drejtë të bëjë një ofertë tjetër për të marrë në kontroll, brenda ditës së 15-të, pas përfundimit të periudhës, brenda së cilës duhet të bëhet deklarata e pranimit.

2. Oferta konkurruese publikohet dhe miratohet nga Autoriteti, nëse për aksionarët është më e favorshme se oferta për marrjen në kontroll apo se një ofertë tjetër e mëparshme konkurruese. Një ofertë konkurruese vlerësohet si më e favorshme, nëse çmimi i përcaktuar me mjete monetare është, të paktën, 5 për qind më i lartë. Nëse jepet një tjetër ofertë konkurruese, ajo vlerësohet më e favorshme, nëse çmimi i saj, i përcaktuar në mjete monetare, është, të paktën, 5 për qind më i lartë se çmimi i ofertës së mëparshme konkurruese. Nëse një ofertë e re konkurruese ndryshon nga oferta e mëparshme konkurruese vetëm në lidhje me çmimin e përcaktuar, Autoriteti vendos për miratimin e saj brenda 3 ditëve pune.

3. Kur oferta konkurruese miratohet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përgjithshme, oferta e mëparshme dhe deklarata e pranimit e saj vlerësohen të pavlefshme.

Neni 21

Transaksione me titujt e shoqërisë, objekt i ofertës

Pas publikimit të dokumentit të ofertës, ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, së bashku me personat që veprojnë në bashkëpunim me to, njoftojnë menjëherë Autoritetin dhe publikojnë, në

përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, të dhënat për çdo shitje ose marrje në zotërim të titujve të shoqërisë, objekt i ofertës.

Neni 22

Publikimi i rezultatit të ofertës

1. Ofruesi, pas mbarimit të kohës së lejuar për pranimin, publikon rezultatin e ofertës, në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Shoqëria aksionare, pavarësisht detyrimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, regjistron kalimin e aksioneve në regjistrin e aksioneve të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në regjistrin e titujve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 23

Ndalimi i ofertave të mëpasshme

1. Në rast të mbylljes pa sukses të një oferte, ofruesi dhe personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të bëjnë një ofertë tjetër për titujt e shoqërisë, objekt i ofertës, brenda 1 një viti nga publikimi i rezultatit të ofertës.

2. Oferta vlerësohet e pasuksesshme nëse:

- a) Autoriteti nuk e ka miratuar;
- b) Autoriteti e ka ndaluar;
- c) nuk është realizuar ndonjë nga kushtet e vendosura nga ofruesi, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 24

Pagesat e paligjshme

Ofruesi ose personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk duhet të japin apo të premtojnë pagesa a përparësi për administratën e shoqërisë, objekt i ofertës, nëse këto nuk janë parashikuar në përmbajtjen e dokumentit të ofertës.

Neni 25

E drejta për të kontrolluar gjithë shoqërinë

1. Ofruesi, i cili, në kuadër të një oferte për marrje në kontroll, ka marrë të paktën 90 për qind të kapitalit që mbart të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, duhet që, brenda 3 muajve nga mbarimi i afatit të lejuar për pranimin e ofertës, t'u kërkojë zotëruesve të aksioneve të mbetura me të drejtë vote t'ia shesin atij këto aksione kundrejt një kundërvlere me kushte të barabarta, vetëm nëse në dokumentin e ofertës është parashikuar një qëllim i tillë i ofruesit, sipas shkronjës “h” të nenit 7 të këtij ligji. Nëse ofruesi zotëron 90 për qind të të gjitha aksioneve, që mbartin të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, ai mund të kërkojë edhe blerjen e aksioneve të mbetura me përparësi dhe çdo aksion tjetër pa të drejtë vote, që i shiten atij.

2. Pagesa për aksionet që kërkohen të merren, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në të njëjtën formë si pagesa e ofruar në ofertën për të marrë në kontroll dhe vlera është ajo e caktuar në një ofertë për marrjen në kontroll (ofertë vullnetare) ose vlera e kapitalit për çdo aksion, cila vlerë të jetë më e madhja.

Neni 26

E drejta e aksionarëve të vegjël për t'u larguar

1. Zotëruesit e aksioneve të mbetura me të drejtë vote kanë të drejtë që, brenda 3 muajve nga mbarimi i afatit të lejuar për pranimin e ofertës, t'i kërkojnë ofruesit të blejë aksionet, kundrejt çmimit të ofruar, në kuadër të ofertës për marrjen në kontroll, nëse ky ofrues ka marrë, të paktën, 90 për qind të kapitalit që mbart të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës së shoqërisë, objekt i ofertës. Nëse ofruesi zotëron 90 për qind të të gjitha aksioneve, këtë të drejtë e gëzojnë edhe zotëruesit e aksioneve të mbetura me përparësi pa të drejtë dhe të gjitha aksionet e tjera pa të drejtë vote. Për formën dhe vlerën e pagesës, në këtë rast, zbatohet rregulli i parashikuar në pikën 2 të nenit 25 të këtij ligji.

2. Kur, si rezultat i një oferte për marrje në kontroll, ofruesi merr 90 për qind të aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, nuk zbatohen parashikimet e nenit 212 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 27

Ofertat vullnetare të pjesshme

1. Për ofertat vullnetare të pjesshme, të cilat kanë për qëllim marrjen në zotërim të një pjese të aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, që nuk arrin kufirin e kontrollit, zbatohen nenet 6 deri në 14 dhe 19 deri në 24 të këtij ligji.

2. Nëse aksionarët, që pranojnë ofertën, përfaqësojnë më shumë aksione se ato që kishte si synim të blinte ofruesi, ata duhet të trajtohen në mënyrë përpjesëtimore.

KREU III

OFERTAT E DETYRUESHME

Neni 28

Detyrimi për të bërë një ofertë dhe për ta publikuar atë

1. Kur ofruesi, vetë ose së bashku me persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, merr në zotërim tituj të shoqërisë, objekt i ofertës, të cilët, nëse mblidhen me titujt, që zotëronin para ofertës, i japin atij një përqindje të drejtash vote, të cilat i mundësojnë kontrollin mbi shoqërinë në fjalë, ofruesi, brenda 7 ditëve, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, njofton dhe publikon këtë fakt, si dhe, në mënyrë të saktë, të drejtat e votës që zotëron. Afati i mësipërm fillon nga dita kur ofruesi vihet në dijeni ose, në bazë të rrethanave, duhet të ishte në dijeni për fitimin e kontrollit mbi shoqërinë, objekt i ofertës.

2. Brenda 10 ditëve nga data e publikimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i paraqet për miratim Autoritetit një dokument oferte dhe e publikon atë në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji.

3. Oferta u drejtohet të gjithë zotëruesve të mbetur të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë.

4. Kur kontrolli është ndërmarrë në bazë të një oferte vullnetare, të publikuar në përputhje me nenin 7 të këtij ligji dhe drejtuar të gjithë zotëruesve të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë, detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, për publikimin e ofertës, nuk zbatohet.

5. Të drejtat, që rrjedhin prej aksioneve të zotëruara nga ofruesi ose nga personat që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të ushtrohen, nëse nuk janë përmbushur kërkesat e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni.

6. Dispozitat e kreut II të këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të bëra në nenet 11 pika 1, 23 e 27 të tij, zbatohen edhe për kreun III, nëse në to nuk parashikohet ndryshe.

Neni 29

Përrjashtime nga detyrimi për të bërë ofertë

1. Nëse si rezultat i blerjes së aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, ofruesi apo personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk marrin kontrollin e shoqërisë dhe nuk ndryshon personi që ka kontrollin e shoqërisë, objekt i ofertës, atëherë ofruesi nuk ka detyrim për të bërë një ofertë, por duhet të njoftojë Autoritetin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij ligji.

2. Pavarësisht se nuk është e detyrueshme të bëhet ofertë, Autoriteti duhet të njoftohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij ligji edhe në rastet kur:

a) një aksionar tjetër ose persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, zotërojnë, të paktën, të njëjtën sasi të drejtash vote të shoqërisë, objekt i ofertës, me ofruesin;

b) përqindja e aksioneve që japin kontrollin kalohet vetëm përkohësisht ose pa paramendim dhe ulet menjëherë sapo ofruesi të vihet në dijeni të këtij fakti;

c) aksionet janë marrë përmes dhurimit, trashëgimisë apo ndarjes së pasurisë;

ç) aksionet janë marrë për ristrukturim, nëse shoqëria, objekt i ofertës, është në krizë ose nëse një grup shoqëri është në krizë, sipas neneve 206 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Autoriteti, brenda 10 ditëve nga marrja e informacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund t’i kërkojë ofruesit të bëjë një ofertë, nëse, për shkak të rrethanave të rastit, e vlerëson të nevojshme ofertën për të ruajtur interesat e shoqërisë, objekt i ofertës, apo të aksionarëve të saj.

4. Nuk zbatohet detyrimi për të bërë një ofertë për operacionet e riorganizimit të parashikuar në nenin 214 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KREU IV

DISPOZITA PROCEDURALE

Neni 30

Kompetenca e Autoritetit dhe bordit të tij

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është përgjegjës për:

a) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, në përputhje me objektivat e parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”;

b) marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e të metave, që mund të lindin gjatë procedurës së ofertës për marrjen në kontroll.

2. Autoriteti miraton rregulloret e nevojshme, në zbatim të këtij ligji.

Neni 31

E drejta për ankim

Vendimet e Autoritetit janë objekt ankimi në gjykatë. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimeve të marra nga Autoriteti në zbatim të këtij ligji.

Neni 32

Bashkëpunimi ndërkombëtar i autoriteteve

1. Autoriteti krijon marrëdhënie ose hyn në marrëveshje mirëkuptimi me çdo autoritet mbikëqyrës, vendas apo të huaj, me mbikëqyrës të sektorit financiar, agjenci kundër pastrimit të parave apo çdo institucion tjetër, për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe shkëmben informacion me këto autoritete, sa herë e shih të nevojshme, për arsye të përmbushjes së funksioneve të përcaktuara nga dispozitat e këtij ligji.

2. Bashkëpunimi përfshin të drejtën për të dhënë dokumentet ligjore të nevojshme për vënien në zbatim të masave të marra nga autoritetet kompetente për ofertat, si edhe ndihmën në fusha të tjera, sipas kërkesës së autoriteteve mbikëqyrëse, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara nga Autoriteti.

KREU V SANKSIONET

Neni 33

Pezullimi i të drejtave

Të drejtat e aksioneve, që zotërohen nga ofruesi ose personat, të cilët veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të ushtrohen për sa kohë nuk përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 34

Kundërvajtje administrative

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia:

a) mospublikimi ose dhënia e informacionit apo mospublikimi ose dhënia e informacionit të pasaktë e të paplotë e jo brenda afatit, në përputhje me:

- i) nenet 6 pikat 1 e 2, 7 pika 3, 28 pikat 1 e 2 e 29 të këtij ligji;
- ii) nenet 12 pikat 2 e 3, 14 pika 3, 19 pika 2, 21 e 22 pika 1 të këtij ligji;
- iii) nenet 6 pika 3, 7 pika 4 e 14 pika 2 të këtij ligji;
- iv) nenet 16 pika 3, 17 pika 3 e 18 pika 3 të këtij ligji;
- v) pikën 2 të nenit 36 të këtij ligji;

b) mosparaqitja e një dokumenti oferte, sipas kërkesave të pikave 1 e 2 të nenit 1 të këtij ligji, ose paraqitja e pasaktë, e paplotë ose jashtë afati e këtij dokumenti;

c) publikimi i ofertës, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji;

ç) veprimi në kundërshtim me nenin 15 ose 16 pika 2 shkronja “a” të këtij ligji;

d) bërja e një oferte në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji;

dh) premtimi i avantazheve, pa i bërë të ditura ato, sipas parashikimeve të nenit 24 të këtij ligji;

e) ushtrimi i së drejtës për të larguar aksionarët e vegjël nga shoqëria pa e bërë të ditur, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 26 të këtij ligji.

2. Autoriteti zbaton sanksionet e mëposhtme:

a) shkeljet e parashikuara në shkronjat “i” e “iii”, “b”, “c”, “ç”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë nga 5 000 000 (pesë milionë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

b) shkeljet e parashikuara në nënndarjet “ii”, “iv” e “v” të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë nga 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

KREU VI VLEFSHMËRIA NDËRKOMBËTARE

Neni 35

Shoqëritë aksionare të regjistruara në Shqipëri dhe të listuara në bursë jashtë Shqipërisë

Nëse aksionet me të drejtë vote të një shoqërie, objekt i ofertës, nuk janë listuar në tregun e organizuar të Shqipërisë, por në tregun e organizuar të një shteti tjetër anëtar të BE-së ose të një

shteti të zonës ekonomike europiane, për ofertat vullnetare dhe të detyrueshme zbatohen vetëm dispozitat në vijim të këtij ligji:

- a) nenet 6 pika 3, 7 pika 4 dhe 14 pika 2, për njoftimin e punëmarrësit e shoqërisë, objekt i ofertës;
- b) shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 2, për përkufizimin e kontrollit;
- c) neni 15 për veprimet mbrojtëse, që kryen administrata e shoqërisë, objekt i ofertës;
- ç) nenet nga 16 deri në 18, për kufizimet me zgjedhje për veprimet mbrojtëse;
- d) neni 28, për detyrimin për të bërë një ofertë;
- dh) neni 29, për përjashtimet nga bërja e një oferte;
- e) çdo dispozitë tjetër e ligjit për shoqëritë tregtare, në të cilën referon ky ligj.

Neni 36

Shoqëritë aksionare të regjistruara jashtë Shqipërisë dhe të listuara në bursë në Shqipëri

1. Nëse shoqëria, objekt i ofertës, e ka selinë në një shtet tjetër anëtar të BE-së ose të zonës ekonomike europiane, zbatohen dispozitat e këtij ligji, për përmbajtjen dhe procedurën e ofertave, konkretisht dispozitat e krerëve I, IV e V dhe nenet nga 5 deri në 29 të këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të nenit 35 të këtij ligji, si dhe dispozitat e tjera të ligjit për shoqëritë tregtare, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) aksionet me të drejtë vote pranohen vetëm në tregun e organizuar në Shqipëri;
- b) aksionet me të drejtë vote pranohen në tregun e organizuar në Shqipëri dhe në një shtet tjetër, por jo në shtetin ku ka selinë shoqëria, objekt i ofertës dhe:
 - i) pranimi i parë në tregun e organizuar ka ndodhur në Shqipëri;
 - ii) pranimet në tregjet e organizuara kanë ndodhur njëkohësisht dhe shoqëria, objekt i ofertës, ka zgjedhur Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, si autoritetin kompetent.

2. Një shoqëri, objekt i ofertës, aksionet me të drejtë vote të së cilës janë pranuar njëkohësisht për tregtim në tregjet e organizuara në Shqipëri dhe në një shtet tjetër, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, por jo në shtetin ku ka selinë, vendos vetë se cili prej autoriteteve përkatëse për mbikëqyrjen e një oferte mund të jetë autoriteti kompetent. Shoqëria, objekt i ofertës, e bën të ditur këtë vendim, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 6 të këtij ligji, ditën e parë të tregtimit të aksioneve të veta në tregun e organizuar në Shqipëri.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 37

Zbatimi

- 1. Ky ligj zbatohet për ofertat vullnetare të bëra pas hyrjes në fuqi të tij.
- 2. Ky ligj zbatohet për ofertat e detyrueshme, nëse ngjarja, që sjell lindjen e detyrimit për të bërë ofertën, sipas pikës 1 të nenit 28 të këtij ligji, ndodh pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6457, datë 9.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 296, datë 8.7.2010

PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike¹ të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.

Neni 3
Fusha e zbatimit të ligjit
(Ndryshuar paragrafi i parë, me ligjin 110/2015)

Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku, sipas këtij ligji, përfshihen:

1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.
3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.

¹ Kudo në përmbajtjen e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

1. Emërtim i “Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” zëvendësohet me emërtimin “Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.
2. Emërtimi “Njësi e sektorit publik” zëvendësohet me emërtimin “Njësi Publike”, *ndryshuar me ligjin nr.110/2015*

Neni 4

Përkufizime

(Ndryshuar pikat 5, 6, 7, 8, 22 dhe 24, si dhe shtuar pikat 19/1, 22/1 dhe 23/1, me ligjin 110/2015, datë 23.10.2015)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP)” është tërësia e sistemit të kontrollit të brendshëm që ushtrohet nga njësitë publike, për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive publike është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të njësive publike. Ai, gjithashtu, përfshin harmonizimin qendror dhe koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të auditimit të brendshëm.

2. “Fonde publike” janë të gjitha fondet, përfshirë edhe fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen e shpenzohen nga njësitë publike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë publike.

3. “Kontroll i brendshëm” është procesi integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të tij qeverisës, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

4. “Njësi të qeverisjes së përgjithshme” janë njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

5. “Njësi të qeverisjes qendrore” janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore. Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.

6. “Njësi të qeverisjes vendore” janë organet e qeverisjes vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore brenda një territori të caktuar. Njësia e qeverisjes vendore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.

7. “Njësi e fondeve speciale” është njësia e krijuar me ligj për të ushtruar funksione specifike të qeverisjes qendrore dhe vendore. Njësia e fondeve speciale përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.

8. Të gjitha nivelet e njësisë publike ose njësi janë terma që u referohen njësive të përmendura në nenin 3, të këtij ligji, dhe nënkuptojnë organin qendror të njësisë publike dhe secilën njësi vartëse, të konsideruar më vete.

9. “Përgjegjshmëria menaxheriale” është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera.

10. “Garanci e arsyeshme” është një nivel i kënaqshëm besimi se një çështje është shqyrtuar në aspektin e kostove, të përfitimeve dhe të risqeve.

11. “Risk” është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë.

12. “Sisteme të menaxhimit të informacionit” përfshin përpunimin manual ose automatik të të dhënave, procedurat, planet, kontrollet, pajisjet dhe programet kompjuterike e personelin që vë në zbatim dhe mirëmban funksionet e sistemit.

13. “Mashttrim”, ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

14. “Parregullsi” është moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo i rregulloreve të tjera, që e ka origjinën te veprimet a mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për fondet publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat, shpenzimet/të dalat, fondet e kthyer mbrapsht, aktivet apo detyrimet financiare.

15. “Menaxherë” janë të gjithë personat që ushtrojnë funksione menaxheriale dhe që mbajnë përgjegjshmëri menaxheriale në njësinë publike.

16. “Veprimtari të kontrollit”, përkufizohen si kontrole para faktit dhe pas faktit. Ato përfshijnë kontrollin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë dhe marrin parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

17. “Kontrolle para faktit” janë kontrollet e bëra, me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit, para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra, para se të ndodhë një transaksion i caktuar.

18. “Kontrolle pas faktit” janë kontrole të herëpashershme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit, sipas një plani apo në vijim të një kërkesë. Kontrollet pas faktit verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike.

19. “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

19/1. “Veprimtaritë kryesore” janë ato veprimtari që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve, projekteve më të rëndësishme të saj.

20. “Mbikëqyrje” është përgjegjësia e menaxherit për ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Nëpërmjet mbikëqyrjes, menaxheri jep udhëzime dhe kryen trajnimin e nevojshëm për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna prej tij kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

21. “Nëpunës i parë autorizues” është zyrtari i nivelit më të lartë, sipas ligjit për statusin e nëpunësit civil, në ministrinë përgjegjëse për financat, përgjegjës për monitorimin e progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në sektorin publik, për të cilin i raporton Ministrit të Financave.

22. “Titullar i njësisë publike” është kreu i organit qendror të njësisë publike. Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike, që drejtohet me organe vendimmarrëse kolegjiale, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ.

22/1. Titullar i njësisë në shoqëritë tregtare konsiderohet organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

23. “Nëpunës autorizues” është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

23/1. Nëpunës autorizues i nivelit të dytë dhe/ose i niveleve të tjera janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues.

24. “Nëpunës zbatues” është një nëpunës i nivelit menaxherial të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë.

25. “Sistem i kontabilitetit” është sistemi për përcaktimin, njohjen, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare që lidhen me veprimtarinë e një njësie publike.

26. “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.

27. “Procedura antikorrupsion”, ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9508, datë 3.4.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”.

28. “Sistem i thesarit”, ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Ndrysuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Neni 6

Ministri i Financave

Shtuar me ligjin nr.110/ 2015, datë 23.10.2015

1. Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për miratimin e udhëzimeve e të manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë publike, që mbulojnë në mënyrë të veçantë:

a) metodologjinë për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me standardet e kontrollit të brendshëm, të pranuar ndërkombëtarisht;

b) formën, përmbajtjen dhe afatet për raportimin periodik të nëpunësi i parë autorizues rreth funksionimit, përshtatshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit të sistemeve ekzistuese të menaxhimit financiar dhe kontrollit, parregullsitë e gjetura dhe masat e marra;

c) formën, përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së deklaratës për cilësinë dhe kushtet e kontrolleve të brendshme për vitin paraardhës;

ç) dokumentet standarde të gjurmëve të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara në të gjitha njësitë publike;

d) procedurat standarde për një kontabilizim të plotë, të vërtetë, të saktë dhe në kohën e duhur të të gjitha transaksioneve të njësitë publike;

dh) procedurat standarde për ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve financiare në njësitë publike, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi;

e) procedurat standarde për ruajtjen, dokumentimin, qarkullimin, shitjen dhe nxjerrjen jashtë qarkullimit të aktiveve në njësitë publike.

ë) funksionet dhe detyrat e strukturës përgjegjëse për financat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

2. Ministri i Financave mund të miratojë udhëzime të përbashkëta, me propozimin e titullarëve të njësive publike të interesuara, për orientime specifike në fusha të caktuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Neni 7

Përgjegjshmëria e nëpunësit të parë autorizues

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave është nëpunësi i parë autorizues për njësitë e qeverisjes qendrore, fondet speciale dhe fondet e transferuara te njësitë e qeverisjes vendore.

2. Nëpunësi i parë autorizues përgjigjet përpara Ministrit të Financave për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe për monitorimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, sipas këtij ligji, dhe i paraqet komisionit përkatës parlamentar raporte për ecurinë, si dhe pasqyrat financiare e raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit, ai raporton gjatë vitit lidhur me çështje të zbatimit të buxhetit apo të kontrollit të brendshëm financiar publik.

KREU II

PËRGJEGJSHMËRIA MENAXHERIALE

Neni 8

Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit

Ndryshuar shkronja "a" dhe "d" e pikës 8 me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015

1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

2. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, caktojnë nëpunësit autorizues, sipas përcaktimeve të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

3. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues.

4. Në rast mosçaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike.

5. Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësive të varësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, deri tek titullari i njësisë publike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

6. Titullarët e njësive publike, drejtuesit e strukturave, që zbatojnë detyra që lidhen me shpenzimin apo menaxhimin e fondeve të Bashkimit Europian, ose kryejnë funksionin e organeve ndërmjetëse të këtyre fondeve, përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të rregulloreve përkatëse të Bashkimit Europian.

7. Gjatë zbatimit të programeve, që përfshijnë më shumë se një njësi dhe/ose strukturë të sektorit publik, titullarët e tyre nënshkruajnë udhëzime ose marrëveshje të përbashkëta, lidhur me pjesën e përgjegjshmërisë menaxheriale që do të mbajë secili prej tyre.

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;

ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;

d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;

e) futjen e procedurave antikorruption, bazuar në legjislacionin në fuqi;

ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Neni 9

Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues

(Shtuar pika 2/1, ndryshuar pika 3 dhe shfuqizuar shkronja “ç” e pikës 4, me ligjin nr. 110/2015)

1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njësisë publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

2. Nëpunësi autorizues i njësisë publike i propozon titullarit të njësisë publike akte të brendshme administrative, monitoron dhe përditëson sistemet për menaxhimin financiar dhe kontrollin e njësisë publike, brenda kuadrit rregullator të Ministrisë së Financave, si dhe merr masa për përmirësimin e sistemeve, në vijim të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm dhe të vlerësimeve e të analizave të tjera.

2/1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, për efekt të menaxhimit financiar dhe kontrollit, cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë drejtuesit e programeve e nënprogrameve të çdo strukture dhe njësie të varësisë direkte, për të cilat identifikohet buxheti i veçantë. Në njësitë publike të përshkallëzuara me disa nivele njësinh shpenzuese, nëpunësit autorizues caktohen nga organi epror direkt dhe emërtohen sipas nivelit të varësisë në nëpunës autorizues të nivelit të dytë, të tretë e të katërt.

3. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.

4. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

a) propozimin e nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;

b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike;

c) monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;

ç) Shfuqizuar

d) planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike;

dh) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

e) krijimin e kushteve për menaxhim të ligjshëm, efektiv e të përshtatshëm dhe për sjellje etike të punonjësve të njësisë;

ë) përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;

f) ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.

5. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike nuk kanë të drejtë delegimi të përgjegjësive të përmendura në pikën 3 dhe në pikën 4 shkronjat “a”, “ç”, “dh” e “P” të këtij neni.

Neni 10

Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

2. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

3. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 11

Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë

Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar.

4. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

5. Informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.

Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues

(Ndryshuar pika 1, shtua pika 3/1, me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike.

2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së:

a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike;

b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:

a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit;

b) përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë;

c) llogaritjen e kostove të veprimtarive të përcaktuara nga drejtuesit e programeve;

ç) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve në varësi funksionale të tij, si dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;

d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;

dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi;

e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

ë) mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave. Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave;

f) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;

g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta;

gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.

3/1. Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele varësie, punonjësit e financës në strukturat përgjegjëse të financave, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, konsiderohen

punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues të njësisë nga varen. Punonjësit e financës, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike dhe raportojnë në mënyrë të dyfishtë te nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës.

4. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike nuk kanë të drejtë delegimi të përgjegjësi të përmendura në pikën 2 dhe në pikën 3 shkronjat “a”, “ç”, “e”, “g” dhe “gj” të këtij neni.

Neni 13

Dokumentimi dhe raportimi i urdhrave të kundërshtuar

1. Urdhri gojor ose i shkruar i nëpunësit autorizues apo i personit të deleguar prej tij, që rregullon menaxhimin operacional, drejtuar nëpunësit zbatues, kundërshtohet nga ky i fundit në rast se:

- a) bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi;
- b) ka pamjaftueshmëri fondesh;
- c) urdhri për pagesën përfundimtare jepet pa u përfunduar shërbimi, pa hyrjen e vlerave materiale në njësi ose marrjen në dorëzim nga njësia e investimit të përfunduar;
- ç) kur ka ndryshime në sasi ose në vlerë ndërmjet faturës dhe kontratës.

2. Në rast mosmarrëveshjes ndërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues respektivisht ia dorëzojnë urdhrin e kundërshtuar me shkrim, së bashku me dokumentacionin përkatës, nëpunësit të parë autorizues, nëpërmjet sistemit të thesarit, siç përshkruhet në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 14

Veprimet që merren gjatë shqyrtimit të urdhrave të kundërshtuar

1. Me marrjen e një raporti kundërshtimi, sipas nenit 13 të këtij ligji, nëpunësi i thesarit duhet të kryejë procedurat e mëposhtme:

- a) të shqyrtojë dokumentacionin;
- b) t’ia përcjellë dokumentacionin nëpunësit të parë autorizues, së bashku me opinionin e tij, nëse e vlerëson të drejtë urdhrin për përpunimin e pagesës;
- c) nëpunësi i parë autorizues vendos nëse duhet të procedohet me pagesën, të kërkohet një investigim nga titullari i njësisë publike apo të fillojë inspektimi financiar. Në rastin kur vendoset të kryhet investigim ose të nisë inspektimi financiar, pagesa pezullohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Kur rezultatet e inspektimit financiar tregojnë për ekzistencën e mashtrimit apo korrupsionit në fusha të caktuara, nëpunësi i parë autorizues u dërgon autoriteteve përkatëse raportin e inspektimit financiar, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

Neni 15

Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave

(Ndryshuar pika 4, me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Gjatë ushtrimit të përgjegjësi të tyre, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, nëpunësi i parë autorizues, nëpunësit autorizues kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre te punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues, duke specifikuar kërkesat për raportimin për realizimin e detyrave të deleguara.

2. Nëpunësit zbatues dhe menaxherët e tjerë kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre te vartësit funksionalë, duke specifikuar kërkesat për raportimin për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Nuk mund të delegohen të drejtat dhe detyrat, për të cilat ndalohet shprehimisht delegimi në këtë ligj apo në ligje të tjera.

4. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat. Delegimi kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 16

Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Ministri i Financave është përgjegjës për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara për të gjitha njësitë publike.

2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

Procedura e sinjalizimit

1. Çdo punonjës, i cili gjatë kryerjes së punës apo në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, vëren fakte, të cilat lënë vend për mundësi të ekzistencës së parregullsive dhe mashtrimeve, informon menjëherë me shkrim eprorin e drejtpërdrejtë ose eprorin e një niveli më të lartë, apo, nëse ai e sheh të dobishme, njofton nëpunësin autorizues ose titullarin e njësisë publike ose direkt nëpunësin e parë autorizues apo njësinë e antikorrupsionit.

2. Çdo punonjës, që merr informacion lidhur me përmbajtjen e pikës 1 të këtij neni, menjëherë i transmeton nivelit më të lartë drejtues dhe nëpunësit të parë autorizues çdo evidencë që mund të provojë parregullsitë, sipas pikës 1 të këtij neni. Procedurat në vijim rregullohen me ligj të veçantë për inspektimin financiar publik dhe akte të tjera ligjore.

3. Punonjësi nuk duhet të dëmtohet nga efektet paragjyquese nga ana e njësisë, si rezultat i komunikimit të informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, duke marrë të mirëqenë se ai ka vepruar me ndershmëri dhe në mënyrë të arsyeshme.

4. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk aplikohen për dokumentet, veprimet, raportet, shënimet apo informacione të mbajtura në çfarëdolloj forme për qëllimet e punonjësit apo të zbuluara ndaj tij, gjatë rrjedhës së seancave të çështjeve gjyqësore, qofshin këto të fundit pezull apo të mbyllura.

Neni 18

Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.

2. Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit maj, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij

neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimit brendshëm në sektorin publik.

3. Ministri i Financave u paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda muajit qershor të çdo viti, raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë edhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit.

KREU III KOMPONENTËT E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Neni 19

Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Titullarët e njësive publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Neni 20

Mjedisi i kontrollit

1. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

2. Mjedisi i kontrollit përmban:

- a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;
- b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës;
- c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- ç) politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- d) aftësitë profesionale të punonjësve.

Neni 21

Menaxhimi i riskut

1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

Neni 22

Veprimtaritë e kontrollit

(Hequr fjalë në shkronjën "b" dhe shtuar shkronja "c" të pikës 3, me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

2. Veprimtaritë e kontrollit duhet të jenë të përshtatshme dhe kostoja e zbatimit të tyre nuk tejkalon përfitimet e pritshme.

3. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:

a) procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta;

b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin;

c) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut të lidhur me të, të vlerësuar për çdo angazhim;

ç) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre;

d) të drejtat për përdorimin e aktiveve dhe të informacionit të njësisë dhe mbrojtjen e aktiveve;

dh) procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave;

e) procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive;

ë) procedurat e monitorimit;

f) rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore;

g) rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e njësisë;

gj) rregullat për garantimin e ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësisë.

4. Veprimtaritë e kontrollit, që jepen në pikën 3 të këtij neni, janë kontrolle para faktit dhe pas faktit. Përfshirë, kontrollet para faktit, për proceset apo transaksionet e punës, që gjykohen si më të ekspozuara ndaj risqeve të mëdha, mund të ushtrohen nga kontrollorët financiarë apo persona të tjerë, të caktuar nga nëpunësi autorizues.

5. Termat dhe procedurat e ushtrimit të kontrolleve para faktit dhe pas faktit miratohen nga titullarët e njësive publike, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave. Kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit. Kontrolli pas faktit ushtrohet, gjithashtu, nga audituesit e brendshëm dhe të jashtëm, inspektorët financiarë publikë, që rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 23

Informacioni dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë:

1. Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

2. Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

3. Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

6. Ngritjen e një sistemi deklarimi efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.

Neni 24

Monitorimi

1. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.

2. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Funksioni i auditimit të brendshëm rregullohet me ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

KREU IV

HARMONIZIMI I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Neni 25

Përgjegjësia e Ministrit të Financave për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Ministri i Financave, në përmbushjen e detyrave të tij, sipas nenit 3, të këtij ligji, mbështetet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si pjesë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik i raporton nëpunësit të parë autorizues dhe ministrit përgjegjës të financave.

2. Punonjësit e Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin janë nëpunës civilë dhe rregullat e procedura për emërimin e shkarkimin e tyre i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për shërbimin civil.

3. Titullarët e njësive publike, në vijim të njoftimit me shkrim nga Ministri i Financave, u sigurojnë punonjësve të Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit’.

akses të plotë në dokumentacion, regjistra apo informacione të tjera të nevojshme vetëm për qëllimin e monitorimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk ka si përgjegjësi kryerjen e auditimeve apo të inspektimeve financiare.

Neni 26

Roli i Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

(Shtuar shkronja "dh", dhe shfuqizuar pika 4, me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për:

a) përgatitjen e ligjeve, të udhëzimeve, të urdhrave dhe të manualeve për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit;

b) përgatitjen, shpërndarjen dhe përditësimin e strategjive dhe të udhëzimeve metodologjike për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar për kontrollin e brendshëm, rregulloret e zbatueshme dhe praktikën e mira të Bashkimit Europian;

c) përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike.

ç) bashkërendimin e punës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik;

d) ndërgjegjësimin për KBFP-në me anë të seminareve dhe krijimit të faqes së internetit.

dh) krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësite publike.

2. Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit siguron monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike, me qëllim mbledhjen e informacionit për të përmirësuar metodologjinë dhe standardet e punës.

3. Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmbledhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.

4. Shfuqizuar.

Neni 27

Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njesisë publike

1. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njesisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

2. Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njesisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimarrjeje.

Neni 28

Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

1. Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik.

2. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përbëhet nga Ministri i Financave, në cilësinë e kryetarit të këtij bordi, nëpunësi i parë autorizues, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për kontrollin e

brendshëm financiar publik, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për buxhetin, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për thesarin, tre anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave, me përvojë në fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetit dhe auditimit të brendshëm.”.

3. Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të kontrollit të brendshëm financiar publik.

4. Bordi diskuton rreth raportit vjetor për kontrollin e brendshëm financiar publik para se të miratohet nga Ministri i Financave.

5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik, në Ministrinë e Financave, siguron shërbimin e sekretariatit për veprimtarinë e bordit.

6. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të bordit miratohet me urdhër të Ministrit të Financave.

7. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit dhe të sekretarit të bordit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 29

Kundërvajtjet administrative

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, me përjashtim të shkeljeve që përbëjnë vepër penale, përbën kundërvajtje administrative si më poshtë:

1. Shkelja apo mospërmblidhja e detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e pikës 1 të nenit 18 të këtij ligji nga nëpunësi autorizues i njësisë publike, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë.

2. Vendimi i kundërvajtjes administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, nxirret nga nëpunësi i parë autorizues.

Neni 30

Ankimet

Për vendosjen e sanksioneve ndëshkuese për shkelje, sipas pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji, bëhet ankim te Ministri i Financave ndaj vendimit të nëpunësit të parë autorizues, që e ka nxjerrë atë, brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 31

Masa disiplinore dhe masa të tjera

1. Mosrespektimi nga titullari i njësisë publike të kërkesave të nenit 8 pika 8 shkronjat “a”, “b”, “ç” dhe “e” përbën rast të rëndë të mosfunksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësinë publike. Në këtë rast Ministri i Financave rezervon të drejtën e bllokimit të përkohshëm të përdorimit të fondeve buxhetore të përcaktuara në aktin vjetor të Buxhetit të Shtetit për vitin përkatës në nivel programi, zëri apo projekti deri në plotësimin e kërkesave ligjore.

2. Mosrespektimi nga nëpunësi autorizues i kompetencave të përmendura në pikën 5 të nenit 9 të këtij ligji, përbën rast të keqmenaxhimit financiar dhe ndaj tij fillojnë procedurat disiplinore apo të uljes në detyrë.

3. Ndaj nëpunësit zbatues dhe menaxherëve të tjerë, të cilët nuk respektojnë përgjegjësitë e parashikuara nga nenet 11 e 12 të këtij ligji, fillojnë procedurat disiplinore me propozimin e nëpunësit autorizues të njësisë publike.

Neni 32

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 33

Periudha kalimtare për zbatimin e këtij ligji

Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore që përcakton ky ligj, zbatohen aktet nënligjore ekzistuese, deri në masën që nuk bien ndesh me këtë ligj, por jo më vonë se një vit nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Dispozita kalimtare

(Shtuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015)

Kërkesat e pikave 1 dhe 3.1, të nenit 12, do të përmbushen brenda një periudhe kalimtare dyvjeçare, deri në implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues.

Neni 34

Shfuqizime

Ligji nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2011.

Shpallur me dekretin nr. 6648, datë 21.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

UDHËZIM

Nr.30, datë 27.12.2011

PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014; nr. 11, datë 6.5.2016; nr. 24, datë 7.12.2016)

(I përditësuar)

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 6, germa “e” të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ministri i Financave

UDHËZON:

I. Të përgjithshme

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standarde dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

2. Të gjitha njësitë e sektorit publik² kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

3. Aktivet e njësisë publike³, në kuptim të këtij udhëzimi, përfshijnë të gjitha elementet e pasurisë së njësisë publike që sipas kriterit kontabël dallohen në:

- a) aktive afatgjata materiale, jomateriale dhe financiare;
- b) aktive afatshkurtra materiale si vlerat e inventarit dhe vlerat monetare në arkën e njësisë.

4. Nga pikëpamja e menaxhimit aktivet e të gjitha niveleve të njësisë publike ndahen në tre kategori:

- a) Aktivet gjendje në magazinë, si dhe vlerat monetare të arkës së njësisë.
- b) Të gjitha aktivet e vëna në përdorim brenda njësisë, pavarësisht nga vendndodhja e tyre (në përdorim të personelit, brenda ambienteve të organit qendror apo të njësive të vartësisë).
- c) Të gjitha aktivet e dhëna me qira, enfitozë, koncesion, nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive tregtare, apo forma të tjera të përcaktuara me ligj të përdorimit të pronës publike e të cilat krijojnë të ardhura.

Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike⁴

5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike⁵ në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Përgjegjësia e nëpunësve autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike⁶

6. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

7. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësive që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre⁷ dhe japin llogari në linjë hierarkike deri të nëpunësi autorizues i njësisë publike.

8. Nëpunësi autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike dhe jep llogari te titullari për mënyrën e funksionimit të tyre.

9. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike kanë detyrimin që:

a) Të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve;

b) Të marrin masa konkrete për trajtimin e riskut lidhur me aktivet sipas kapitullit II të këtij udhëzimi, dhe zhdëmtimin deri në nivelin e përgjegjësisë së deleguar nga nëpunësi autorizues i njësisë publike sipas paragrafit 6 të këtij udhëzimi;

c) Të propozojnë në linjë hierarkike deri te titullari masa lidhur me trajtimin e mëtejshëm të aktivitetit të dëmtuar, masa administrative ndaj shkaktarëve deri në ndjekjen penale të tyre.

Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë

10. Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve,

² Sipas përcaktimit të nenit 3 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

³ Si një e tërë ku përfshihet organi qendror dhe të gjitha njësitë e vartësisë.

⁴ Kreu i organit qendror të njësisë publike sipas nenit 4/22 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për MFK” (Ministri, kreu i institucionit të pavarur, kryetari i bashkisë, komunës, këshillit të qarkut)

⁵ Sipas përcaktimit të nenit 8 pika “d” të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për MFK”

⁶ Nëpunësi i nivelit më të lartë manaxherial në njësinë publike në vartësi direkte të titullarit (p.sh. Sekretari i Përgjithshëm në ministri), si dhe drejtuesit e njësive të vartësisë nga njësia publike. Ref. neni 4/22, neni 9 i ligjit nr.10 296 për MFK dhe neni 5 i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”

⁷ Sipas përcaktimit të nenit 9 pika (4/h) të ligjit për MFK-në

keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.

11. Nëpunësit/punonjësit e caktuar përgjegjës për menaxhimin e aktiveve duhet të plotësojnë kriteret e punësimit të shprehura në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, Kodin të Punës, ligjeve të tjera specifike, si dhe sipas dispozitave të rregulloreve të brendshme të njësisë.

12. Aktivitetet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave, si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.

13. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga nëpunësi autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkak objektiv, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.

14. Në këtë mënyrë veprohet edhe për hyrjen ose daljen e aktiveve nga magazina kur mungon përkohësisht personi që i ka ato në ngarkim dhe për këtë shkak pengohet funksionimi normal i punës së institucionit. Në rast mungese të përkohshme të punonjësit që ka në ngarkim aktive, veprimet me këto vlera kryhen nga një komision i caktuar nga nëpunësi autorizues i njësisë respektive.

15. Menaxheri që urdhëron për hyrjen dhe daljen e aktiveve nuk mund të ngarkohet edhe me detyrën e arkëtarit dhe/ose të magazinierit. Në institucione të vogla me personel deri në 10 punonjës, ku nuk justifikohet ekzistenca e një pozicioni të veçantë pune për arkëtarin dhe magazinierin, mund të vendoset në çdo pozicion tjetër pune. Nëpunësi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë nuk duhet të ngarkohet me detyrën e arkëtarit dhe/ose të magazinierit.

Përgjegjësitë e grupit të menaxhimit strategjik⁸

16. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me menaxhimin e aktiveve të njësisë dhe riskut të lidhur me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis menaxherëve, i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre.

II. MENAXHIMI I RISKUT TË LIDHUR ME AKTIVET

17. Aktivitetet janë të vlefshme për njësinë publike vetëm kur përdoren për qëllimet afatgjata të përcaktuara për funksionimin e njësisë. Për t'u siguruar se kjo mund të ndodhë duhet të ekzistojnë:

a) Objektivat për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerës që ato duhet të kontribuojnë për njësinë.

b) Një plan ku përcaktohet se si do të realizohen këto objektiva.

c) Një mekanizëm kontrolli, bazuar në informacionin historik apo të pritshëm mbi situatat ku aktivitetet afatgjata mund të mos jenë të mjaftueshme/të përshtatshme për arritjen e objektivave të tyre, si dhe veprimet që mund të ndërmerren për t'iu kundërpërgjigjur këtyre situatave.

18. Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.

19. Aktivitetet duhet të menaxhohen njësoj si çdo pjesë tjetër e punës së njësisë, që do të thotë se duhet të ekzistojnë sistemet e kontrollit dhe informimit për të provuar nëse mjetet monetare janë shpenzuar me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi. Informacioni historik mund të jetë informacion mbi performancën e aktiveve, informacioni mbi koston e aktiveve, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e makinerive, vlerësimet e ndërtesave, etj. Informacioni i pritshëm mund të lidhet me

⁸ Përbërja dhe përgjegjësitë e GMS jepen në nenin 27 të ligjit nr.10 296 për MFK

ndryshimet që ndodhin në mjedisin organizacional, për shembull kërkesat e sistemeve të reja, të cilat do të ndikojnë në specifikimet e pajisjeve të kompjuterëve, zhvillimet që sjellin ndryshime në kërkesat për akomodim të personelit, etj.

20. Ka një numër rastesh ose situatash të mundshme të cilat mund të kenë ndikim në aftësinë e aktiveve për të përmbushur misionin e tyre dhe për të arritur objektivat që njësi ka caktuar për to. Të tilla përmenden vjedhjet, vandalizmat, dëmi i shkaktuar nga përmytjet, zjarri, kushtet e kohës, avaritë, konsumimi dhe shpërbërja e pajisjeve, vjetrimi fizik dhe teknik, mospërshtatja me objektivin për shkak të ndryshimit të kërkesave teknike, etj.

21. Për identifikimin e risqeve të lidhura me aktivet për ndodhitë e mundshme, duhet të përdoret më shumë se një burim informacioni. Risku identifikohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Shqyrtimi i dokumentacionit
- b) Analiza për identifikimin e shkallës së ndërvarësisë së pjesëve të ndryshme të veprimtarisë së njësisë;
- c) Survejimet (inspektimet) fizike;
- d) Risqe të raportuara nga auditimet;
- e) Intervistat me personelin bazë dhe eksperiencia të mëparshme.

22. Risku duhet të analizohet duke shmangur mbipërqendrimin në ngjarjet që gjenerojnë riskun, por me qëllim për të trajtuar shkaqet e tij, si dhe efektet e rasteve apo situatave të mundshme.

23. Masat që duhet të ndërmerren në raport me riskun për kufizimin e humbjeve financiare, mund të përfshijnë:

a) Mbrojtjen fizike kundër vjedhjes, vandalizmit, dëmtimeve natyrore, nëpërmjet instalimit të kasafortave, drynave të sigurisë/alarmet/patrullat, sistemit të pompave për parandalimin e zjarrit, kontrollet e inventarëve dhe siguracionet, etj.

b) Aksesin e kontrolluar dhe ruajtjen e informacionit mbi aktivet, të dhënat e personelit, të dhënat financiare, sistemet e kompjuterizuara të informacionit, etj.

c) Depozitimi në llogaritë e sistemit të thesarit të vlerave monetare të arkëtuara nga të gjitha nivelet e njësisë së qeverisjes së përgjithshme⁹, menjëherë pas pranimit të tyre.

d) Përcaktimin e sistemeve dhe të procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyrë për parandalimin e mosfunksionimit të papritur të ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktiv duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktivi mund të vazhdojë të jetë në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kritereve të këtij udhëzimi.

e) Riparim i menjëhershëm i dëmeve. Duhet të kryhen inspektime të rregullta dhe të ekzistojë një sistem për regjistrimin e dëmeve dhe për garantimin se veprimet e duhura po merren me shpejtësi.

f) Shërbime të rregullta mirëmbajtjeje për minimizimin e avarive të mundshme. Për t'u siguruar për efikasitetin e aktiveve është e nevojshme të ekzistojnë sistemet përkatëse të kontrollit.

g) Mirëmbajtja e planifikuar. Aktivet afatgjata materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre (p.sh. çatisë, sistemit të ngrohjes, etj.). Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar, ky informacion përdoret për t'i orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit të avarive. Çdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme, si dhe sigurimin e efikasitetit në përdorimin e aktiveve.

⁹ Përfshihen nga detyrimet sipas këtij paragrafi, njësitë publike të parashikuara në nenin 3, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

h) Trajnimi i punonjësve për përdorimin dhe mbrojtjen e aktiveve.

i) Përshtatshmëria për përdorim e aktiveve, nëse është e mundur, për minimizimin e riskut që vjen nga mospërputhja e aktivitetit me objektivin në rast të ndryshimit të kushteve të punës.

j) Planet e emergjencës për vlerësimin e të gjitha pasojave potenciale të riskut nga faktorë të jashtëm si fatkeqësi natyrore, epidemi e të tjera të ngjashme, nëpërmjet katër fazave të mëposhtme:

- Rishikimi i rreziqeve dhe vlerësimi i ndikimeve potenciale mbi veprimtarinë, duke regjistruar dhe analizuar humbjet për të identifikuar prirjet dhe problemet e reja

- Zhvillimi, azhurnimi, auditimi dhe testimi i planit

- Menaxhimi i krizave-zbatimi i planit gjatë dhe pas një incidenti

- Rikthimi në operacionet normale

24. Masat e sipërpërmendura shoqërohen me kosto, por nga vetësigurimi ka përfitime direkte të konsiderueshme nga pikëpamja e uljes së çmimeve të siguracioneve apo e humbjeve, si dhe indirekte nga përmirësimi i marrëdhënieve të punës.

25. Menaxhimi i aktiveve afatshkurtra materiale, gjendje inventari, është tërësisht i lidhur me gjetjen e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme për arritjen e kërkesave operacionale me minimumin e riskut dhe të koston për mbajtjen e këtyre aktiveve. Kjo përfshin:

a) Identifikimin e operacioneve dhe të nevojës ekzistuese për mbajtje inventari,

b) Rishikim të operacioneve me idenë e uljes së nevojës për mbajtje inventari, pasi të jetë marrë në konsideratë nevoja për gjendjen e sigurisë (vlerat materiale që mbahen për t'u paraprirë pasojave serioze të mbarimit të gjendjes në inventar).

c) Identifikimin e madhësisë dhe kohës së zëvendësimit të gjendjes së inventarit dhe të mënyrave më efikase të mbajtjes dhe furnizimit.

d) Identifikimin dhe minimizimin e kostove të mbajtjes së gjendjes së inventarit.

III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre

Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik

26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues¹⁰ për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.

28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

29. Kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10 000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit. Nëpunësi autorizues i njësisë duhet të vendosë një prag të arsyeshëm për vlerësimin e aktiveve nga afatshkurtra në afatgjata nëse nuk plotësohet njëri nga dy kushtet e mësipërme. Në hartimin e regjistrit të aktiveve, kujdes i veçantë i duhet kushtuar dy llojeve të aktiveve:

a) aktiveve atraktive, të tilla si punimet e artit, objekte me vlerë historike, dhe sendet e tjera, që mund të jenë të riskuara nga vjedhjet. Këto aktive mund të përfshihen edhe kur janë nën pragun e vlerësimit. Këto duhet të kontrollohen të paktën një herë në vit.

b) investimet në formën e pjesëmarrjeve në kapital, aksioneve dhe obligacioneve, aktivet e dhëna me qira, enfiteozë, koncesion apo forma të tjera të parashikuara me ligj¹¹. Këto duhet të kontrollohen të paktën një herë në vit.

30. Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në

¹⁰ Nëpunës i nivelit të lartë menaxherial përgjegjës për financat e njësisë. Ref. neni 4, paragrafi 24, neni 12 i ligjit nr.10 296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" për përgjegjësitë e nëpunësit zbatues.

¹¹ P.sh. Autoriteti Portual i Durrësit, ANTA, etj.

vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

31. Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës, me të dhënat si vijon:

a) Emërtimi i pronës, NIPTI dhe vendndodhja (shoqëri koncesionare, objekti i dhënë me qira, shoqëri tregtare).

b) Për kontratat e koncesionit dhe enfiteozës - Objekti i koncesionit, afati në vite, kushti bazë i pagesës, fillimi i pagesës, arkëtuar deri në vitin xxxx, viti aktual (planifikuar, derdhur), parashikimi për vitin e ardhshëm, akti që ka miratuar kontratën koncesionare apo të enfiteozës.

c) Për aksionet apo të drejtat e tjera që shteti zotëron në shoqëritë tregtare, në administrim të njësive publike – Statusi i shoqërisë, % e pjesëmarrjes në kapital, dividendi për vitin raportues (planifikuar, derdhur) dhe parashikimi për vitin e ardhshëm.

d) Për objektet e dhëna me qira – Sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

32. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, njësia publike, brenda muajit qershor të çdo viti, i kërkon shoqërive tregtare në të cilat shteti zotëron kuota apo të drejta të tjera e që janë në administrim të njësive publike, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës, si dhe të vendimit të asamblesë së përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit.

33. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, dhe analizës njësia publike, brenda muajit qershor të çdo viti, i kërkon shoqërive koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, të depozitojnë në autoritetin kontraktor një kopje të pasqyrave financiare vjetore, pasqyrën e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, të shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pagesën, si dhe llogaritjen e parashikimit të detyrimeve për vitin ushtrimor në vazhdim.

Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve

34. Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a) Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b) Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c) Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloji forme¹², bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të

¹² Sipas përcaktimit në nenin 4/26 të ligjit nr.10 296 dhe të nenit 3/1 të ligjit nr.10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.

nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative¹³. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.

37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).

38. Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

40. Magazinieri dorëzon te nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletëhyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit), si dhe fletëdaljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

41. Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te përdoruesi (p.sh. direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (p.sh. Në magazinën qendrore të njësisë publike). Në këtë rast duhet të miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara

42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

44. Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë:

a) Kur sasia e aktivitetit matet me anë të peshimit, verifikimi i sasisë bëhet duke zbritur nga pesha bruto peshën e ambalazhit ose duke peshuar vlerat materiale që gjenden brenda ambalazhit, sipas natyrës së tij.

b) Llogaritja e peshës së ambalazhit bëhet sipas shënimeve të vëna nga furnizuesi mbi secilën pako, duke bërë në rast nevojë prova verifikimi me zgjedhje, me anën e peshimit të ambalazhit të zbrazur. Kur nga verifikimi i tij del se ka diferencë ndërmjet peshës së tij në fakt dhe shënimeve të vëna nga shitësi, bëhet peshimi i gjithë ambalazhit. Kështu veprohet edhe për aktivet e vendosura në ambalazh të hapur.

c) Kur në ambalazhin standard e me shenjën e fabrikës nga verifikimi me zgjedhje duke peshuar jo më pak se 10 për qind të gjithë sasisë së ambalazhit dalin diferenca, verifikimi të shtrihet në të gjithë sasinë.

d) Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtme të paketuara standarde, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje dhe, kur ka diferenca, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një.

45. Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose

¹³ Sipas përcaktimit në nenin 4/26 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për MFK"

në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, si dhe në cilësi, llojshmëri, qenien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin dhe lajmëron shitësin që të paraqitet brenda një afati kohor të përcaktuar (në varësi të vendndodhjes brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësi publike në marrëdhënie me furnitorin).

46. Kur shitësi nuk paraqitet brenda afatit për të parë gjendjen dhe për t'i dhënë rrugë veprimit, komisioni vazhdon verifikimin rregullisht. Verifikimi nuk ndërpritet kur mospërputhjet mund të provohen edhe në mbarim të verifikimit.

47. Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dhe njofton shitësin për t'i tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësi publike në marrëdhënie me furnitorin).

48. Kur shitësi nuk paraqitet brenda afatit të lajmëruar nga blerësi dhe aktivet prishen shpejt e për pasojë nuk mund të vihen në ruajtje, blerësi harton procesverbal me komision prej jo me pak se tre persona për diferencat, dëmtimet, apo ndryshimin e cilësisë, dhe aktivet në gjendje të përdorshme i vë në përdorim për diferencat në sasi apo çmim përgjegjësi bie mbi shitësin.

49. Aktivet e marra në ruajtje dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin “vlera në ruajtje”.

50. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje sipas dispozitave në fuqi në rastet e nevojshme.

Transportimi i aktiveve

51. Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi të marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumenteve përkatëse që janë plotësuar për çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhrin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-daljeje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dyja palët (furnitori dhe transportuesi).

Veprimet që kryejnë strukturat e nëpunësit zbatues:

52. Strukturat e nëpunësit zbatues para marrjes në dorëzim të dokumenteve nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikëpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

53. Kontrollon numri rendor i dokumentit, si për fletëhyrje dhe fletëdalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jokronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.

54. *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*

55. Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletëhyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; shkresën e njësisë për transferimin e aktiveve; autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

56. Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësi publike pritëse e aktivitetit i përcjell akt-konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse.

57. Për hyrjet e aktivave të dhuruara dokumentacioni shoqërues përbëhet nga marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësitë donatore; faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (në rast importi); procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Në rastet kur dhurimet në natyrë të aktiveve nga donatorë të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre.

58. Bëhet kontrolli i artikujve sipas sasisë dhe çmimit (sasia dhe çmimi që ka fatura e furnitorit që bën dalje aktivet duhet të jenë të njëjta me ato të regjistruara nga magazinieri në fletëhyrje), kryhen shumëzimet dhe nxirret vlera totale e fletëhyrjes.

59. Bëhet kontrolli i fletëdaljes së magazinës për daljet e brendshme me listëshpërndarjen, për çdo artikull në sasi dhe në vlerë të firmosur nga sektori i shërbimit përkatës.

60. Bëhet regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre. Në dokument shënohet numri i faqes së librit dhe si fraksion numri rendor që ka marrë regjistrimi i kryer. Në fund të çdo muaji dokumentet e regjistruara vendosen në dosjen përkatëse.

Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë

61. Pagesat ndërmjet njërive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet sistemit të thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësite e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i njësisë respektive.

62. Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njësisë publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës.

63. Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga nëpunësi i parë autorizues me propozim të sistemit të thesarit, me akte të veçanta sipas specifikave të njërive publike.

64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë.

Përfundim bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor.

65. Tërheqja e limitit të arkës kryhet nëpërmjet sistemit të thesarit sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim.

66. Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga nëpunësi zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera të nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë.

67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.

68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar:

a) Mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

b) Mandatpagesa nënshkruhet nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare.

c) Nëpunësi autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhërues të nënshkruar prej tij.

69. Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

70. Përmbledhja e listëpagesave, e cila shoqëron urdhrin për shpenzimin e pagave, duhet të nënshkruhet nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues ose i deleguari i tij.

71. Të dhënat për të përcaktuar të drejtën e punonjësit për pagë, kur ai nuk punon për shkak ndërprerjeje në punë jo për fajin e tij, të lejes së zakonshme, të pjesëmarrjes në kurse trajnimi, për paaftësi të përkohshme në punë, për kryerjen e detyrave të tjera shtetërore ose shoqërore, vërtetohen me dokumente të miratuara me akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

72. Vlerat monetare dhe të barasvlershme me to ruhen në kasafortën e njësisë dhe janë në përgjegjësi të punonjësit të ngarkuar me veprimet e arkës në vartësi të nëpunësit zbatues.

IV. SISTEMI I KONTROLLIT PERIODIK TË AKTIVEVE

Inventarizimi i aktiveve

73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. *Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.*

74. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

75. Titullari i njësisë publike, kur ka dyshime për mashtrime, abuzime, keqpërdorime, vjedhje apo grabitje të aktiveve apo të një pjese të tyre, ose qoftë edhe për të vërtetuar saktësinë e veprimeve ligjore për një periudhë kohore, mund të urdhërojnë kryerjen e inventarizimeve të plota ose të pjesshme të tyre, pa kufizim në numër, jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve.

76. Inventarizimi bëhet, sipas rastit, me numërim, matje/peshim, verifikim etiketash/matjesh teknike, etj. të të gjitha objekteve që inventarizohen. Si përjashtim, me autorizim të titullarit për aktivet e ambalazhuara standard dhe të vulosura nga prodhuesi, inventarizimi në magazinë mund të bëhet në bazë të të dhënave të etiketave, duke bërë kontrole në jo më pak se 5 për qind të numrit të përgjithshëm të pakove dhe, kur dalin diferenca, shtrihet në të gjithë sasinë.

77. Në raste të veçanta, gjatë inventarizimit mund të bëhet lëvizje e aktivitetit, por kurdoherë në prani të komisionit të inventarizimit.

78. Kur inventarizimi i sasisë brenda ambalazhit dëmton aktivitetin, lejohet, me autorizim të titullarit, të bëhet verifikimi vetëm si peshë bruto duke caktuar peshën neto me anë të zbritjes së peshës së ambalazhit në masën e caktuar me rastin e marrjes në dorëzim të aktiveve.

79. Përcaktimi i gjendjes së vërtetë të aktiveve me karakter të veçantë dhe masiv, bëhet me anë të matjeve teknike.

80. Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.

Përgjegjësitë për inventarizimin

81. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të titullarit të njësisë publike ose nëpunësit autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

82. Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi¹⁴. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.

¹⁴ Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

83. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.

84. Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:

a) Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.

b) Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c) *Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.*

86. Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.

87. Nëpunësi autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga nëpunësi zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara.

88. Mungesat dhe tepricat në artikuj të veçantë të aktiveve mund të kompensohen ndërmjet tyre në këto raste:

a) kur janë në sasi dhe vërtetohet se ndërmjet tyre ka lidhje shkakësore (në të njëjtin inventar);

b) në raste të tjera të veçanta (ndërmjet dy inventarëve të njëpasnjëshëm), kur vërtetohet se ka lidhje shkakësore ndërmjet tyre (kur diferenca është pasojë e pasaktësisë së inventarit të mëparshëm);

c) kur tepricat e mungesat që janë gjetur në persona të ndryshëm me përgjegjësi materiale, kanë lidhje shkakësore ndërmjet tyre dhe dalin nga inventarizimet e kryera njëkohësisht në të dy punonjësit me përgjegjësi materiale.

89. Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të njësisë.

90. Mungesat përtej normave të firove ligjore, prishjet dhe dëmtimet e aktiveve që u ngarkohen fajtorëve, vlerësohen si vijon:

a) Aktivet në magazinë në bazë të çmimit të shitjes me pakicë, dhe, kur nuk ka të tillë, në bazë të koston së blerjes.

b) Inventari i imët në përdorim dhe ambalazhi jo me pak se 50% të çmimit të blerjes ose të koston.

c) Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale në bazë të vleftës bruto (vlefta fillestare dhe shpenzimet e mëpasshme të aktivitetit) të pakësuar me amortizimin efektiv, *ose vlerës së drejtë por jo më pak se 50% të çmimit të blerjes ose të vlerës bruto.*

91. Në rast se punonjësi me përgjegjësi materiale ka kundërshtim për rezultatet e inventarizimit, për gjendjen fizike, cilësinë dhe çmimin, kërkesa e tij shqyrtohet nga nëpunësi autorizues pas përfundimit të inventarizimit.

92. Në rast se pranohen si të drejta këto kundërshtime, komisioni i inventarizimit, pasi i verifikon, bën ndreqjet përkatëse. Kur ka bazë të mjaftueshme dhe nëse magazina apo lokali nuk është hapur pas përfundimit të inventarit, me urdhrë të titullarit, bëhet inventarizimi i dytë dhe shpenzimet e bëra përballohen nga persona që kanë kryer inventarin e pasaktë.

93. Nëpunësi autorizues i njësisë jep urdhër zhdëmtimin për mungesat e konstatuara në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi zbatues ndjek procesin dhe kryen regjistrimet kontabël përfundimtare.

94. Çdo njësi publike duhet të hartojë procedurat e saj specifike në lidhje me masat që ndërmerren për kompensimin, zëvendësimin, riparimin e aktiveve.

Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi

95. Është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

96. *Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsim apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Komisioni i vlerësimit ngrihet me miratim të titullarit. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.*

Për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të organizuara me disa nivele vartësie të njëjve shpenzuese, komisioni i vlerësimit ngrihet nga nëpunësi autorizues i nivelit të dytë në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Nëpunësi autorizues i nivelit të dytë ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit në njësitë e vartësisë së tij, i cili raporton tek nëpunësi autorizues i njësisë publike.

97. Në të gjitha rastet komisioni i vlerësimit të aktiveve ka përbërje tjetër nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi në njësi të aktiveve. Titullari mund të ngrejë një komision të vetëm për kryerjen e inventarizimit¹⁵ dhe vlerësimit të aktiveve.

98. Komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë dhe të kriterëve të miratuara në këtë udhëzim respektivisht për vlerësimin në paragrafin 103 dhe për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike në paragrafët 107, 108 dhe 109.

99. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës, si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është nëpunësi zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit.

100. *Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në varësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi.*

101. Për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve afatgjata me rëndësi të veçantë për institucionin, komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhen nga jo më pak se 7 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht dy specialistë të lartë të fushës. Kur këto specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore.

Lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim

102. Nëpunësi zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tri kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

Kriteret për vlerësimin e aktiveve

103. Vlerësimi i aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve:

¹⁵ Shih paragrafët 80 deri 93 të këtij udhëzimi.

- a) kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;
- b) kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;
- c) kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;
- d) kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;
- e) kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;
- f) kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;
- g) kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;
- h) kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesëm ose afatgjatë nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Procesverbali i vlerësimit

104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

- a) nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë;
- b) nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;
- c) nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.

105. Procesverbali hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike.

Relacioni i vlerësimit

106. Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve

107. Aktivet afatgjata që pas vlerësimit konsiderohen të panevojshme përkohësisht për njësinë në një periudhë të mëvonshme të funksionimit të saj (në rast ndryshimi të objektivave afatmesëm ose afatshkurtër të njësisë), por që mbeten në gjendje përdorimi, mund të jepen në përdorim të përkohshëm në rend shterues (nga a në c):

a) jepen për përdorim të përkohshëm brenda njësisë publike (nga qendra në njësi shpenzuese dhe anasjelltas).

b) jepen për përdorim të përkohshëm pa pagesë në njësi të tjera të qeverisjes së përgjithshme. Nuk i nënshtrohen kësaj kërkesë njësitë e sektorit publik sipas nenit 3, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.10 296, datë 8.10.2010;

c) jepen me qira në njësi jashtë sektorit të qeverisjes së përgjithshme¹⁶ sipas kuadrit ligjor në fuqi.

108. Aktivet afatgjata që konsiderohen të panevojshme për njësinë në një periudhë të mëvonshme të funksionimit të saj (në rast mbylljeje/shkrirjeje të njësisë, ndryshimi të misionit apo objektivave afatgjatë të njësisë), por që mbeten në gjendje përdorimi mund të jepen në rend shterues (nga a në b):

a) transferohen pa pagesë në njësi tjetër publike brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit;

¹⁶ Sektori i qeverisjes së përgjithshme përfshin njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale sipas përkufizimit të nenit 4/4,5,6,7 të ligjit nr.10 296 për MFK.

b) shiten në formën e ankandit publik.

109. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

Procesverbali për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve

110. Hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tri kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme

111. Makineritë dhe pajisjet nxirren nga përdorimi me miratimin e:

a) Titullarit të njësisë publike për aktive të tilla si: Sisteme dhe rregullime të tokave; prita mbrojtëse e të ngjashme; mure rrethuese; terrene sportive; rrugë, rrjete (përfshi rrjetin kompjuterik) dhe vepra ujore, mjete transporti; sisteme të teknologjisë dhe informacionit me shtrirje kombëtare, instalime teknike e pajisje me vlerë materiale dhe rëndësi të konsiderueshme për realizimin e objektivave të njësisë publike; aktive afatgjata jomateriale si studime dhe kërkime.

b) Për aktivet e përmendura në paragrafin e mësipërm, në përdorim të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror ose ku shteti ka paketën kontrolluese, titullari i njësisë publike, në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohet kreu i njësisë publike qendrore ose vendore që zotëron apo kontrollon shoqërinë në fjalë. Miratim paraprak kërkohet nga këshillat mbikëqyrëse të shoqërive tregtare.

112. Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune, nxirren jashtë përdorimit me miratimin e:

a) Nëpunësit autorizues të njësisë publike për një emërtesë të caktuar nga titullari i njësisë publike;

b) Nëpunësit autorizues të njësisë së vartësisë, që sipas shkallës hierarkike raporton direkt te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për pajisje dhe instrumente të tjera.

113. Inventar specifik sensitiv ose me vlerë të konsiderueshme dhe ndërtime të përkohshme nxirren jashtë përdorimit me miratim të nëpunësit autorizues të njësisë publike sipas përcaktimeve të titullarit të njësisë.

114. Aktivet afatshkurtra si inventari i imët, ambalazhet, materialet dhe mallrat nxirren jashtë përdorimit me miratimin e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të nëpunësit autorizues të njësisë publike.

115. Aktivet ushtarake dhe policore në magazinë ose në përdorim të ushtrisë, policisë, shërbimit informativ shqiptar (SHISH) dhe Gardës së Republikës, për të cilat janë caktuar afate përdorimi, nxirren jashtë përdorimit sipas përcaktimit që bën Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHISH, sipas përkatësisë.

116. Procedurat specifike për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve biologjike, si dhe kriteret specifike për nxjerrjen nga përdorimi të tyre përcaktohen nga ministri përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin.

117. Procedurat specifike për menaxhimin dhe ruajtjen e rrugëve, rrjeteve dhe veprave ujore, si dhe kriteret shtese specifike për nxjerrjen nga përdorimi të tyre përcaktohen nga ministri përgjegjës për punët publike dhe transportin.

118. Nxjerrja nga përdorimi i aktiveve financiare në formën e pjesëmarrjes në kapital, aktiveve afatgjata jomateriale, si: koncesione, patenta, licenca, rezervat shtetërore, terrenet dhe aktivet natyrore bëhet sipas dispozitave të veçanta ligjore në fuqi.

118.1 Nxjerrja nga përdorimi i ndërtesave ekonomike dhe administrative do të bëhet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në pikën 103 të udhëzimit. Për çdo objekt do të përgatitet një formular sipas modelit të caktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur.

118.2 Në bazë të procesverbalit të vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit, titullari i njësisë publike miraton nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës, duke i trajtuar sipas rendit shtrues më poshtë:

a) Në rastet kur objekti do të transferohet nga njësitë e qeverisjes qendrore në njësitë e qeverisjes vendore do të zbatohen procedurat që parashikon ligji nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) Transferimi i objektit brenda njësive të qeverisjes së përgjithshme ose dhe në njësitë e tjera publike duhet të bëhet mbi bazën e një marrëveshje dypalëshe, ndërmjet njësive që e dhuron dhe njësive përfituese, duke marrë dhe miratimin e Këshillit të Ministrave;

c) Nëse objekti është përcaktuar për t'u shitur do të zbatohen kriteret që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes";

d) Për rastet kur objekti do të shkatërrohet miratimi bëhet nga titullari i njësisë publike. Në çdo rast objekti që do të shkatërrohet duhet të ketë dokumentacionin përkatës, i cili duhet të përmbajë të paktën:

i) zgjidhjet teknike që lidhen me mënyrën e heqjes nga ndërtesa të objekteve të ndryshme të përfshira në të, mënyrën e ndarjes së ndërtesës nga pajisje të ndryshme elektrike ose infra-struktura të tjera, masat e sigurisë, masat e menaxhimit të mbeturinave, riciklimin ose asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara nga heqja e ndërtesës në përputhje me rregullat përkatëse për këto procese;

ii) planzbulimi në lidhje me ndërhyrjet në zonë pas heqjes së ndërtesës ose pjesëve të saj, menaxhimin e mbeturinave, heqjen dhe asgjësimin e materialeve të ndërtimit;

iii) shpenzimet e planifikuara që nevojiten për të realizuar shkatërrimin dhe proceset e tjera që lidhen me të deri në pastrimin e mjedisit;

iv) siguri ose dëshmi të tjera inxhinierike, që pas largimit të mbetjeve nuk do të ketë ndikime në stabilitetin e strukturës së tokës ose objekteve të tjera për rreth, të cilat mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve ose mjedisin.

119. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të kriterëve të mësipërme, caktojnë rregulla të hollësishme për nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve, duke treguar edhe kufirin monetar ose rastet kur nxjerrja jashtë përdorimit duhet të provohet me analiza laboratorike.

120. Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjeve nga përdorimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të informojnë këshillat e njësive vendore.

V. Të tjera

121. Ngarkohen të gjitha njësitë publike me zbatimin e këtij udhëzimi dhe hartimin e gjurmëve specifike të auditit të nevojshme për menaxhimin e aktiveve që disponojnë.

122. Gjurmët Standarde të Auditit paraqiten bashkëlidhur dhe janë pjesë e këtij udhëzimi:

a) Gjurma për menaxhimin e aktiveve sipas përgjegjësi;

b) Gjurma për inventarizimin fizik të aktiveve;

c) Gjurma për marrjen në dorëzim të aktiveve;

d) Gjurma për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve.

123. Ministria e Financave krijon regjistrin kombëtar të aktiveve afatgjata të njësive të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet Sistemit të Thesarit.

124. Format i raporteve financiare për nevoja të përdorimit nga institucione të treta jashtë njësive se sektorit publik, përcaktohen me akte të veçanta.

125. Shfuqizohen vendimi i Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.425, datë 27.10.1987, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.445, datë 25.12.1990, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 "Për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare dhe materiale".¹⁷

126. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

¹⁷ Ligji nr.6942, datë 25.12.1984 është shfuqizuar me nenin 34 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 për MFK.

ANEKS NR. 1
FORMULAR PËR NXJERRJEN NGA PËRDORIMI TË NDËRTESAVE
(Shtuar me udhëzimin nr. 11, datë 6.5.2016)

Përshkrimi i aktivitetit	
Data e hyrjes në përdorim	
Vlera fillestare	
Shpenzimet kapitale të kryera	
Vlera e akumuluar e amortizimit	
Vlera e aktivitetit në kontabilitet	
Data e vlerësimit të nxjerrjes nga përdorimi	
Personi/institucioni përgjegjës për administrim	
Arsyet e nxjerrjes nga përdorimi	
Vlerësimi i ekspertit të fushës	
Metoda që propozohet për daljen nga përdorimi	

Nëpunësi zbatues/personi përgjegjës për financën

Data ____.

Nëpunësi autorizues/drejtuesi i njësisë publike

Data ____.

LIGJ
Nr. 48/2014

**PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET KONTRAKTORE
E TREGTARE¹⁸**

(Ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.3.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

¹⁸ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, "Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare"; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

(Shtuar shkronja "d" me ligjin nr. 24, datë 19.3.2015)

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat:

- a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit;
- b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët;
- c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt;
- ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit;
- d) që rrjedhin nga shitja, blerja dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa përfshirë pagesat që kryhen në tregun e parregulluar, sipas përcaktimeve të rregullave të tregut të energjisë elektrike.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Veprimi juridik tregtar" është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare, nga njëra anë, dhe autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në livrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpaguese.

2. "Autoritet publik" është çdo autoritet kontraktues shtetëror, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, ku përfshihen njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

3. "Sipërmarrje tregtare" është çdo person juridik, i krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me përjashtim të një autoriteti publik, i cili vepron në kuadër të veprimtarisë së tij të pavarur ekonomike a profesionale.

4. "Pagesë me vonesë" është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e sipërmarrjes tregtare dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

5. "Pagesë me vonesë e thesarit" është pagesa që nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, por kur ka gjendje me mungesë likuiditeti në llogarinë e unifikuar të thesarit pas datës së regjistrimit në sistemin informatik financiar të qeverisë.

6. "Sistem i thesarit", ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

7. "Kamatëvonesë ligjore për pagesën me vonesë" është kamatëvonesa e parashikuar nga ligji për pagesën me vonesë, me normë interesi të barabartë me shumën e normës bazë të interesit për lekun ose normës bazë të interesit për zonën euro, apo normës bazë të interesit në monedhë të huaj dhe, të paktën, tetë pikë përqindjeje dhe që llogaritet sipas nenit 5 të këtij ligji.

8. "Marrëveshje riblerjeje (REPO)" është marrëveshja, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet titujt, duke marrë përsipër t'i blejë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

9. "Marrëveshje e anasjellë riblerjeje (REPO të anasjella)" është marrëveshja, me anën e së cilës Banka e Shqipërisë blen titujt, duke marrë përsipër t'i shesë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

10. “Norma bazë e interesit për lekun” është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

11. “Norma bazë e interesit për zonën euro” është norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

12. “Norma bazë e interesit në monedhë të huaj” është norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara nga organet kompetente të bankave qendrore, e cila emeton monedhën në të cilën është bërë pagesa.

13. “Shuma për t’u paguar” është principi që duhej të ishte paguar brenda afatit ligjor ose kontraktor të pagesës, duke përfshirë tatimet, taksat, tarifatat a detyrimet e zbatueshme, të përcaktuara në faturë ose në kërkesën e njëvlershme për pagesë.

14. “Urdhër ekzekutiv” është urdhri për vënien në ekzekutim të titujve të ekzekutimit, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 4

Veprimet juridike ndërmjet sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike

Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t’i dërguar njofim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur:

a) kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin;

b) kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t’u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjësi për vonesën nuk është debitori.

Neni 5

Llogaritja e kamatëvonesës

1. Norma bazë e interesit për lekun, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

2. Norma bazë e interesit për monedhën euro, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

3. Norma bazë e interesit për monedhat e tjera, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është sipas llogaritjes në lekë të normës së interesit, duke marrë si kurs të llogaritjes në lekë të detyrimit, kursin e ditës që kërkohet pagesa e kamatëvonesës ligjore.

Neni 6

Afati

Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit

Civil. Kreditorit, të cilit debitori nuk i ka kundërshtuar furnizimin me mallra apo shërbime, i lind e drejta për të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga dita e nesërme pas datës së afatit të pagesës, të përcaktuar në kontratë.

Në ato raste kur debitori ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;

b) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;

c) kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimit të mallrave ose shërbimeve, 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve;

ç) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Afati i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike.

Afatet kontraktore për kryerjen e pagesave nuk mund të jenë më të gjata se 60 ditë nga data e parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni. Në ato raste kur me kontratë apo në marrëveshje me palët është caktuar një afat tjetër, ky afat konsiderohet i vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur dëmton dhe vë në pozitë diskriminuese kreditorin.

Neni 7

Afati për autoritetet publike

Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe:

a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës;

b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit;

c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme;

ii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;

iii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimit të mallrave ose shërbimeve;

iv) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën, dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Në ato raste kur ndërmjet kreditorit dhe debitorit ka një datë të përcaktuar për dorëzimin e faturës, afatet për pagimin e kamatëvonesave fillojnë të llogariten që nga e nesërmeja e datës së përcaktuar në marrëveshje.

Afati i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur në kontratë apo marrëveshje është rënë dakord për një afat tjetër.

Në ato raste kur autoriteti publik ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Afati i parashikuar në paragrafin e parë, të këtij neni, i jep të drejtë kreditorit të kërkojë të marrë kamatëvonesë pas 60 ditëve kalendarike gjithsej, duke përfshirë 30 ditët kalendarike të vonesës nga thesari, në shtesë nga 30 ditët e vonesës së pagesës për shkak të autoritetit publik.

Neni 8

Zgjatja e afateve për autoritet publike

Afatet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.

Neni 9

Pagesat me këste

Për pagesat të cilat, sipas marrëveshjes së palëve, është parashikuar që të kryhen në periudha kohore të ndryshme, nëse ndonjëri prej kësteve nuk paguhet brenda datës për të cilën është rënë dakord, kamatëvonesa dhe dëmshpërblimi i parashikuar në këtë ligj llogariten në bazë të vlerave për kestin, të cilit i ka kaluar afati i kryerjes së pagesës.

Neni 10

Afatet e marrjes në dorëzim të mallrave

Në ato raste kur, nga kontrata ose marrëveshja e palëve, është parashikuar që mallrat do të merren sipas një procedure dorëzimi apo në rastet kur duhet të bëhet kolaudimi i tyre, afati i marrjes në dorëzim apo i kolaudit të mallrave nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike. Ky afat fillon të llogaritet nga e nesërmja e mbërritjes së mallit në destinacionin e përcaktuar nga blerësi.

Nëse në kontratën apo marrëveshjen e palëve është përcaktuar një afat tjetër, i ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ky afat do të quhet i vlefshëm, me kusht që, nisur nga natyra e mallit apo nga praktika tregtare, të mos jetë në dëm të interesave të kreditorit dhe të mos e vërë këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Neni 11

Shpërblimi i shpenzimeve për rikthimin e kredisë

Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën.

Shpenzimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni llogariten si kosto shtesë ndaj shumës që ka lindur për shkak të pagesës së vonuar dhe përfshijnë çdo shpenzim të provuar të kreditorit, që ai ka kryer kundrejt avokatëve, shpenzime të tjera ligjore të kryera për të bërë të

mundur arkëtimin e pagesës, si dhe çdo shpenzim të paguar prej tij për të vënë në ekzekutim pagimin e shumës së detyrimit.

Neni 12

Pagimi i shpenzimeve

Në rastin e pagesës së vonuar, debitori ka detyrimin për të paguar në favor të kreditorit, përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, edhe një dëmshpërblim në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Kjo shumë është e pagueshme menjëherë, pa qenë nevoja e kryerjes së ndonjë njoftimi nga kreditori për pagimin e saj.

Neni 13

Kushtet kontraktore

Çdo marrëveshje që përjashton palët nga detyrimi për pagimin e kamatave, në rastet e pagesës së vonuar, është e pavlefshme.

Janë të padrejta dhe nuk krijojnë efekte juridike ato kushte kontraktore në lidhje me kushtet, afatet apo norma të tjera për llogaritjen e kamatëvonesave, si dhe për mospagimin e shpenzimeve për rikthimin e kredisë, sipas përcaktimeve të nenit 11 të këtij ligji, për aq kohë sa ato sjellin një dëmtrim të shpërpjesëtuar të interesave të kreditorit dhe e vendosin këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Për konstatimin e një kushti të padrejtë, sipas paragrafit të mësipërm, i cili përkeqëson gjendjen e kreditorit, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë:

- a) çdo shmangie thelbësore nga praktika e mirë tregtare, e cila bie ndesh me parimet e mirëbesimit dhe paanësisë;
- b) natyrën e mallit apo të shërbimit, me të cilin është furnizuar debitori;
- c) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shtyrjen e afateve të kontratës, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji; ose
- ç) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shmangien në kryerjen e pagesës së parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 14

Pasojat e pavlefshmërisë së kushteve kontraktore

Në rast se një kusht kontraktor është i pavlefshëm, sipas nenit 13 të këtij ligji, kreditori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për dëmin e ardhur nga zbatimi i këtyre kushteve.

Nëse palët i kanë paguar njëra-tjetrës pagesa të llogaritura tej normave të përcaktuara në këtë ligj, pala e cila ka kryer pagesën, ka të drejtën e ngritjes së padisë së begatimit pa shkak, si dhe të kërimit të shpërblimit për dëmin e ardhur.

Neni 15

Detyrimet e sipërmarrjeve tregtare para hyrjes në fuqi të ligjit

Parashikimet e këtij ligji nuk do të zbatohen për detyrimet monetare që kanë të bëjnë me furnizimet e kryera për mallra dhe shërbime ndërmjet sipërmarrjeve tregtare të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që nuk janë përmbushur ende dhe që për to nuk kanë filluar procedurat për vënien në ekzekutim të tyre.

Për detyrimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, për të cilat ka një vendim gjyqate, kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e kamatëvonesave dhe pagesave të tjera që lidhen me rikuperimin e pagesës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16
Titulli ekzekutiv

1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 17
Detyrimet e autoriteteve publike para hyrjes në fuqi të ligjit

Për detyrimet e autoriteteve publike kundrejt ndërmarrjeve tregtare, të lindura dhe të paekzekutuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohen parashikimet e këtij ligji. Nuk mund të kërkohet zbatimi i parashikimeve të këtij ligji në rastet e ekzekutimit të detyrimeve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga ana e autoriteteve publike dhe të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.4.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8568, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 131/2015

PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin e funksionimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2
Krijimi dhe statusi i QKB-së

1. Krijohet Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”).
2. QKB-ja është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë (në vijim “ministri”) dhe e ka selinë në Tiranë.
3. QKB-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

Neni 3
Funksionet

1. QKB-ja ka këto funksione:
 - a) mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit;
 - b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;
 - c) kryen regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës;
 - ç) lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, sipas përcaktimit të ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;
 - d) publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;
 - dh) trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
 - e) mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
 - ë) siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
 - f) informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;
 - g) jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve;
 - gj) kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla ministrin, Këshillin e Ministrave apo institucionet qendrore dhe të pavarura, në lidhje me nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve, si dhe asiston në përgatitjen e politikave për përmirësimin e mjedisit rregullator në këto fusha.
2. Procedurat për ushtrimin funksioneve të QKB-së, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit dhe në ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet.
3. QKB-ja ka pavarësi të plotë në vendimmarrjen për çështje konkrete në realizimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 4
Organizimi dhe sportelet e shërbimit të QKB-së

1. QKB-ja ka juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është institucioni i vetëm që ofron shërbim ndaj publikut, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. QKB-ja ushtron funksionet e saj drejtpërdrejt për publikun, nëpërmjet sportelit të saj qendror dhe nëpërmjet sporteleve të shërbimit në territor.
3. QKB-ja ofron shërbim në territor, nëpërmjet sporteleve të shërbimit pranë njërive të qeverisjes vendore, si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për organizimin dhe

funksionimin e qeverisjes vendore. QKB-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e qeverisjes vendore, ku përcaktohen kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit.

4. QKB-ja ofron shërbim në territor edhe nëpërmjet sporteleve të shërbimit, të hapura në bashkëpunim dhe pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të tregtisë rregulluar sipas legjislacionit përkatës. Hapja e këtyre sporteleve bëhet në marrëveshje me këto organizata, të cilave u delegohen funksionet e sportelit të QKR-së, në përputhje me kushtet e këtij ligji dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit.

5. Numri dhe vendndodhja e sporteleve të shërbimit pranë njërive të qeverisjes vendore apo organizatave të tjera, të përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, miratohen nga ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, në bazë të planifikimit të nevojës për hapjen e sporteleve të shërbimit në territor dhe ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportele.

6. Në rast se njësia përkatëse e qeverisjes vendore apo organizata, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, sipas këtij neni, nuk ofron shërbimin e sportelit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji apo me parashikimet e marrëveshjes së lidhur me QKB-në, titullari i QKB-së ka të drejtë t'i propozojë ministrit mbylljen e sportelit përkatës.

7. Në rastet e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, QKB-ja, në bazë të vlerësimit paraprak të nevojës së hapjes së sporteleve në territor dhe të ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportelin përkatës, mund të zëvendësojë sportelin e mbyllur, duke hapur një sportel shërbimi, në kuadër të strukturës së saj, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij ligji.

8. Të gjitha sportelet e shërbimit në territor lidhen *on-line* me sistemin qendror të QKB-së.

9. QKB-ja mund të kryejë funksionet e saj sipas këtij ligji edhe nëpërmjet hapjes së një sporteli elektronik për kryerjen e procedurave përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe të ligjit që rregullon licencat, lejet dhe autorizimet.

Neni 5

Drejtimi i QKB-së

1. Veprimtaria e QKB-së drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së ushtron udhëheqjen metodologjike për zbatimin e procedurave që ndiqen sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe ligjit që rregullon licencat, autorizimet e lejet dhe nxjerr, për këtë qëllim, urdhra e udhëzime të detyrueshme për nëpunësit e QKB-së dhe për të gjitha sportelet e shërbimit.

Neni 6

Organizimi i brendshëm

Organizimi i brendshëm i QKB-së miratohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Nëpunësit dhe punonjësit administrativë të QKB-së

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të QKB-së, përfshirë nëpunësit e sportelit qendror të shërbimit dhe të sporteleve të shërbimit, të krijuara sipas pikës 7, të nenit 4, të këtij ligji, rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të QKB-së rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 8

Nëpunësit që ushtrojnë funksione të deleguara

1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë nëpunës civilë të njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji, janë punonjës të organizatës përkatëse, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

3. Me qëllim njësimit të shërbimit që i ofrohet publikut në të gjitha sportelet e shërbimit në territor, nëpunësit e sporteleve të shërbimit duhet të plotësojnë të njëjtat kritere të posaçme profesionale që zbatohen për nëpunësit e sportelit qendror të QKB-së. QKB-ja siguron për nëpunësit e sporteleve të shërbimit të njëjtin trajnim që zbatohet për nëpunësit e sportelit qendror të kësaj qendre.

Neni 9

Pagat

1. Struktura dhe nivelet e pagave dhe të shpërblimit të QKB-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve apo punonjësve të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 8, të këtij ligji, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, nga njësitet e qeverisjes vendore apo subjektet e tjera, me të cilat QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 10

Buxheti i QKB-së

1. Buxheti i QKB-së është pjesë përbërëse e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Buxheti i QKB-së përbëhet nga të ardhurat që realizohen, sipas këtij ligji, nga të gjitha sportelet e shërbimit dhe nga të gjitha shpenzimet e kësaj qendre, përfshirë fondet për shpenzime operative dhe kapitale për sportelet e shërbimit, që krijohen sipas pikave 3, 7 dhe 9, të nenit 4, të këtij ligji. Fondet për funksionimin e QKB-së janë fonde buxhetore.

3. Fondet për shpenzime korrente për çdo sportel shërbimi të krijuar sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë fonde të kushtëzuara dhe përcaktohen në buxhetin e QKB-së, në bazë të rregullave të planifikimit e të zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

4. Shpenzimet për hapjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sporteleve të shërbimit, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji, me përjashtim të fondeve për kryerjen e trajnimeve për punonjësit e sportelit, që përballohen nga QKB-ja, mbulohen nga subjektet përkatëse dhe nuk janë pjesë e buxhetit të QKB-së.

5. Njësia e qeverisjes vendore apo subjekti tjetër, me të cilin QKB-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi, në përputhje me objektivat e vet, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve në sportelin përkatës.

Neni 11

Shërbimet e tarifit

1. QKB-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera shtesë, në mbështetje të këtyre funksioneve.

2. Ministri përcakton shërbimet e tjera shtesë, që ofrohen nga QKB -ja, tarifat e të cilave miratohen, me propozimin e tij, nga Ministri i Financave.
3. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet, që lidhen me kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.
4. Të gjitha tarifat shpallen në çdo sportel shërbimi dhe në faqen e internetit të QKB-së.

Neni 12

Përdorimi i të ardhurave

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për kryerjen e funksioneve, sipas nenit 3, të këtij ligji, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e shërbimit, derdhen në Buxhetin e Shtetit.
2. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e tjera shtesë, të krijuara nga QKB-ja nëpërmjet sportelit qendror apo nëpërmjet sporteleve të shërbimit, sipas pikave 4, 5, 7 apo 9, të nenit 4, të këtij ligji, derdhen vetëm në masën 10 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 90 për qind përdoret nga QKB-ja për përmirësimin e funksionimit të shërbimeve. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe Ministrit të Financave.

Neni 13

Raportimi dhe mbikëqyrja

1. Ministri miraton objektivat specifike të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen QKB-ja dhe mbikëqyr arritjen e tyre.
2. QKB-ja i raporton ministrit për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit.
3. Ushtrimi i mbikëqyrjes nga ministri, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk shtrihet mbi vendimmarrjen për çështje konkrete në ushtrimin e funksioneve të QKB-së, të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 14

Statuti i QKB- së

1. Statuti i QKB-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
2. Statuti përmban rregulla të detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të QKB-së.

KREU II

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 15

Inventarizimi

Brenda një afati prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, titullari i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe titullari i Qendrës Kombëtare të Licencimit inventarizojnë gjendjen e aktiveve dhe pasiveve të institucioneve përkatëse, numrin dhe vendndodhjen e sporteleve të shërbimit, kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, që këto institucione kanë me palë të treta, formularët e aplikimit, formatet e certifikatave dhe dokumentet e tjera që përdoren për kryerjen e procedurave të regjistrimit të biznesit e të licencimit, autorizimit e lejimit, sipas ligjeve përkatëse, dhe ia vënë këto në dispozicion ministrit.

Neni 16
Aktet nënligjore

1. Ministri, brenda një afati prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, cakton titullarin e QKB-së, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

2. Brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, me propozimin e ministrit:

a) Këshilli i Ministrave miraton statutin e QKB-së, sipas nenit 14, të këtij ligji;

b) Kryeministri miraton strukturën dhe organikën e QKB-së, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së dhe brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, numrin dhe vendndodhjen e sporteve të QKB-së, në përputhje me parashikimet e pikave 4 dhe 5, të nenit 4, të këtij ligji.

4. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së dhe brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, formatin e formularëve, certifikatave dhe të dokumenteve të tjera procedurale për kryerjen nga QKB-ja të funksioneve të regjistrimit të biznesit dhe të licencimit e të lejit, në përputhje me parashikimet e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Ndryshime në legjislacion

1. Në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i ligjit nga “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ndryshohet në “Për regjistrimin e biznesit”;

b) Neni 1, “Objekti i ligjit”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon mënyrën e administrimit të regjistrit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit.”.

c) Kreu II, “Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”, që përfshin nenet nga 3 deri në 17, shfuqizohet në tërësinë e tij;

ç) Kudo, në ligj, emërtimi “Qendra Kombëtare e Regjistrimit” dhe shkurtimi “QKR” ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe “QKB”.

2. Në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Në nenin 2, pika 1, shkronja “d” shfuqizohet.

b) Në nenin 3, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) “Ministria” është ministria përgjegjëse për tregtinë.”.

c) Në nenin 3, pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) “Ministër” është ministri përgjegjës për tregtinë.”.

ç) Kreu VI, “Krijimi, organizimi dhe funksionimi i QKL-së”, i cili përfshin nenet nga 37 deri në 51, shfuqizohet në tërësinë e tij.

d) Kudo, në ligj, emërtimi “Qendra Kombëtare e Licencimit” dhe shkurtimi “QKL” ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe “QKB”.

3. Në çdo ligj tjetër apo akt nënligjor në fuqi, emërtimi “Qendra Kombëtare e Regjistrimit” apo shkurtimi “QKR”, si dhe emërtimi “Qendra Kombëtare e Licencimit” apo shkurtimi “QKL” ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe “QKB”.

4. Në çdo ligj tjetër apo akt nënligjor në fuqi, referencat në një dispozitë të ligjit nr. 9723, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ndryshohen si referenca në dispozitën korresponduese të ligjit “Për regjistrimin e biznesit”.

Neni 18

Fillimi i funksionimit të QKB-së

1. Qendra Kombëtare e Biznesit fillon ushtrimin e funksioneve të saj në datën e hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji:

a) Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit shpërbëhen dhe të gjitha aktivet e pasivet e këtyre institucioneve, në atë datë, i transferohen automatikisht QKB-së;

b) QKB-ja trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit;

c) të gjitha sportelet e shërbimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit, që përfshihen në sportelet e miratuara sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 16, të këtij ligji, i transferohen QKB-së, ndërsa sportelet e tjera mbyllen;

ç) të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi, të lidhura nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit me palë të treta i transferohen QKB-së;

d) buxhetet e miratuara për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrën Kombëtare e Licencimit, sipas ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, do të bashkohen, duke përbërë buxhetin e miratuar të QKB-së.

Neni 19

Procedurat në proces

Procedurat, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, dhe ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, të cilat, në datën e shpërbërjes së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit, sipas këtij ligji, nuk kanë përfunduar ende, do të vijojnë të kryhen nga QKB-ja, pa pasur asnjë detyrim shtesë në ngarkim të subjekteve përkatëse që kanë aplikuar për këto procedura.

Neni 20

Vlefshmëria e dokumenteve

Dokumentet e lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe përkatësisht ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet, përpara datës së hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji, mbeten të vlefshme për çdo qëllim ligjor dhe subjektet që janë pajisur me to nuk detyrohen të kryejnë asnjë veprim shtesë.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj, me përjashtim të nenit 17, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Neni 17 i këtij ligji hyn në fuqi 90 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1 të këtij neni.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9339, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr. 883, datë 21.12.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË
VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TRANSPORTIT KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR DETAR PËR AUTOMJETE
DHE/OSE UDHËTARË DHE SHKAQET E PROCEDURAT E PEZULLIMIT APO
REVOKIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” neni 401, pika “b” i ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10137, datë 11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet”, ligjit nr. 131/2015, datë 26.11.2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe lehtësimin e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet nga operatorët në fushat e transportit detar:

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim përcakton parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve, që persona fizikë/juridikë kërkojnë të ushtrojnë në fushën e transportit detar dhe parimet për procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre dhe është i detyrueshëm të zbatohet prej tyre.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen termat e unifikuara me termat e përdorura në legjislacionin kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar në fushën e transportit detar.

1. Administrata Detare: është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë.
2. Agjent Detar: është çdo person juridik/fizik i cili ka fituar një status të tillë pas regjistrimit në institucionet përkatëse dhe vepron si përfaqësues i pronarit ose operatorit të një mjeti lundrues në një port në lidhje me marrëdhëniet që pronari i mjetit lundrues krijon me autoritetet shtetërore dhe ato të shërbimeve në port.
3. Anije turistike: është një mjet lundrues në një transport ndërkombëtar ose kombëtar që transporton udhëtarë që marrin pjesë në një grup të programuar dhe i vendosur në bord, për qëllimet e bërjes së një vizite turistike të përkohshme të programuar në një ose disa porte të ndryshme, dhe që gjatë udhëtimit nuk mund të:
 - a) Imbarkojë ose disimbarkojë ndonjë udhëtar tjetër;
 - b) Ngarkojnë ose shkarkojnë çdo ngarkesë.

4. Drejtoria e Përgjithshme Detare: është autoriteti që drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar me ligj nga Republika e Shqipërisë.

5. E drejta e zhvillimit të veprimtarisë në transportin detar: është e drejta që fiton një pronar ose operator mjeti lundrues për të kryer transport detar.

6. Licencë për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit detar: është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë dhe të ushtrojë veprimtarinë në transportin detar mbi bazën e procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Ministri: ministri përgjegjës për transportin detar.

8. Ministria: ministria përgjegjëse për transportin detar.

9. Mjet Lundrues: është ai mjet lundrues i certifikuar nga shoqëritë klasifikuese përkatëse dhe është i aftë për të kryer një shërbim në transportin detar.

10. Operim në linjë të rregullt për transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë: është veprimtaria që ushtrohet për transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ ose udhëtarë me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, nga një port i hapur i Republikës së Shqipërisë drejt një porti të huaj.

11. Operim në linjë të rregullt për transport kombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë: është veprimtaria që ushtrohet për transport kombëtar detar për automjete dhe/ ose udhëtarë me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, brenda porteve të hapura të Republikës së Shqipërisë, ose kalatave apo vendbazime të miratuara.

12. Operim për transport turistik kombëtar detar dhe liqenor: është veprimtaria që ushtrohet për transport turistik kombëtar detar dhe liqenor për udhëtarët në ujërat e brendshme dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë.

13. Persona juridikë/fizikë në fushën e transportit detar: janë persona të regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me objekt veprimtarie sipas aktiviteteve në fushën e transportit detar.

14. Pronar mjeti lundrues: është çdo person juridik/fizik që ka në pronësi ose me kontratë qiraje një ose më shumë mjete lundruese të llojeve të ndryshme.

15. QKB: Qendra Kombëtare e Biznesit.

16. Kontrolli Shtetëror i Flamurit (KSHF): është strukturë në përbërje të administratës detare dhe ushtron veprimtarinë për inspektimin e certifikimin e sigurisë teknike të mjeteve lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar.

17. Kontrolli Shtetëror Portual (KSHP): është një strukturë e veçantë që funksionon në kapitenerinë e porteve për kontrollin shtetëror portual e mjeteve lundruese që mbajnë flamur të huaj.

KREU II VEPRIMTARIA QË LICENCOHET DHE AUTORITETI KOMPETENT PËR LËSHIMIN E TYRE

Neni 3 **Veprimtaria që licencohen**

Veprimtaria në fushën e transportit detar që është subjekt licencimi nga QKB-ja bën pjesë në kategorinë VII.4 “Transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë”, sipas nënkategorive si më poshtë:

a) “Transport kombëtar detar i mallrave dhe i njerëzve”, me kodin VII.4.1.

b) “Transport ndërkombëtar detar i mallrave dhe i njerëzve”, me kodin VII.4.2.

Neni 4

Autoriteti kompetent për licencimin

Licencimi i veprimtarive parashikuar në nenin 3, të këtij udhëzimi trajtohen nëpërmjet QKB-së, sipas grupit të tretë parashikuar në nenin 16, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU III

PROCEDURAT E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE LËSHIMIT TË LICENCEVE

Neni 5

Të përgjithshme

Kërkesat dhe dokumentacioni i personave juridikë/fizikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit detar parashikuar nga neni 3, dorëzohen në QKB.

Dokumentet quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data kur personi juridik/fizik ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës në QKB, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi

Në përfundim të procesit të licencimit, personi juridik/fizik pajiset me titullin e licencës dhe aktin e miratimit përkatës.

Formati i licencës për veprimtarinë në transportin ndërkombëtar dhe kombëtar detar të udhëtarëve dhe/ose automjeteve nga persona juridikë, miratohet në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Licencës i bashkëlidhet orari dhe itinerari i linjës dhe çmimet e biletave përfshirë taksat.

Tarifat e licencimit janë të njëjta me tarifat e përcaktuara në VKM-në nr. 1035, datë 9.7.2008, “Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të transportit.

Licenca hyn në fuqi me miratimin dhe publikimin në Regjistrin Kombëtar të Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve.

Neni 6

Dorëzimi i dokumentacionit pranë QKB-së

Procedurat për dorëzimin e dokumentacionit nga subjektet, pranimin, shqyrtimin dhe licencim nga QKB-ja parashikohen në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10137, datë 11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet”, ligjit nr. 131/2015, datë 26.11.2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Dokumentet për marrjen e licenceve paraqiten 30 ditë para afatit të përfundimit të vlefshmërisë së tyre.

Dokumentacioni paraqitet në origjinal ose kopje e njehsuar dhe pas verifikimit (skanimit) të gjitha dokumentet i dorëzohen (kthehen) personit fizik/juridik ose personit të autorizuar që paraqet kërkesën.

Ministria, pas shqyrtimit, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti brenda një afati 20 (njëzet) ditë pune.

Për nevoja teknike, para mbarimit të këtij afati, ministria shpall në regjistrin aplikativ shtyrje afati. Shtyrja e pashpallur në regjistrin aplikativ është e pavlefshme. Shtyrja e afatit bëhet vetëm për shkaqe objektive të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesës. Vendimi i shtyrjes sqaron domosdoshmëri

edhe shkaqet që e kanë diktuar atë. Shtyrja mund, përdoret vetëm njëherë dhe shtyrja shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit.

Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara më sipër, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i ministrisë.

Menjëherë pas marrjes së licencës, subjekti duhet ta dorëzojë atë në zyrat e Kapitenerisë së portit ku do të operojë.

KREU IV KËRKESA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORT KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE UDHËTARË

Neni 7

Licencimi i personave juridikë

Kanë të drejtë të operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare dhe kombëtare detare për transport automjetesh dhe/ose udhëtarësh, persona juridikë shqiptarë apo të huaj të cilët për marrjen e licencës duhet të paraqesin pranë QKB-së dokumentet e mëposhtme:

- a) Formulari i autodeklarimit sipas standardit të miratuar;
- b) Formulari i regjistrimit në QKB;
- c) Dokument ligjor ku vërtetohet pronësia mbi mjetin/mjetet lundrues, dokument/kontratë që vërteton charterimin e mjetit lundrues për operim (në format e parashikuara nga Kodi Detar). Këto dokumente duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara;
- d) Format i konformitetit të dokumenteve të plotësuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare pas kontrollit të dokumentacionit të mjetit lundrues parashikuar nga neni 8;
- e) Vërtetim për regjistrimin në Dhomën e Detarisë ose të Tregtisë, në shtetin përkatës ku është regjistruar personi juridik, në emër të të cilit lëshohet licenca (përkthyer dhe noterizuar);
- f) Kontrata ndërmjet pronarit (ose operuesit) me agjencinë detare në portin që prek. Në rastet kur kjo kontratë nuk është në gjuhën shqipe atëherë ajo dorëzohet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar;
- g) Deklaratën me tarifën maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive përfshirë dhe taksat;
- h) Vërtetimi nga Drejtoria e Përgjithshme Detare që mjeti lundrues objekt licencimi i plotëson kriteret teknike për të kryer shërbimin e transportit.

Neni 8

Formular i konformitetit

1. Para dorëzimit të dokumentacionit pranë autoritetit të licencimi, subjekti që do licencohet dorëzon pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dokumentacionin e mjetit lundrues si më poshtë:

- Dëshmia e pronësisë (për anijet me flamur shqiptar);
- Dëshmia e flamurit (për anijet me flamur shqiptar);
- Certifikata e regjistrimit (për anijet me flamur të huaj);
- Certifikata e klasit;
- Certifikatat e sigurisë për anijet pasagjere;
- Certifikata ndërkombëtare e tonazhit;
- Certifikata e vijës së ngarkesës;
- Certifikatat sipas MARPOL-it;
- Certifikatat e ISM-së (DoC, dhe SMC);
- Certifikata e ISPS-së;
- Polica e sigurimit të lëshuar nga një shoqëri P&I.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit, Drejtoria e Përgjithshme Detare plotëson një formular konformiteti, formati i të cilit parashikohet nga aneksi i këtij udhëzimi. Formulari i dërgohet zyrtarisht aplikantit për ta paraqitur së bashku me dokumentet e tjerë për marrjen e licencës pranë QKB-së.

Neni 9

Vërtetimi për kushtet teknike të anijes

Para dorëzimit të dokumentacionit për marrjen e licencës, subjekti detar që kërkon të licencohet i drejtohet me një kërkesë me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme Detare për kryerjen e një inspektimi teknik të anijes duke parashikuar periudhën kur anija do të prekë portin / terminalin portual.

Inspektimi do të kryhet nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit për anijet me flamur shqiptar dhe nga Kontrolli Shtetëror Portual për anijet me flamur të huaj.

Inspektimi do të kryhet në rastin e parë që anija prek portin/terminalin portual dhe do të zgjasë jo më shumë se pesë ditë pa ndërprerë operimin e mjetit lundrues.

Pas përfundimit të inspektimit, Drejtoria e Përgjithshme Detare do t'i lëshojë subjektit një vërtetim nëse mjeti lundrues objekt licencimi i plotëson ose jo, kriteret teknike për të kryer shërbimin e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe/ose automjeteve dhe do të dërgojë në ministri, raportin e inspektimit duke përcaktuar masat e dhëna.

Neni 10

Kontrata me Portin/terminalin portual

Pas licencimit, subjekti i licencuar do të lidhë një kontratë me portin/terminalin portual. Kjo kontratë duhet të përmbajë të paktën këto kriterë:

1. Garancia bankare që kompania vë në dispozicion të portit si garanci për përmbushjen e detyrimeve të kontratës. Kjo garanci do të jetë jo më pak se 10.000 euro për çdo anije që do të ushtrojë aktivitetin në port.

2. Sanksionet në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në kontratë.

3. Oraret e operimit të mjetit/mjeteve lundrues/lundruese të miratuara.

4. Listën me tarifatat maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive përfshirë taksat të cilat duhet të jenë të shpallura edhe në faqen e internetit të kompanisë.

5. Depozitimin e detajuar të të gjitha kostove reale për shërbimin që ofrojnë.

6. Mbajtjen nga ana e operatorëve të të dhënave ditore për tarifatat e aplikuara për çdo biletë të shitur si edhe mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave për një periudhë të paktën 3-vjeçare (trevjeçare). Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në çdo kohë nga institucionet mbikëqyrëse.

7. Deklarimin e operatorëve për respektimin e orareve në nisje/mbërritje nga/në portet nga mjeti/mjetet lundrues/lundruese objekt licencimi, si dhe të përgjegjësive monetare ndaj udhëtarëve/transportuesve për vonesa të pajustificuara nga autoritetet shtetërore, si; policia kufitare dhe migracionit, shërbimi doganor dhe kapiteneria e portit.

Porti/Autoriteti portual në periudha 4-mujore (katërmujore) do të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të aplikuara nga operatorët krahasuar me tarifatat maksimale parashikuar në pikën 4 të këtij neni, dhe do të njoftojë Ministrinë.

Neni 11

Prekjet e anijes në port

1. Subjektet detare do të operojnë në linjat ndërkombëtare detare me destinacion transportin e udhëtarëve dhe/ose automjeteve sipas kontratës me portin/terminalin portual.

2. Gjatë hartimit të grafikut nga porti / terminali portual duhet të mbahen parasysh që prekjet të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët dhe në mënyrë proporcionale gjatë gjithë muajit. Grafiku dhe çdo ndryshim i tij është pjesë përbërëse e dokumentacionit për miratimin e licencës së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar të mallrave dhe të njerëzve dhe që miratohet nga kapiteneria e portit përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Operatorët të cilët operojnë në linjë ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse, sipas grafikut të miratuar për linjë, çdo ditë të javës, duhet ta prekin atë port minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) herë në muaj. Ndërsa operatorët të cilët operojnë në linjat ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse, sipas grafikut të miratuar për linjë, 5 (pesë) herë në javë e më pak, duhet ta prekin atë port minimalisht 4 (katër) herë në muaj. Mospërmblidhja e këtij detyrimi nga operatori sjell si pasojë revokimin e licencës në zbatim të kapitullit VI të këtij udhëzimi.

4. Në rastet kur operatori i licencuar kërkon të kryejë riparim të anijes, duhet të jetë i pajisur me një leje të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Neni 12

Afatet e licencimit

1. Licencat për veprimtarinë e parashikuar në nenin 3, jepen me vit kalendarik (1 janar – 31 dhjetor) me afat njëvjeçar.

a) Përjashtim nga viti kalendarik bëhet për linjat e reja detare ose për ato linja ku licencat e dhëna janë anuluar dhe nuk operon më asnjë subjekt, ose për interesa të veçanta shtetërore.

b) Përjashtim mund të bëhet edhe për rastet kur subjektet operuese në një linjë nuk përballojnë kërkesat e udhëtarëve dhe transportuesve në atë port detar. Me kërkesë të argumentuar të portit detar, autoriteti licencues merr vendim për licencim ose jo të subjekteve të reja në këtë linjë pasi ato kanë ndjekur procedurat ligjore.

c) Në të dyja rastet përjashtimore të mësipërme, afati i përfundimit të licencës është muaji dhjetor i vitit kalendarik.

Neni 13

Zëvendësimi, shtesa ose prekjet shtesë të mjetit lundrues në një linjë të miratuar

1. Në rastet e zëvendësimit të mjeteve lundruese nga mjete të tjera, shtimit të tyre dhe/ose prekjeve shtesë në të njëjtën linjë, subjekti duhet të marrë miratimin nga kapiteneria e portit përkatës, të lidhë kontratë me Portin ose terminalin portual që prek në zbatim të nenit 10, më pas, në zbatim të nenit 8 të këtij udhëzimi dokumentet e mjetit lundrues dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe në zbatim të nenit 9 të këtij udhëzimi, i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare kryerja e inspektimit. Për këto ndryshime Drejtoria e Përgjithshme Detare njofton Ministrinë.

2. Nuk lejohet zëvendësimi i mjeteve lundrues katamaran me tragete dhe anasjelltas.

Neni 14

Transporti detar turistik

1. Transport detar turistik me mjet lundrues quhet ai transport, jo në linjë të rregullt, që kryhet me një numër të caktuar udhëtarësh dhe ku nuk lejohet zbarkimi i përhershëm dhe imbarkimi i udhëtarëve turistikë jashtë listës së deklaruar.

2. Ky transport do të kryhet vetëm në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë dhe do të kryhet kundrejt pagesës së të gjitha taksave portuale, njoftimit standard sipas Konventës FAL, deklarimit të listës së mbyllur për udhëtarët-pasagjerë, dokumentacionit të mjetit lundrues pa penguar përpunimin e mjeteve lundruese të licencuara për transport kombëtar dhe ndërkombëtar të pasagjerëve dhe/ose mjeteve në linja të rregullta.

3. Mjetet detare për transport detar turistik do t'i nënshtrohen një inspektimi të detajuar nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, përpara fillimit të sezonit turistik dhe në fund të inspektimit do të pajisen me certifikatën e konformitetit.

4. Mjetet e përfshira në licencim për kryerjen e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtar, nuk mund të kryejnë udhëtime turistike pa zbatuar grafikun e miratuar, ose pa u zëvendësuar me mjet tjetër.

KREU V
PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCEVE

Neni 15
Pezullimi

1. Licencat për veprimtarinë në fushat e transportit detar pezullohen, kur:
 - a) nuk e fillojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të tyre;
 - b) ndërpret veprimtarinë për më shumë se 30 ditë pa lajmëruar portin detar;
 - c) nuk zbatojnë parashikimet e nenit 11 të këtij udhëzimi;
 - d) subjekti nuk përmbush më kriteret për të cilat i është dhënë titulli (licencës);
 - e) nuk respekton detyrimet kontraktuale me portin.
2. Konstatimi i mospërmbushjes së kriterëve dhe mos respektimi i detyrimeve kontraktuale bëhet nga porti detar/terminali portual me të cilët subjekti ka lidhur kontratën ose kapiteneria e portit që menaxhon lundrimin detar.
3. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit, porti detar/terminali portual ose kapiteneria e portit përkatës, njofton zyrtarisht subjektin për përmbushjen e kriterëve apo detyrimet kontraktuale, brenda një afati jo më shumë se 30 ditë.
4. Në rastet kur operatori nuk i përmbush kriteret brenda afatit të lënë, kapiteneria e portit merr vendimin për pezullimin e aktivitetit të subjektit.
5. Kur vendoset pezullimi i aktivitetit të subjektit, kapiteneria e portit lajmëron menjëherë zyrtarisht Ministrinë, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar arsyet që e kanë çuar për të dhënë urdhrin e pezullimit.
6. Vendimi për pezullimin e licencës, revokohet ose lihet në fuqi nga Ministria, sipas legjislacionit në fuqi pas kërkesës zyrtare nga i interesuari (operatori ose organi kompetent), kur verifikohet dhe vlerësohet se subjekti i ka plotësuar ose jo të gjitha detyrimet, sipas rastit ose kur vërehet se urdhri i pezullimit nuk ka qenë në proporcion me shkeljen.

Neni 16
Revokimi

1. Licencat revokohen nga ministria, pas propozimit nga porti detar/terminali portual që ka lidhur kontratën ose nga kapiteneria e portit, në rastet si më poshtë:
 - a) Kur licenca nuk tërhiqet në një afat brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.
 - b) Kur personat juridikë/fizikë falsifikojnë ose bëjnë ndryshime të paligjshme në licencën e veprimtarisë së miratuar. Në këtë rast, ndaj tyre ndiqen dhe procedura të parashikuara sipas ligjit.
 - c) Kur vërtetohet se personat juridikë/fizikë kanë paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës për të cilën kanë aplikuar.
 - d) Me kërkesë nga porti/terminali portual për mos zbatim të grafikut të miratuar, kushteve të kontratës së lidhur edhe pas njoftimeve dhe afateve të lëna.
 - e) Me kërkesë nga Kapiteneria e Portit, për mos zbatimin në mënyrë të përsëritur të rregullave dhe urdhrave të Kapitenerisë.
 - f) Në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga subjekti dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik.
2. Nëse licenca revokohet si rezultat i një nga shkeljet e mësipërme të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, personat juridikë/fizikë nuk pajisen me licencë veprimtarie për një periudhë nga 1 (një) deri 3 (tre) vjet.

Dispozita tranzitore dhe të fundit

1. Udhëzimi i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, i ndryshuar shfuqizohet.

2. Licencat e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, i ndryshuar, do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

3. Aplikimet e para në QKB para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, trajtohet sipas kushteve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Damian Gjilknuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. prot. _____

Durrës, ____/____/____

Lënda: Përcillet formulari i konformitetit për mjetin lundrues _____

Zonjës/zotit _____

Për dijeni: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Tiranë

Mbështetur në udhëzimin nr. ____, datë ____/____/____, Drejtoria e Përgjithshme Detare pas kontrollit të dokumentacionit teknik të mjetit lundrues _____ paraqitur nga subjekti _____, rezulton se:

DOKUMENTET E MJETIT LUNDRUES	PARAQITUR	MANGËT	SHËNIME
Dëshmia e flamurit			
Dëshmia e pronësisë			
Certifikata e regjistrimit			
Certifikata e klasit			
Certifikatat e sigurisë për an. pasagjerë			
Certifikata ndërkombëtare e tonazhit			

Certifikata e vijës së ngarkesës			
Certifikatat sipas MARPOL-it			
Certifikatat e ISM-së (DoC dhe SMC)			
Certifikata e ISPS-së			
Polica e sigurimit të anijes (P&I)			

Për sa më sipër konfirmojmë që dokumentacioni i paraqitur nga subjekti _____ për mjetin lundrues “_____”, _____ janë në përputhje me kërkesat e udhëzimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhje legjislacioni për teknologjinë e informacionit
dhe komunikimin elektronik / Qendra e Botimeve Zyrtare.

- Tiranë : QBZ, 2020

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-114-5

1.Teknologjia e informacionit 2.Komunikimi 3.Ligje 4.Shqipëri

004(496.5) (094.5)

654(496.5) (094.5)

Tirazhi 50